

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 92-të i botimit
SHKURT-MARS 2024 / Nr. 2



**FA, KONTRIBUTORE E PAQES
DHE SIGURISË EUROATANTIKE**

DREJTOR I QKMBMFA

ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktore

ANJEZA MUSOLLARI

GAZETARË:

MIMOZA GOLIKJA

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI

GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

KOLONEL MYSLIM PASHA

KAPITEN (P) VERI TALUSHILLARI

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitim, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut

Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimel/revista-mbrojtja>



Mbrojtja

- Ministri Peleshi: Baza Ajrore Taktike e NATO-s, aset për të gjithë rajonin 4
- Presidenti Begaj: Shqipëria, rol kontributor për paqen dhe sigurinë euroatlantike në rajon 6
- Ministri Peleshi: Do të punojmë me besnikëri për fqinjësinë e mirë, stabilitetin politik dhe sigurinë në rajon 7
- Shqipëria përbushi kërkesën për 2%, ministri Peleshi: Përkrah sfidave të sigurisë së Aleancës 8
- Ministri Peleshi: Po punohet për ringjalljen e industrisë së prodhimit të armëve në Shqipëri 10
- Stërvitja "Mbrojtja e Qëndrueshme 2024", Ministri Peleshi: Të gatshëm në konsolidimin e dimensionit operacional dhe taktik 12
- Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi inspekton punimet në Kampusin e ri të AFA-së 14
- Gjeneralmajor Arben Kingji inspektoi stërvitjen "Reagim i Menjëhershëm - 24" 16
- Siguria, paqja, barazia gjinore në FA, prioritet i liderit politik dhe atij ushtarak 17
- Vizitë e komandantit të Qendrës së Kombinuar të Operacioneve Ajrore Torrejón, Spanjë, në Komandën e Forcës Ajrore 18
- Forcat Detare realizuan trajnim me Distriktin Detar Verior dhe Qendrën Stërvitore Detare 19
- SFAB përfundon trajnimin e efektivëve të FT-së, si Vrojtues të Përparuar dhe për Drejtim Zjarri të mortajave 21
- Forcat Speciale / ROS, përfunduan me sukses stërvitjen trajnuese "JCET 24-1" 22
- Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në një vizitë kortezie të ngarkuarin me punë në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, David Wisner 23
- Starton Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-14) 26
- Përfundoi Kursi i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Municioneve 28
- Ilir Lame: Respekti i njerëzve është çmimi dhe lumturia ime më e madhe 30
- Atdheu përjetë mirënjohës, veprës tuaj 34
- Nuredin Gorçe, heroi i pavdekësisë së "Komandove" shqiptare 35
- Një letër nga SHBA 37
- Drejt 80-vjetorit 'Skënderbegas' 40
- "Spiunazhi turistik", instrumenti më i ri i luftës hibride ruse 42
- Stërvitjet NATO/SHBA, përtej kakofonisë bolshevike 46
- Maro Kondi, portreti i labes së rrallë 48
- Lamtumira për pedagogun ushtarak Avni Hajro në tokën e bekuar 50
- Gjergj Klimi, pedagogu skënderbegas i 'balistikës së predhave' 52
- Flamuri suedez ngrihet në selinë e Aleancës: Askush nuk mund ta mbyllë derën e NATO-s 54
- Nënna që lindën diktatorë 58
- Brezat e pakohë të shekullit XXI 60
- 'Kush bie për atdhe, nuk vdes por ka le' 62
- Ata ishin katër... 65
- Arsimitarët, martirë që gjakun ia falën lirisë së gjuhës shqipe 66
- "Skënderbegas, tokë, qiell, det, syri i shqipes që vigjilon" 68
- Sistemi gjeodezik i standardeve të NATO-s, realitet krenarie 70
- EOD, 25 vite histori krenarie, guximi, trimërie 72
- Heraldika 73
- Gratë shqiptare që i dhanë emër historisë 76
- Simbolet e LANÇ-it, evidentim i vlerave historike të popullit shqiptar 78
- Nga Shkodra në Çamëri 80
- Tragjedia e Fekenit, Dëshmi e sakrificës sublime 82
- 'Bac u kry', Kosova e lirë nën hisen e diellit të vet 86
- Gjuha Amtare, identifikim, vlerë, histori kombëtare 90
- WINSTON CHURCHILL: Unë nuk kam asgjë tjetër për të ofruar, veç mund, djersë, gjak e lot 92

17

**Siguria, paqja,
barazia gjinore
në FA, prioritet i
liderit politik dhe
atij ushtarak**

04

Ministri Peleshi: Baza Ajrore Taktike e NATO-s, aset për të gjithë rajonin

08

Shqipëria përmbushi kërkesën për 2%, Ministri Peleshi: Përkrah sfidave të sigurisë së Aleancës

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi prej dy ditësh ndodhej i pranishëm në Ministerialin e NATO-s në Bruksel. Në ditën e dytë të punimeve të tij, ministri Peleshi iu përgjigj disa pyetjeve të mediave, mbi sfidat e sigurisë së aleancës. Fillimisht ministri Peleshi komentoi deklaratën...

10

Ministri Peleshi: Po punohet për ringjalljen e industrisë së prodhimit të armëve në Shqipëri

Takimi i Nivelit të Lartë "Ukrainë - Europa Juglindore" u mbajt në Tiranë, me pjesëmarrjen e Presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky. Samiti ishte një shprehje e mbështetjes për Ukrainën, që prej dy vitesh po përballet me agresionin e paprovokuar. Kjo është vizita e parë e Zelenskyt në Shqipëri, ndërkohë që kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama udhëtoi drejt Kievit në qershor të vitit 2022, disa muaj pas nisjes së luftës në Ukrainë, ku vizitoi zonat e bombarduara të Borodyanka dhe Irpin. Samiti u zhvillua si një takim solidariteti...



Presidenti Begaj: Shqipëria, rol kontributor për paqen dhe sigurinë euroatlantike në rajon

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji, zhvilluan një vizitë në Komandën Strategjike të NATO-s për Operacionet, ku pati një takim...

Faqe 6



"Spiunazhi turistik", instrumenti më i ri i luftës hibride ruse

Në një studim nga Universiteti i Portsmouth në Angli, lidhur me tendencat e inteligjencës për vitet 2024-2030 dhe në vazhdim, është zbuluar se "spiunazhi turistik", është një fenomen në përhapje si në terrenin real ashtu edhe atë online. Operacionet klandestine ruse në Europën Juglindore...

Faqe 42





MINISTRI PELESHI:

Baza Ajrore Taktike e NATO-s,
aset për të gjithë rajonin



Baza Ajrore Taktike e NATO-s në Kuçovë, filloi funksionimin e saj. Data 4 mars mbledhi në ceremoninë e rastit drejtuesit më të lartë të shtetit: presidentin Bajram Begaj, kryeministrin Edi Rama, kryetaren e Kuvendit Lindita Nikolla, ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi, shefin e SHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, përfaqësues të lartë të NATO-s, ministra të vendeve anëtare të Aleancës, ministrin e Mbrojtjes së Kosovës, Ejup Maqedonci, ambasadorë, ushtarakë dhe ish-ushtarakë. Në fjalën e tij me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi tha se Baza e Kuçovës është një prej investimeve më madhore të NATO-s në Shqipëri, që do të shërbejë si bazë ajrore taktike dhe operacionale. Z. Peleshi theksoi se baza ka kapacitetin e nevojshëm edhe për të mbështetur përpjekjet e përbashkëta në rajon për fatkeqësitë natyrore: “Pozicioni gjeografik i favorshëm mund ta kthejë këtë vend në një nyje lidhëse të vlefshme për të gjithë vendet e rajonit tonë. Në këtë kontekst, ndihma dhe mbështetja që Shqipëria mund të japë për vendet fqinje na bën të ndihemi më të vlefshëm se kurrë më parë, por edhe më të përkushtuar se kurrë më parë për të qenë në lartësinë e duhur përballë çdo situatë”, - tha ministri Peleshi.

Ndër të tjera ministri i Mbrojtjes kërkoi mbështetjen e vendeve aleate në përpjekjet e Shqipërisë për ta vendosur në përdorim të NATO-s edhe përdorimin ushtarak të Porto Romanos: “Në këtë logjikë baza që inaugurojmë sot është një aset për të gjithë rajonin. Shqipëria do të vijojë përpjekjet e saj për të vendosur në përdorim të NATO-s edhe përdorimin ushtarak të Porto Romanos, që së bashku me Korridorin strategjik VIII, i siguron Aleancës sonë aksin më të shkurtër të kalimit nga brigjet e

Baza e Kuçovës është një prej investimeve më madhore të NATO-s në Shqipëri, që do të shërbejë si bazë ajrore taktike dhe operacionale.

Adriatikut në Detin e Zi. Shpresoj të kemi mbështetjen e vendeve aleate dhe mike në këtë projekt madhor”, - tha ministri i Mbrojtjes.

Presidenti Bajram Begaj u shpreh se rijetësimi i kësaj baze shënon një kapitull të ri në historinë e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit tonë e të gjithë rajonit: “Ne së bashku dërgojmë mesazhin e fuqishëm të paqes dhe dëshmojmë se NATO është e vendosur të mbrojë lirinë dhe sigurinë e aleatëve, duke garantuar mbrojtje kolektive”, - u shpreh komandanti i Përgjithshëm i FA-së.

Kryeministri Edi Rama deklaroi se Baza e re Ajrore e NATO-s në Kuçovë i jep vendit tonë një rëndësi të re gjeostrategjike. Kryeministri shprehu vlerësim për të gjithë ata që kontribuuan në hapjen e bazës: “Dua t’i shpreh një falënderim të posaçëm të gjithë atyre që kontribuuan, duke filluar, sigurisht nga aleatët tanë të NATO-s me shpresën dhe besimin që kjo Bazë e re Taktike Ajrore e NATO-s do të shoqërohet në vitet në vijim nga Baza e re Detare e NATO-s në Porto Romano, gjë për të cilën po punojmë ngushtësisht me NATO-n dhe jemi shumë besimplotë se së shpejti do të mund t’i gëzohemi lajmit të përfshirjes së këtij projekti në planet e Aleancës. Riaktivizimi i këtij aeroporti ushtarak është njëkohësisht edhe pjesë e ripërtëritjes dhe rritjes së mëtejshme cilësore të Flotës sonë Ajrore. Një bazë, e

cila sot është tërësisht e transformuar dhe e gatshme si një Bazë e re Taktike e NATO-s, me një rëndësi që i tejkalon kufijtë e Shqipërisë. Një bazë, e cila është një tjetër element sigurie për rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor”, - u shpreh z. Rama.

Kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla e cilësoi si një moment krenarie hapjen e kësaj baze, pasi: “SHBA e NATO kanë krijuar bindjen se, nëse ka një vend anëtar të ri të Aleancës që mbështet qartësisht, vendosmërisht dhe pa asnjë dilemë vendimet e saj, ky vend është Shqipëria”.

Komandanti i NATO-s, gjeneralletënant Juan Pablo Sanchez De Lara deklaroi nga Kuçova se Shqipëria është më shumë se kurrë e gatshme të marrë përgjegjësi për të mbrojtur sigurinë dhe paqen.

Shefi i misionit dhe i ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, David Wisner tha në fjalën e tij se hapja e Bazës së parë Ajrore në Kuçovë përbën një tjetër gur kilometrik në përkushtimin e vazhdueshëm të Shqipërisë ndaj parimeve të NATO-s.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneralmajor Arben Kingji e konsideroi hapjen e Bazës Ajrore të NATO-s në Kuçovë një ngjarje të shënuar për forcat shqiptare dhe vetë Aleancën.

Kjo ceremoni u mbyll me një performancë të avionëve “Euro Fighter F-2000”, “F-16” dhe dy helikopterëve “Black Hawk”.



Presidenti Begaj: Shqipëria, rol kontributor për paqen dhe sigurinë euroatlantike në rajon

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral-major Arben Kingji, zhvilluan një vizitë në Komandën Strategjike të NATO-s për Operacionet, ku pati një takim kokë më kokë me Komandantin Suprem, Gjeneral Cavolin.

Siguria globale, siguria në rajonin e Ballkanit Perëndimor, roli i Shqipërisë si kontributor për paqen, sigurinë dhe orientimin euroatlantik të rajonit, si edhe fuqizimi i kapaciteteve ushtarake të Shqipërisë dhe kontributi i drejtpërdrejtë në NATO, ishin disa nga çështjet ku u fokusuan bisedimet mes palëve.

“Sot situata e sigurisë është përkeqësuar dhe konflikti në Lindjen e Mesme, si dhe agresioni brutal rus kundër Ukrainës, kanë tendencë të përhapen edhe në rajone të tjera. Situata në Ballkanin Perëndimor vijon



të jetë e brishtë, gjë që na rikujton se sa mund të përpjekje duhet, që të mbrohen jo vetëm parimet demokratike, por edhe paqja dhe siguria e vendeve tona”, - u shpreh Presidenti Begaj. Presidenti Begaj e siguroi Gjeneral Cavolin se: “Shqipëria do të jetë gjithmonë aty ku NATO do të ketë nevojë, sikundër e ka dëshmuar me prezencën e saj në misionet

dhe operacionet e NATO-s në Afganistan, KFOR (Kosovë), Letoni, Bullgari dhe Irak. Më tej, Presidenti Begaj vlerësoi në veçanti investimin që NATO bëri në Bazën Ajrore të Kuçovës, duke theksuar se: “Shqipëria ofron dhe mirëpret angazhimin dhe investimin e NATO-s për të shndërruar portin e Porto Romano-s në një bazë detare të saj”.



Ministri Peleshi: Do të punojmë me besnikëri për fqinjësinë e mirë, stabilitetin politik dhe sigurinë në rajon

Në kuadër të takimit të Këshillit Strategjik të Nivelit të Lartë, kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga kabineti qeveritar, vizitoi Turqinë, ku u prit në një ceremoni zyrtare nga Presidenti i Republikës së Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan. Delegacioni shqiptar, pjesë e të cilit ishte dhe Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u mikprit me nderime të larta. Pas ceremonisë së mikpritjes në Presidencën e Republikës së Turqisë, Kryeministri Rama dhe Presidenti turk Erdogan zhvilluan një takim bilateral mes tyre.

Më pas, Kryeministri Rama dhe Presidenti Erdogan drejtuan mbledhjen e bashkëpunimit të nivelit të lartë midis dy vendeve, me pjesëmarrjen edhe të disa prej ministrave të kabineteve qeveritare respektive. Në kuadër të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes Turqisë dhe Shqipërisë u nënshkruan disa marrëveshje dhe memorandumë mirëkuptimi dypalëshe në fushën e mjedisit, mbrojtjes, të medias dhe komunikimit.

Mes Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë dhe asaj të Turqisë u nënshkrua edhe Marrëveshja Kuadër ushtarake ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së



Turqisë. Në Takimin e Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë që u mbajt mes dy vendeve, ministri Peleshi vlerësoi se kjo marrëveshje është shprehje e bashkëpunimit edhe për shumë vite në vazhdim. Ministri Peleshi falënderoi qeverinë turke për mbështetjen e vazhdueshme në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare me pajisje të rëndësishme si dronët “Bayraktar”, mjete ushtarake si dhe për trajnimin e personelit tonë ushtarak. Më tej, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ftoi autoritetet turke të marrin pjesë në ceremoninë

e inaugurimit të Bazës Ajrore të Kuçovës, më 4 mars.

Teksa shprehu synimin e FA-së shqiptare për të shtuar prezencën në misionet jashtë vendit, ministri Peleshi tha se trupat shqiptare do të jenë nën komandën e atyre turke në misionin ALTHEA në Bosnjë - Hercegovinë.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se Shqipëria do të punojë në mënyrë konstruktive dhe me besnikëri për të promovuar fqinjësinë e mirë, stabilitetin politik, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në rajon.



Shqipëria përmbushi kërkesën për 2%, Ministri Peleshi: Përkrah sfidave të sigurisë së Aleancës

"Pikat e nxehta të Ballkanit Perëndimor janë Veriu i Kosovës dhe politikat separatiste të Republika Srpska. Një kërcënim vjen nga Serbia dhe tjetri nga Republika Srpska".

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi prej dy ditësh ndodhej i pranishëm në Ministerialin e NATO-s në Bruksel. Në ditën e dytë të punimeve të tij, ministri Peleshi iu përgjigj disa pyetjeve të mediave, mbi sfidat e sigurisë së aleancës. Fillimisht ministri Peleshi komentoi deklaratën kërcënuese ndaj aleancës së ish-Presidentit amerikan, Donald Trump, i cili tha se do t'i kërkojë Rusisë të sulmojë vendet e NATO-s, që nuk përmbushin detyrimet financiare. Sipas ministrit, Shqipëria është në listën e 2/3 të anëtarëve

të NATO-s që ka përmbushur angazhimin me vendosjen e 2% të GDP-së në funksion të sigurisë dhe mbrojtjes. Në korrik, pjesa më e madhe e aleatëve do të sigurohet që të ketë plotësuar këtë kusht, duke qenë se 2% është kthyer në një dysheme, nisur edhe nga sfidat aktuale në fushën e sigurisë. Pyetjes se: "A ka shqetësim mes vendeve të NATO-s, edhe me bisedat që ju keni ndarë me homologët tuaj për një skenar të largimit të Amerikës nga NATO, meqenëse po diskutohet shumë, sidomos pas deklaratës së ish-Presidentit Trump?",

ministri Peleshi iu përgjigj se: “Ka pasur një unitet nga të gjithë aleatët, i palëkundur. Nuk ka lëvizje nga linja zyrtare e çdo aleati në NATO. E kundërta është e vërtetë. Këtu flitet për mobilitet ushtarak të shtuar. Në këtë pikë dua të theksoj një takim që sapo përmbyllëm me ministrat e Mbrojtjes të Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, ku diskutuam për hapat e mëtejshme drejt lobiut për “Korridorin 8”. Korridori 8 është një korridor tashmë edhe sigurie, jo vetëm konektiviteti. Ne e lidhim me projektin që kemi dorëzuar në NATO për portin ushtarak të Porto Romanos. Po shtojmë përpjekjet për të investuar një mobilitet më të mirë në krahun lindor. Krahu lindor është krahu më i kërcënuar i NATO-s. Ky korridor përfundon në Detin e Zi, që është pika ku grumbullohet tensioni më i madh pas agresionit rus në Ukrainë. Nuk ka lëvizje nga qëndrimet, përkundrazi ka bashkëpunim për nivel më të lartë të mbrojtjes kolektive”. “Duket sikur lufta Rusi-Ukrainë, por edhe lufta në Rripin e Gazës e ka futur botën në një rend të ri, aq sa ne po armatosemi. Të paktën po pajisemi me mjete moderne. Raketa “Javelin”, helikopterë “Black Hawk”, dronë “Bayraktar”. Për çfarë po përgatitemi, zoti Ministër, dhe a pritët të marrim edhe armatime të tjera më të renda. Nëse po, çfarë konkretisht?”, ishte një tjetër pyetje në adresë të ministrit Peleshi, i cili përgjigjet: “NATO është një aleancë jo ofensive por difensive. Por gjithsesi mbrojtja, politika difensive e NATO-s realizohet përmes shkurajimit, ajo që quhet deterenca. Çka do të thotë modernizimi dhe shtimi i kapaciteteve ushtarake të gjitha vendeve të NATO-s synon të shkurajojë fuqitë e tjera destruktive që vijnë nga Lindja, ose konflikte të mundshme, qoftë në rajonin tonë, kryesisht në krahun Lindor të NATO-s mund të ndodhin. Sapo kemi filluar të ndërtojmë flotën e helikopterëve “Black Hawk”. Dy tashmë janë në Shqipëri, po punojmë për të arritur në 6, në afatmesëm. Do të vijnë dronët “Bayraktar” për pak javë. Më 4 mars kemi inaugurimin, ditën e hapjes së bazës ajrore taktike të NATO-s në Shqipëri, në Ballkanin Perëndimor që ndodhet në Kuçovë. Aty do të kemi edhe avionë luftarak nga vendet aleate të NATO-s që do të bëjnë një demonstrim. Le ta quajmë dhe demonstrim force, nuk ka vend për ta fshehur, pasi bota nuk është

më normale dhe nuk dihet kur do të rikthehet në normalitetin që ka qenë dikur. Ne do të përgatitemi për më të keqen, por do të shpresojmë për më të mirën. Jo vetëm do të shpresojmë por do ta shkurajojmë të keqen”.

Për sa i përket pyetjes: “A ka një rrezik real në sigurinë e rajonit tonë?”, ministri Peleshi u shpreh se: “Pikat e nxehta të Ballkanit Perëndimor janë Veriu i Kosovës dhe politikat separatiste të Republika Srpska. Një kërcënim vjen nga Serbia dhe tjetri nga Republika Srpska. Këto janë influenca të Rusisë në rajonin tonë që duhet të dekurajohen. Ne e ndjekim me shqetësim dhe disa vende kanë ngritur në ministerialin e NATO-s çështjen e militarizimit të shpejtë të Serbisë, që nuk bëhet pa një qëllim, të mos jemi naiv. Natyrisht që mbi 1 miliardë

këto janë konfliktet. Ka një garanci shumë të madhe që është prezenca e NATO-s. Kosova ka NATO-n prezente këmbëkryq dhe të gatshme për çdo agresion që mund të vijë nga Veriu. Ne planifikojmë të ngremë sisteme të reja që nuk i kemi pasur më parë. Duke filluar nga ky vit do të implementojmë sistemin e mbrojtjes antidron, jo vetëm për infrastrukturën ushtarake, por edhe civile, porte, aeroporte, hidrocentrale. Dhe po punojmë me SHBA-në për të kompletuar mbrojtjen kundërajrore. Nuk bëhet fjalë për një kërcënim me probabilitet të lartë për Shqipërinë, ne jemi një aleat i NATO-s dhe askush nuk mund të guxojë të prekë 1 metër katror të Shqipërisë. NATO është gati të mbrojë stabilitetin në Ballkanin Perëndimor”.

Ndërsa për rikthimin e shërbimit ushtarak



dollarë buxhet për mbrojtjen dhe porosinë e fundit nga Rusia e Kina, e kapaciteteve ushtarake nga ana e Serbisë shihen me shqetësim dhe duhen shkurajuar përmes fuqizimit të prezencës së NATO-s në rajon. KFOR-i është këmba e NATO-s aty që duhet ta fuqizojmë. Në Bosnjë është misioni i BE-së, “Altea”. Do të dërgojmë së shpejti një togë në Bosnje. Kemi dërguar gjithashtu një togë në Bullgari për të forcuar krahun lindor. Gjithashtu, do të dërgojmë në Rumani një kompani me 100 ushtarë sapo të na hapet dritë jeshile. Pra

të detyrueshëm, ministri u shpreh se është për t’u diskutuar dhe se është hartuar një ligj që do të miratohet shumë shpejt në qeveri dhe parlament për krijimin e forcës rezerviste. “Duke filluar nga vjeshta e këtij viti do të kemi kontingjentin e parë të forcës rezerviste që e mendojmë në Elbasan. Më pas, ky numër do të shkojë deri në 2 mijë apo 2200, maksimumi i parashikuar. Forca rezerviste mbi baza vullnetare, trupa të shtuar për 2 apo 4 javë, aty ku parashikohet, në domene të ndryshme”, - u shpreh ministri Peleshi.



Ministri Peleshi: Po punohet për ringjalljen e industrisë së prodhimit të armëve në Shqipëri

Takimi i Nivelit të Lartë “Ukrainë – Europa Juglindore” u mbajt në Tiranë, me pjesëmarrjen e Presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky.

Samiti ishte një shprehje e mbështetjes për Ukrainën, që prej dy vitesh po përballlet me agresionin e paprovokuar.

Kjo është vizita e parë e Zelenskyt në Shqipëri, ndërkohë që kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama udhëtoi drejt Kievit në qershor të vitit 2022, disa muaj pas nisjes së luftës në Ukrainë, ku vizitoi zonat e bombarduara të Borodyanka dhe Irpin.

Samiti u zhvillua si një takim solidariteti e angazhimi të mëtejshëm të demokracive të vendeve kundër agresionit rus, ku u diskutuan rrugët e bashkëpunimit në ofrimin e mbështetjes për Ukrainën dhe në kontributin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe Evropë.

I pyetur se çfarë fiton Shqipëria në këtë mes, kryeministri Rama tha se: “Mbështetja po bëhet edhe për vendin tonë dhe për mënyrën si e shohim të ardhmen. Ne e kemi mbështetur Ukrainën edhe me paketa mbështetjeje që nuk janë hua dhe nuk janë pjesë e ndonjë biznesi. Kurrë nuk i kemi kërkuar Ukrainës të paguajnë mbrapsht, ndonjë gjë nga ato që kanë marrë prej nesh, modeste. Por jemi të vetëdijshëm se për atë front lufte kjo është diçka shumë e vogël. Po e bëjmë për veten tonë. Ky nuk është një kërcënim ekzistencial vetëm për Ukrainën.

Ky është kërcënim ndaj gjithçkaje që ne mendojmë se duhet të jetë e ardhmja jonë. Nëse duam një të ardhme në BE, nuk duam ta shohim BE-në të shpërbëhet.

Ka pasur shumë sanksione kundër Russisë, por ne e dimë që varësia nga gazi rus, nga nafta ruse, nuk është kaq e thjeshtë kështu që rritja e çmimeve në vendet më të pasura janë pjesë e planit për të bërë publikun të nisë e të thotë “nuk mund të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën”, - u shpreh kryeministri Rama. Nga ana e tij presidenti Zelenski falënderoi Shqipërinë për ndihmën dhe tha se dy vendet duhet të mbështesin njëri-

"Nuk e kishim menduar se do vinte koha e një konflikti konvencional. Dy vite më parë Rusia tronditi gjithë situatën gjeopolitike në botë. Në aspektin ekonomik është një industri që siguron të ardhura, por edhe në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse sidomos në këto kohë ku paqja dhe stabiliteti janë në kërcënim".

tjetrin në rrugën drejt integritit europian. “Dëshiroj t’ju falënderoj juve Edi, popullin tuaj, të gjithë shqiptarët për mbështetjen e sinqertë që ju na keni dhënë ne, popullit tonë dhe mbështetjen që i jepni drejtësisë në Europë. Ju falënderojmë për të gjitha paketat që keni mbështetur. Na duhet më shumë besim të çfarë mund të bëjmë ne. Duhet që ju të keni besim te ne. Ne mbështesim edhe integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, por duhet që edhe ju të na mbështesni ne. Faleminderit për vullnetin tuaj të qartë. Ukraina si edhe i gjithë rajoni i Europës Juglindore, duhet të bashkëpunojmë, të ecim përpara, të na mbështesni edhe në formulën tonë të paqes, planin me një pikë. Lufta është filluar nga një person i vetëm, por punën për paqe do ta bëjmë të gjithë së bashku”, - përfundoi Zelensky.

Për mediat ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, pasi shprehu përkrahjen e institucionit që ai drejton ndaj popullit ukrainas, u shpreh se do të ringrihen uzinat e dikurshme të prodhimit të armëve, se po punohet për ringjalljen e kësaj industrie në vendin tonë. Sipas tij, nga kjo industri Shqipëria do të ketë përfitime ekonomike, por gjithashtu do forcojë dhe kapacitetet e saj mbrojtëse. “Nuk e kishim menduar se do vinte koha

e një konflikti konvencional. Dy vite më parë Rusia tronditi gjithë situatën gjeopolitike në botë. Në aspektin ekonomik është një industri që siguron të ardhura, por edhe në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse sidomos në këto kohë ku paqja dhe stabiliteti janë në kërcënim”.

Ministri i Mbrojtjes shtoi gjithashtu se së shpejti do të kryhet një studim fizibiliteti, ku do të shihen fabrikat e prodhimit të armëve në Gramsh dhe Poliçan, e më pas do të kërkohen investime për të vënë në funksion fabrikat e armatimeve. “Ka disa aktivitete minore prodhimi, edhe ajo e Gramshit dhe Poliçanit është pasive. Ne duam të futemi në industri, dhe po kërkojmë investime. Kemi bërë hapa serioze me MSPA për të hartuar një studim fizibiliteti. Pjesa e madhe e makinerive nuk punon më, gjithashtu gjendja e industrisë ushtarake në vendin tonë dihet dhe se po synohet të ringrihet dhe rigjenerohet në bazë të standardeve të NATO-s”.

Ministri i Mbrojtjes deklaroi se kompanitë e armatimeve nuk do të bëhen vetëm për të furnizuar Ukrainën por do të jetë një industri më e gjerë. Në fund ai iu bëri një thirrje investitorëve përfshirë dhe atyre shqiptarë, që të hedhin sytë nga biznesi i sigurisë dhe mbrojtjes.



Stërvitja “Mbrojtja e Qëndrueshme 2024”, Ministri Peleshi: Të gatshëm në konsolidimin e dimensionit operacional dhe taktik

Përfundon me sukses stërvitja kompaktësuese dimërore e Grup - Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë e koduar “Mbrojtja e Qëndrueshme 2024”. Në ditën e fundit të kësaj stërvitjeje, e cila u zhvillua në rajonin e Pukës, morën pjesë presidenti i Republikës, njëherësh komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, sh.t. z. Bajram Begaj, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji si dhe komandantë të forcave. Në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi përgëzoi efektivet, djemtë dhe vajzat e Grup - Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, e cila është një njësi e certifikuar nga NATO, si forcë e gatshme për dislokim dhe operim në ndërveprim të plotë me Aleancën, si edhe të njësive të tjera që u përfshinë në këtë stërvitje, për përkushtimin dhe vendosmërinë e tyre.

“Mjedisi i sotëm i sigurisë, karakterizohet nga një numër në rritje i kërcënimeve dhe kundërshtarëve të vlerave perëndimore. Agresioni brutal i Rusisë kundër Ukrainës dhe konflikti në Lindjen e Mesme kanë tronditur rendin dhe sigurinë globale, duke sjellë nevojën jo vetëm të një reagimi të përbashkët nga të gjithë vendet e Aleancës, por dhe atë të zhvillimit të kapaciteteve



kritike dhe të forcimit të qëndrueshmërisë kombëtare”, - u shpreh ministri Peleshi, duke evidentuar faktin se fokusi është në atë që po ndodh sot në rajonin tonë, i cili vazhdon të mbetet një rajon i brishtë dhe

me tensione të provokuara që tentojnë destabilizimin e tij.

“Ndaj sot kemi një Strategji të re të Sigurisë Kombëtare, e cila do të pasohet së shpejti nga Strategjia Ushtarake dhe Plani



Afatgjatë i zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ky bazament i fortë strategjik, na jep një shtysë për të konsoliduar dimensionin operacionel dhe taktik, duke vendosur theksin tek transformimi i pandërprerë i forcave dhe i kapaciteteve tona”, - deklaroi z. Peleshi. Sipas ministrit të Mbrojtjes këto kapacitete do të testohen shumë shpejt në funksion të stërvitjes së madhe të NATO “Steadfast Defender 2024”. Ministri i Mbrojtjes u shpreh i kënaqur me faktin se këtë vit përmbushet zotimi për investimet në 2 për qind të PBB-së në kuadër të NATO-s për Sigurinë dhe Mbrojtjen, ndërsa theksoi vi-



jimin e mbështetjes financiare dhe sociale për personelin ushtarak.



Në fjalën e tij, presidenti i Republikës Bajram Begaj u shpreh se: “Shqipëria ka qenë dhe mbetet euroatlantike në frymë dhe në veprim. Si popull historikisht paqedashës, orientimi ynë është paqja dhe siguria, ndaj sot është me rëndësi jo vetëm solidariteti me vlerat e vendeve të tjera anëtare, por edhe forcimi i mëtejshëm i lidhjeve transatlantike”. Nga ana e tij, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, teksa shprehu falënderimet dhe mirënjohjen për mbështetjen ndaj ushtarakëve, u zotua se kjo forcë do të jetë e angazhuar dhe do të punojë me përkushtim, disiplinë dhe profesionalizëm të lartë për realizimin e çdo detyre dhe në përmbushje të detyrimeve ndaj Aleancës.

Stërvitja “Mbrojtja e Qëndrueshme 2024” është pjesë e programit trajnues dhe stërvitor vjetor të Forcës Tokësore për këtë vit dhe zhvillohet në një moment kyç, pasi, prej 1 nëntorit 2023, kjo forcë ka kaluar në strukturën e re organizative, e cila konsiston në një forcë ushtarake më efektive, e kompletuar me personel, e mirë pajisur me armatim dhe teknikë të avancuar, e mirë trajnuar, e stërvitur dhe e motivuar, e gatshme të kryejë misionin kushtetues në mbrojtje të vendit.

Gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në stërvitjen “Mbrojtja e Qëndrueshme - Voskopoja '24”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar (DVD) të stërvitjes “Mbrojtja e Qëndrueshme - Voskopoja '24”. Stërvitja “Mbrojtja e Qëndrueshme - Voskopoja - 24”, u zhvillua në rajonin e Voskopojës, në Korçë, pati si qëllim testimin e aftësive operacionale të nënrepartit të gatishmërisë së Grup-Batalionit të Bashkimit Evropian për dislokim dhe rritjen e aftësive operacionale për kryerjen e detyrave taktike në një operacion luftarak, dhe jo vetëm, të kompanisë së deklaruar NRF për vitin 2024, si dhe të shtabeve të regjimentit dhe batalioneve për të planëzuar dhe për të ndjekur dinamikat operacionale të nënrepartëve të manovrës dhe atyre mbështetëse.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, në fjalën e tij, pasi falënderoi efektivat e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar u shpreh ndër të tjera: “Forcat tona të Armatosura kanë hyrë tashmë në një periudhë intensive aktivitësh stërvitore brenda dhe jashtë vendit, ndër të cilat do të theksoja angazhimin



në stërvitjet ‘Brilliant Jump 24’ dhe ‘Crystal Arrow’ në kuadër të ‘Steadfast Defender 24’, e cila është stërvitja më të madhe që ka zhvilluar Aleanca nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Duke qenë pjesë e Aleancës, është domosdoshmëri që në operacionet, misionet dhe stërvitjet e drejtuara prej saj të jemi të ndërveprueshëm me forcat e



tjera pjesëmarrëse. Për këtë i shërbeu dhe kjo stërvitje ku ju, testuat efektivitetin e planëzimeve, kapaciteteve operacionale të formacioneve tuaja luftarake dhe nivelin real të gatishmërisë...”. Duke u ndalur në konceptin e ri që aleanca po vë në jetë, gjeneralmajor Kingji vuiri theksin në planëzimin dhe realizimin e stërvitjeve të drejtuara nga Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut, duke i kushtuar vëmendje të veçantë reflektimit të këtyre koncepteve të reja për shkurajimin dhe mbrojtjen dhe kriteret për zbatueshmërinë e saj. “Aleanca në të cilën bëjmë pjesë është në proces të vazhdueshëm transformimi, për t’u bërë ballë më mirë ndryshimeve në mjedisin e sigurisë në zonën Euroatlantike dhe kërcënimeve të identifikuara në konceptin strategjik të saj. Element thelbësor në këtë koncept të ri të shkurajimit dhe mbrojtjes është vënia në funksion e modelit të ri të forcës së NATO-s dhe planeve rajonale. Në këtë drejtim, në planëzimin dhe realizimin e stërvitjeve të drejtuara nga regjimenti juaj, vëmendje e veçantë t’i kushtohet reflektimit të këtyre koncepteve të reja për shkurajimin dhe mbrojtjen, dhe kriteret për zbatueshmërinë e saj”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi inspektion punimet në Kampusin e ri të AFA-së

Me iniciativën e Ministrit të Mbrojtjes, Niko Peleshi, dhe përkrahjen e qeverisë shqiptare ka nisur ndërtimi i Kampusit të ri, i projektuar sipas standardeve të akademisë ushtarake “West Point”, në mjediset e të cilit do të studiojnë dhjetëra studentë, ushtarakët e ardhshëm të Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, pasi inspektoi godinën në ndërtim tha: “Kampusi i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura është një nga projektet më të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes. Një kontribut dhe vlerë e shtuar në rritjen e nivelit të arsimit ushtarak në vendin tonë!”.

Më tej ministri Peleshi u shpreh se: “Ky kampus do të sigurojë mjediset dhe infrastrukturën e nevojshme për arsimimin dinjitoz të studentëve tanë për studime të thelluara në fusha të ndryshme të shkencave ushtarake. Ambicia jonë është që



AFA të jetë një Akademi lider në cilësinë e arsimit, duke ndjekur modelin e prestigjiozës “West Point” që njihet për standardet

e larta akademike, trajnimin e shkëlqyer ushtarak dhe përgatitjen e oficerëve të suksesshëm”.



SHSHPFA, Arben Kingji priti në takim komandantin e Qendrës së Kombinuar të Operacioneve Ajrore të NATO-s, gjenerallejtënant Juan Pablo Sanchez de Lara

Komandanti i Qendrës së Kombinuar të Operacioneve Ajrore të NATO-s, gjenerallejtënant Juan Pablo Sanchez De Lara zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë, me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Arben Kingji. Përgjatë kësaj vizite, gjeneralmajor Kingji zhvilloi një takim të veçantë me gjenerallejtënant De Lara. Gjeneral Kingji shprehu falënderimin për pjesëmarrjen e gjenerallejtënant Juan Pablo Sanchez De Lara në ceremoninë e inaugurimit të Bazës Ajrore të Kuçovës dhe për fjalën e mbajtur me këtë rast, si përfaqësuesi më i lartë i NATO-s. Ndër të tjera SHSHPFA Kingji u shpreh: "Gjeneral De Lara, ju falënderoj për ardhjen tuaj këtu në Shqipëri. E vlerësojmë mbështetjen e Qendrës së Kombinuar të Operacioneve Ajrore (CAOC) të NATO-s për Forcën tonë Ajrore. Po punojmë fort për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme infrastrukturore, logjistike dhe njerëzore që ta transformojmë Forcën Ajrore në një ndër njësitë më të rëndësishme në shërbim të detyrimeve kombëtare dhe në kuadër të Aleancës. Ky është një tregues madhor i angazhimit të NATO-s në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke riafirmuar kësaj dhe rëndësinë strategjike të vendit tonë në garantimin e paqes dhe sigurisë". Nga ana e tij, gjeneral De Lara falënderoi gjeneralmajor Kingjin për mikpritjen e ngrohtë dhe miqësore përgjatë ditëve të qëndrimit të tij në vendin tonë. "Gjej rastin të përgëzoj Shqipërinë për shtimin në radhët e saj, të një aseti të rëndësishëm siç është Baza Ajrore e Kuçovës. Përurimi i Bazës së Kuçovës dëshmon



se Aleanca jonë është mjaft e angazhuar në këtë rajon. Shqipëria është e gatshme të marrë përgjegjësi për të mbrojtur sigurinë dhe paqen. Duke punuar në sistemin ajror, ne garantojmë sigurinë dhe ndërtojmë stabilitet që është shumë e rëndësishme për NATO-n". Gjatë takimit u diskutua gjithashtu edhe mbi gjetjen e rrugëve dhe mundësive të reja të bashkëpunimit me CAOC, e fokusuar kryesisht në trajnimin e personelit. Gjeneral De Lara u shpreh së mbështet plotësisht rritjen e kapaciteteve njerëzore të Forcës Ajrore, me anë të mundësimit të trajnimeve dhe stërvitjeve, duke iu përshtatur nevojave të zhvillimeve të reja brenda Forcave të Armatosura Shqiptare, në strukturë dhe modernizim.

Gjeneralmajor Arben Kingji priti në takim përfaqësuesit e Departamentit Amerikan të Shtetit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, zhvilloi një takim me përfaqësues të Zyrës Globale të Reformës së Mbrojtjes të Departamentit Amerikan të Shtetit, në kuadër të reformave dhe ndryshimeve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Synimi i këtij bashkëpunimi është këshillimi dhe asistenca në procesin e rekrutimit të FARSH-së, ku është vendosur posaçërisht një këshilltar amerikan pranë Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR) dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (J-1), të cilët do të ndjekin procesin e ecurisë së reformave dhe ndryshimeve që po bëhen në këtë drejtim, po ashtu dhe për të dhënë ekspertizën dhe këshillimin e tyre për



ritjen e shifrave të rekrutimit në Forcat e Armatosura.

Gjeneralmajor Arben Kingji shprehu mirënjohje dhe falënderim për mbështetjen e gjithanshme të dhënë nga SHBA-të, për rritjen e mëtejshme të kapaciteteve dhe aftësive operacionale dhe profesionale të



FARSH-së, si dhe vlerësoi rolin dhe profesionalizmin e këshilltarëve të tjerë të DASH të atashuar pranë zyrave tona, të cilët deri më tani kanë dhënë ekspertizën më të mirë të mundshme në hartimin e rregulloreve dhe praktikave konform standardeve të NATO-s.

Gjeneralmajor Arben Kingji inspektoi stërvitjen “Reagim i Menjëhershëm - 24”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji inspektoi stërvitjen “Reagim i Menjëhershëm - 24”, e cila u zhvillua nga kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit në kuadër të programit mësimor.

Gjeneralmajor Arben Kingji, pasi ndoqi nga afër prezantimin mbi “Analizën e Misionit”, ku kursantët të vendosur në rolet respektive prezantuan mbi skenarin e dhënë, adresoi një falënderim për stafin drejtues dhe atë pedagogjik, për masat e marra, për drejtimin dhe zhvillimin me sukses të kësaj stërvitjeje. “Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, si institucion i ri në Forcat e Armatosura, është në rrugën e duhur për rritjen e cilësisë së edukimit dhe arsimimit të ushtarakëve dhe civilëve të Forcave të Armatosura, Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe më gjerë, dhe stërvitjet janë element i rëndësishëm i punës sonë, ndaj Kolegji duhet të vijojë me plotësimin e kurrikulës dhe të programeve mësimore me të dhënat më të fundit të zhvillimeve në NATO e më gjerë...”, - u shpreh ndër të tjera SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji.

Kjo stërvitje iu shërben kursantëve për përvetësimin e aftësive mbi zbatimin e koncepteve doktrinale për përdorimin e forcave ushtarake në operacione luftarake si dhe planëzimin, koordinimin dhe bashkëveprimin me aktorët civil brenda zonës së operacionit.



SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti Ministrin e Industrive Strategjike të Ukrainës, z. Oleksandr Kamyshin

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji priti ministrin e Industrive Strategjike të Ukrainës z. Oleksandr Kamyshin. Gjatë takimit u diskutua mbi mbështetjen e plotë politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Ukrainës, si dhe rolin aktiv në arenën ndërkombëtare për dënimin e sulmit rus, si një cenim i paprecedentë ndaj sigurisë dhe paqes në botë. Që nga fillimi i luftës dy vite më parë, dy vendet tona kanë parë nivelin më të lartë të bashkëpunimit, i dëshmuar sot me mbajtjen e samitit për Ukrainën.





Siguria, paqja, barazia gjinore në FA, prioritet i liderit politik dhe atij ushtarak

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ishte e pranishme në aktivitetin “Gratë ushtarake në Forcat e Armatosura”. Tashmë prej vitesh marsi është kthyer në një vëmendje të shtuar për liderin ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm, njëkohësisht përfaqësuese dinjitoze e grave nën uniformën ushtarake, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila mes të tjerash në këtë takim u shpreh se: “Është kënaqësi për mua si zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe si një ushtarake me gradë të lartë, të hap këtë aktivitet shumë të rëndësishëm për rolin e femrave ushtarake në Forcat e Armatosura dhe gjithashtu të mirëpres kolegët tanë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ardhja juaj në Shqipëri përkoji me inaugurimin e aeroportit ushtarak të Kuçovës, ku ishit të pranishëm; një ngjarje mjaft e rëndësishme për vendin tonë, por edhe për Forcat e Armatosura Shqiptare, si një nga vendet anëtare të NATO-s, që ofron mbështetje dhe siguri për aleancën. Mandej dëshiroj të shpreh konsideratën më të lartë për bashkëpunimin e shkëlqyer në të gjitha fushat që Shqipëria ka me aleatin e saj strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por si ushtarake, do të veçoja ato në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Më tej gjeneralmajor Shehu do citonte se: “Qëllimi i këtij aktiviteti të përbashkët në kuadër të Rezolutës 1325 është diskutimi i çështjeve që lidhen me sigurinë, paqen dhe rolin e gruas në Forcat e Armatosura, vlerësimi i përvojës së rekrutimit dhe pjesëmarrjes së grave ushtarake në misionet, mbështetje ligjore dhe udhëzime për këndvështrimin gjinor, si dhe përmirësimin e politikave në lidhje me sfidat e grave në Forcat e Armatosura. Nuk ka gjë më të mirë dhe më të bukur, që në kuadër të 8 Marsit, të jemi bashkë me ekipin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, të diskutojmë dhe të ndajmë përvoja të përbashkëta për rolin e gruas, jo vetëm në aspektin ushtarak, por edhe si gra në përgjithësi, si motra dhe nëna që jemi. Bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit daton disa vite më parë, një bashkëpunim, i cili ka bërë të mundur krijimin e një fryme të shkëlqyer të shkëmbimit të përvojave dhe ideve, pasi gratë



ushtarake, pavarësisht se cilit shtet i përkasin, kanë të përbashkët ndjenjën e përkushtimit, përgjegjësinë dhe sakrificën ndaj vendit të tyre dhe globalisht për paqen dhe sigurinë kudo në botë.

Rezoluta 1325 e Këshillit të Kombeve të Bashkuara për “Gratë, paqen dhe sigurinë” është dokumenti më i rëndësishëm që mbron të gjitha gratë në mbarë botën. Në zbatim të kësaj rezolute, çdo vend ka ligjet, strategjitë dhe dokumentet e veta kombëtare që përcaktojnë qartë rolin që grujat duhet të ketë në shoqëri dhe në Forcat e Armatosura. Në fund të fjalës së saj gjeneralmajor Manushaqe Shehu tha se: “Edhe vendi ynë, Shqipëria, ka një sërë ligjesh, rregullash dhe strategjish që burojnë nga kjo rezolutë dhe mbi këtë bazë, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm kanë hartuar Plane Veprimi afatmesme dhe afatgjata me masa konkrete për mbrojtjen e



grave ushtarake nga diskriminimi, nga ngacmimet e ndryshme dhe dhënien e rolit që meriton në hierarki dhe karrierën ushtarake. Uroj që ky event të jetë sa më i ngrohtë, sa më gjithëpërfshirës dhe sa më frytdhënës, duke marrë përvojat më të mira të ndërsjella në lidhje me çështjet e barazisë gjinore”.

Vizitë e komandantit të Qendrës së Kombinuar të Operacioneve Ajrore Torrejón, Spanjë, në Komandën e Forcës Ajrore

Në vijim të aktiviteteve në kuadër të inaugurimit të Bazës Ajrore Taktike të NATO në Kuçovë, komandanti i Qendrës së Kombinuar të Operacioneve Ajrore Torrejón, Spanjë (CAOC TJ), gjenerallejtënant Juan Pablo Sanchez de Lara, zhvilloi një vizitë pune në Komandën e Forcës Ajrore. Ai u prit në takim nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku.

Gjatë takimit, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore falënderoi komandantin e CAOC TJ, për angazhimin e deritanishëm të kësaj qendre në kontrollin dhe menaxhimin e hapësirës ajrore dhe mundësimin e stërvitjeve në kuadër të patrullimit ajror. Palët diskutuan edhe mbi mundësitë e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet kësaj qendre dhe Forcës Ajrore, kryesisht të fokusuar në trajnimin e personelit të Qendrës së Kontroll Raportimit (QKR) si dhe të personelit ushtarak që menaxhon operacionet ajrore, me qëllim krijimin e një terreni sa më të ndërveprueshëm ndërmjet vendeve të Aleancës.

Më pas, takimi vijoi me një briefing njohës nga komandanti i QKR-së, mbi vep-



rimtarinë, kapacitetet e deritanishme dhe planet për të ardhmen për Qendrën e Kontroll Raportimit.

Komandanti i CAOC TJ, gjenerallejtënant De Lara, vlerësoi maksimalisht profesionalizmin e personelit ushtarak shqiptar të Forcës Ajrore përfaqësues në CAOC TJ, si dhe, ofroi mbështetjen e mëtejshme për rritjen e kapaciteteve operacionale të QKR-së. Aktiviteti u mbyll me një vizitë në ambientet e QKR-së.

Gjeneral brigade Ferdinand Dimo priti në takim ekipin e New Jersey-t, Air National Guard

Në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo priti në takim ekipin e New Jersey-t, Air National Guard, i kryesuar nga kolonel Eric A. Guttormsen, komandanti i Krahut të 108-të (108th Wing). Qëllimi i këtij takimi ishte rritja e bashkëpunimit midis New Jersey-t, Air National Guard dhe Komandës së Forcës Ajrore. Gjatë takimit, gjeneral brigade Dimo falënderoi ekipin amerikan për vizitën, si edhe Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak me SHBA-të (ODC), për mbështetjen e ofruar me trajnime dhe kualifikime për personelin e FAj. Në këtë takim morën pjesë edhe kapiteni i rangut II Eric Cote, Atasheu ushtarak i



Shteteve të Bashkuara në vendin tonë dhe zëvendëssefi i zyrës së ODC. Në përfundim të takimit u shkëmbyen dhuratat simbolike.



Forcat Detare realizuan trajnimin me Distriktin Detar Verior dhe Qendrën Stërvitore Detare

Në Portin Detar Durrës, në kalatën 0, ku janë të dislokuara anijet e Distriktit Detar Verior të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, u zhvillua ceremonia e trajnimit treditor “Lufta Kundra Zjarrit në Anije”, me personelin e Forcës së Sigurisë Portuale dhe Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Në ceremoni mori pjesë komandanti i Distriktit Detar Verior, kapiten i rangut II Dritan Seraj, i cili, pasi i falënderoi të pranishmit në ceremoni, u uroi suksese në trajnimin e organizuar nga efektivi të Distriktit Detar Verior dhe Qendrës Stërvitore Detare, Pashaliman.

Qëllimi i këtij trajnimi është përgatitja dhe aftësimi i personelit në veprimet praktike që duhet të bëhen, analizimin, menaxhimin dhe marrjen e vendimeve për organizimin për fikjen e zjarrit. Personeli merr bazën e njohurive për detyrat bazë që ka si individ dhe ajo që është më e rëndësishme organizimi i veprimeve si grup i ndërhyrjes për fikjen e zjarrit.

Gjatë trajnimit treditor do të zhvillohen tema teorike dhe praktike që përfshijnë aspektet e përgjithshme të luftës kundra zjarrit në anije, llojet e zjarrit, agjentët fikës të zjarrit, metodat dhe mënyrat e fikjes së zjarrit.



Operacion SAR nga efektivi i anijes P - 133 “Lissus”

Anija P - 133 “Lissus”, pjesë e misionit “Sea Guardian” në detin Egje, gjatë lundrimit në zonën e patrullimit, mori njoftim nga Roja Bregdetare greke për një gomone të nisur nga brigjet e Turqisë drejt brigjeve greke. Në gomone ndodheshin 25 emigrantë, mes tyre 3 gra dhe 22 burra. Emigrantët ishin nga Jemeni, Sudani dhe Palestina. Roja Bregdetare turke ka marrë në bord personat që ndodheshin në gomone për të ndjekur procedurat e mëtejshme.





Zhvillohet takimi dypalësh ndërmjet Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare greke

Në Komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, u zhvillua takimi dypalësh (staff talks) ndërmjet Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare greke.

Delegacioni i Forcës Detare greke, i kryesuar nga kapiten i rangut I Spyridon Pollatis, drejtor i Planifikimit dhe Politikave të Mbrojtjes, u prit në takim nga komandanti i FD/RB, kundëradmiral Adnand Agastra. Në takim u diskutuan çështje që lidhen me fushat e bashkëpunimit dhe më konkretisht, pjesëmarrja në stërvitjet e ofruara nga pala greke në kuadër të NATO-s, vijimi i stërvitjeve dypalëshe dhe ato rajonale në kuadër të nismës “Adrion”, ku marrin pjesë të dy shtetet respektivë, si dhe pjesëmarrja e personelit shqiptar në kurset dhe trajnimet që ofrohen nga pala greke në Qendrën e NATO-s për Trajnimin e Operacioneve



të Ndjekjes në Det (NMIOTC) në Kretë, Greqi. Në përfundim u ra dakord që takimet dypalëshe në nivel shtabi (staff talks) të zhvillohen çdo dy vjet.

Anija P-133 “Lissus” zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Gromitz M1064”

Anija P-133 “Lissus” pjesë e misionit të NATO-s, në detin Egje, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Gromitz M1064” në ujërat ndërkombëtare. Gjatë stërvitjes u zhvilluan seri stërvitore sipas standardeve të manualeve të NATO-s. Stërvitja shërben për rritjen e aftësive operacionale të efektivëve të FD-së. Në përfundim të stërvitjes komandanti i Task Forcës, kapiten i rangut I Felix Hornung shprehu falënderimet për zhvillimin me sukses të stërvitjes dhe profesionalizmit të treguar gjatë kohës në mision si dhe u uruan një mision të mbarë në detin Egje Kontingjentit III.



SFAB përfundon trajnimin e efektivëve të FT-së, si Vrojtues të Përparuar dhe për Drejtim Zjarri të mortajave

Në mjediset e Forcës Tokësore u krye ceremonia e certifikimit të efektivit të dy reparteve, atij të Batalionit të Artilerisë në Regjimentin e Mbështetjes me Luftim dhe Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (BKL), të cilët morën pjesë në trajnimin si vrojtues të përparuar dhe drejtimin e zjarrit të mortajave.

Në këtë ceremoni ishte i pranishëm dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral-major Ilir Xhebexhia, i cili në fjalën e tij përshëndetëse, pasi falënderoi ekipin amerikan të SFAB për ndikimin e drejtpërdrejtë të punës së tyre në arritjen e objektivave të BKL/GBKL, theksoi se: "Forca Tokësore në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kombëtare por dhe Paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s, është në një fazë të rëndësishme të modernizimit me armatim, sisteme e pajisje ushtarake, pjesë e së cilës është dhe modernizimi i kapaciteteve të mbështetjes me zjarr të trupave të luftimit dhe rritjes së fuqisë luftarake të zjarrit direkt dhe indirekt, nëpërmjet kompletimit me sisteme të mortajave 120mm të montuara mbi mjete dhe sistemeve të artilerisë vetëlëvizëse 105 dhe 155mm. Për këtë duhet që trajnimet e ardhshme të përfshijnë një pjesëmarrje më të lartë të personelit duke synuar certifikimin e personelit potencial si instruktor, për sigurimin e vazhdimësisë së trajnimit në strukturat e FT".

Ky trajnim u krye nga ekipi amerikan i SFAB (Security Force Assistance Brigades - Brigada e Ndihmës së Forcave të Sigurisë) të Ushtrisë Amerikane të atashuar pranë BKL, i drejtuar nga kapiten Kevin Kraweski, zgjati një muaj, ku morën pjesë 14 efektivë të FT-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte aftësimi i efektivëve në kryerjen e detyrës së vrojtuesit të përparuar dhe në drejtimin, korrigjimin dhe thirrjen e zjarrit. Kjo stërvitje e planëzuar në tre faza, atë të planëzimit, trajnimit dhe



testimit përfundimtar, u fokusua në trajnimin e efektivëve në drejtim të komunikimit, ndërlidhjes, ndërtimin e skicave të terrenit, kërkesës së mbështetjes me zjarr dhe korrigjimin e tij. Përveç standardizimit të veprimeve sipas procedurave të NATO-s për VP (vrojtues të përparuar) dhe

DZ (drejtim zjarri) nga ekipi amerikan iu kushtua rëndësi certifikimit të personelit në rolin e instruktorit për drejtimin e zjarrit dhe vrojtuesin e përparuar, në mënyrë që të ketë vazhdimësi trajnimi i reparteve në Forcën Tokësore. Në ceremoni u shpërndanë certifikata dhe u mbyll me një foto të përbashkët.



Forcat Speciale / ROS, përfunduan me sukses stërvitjen trajnuese "JCET 24-1"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në stërvitjen trajnuese "JCET 24-1" të Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS).

Në këtë ceremoni, e cila u zhvillua në Regjimentin e Operacioneve Speciale, ishin të pranishëm gjithashtu i ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-ve, në Tiranë, z. David Wisner, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, përfaqësues të ODC, si dhe të ftuar të tjerë.

Të pranishmit në këtë ceremoni, panë nga afër demonstrimet e kombinuara nën drejtimin e instruktorëve amerikanë. Kjo është një stërvitje ku përfshihen trajnimit efektivave tona speciale nga instruktorët e forcave speciale amerikane. Gjatë trajnimit efektivët realizuan tema si trajnim mbi udhëheqjen dhe planifikimin, teknikat e qitjes dhe shpimit, operacionet luftarake në mjediset urbane, zhvillimin dhe drejtimin e operacioneve speciale, taktikat e njësisve të vogla si dhe standardizimin e taktikave



dhe procedurave.

Kjo stërvitje i shërbeu rritjes së aftësive profesionale të operatorëve specialë, rritjes së ndërveprueshmërisë, punës në grup dhe besimit reciprok gjatë kryerjes së misioneve luftarake.

Efektivat e ROS përfundojnë stërvitjen dimërore në Kolashin të Malit të Zi

Efektivët të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore, kryen stërvitjen dimërore alpine në kushte ekstreme të motit në Kolashin, Mali i Zi.

Kjo stërvitje u krye së bashku me alpinistë të kërkim - shpëtimit të Malit të Zi. Në lartësinë 1850 metra, si dhe në kushte ekstreme të motit, 30 efektivët të ROS-së, së bashku me efektivat alpinë të Malit të Zi, kryen stërvitje nëpërmjet teknikave të ngjitjes (marshim në dëborë), orientim me hartë dhe busull në terren të mbuluar me dëborë, kërkim - shpëtim, përdorim i pajisjeve orientuese si dhe përdorim i mjeteve të lëvizjes në dëborë.

Stërvitja shërbeu për rritjen e aftësive të efektivave tonë speciale si në drejtim të lëvizjes, orientimit dhe kryerjes së detyrave në kushte ekstreme të motit, ashtu dhe në zhvillimin e aftësive bashkëvepruese me efektivët të vendeve anëtare të NATO-s.



Efektivat e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut dhe të Batalionit Komando marrin pjesë në stërvitjen shumëkombëshe KFOR - 33

90 efektivët të Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut dhe të Batalionit Komando të Forcës Tokësore, po kryejnë stërvitjen KFOR - 33, në Hohenfels, Gjermani. Kjo është një stërvitje shumëkombëshe, e cila realizohet për të përgatitur efektivat tona për dislokimin e tyre në Komandën Rajonale të Kosovës Lindore. Kjo është një stërvitje shumëkombëshe, e cila realizohet për të përgatitur efektivat tona për dislokimin e tyre në Komandën Rajonale të Kosovës Lindore. Sipas një skenari të mirë përgatitur dhe në kushte sa më reale me ato të terrenit ku ata do të veprojnë, efektivat tanë po stërviten për të rritur aftësitë e tyre në drejtim të menaxhimit të turmave, patrullimit në zona konfliktuale si dhe "Checkpoint" në rrugëkalimet e zonës së tyre të veprimt. Stërvitja do vazhdojë deri më 16 shkurt 2024.



Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në një vizitë kortezie të ngarkuarin me punë në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, David Wisner

Në kuadër të bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në ambientet e Forcës Tokësore zhvilloi një vizitë zëvendëssehefi i misionit dhe i ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, David Wisner.

Ai në këtë vizitë takoi ekipin e SFAB (Security Force Assistance Brigade), i cili prej 6 muajsh po asiston në trajnimin dhe stërvitjen e efektivave të Forcës Tokësore, me fokus kryesor efektivat e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbëorisë. Më tej, ai u prit në takim nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia. Në takim u diskutua mbi bashkëpunimin e shkëlqyer midis dy vendeve dhe dy Forcave tona të Armatosura. Komandanti e falënderoi mikun amerikan për kontributin e vazhdueshëm që forcat ushtarake amerikane japin për ngritjen e kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura shqiptare dhe atyre të Forcës Tokësore në veçanti. Ky kontribut përfshin trajnimin, stërvitjen si dhe modernizimin me mjete e pajisje ushtarake. Më tej, gjeneralmajor Xhebexhia u ndal në punën e palodhur që ekipi i SFAB-it ka bërë në trajnimin e efektivave të FT-së, për ngritjen e nivelit teorik dhe praktik të tyre në përdorimin e armatimit modern me të cilin janë pajisur këto trupa. Nga ana e tij z. Wisner falënderoi komandantin e FT-së për leadershipin dhe bashkëpunimin me SHBA-të. Ai theksoi se ekipi



i SFAB përbën 10-21% të të gjithë prezencës amerikane në Shqipëri dhe vlerësoi bashkëpunimin midis Forcës Tokësore dhe ekipit të SFAB në drejtim të rritjes së kapaciteteve, ndërveprueshmërisë dhe

efektivitetit të efektivave shqiptare në çdo mision që do t'u ngarkohet në përbërje të NATO-s. Ai theksoi se ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe në të ardhmen.

Vizita e të ngarkuarit me punë në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, në komandën e Forcës Tokësore është një tregues i qartë i angazhimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në mbështetjen e vendit tonë dhe FA-së së Shqipërisë për rritjen e konsolidimin e kapaciteteve të saj ushtarake.



Gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonelin Timothy Wight-Boycott

Atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Timothy Wight-Boycott zhvilloi vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura, ku u prit nga zëvendëskomandanti, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj. Gjatë takimit me gjeneral brigade Bardhyl Nuredinajn u diskutua mbi bashkëpunimin e mëtejshëm në fushën e arsimimit ushtarak, planet dhe mundësitë që pala britanike ka për mbështetjen me studime të mëtejshme në Akademitë në Britaninë e Madhe.



Gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti presidentin e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar, Besnik Veliu

Në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti në takim zotin Besnik Veliu, president i Federatës Shqiptare të Sportit Universitar. Në këtë takim z. Veliu vlerësoi pjesëmarrjen dinjitoze të ekipeve të AFA-së në aktivitetin e zhvilluar në qytetin e Korçës; planet e mundshme për bashkëpunimin; nevojën për krijimin sa më shpejt të shoqatës sportive të AFA-së. Në shenjë mirënjohjeje zoti Veliu i dorëzoi gjeneral Bardhyl Nuredinajt, zëvendëskomandantit të AFA-së, një certifikatë për pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar në Korçë. Gjeneral Nuredinaj e falënderoi për vlerësimin e bërë ndaj ekipeve të AFA-së, si dhe e garantoi se AFA-ja do të jetë një IAL që do marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që do të zhvillojë FSHSU në vijimësi.

AFA feston 7 Marsin: Mësimdhënia, mision, pasion, përkushtim

Me rastin e 7 Marsit, ditës së mësuesit, në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura u organizua një ceremoni vlerësimi për stafin akademik dhe bashkëpunëtorët e tyre në rrugëtimin e përçimit të dijes tek të rinjtë dhe të rejat nën uniformën e gjelbër. I pranishëm ishte dhe zëvendëskomandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, i cili në këtë ditë të veçantë për Arsimin Shqiptar u shpreh: “Kjo ditë është po aq e rëndësishme edhe për Akademinë e Forcave të Armatosura, e cila ndër vite rriti, edukoi dhe formoi breza të tërë të oficerëve të rinj. Kjo datë në traditën tonë shumëvjeçare mbetet një ditë ku ne kujtojmë mësuesit dhe pedagogët tanë, kthejmë vëmendjen drejt tyre, duke treguar respekt dhe mirënjohje. Puna e mësuesit dhe pedagogut është një punë me vlerë dhe shumë e ndjeshme, pasi ajo lidhet drejtpërdrejt me moshat e reja, me të ardhmen e vendit, me të ardhmen e Forcave të Armatosura.

Dua që me këtë rast, të falënderoj të gjithë pedagogët e Akademisë, gjithë stafin akademik, drejtuesit e saj, për punën e palodhur dhe të përkryer që kanë bërë gjatë këtyre viteve në drejtim të përgatitjes së brezave të rinj, për të ardhmen e Forcave të Armatosura. Gëzuar festën e 7 Marsit, suksese e mbarësi paçi përherë në profesionin tuaj fisnik”.

Ceremoninë e përshëndeti dhe kolonel Ilirjan Dauti, Dekan i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, i cili uroi për festën e 7 Marsit dhe theksoi se ndihet i privilegjuar dhe krenar për arritjet e deritanishme të stafit akademik, me të cilët do të vijohet të punohet së bashku për përgatitjen e brezit të ri, që do t'i shërbejë Forcave të Armatosura.

Në këtë ceremoni përcolli urimet e saj edhe znj. Etleva Smaçi, zëvendës rektore e AFA-së, e cila u shpreh se: “Në këtë ditë të veçantë, sjellim në mendje kujtime të bukura në këtë profesion sa të bukur, aq dhe të vështirë. Mbajmë pjesën e bukur të mësimdhënies, angazhimin e përditshëm me njëri-tjetrin.

Edhe pse me natyrën e veçantë që kemi, ne mbetemi përcuesit e dijes, ashtu siç shpreheshin edhe rilindasit tanë “Dita e diturisë përpara do të na shpjerë”. Mësimdhënia nuk është vetëm një mision, por thjesht një pasion”, - u shpreh ajo.

Për stafin akademik u shpërndanë medalje mirënjohjeje për kontributin e dhënë në edukimin e brezit të ri, si dhe buqeta me lule. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.



AFA, pjesë e panairit “Work & Study”

Akademia e Forcave të Armatosura vijon turin e panairit “Work & Study” në çdo qytet të Shqipërisë.

AFA përmes këtij aktiviteti ofron për maturantët njohjen me 3 programet e studimit Bachelor sipas modelit “West Point” në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në mënyrë që t’iu mundësojë atyre marrjen e vendimit të duhur mbi ndjekjen e studimeve universitare dhe orientimin e tyre drejt një pune të sigurt dhe me trajtim financiar dinjitoz, që në ditën e parë të studimeve.

Akademia e Forcave të Armatosura mirëpret të gjithë maturantët, të cilët duan një arsim cilësor me standarde bashkëkohore.



INAUGUROHET KABINETI I INFORMATIKËS NË QAPN

Inaugurohet Kabineti i Informatikës në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, duke shënuar kështu një tjetër hap të rëndësishëm në rritjen kushteve të trajnimit sipas standardeve bashkëkohore. Ky kabinet do të luajë një rol kyç në përgatitjen e nënoficerëve të karrierës, për të qenë sa më pranë teknologjisë, por dhe të përgatiten për t'u përballur me luftën kundër kërcënimeve kibernetike dhe mbrojtjes së sistemeve tona të informacionit.

Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë, komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, kolonel Besim Bala, shefi i Arsimimit, nënkolonel Serjan Sakaj, Komandanti i Kurseve, nënkolonel Shkëlqim Alsela, si dhe nënoficeri i QAPN-së, kryekapter Ilmi Popshini.

Ky kabinet u përdor nga kursi i 57-të Bazë i Nënoficerit. Zëvendës shefi i Grupit të Liderimit, kapter Agim Kurti, i cili njëkohësisht drejtonte mësimin me kursin e 57-të Bazë, ndër të tjera theksoi: "Ndihej i privilegjuar që po përdor një kabinet bashkëkohor për të realizuar sa më mirë procesin e mësimdhënies. Duke jetuar në shekullin e teknologjisë, në mënyrë të pashmangshme jeta jonë është e lidhur ngushtësisht me botën dixhitale. Trupa e Nënoficerëve duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të qenë një urë lidhëse sa më e mirë midis vartësve dhe eprorëve."

Pjesëmarrësit u njohën nga afër me strukturën dhe funksionin e këtij kabineti, që ka si qëllim njohjen e paketave bazë, si dhe sistemeve mbrojtëse. Në këtë kabinet përdoret teknologji bashkëkohore, ashtu si edhe në njësitë moderne të vendeve aleate. Në shenjë mirënjohjeje për punën dhe kontributin e dhënë në fushën e informatikës, kolonel Bala, i dha kapter Agim Kurtit certifikatë falënderimi.



Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve filloi kursi i Lartë i Nënoficerit me 30 kursantë. Synimi i kursit është përgatitja e kursantëve si kryenënoficerë kompanie dhe si specialistë në shtab.



Starton Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-14)

Në mjediset e auditoriumit “Enrico Tellini”, u organizua ceremonia e hapjes së Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-14).

Në këtë ceremoni të veçantë, ishin të pranishëm zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, përfaqësues nga Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, komandantë forcash kryesore dhe autonome të FA-së, atashe ushtarakë të akredituar në Shqipëri, drejtorë në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së etj.

Në përshëndetjen e veçantë drejtuar të pranishmëve në këtë ceremoni, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, pasi falënderoi të gjithë të pranishmit u shpreh ndër të tjera: “Më lejoni të shpreh falënderime dhe mirënjohje për liderшипin tuaj të lartë, i cili ka dërguar përfaqësues në këtë kurs. Në një mjedis që po ndryshon, rëndësia e këtij kursi duhet vlerësuar, prandaj ne duhet të forcojmë bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe të japim ekspertizë në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Kurrikula e këtij kursi mbulon çështje të orientuara drejt marrëdhënieve ndërkombëtare, politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe natyrës së konflikteve të shekullit të 21-të”. Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, në fjalën e tij të rastit falënderoi pjesëmarrësit nga FARSH, institucionet e sigurisë në vend, ushtarakët nga vendet e rajonit dhe ato aleate për zgjedhjen e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për zhvillimin e studimeve të tyre si dhe shtetet respektive për vlerësimin e ftesës dhe dërgimin e pjesëmarrësve në Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen - 14. “Me kalimin e viteve jemi më shumë se të kënaqur mbi pjesëmarrjen nga institucionet më të larta civile dhe ushtarake të vendeve të ndryshme, duke e bërë programin e kursit të larmishëm në tema studimore, me trajtimin gjithnjë e më shumë të çështjeve të Sigurisë dhe Mbrojtjes në mjedisin tonë të përbashkët. Gjatë kësaj periudhe tre mujore ka shumë komponentë për t’u diskutuar, vlerësuar dhe nxjerrë mësim. Arritjet e këtij kursi nuk mund të kuptohen pa kontributin e lektorëve nga Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s, Kolegji Baltik, Qendra Marshall, Kolegji i Luftës i



Ushtrisë Amerikane, Instituti për Studime Globale në Romë, Forcat e Armatosura shqiptare, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Institucionet e Sigurisë shqiptare. Me lejoni t’i falënderoj të gjithë për mbështetjen e tyre në konsolidimin dhe përparimin e këtij kursi nga viti në vit. Në kemi besim në përmbushjen e plotë të objektivave të programit, pasi kemi mbështetje nga institucionet shqiptare, veçanërisht nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, Ministria e Mbrojtjes si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Falënderime të veçanta shkojnë dhe për pjesëmarrësit e huaj në këtë kurs, të cilët vijnë nga: Bullgaria, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Italia, Kosova, Rumania dhe Turqia”. Pjesëmarrësit në Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, KLSM-14, kanë filluar programin arsimor, më datë 04 mars 2024, dhe e përfundojnë atë, më 24 maj 2024. Në këtë kurs marrin pjesë civilë dhe ushtarakë të lartë nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Gjermanisë, Greqisë, Italisë, Kosovës, Rumanisë dhe Turqisë dhe nga institucione të larta të sigurisë në vend.

KLO zhvillon praktikën mbi “Menaxhimin e emergjencave civile për situata të shkaktuara nga tërmeti”

Në vijim të modulit “Operacionet në përgjigje të krizave”, kursantët e kursit të Lartë të Oficerit (KLO) zhvilluan ushtrim praktik dyditor mbi “Menaxhimin e emergjencave civile për situatë të shkaktuara nga tërmeti”. Ata e realizuan temën të vendosur në funksionet e strukturës së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, duke diskutuar mbi përdorimin e kapaciteteve operacionale të deklaruara për vitin 2024, sipas planit të Ri kombëtar.

Kursantët e këtij kursi gjatë ushtrimit praktik aftësohen për procesin e planëzimit të operacioneve për Emergjencat Civile me kohë të kufizuar, duke vepruar si një forcë e përbashkët e organizuar për detyrë (FPOD).



Përfundoi me sukses operacioni EOD në qytetin e Durrësit

Një ekip prej tre specialistesh EOD të Batalionit të Xhenios asistoi në verifikimin, asgjësimin dhe transportimin e një predhe topi 100 mm italiane të Luftës së Dytë Botërore të gjetur në bashkinë Durrës.

Nga ekipi EOD u morën masat e nevojshme për sigurimin e municionit të paplasur dhe zonës përreth, konform manualit dhe rregullave EOD.

Mbas verifikimit dhe vlerësimit të bërë nga ekipi EOD rezultoi se municioni i paplasur ishte i rrezikshëm, por i lëvizshëm, ku dhe u transportua dhe magazinua në Batalionin e Xhenios, duke zbatuar të gjitha rregullat e sigurisë.



Komanda Mbështetëse vazhdon të japë kontributin e saj në ndërtimin e urave "Bailey"

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse, kanë përfunduar montimin e urës tip "Bailey", 15 m të gjatë me seksion 2/1, në fshatin Stojan, bashkia Mat. Ndërtimi i kësaj ure, e cila ndodhet pranë një monumenti kulti siç është Kisha e Shna Ndojt, i shërben jo vetëm 400 banorëve të zonës për lidhjen me qendrën shëndetësore, shkollën dhe rrugën nacionale, por një komuniteti më të gjerë të cilët vijnë çdo të diel për kryerjen e riteve fetare të pelegrinazhit në këtë kishë.

Për inaugurimin e përfundimit të punimeve, ishte i pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela dhe përfaqësues të bashkisë Mat, të cilët falënderuan specialistët xhenierë për kontributin e çmuar në ndihmë të komunitetit.

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile, në ndihmë të komunitetit civil

Për shkak të situatës kritike të krijuar nga rritja e nivelit të ujit në liqenin artificial të Tiranës, i cili përbënte rrezik për digën e liqenit, me kërkesën për bashkëpunim dhe mbështetje të Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë, Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC), angazhoi forcat, mjetet dhe agregatet në operacion për uljen e nivelit të ujit në Liqenin Artificial të Tiranës.

BMEC edhe njëherë ka treguar gatishmërinë për t'i ardhur në ndihmë komunitetit civil, duke bërë të mundur normalizimin e nivelit të ujit në liqenin artificial të Tiranës.



Përfundoi Kursi i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Municioneve

Përfundoi Kursi 2-javor i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Municioneve, niveli III, ku u trajnuan 6 kursantë nga FSK-së dhe 3 kursantë të FA-së.

Në ceremoninë e certifikimit të kursantëve ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë së SHPFA, gjeneral brigade Aleksandër Pando, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, atasheu ushtarak i Kosovës, kolonel Enver Hoti, shefi i Zyrës ODC nënkolonel Adrian Liptrot. Qëllimi i këtij kursi ishte trajnimi i personelit të FA-së dhe FSK-së për menaxhimin e municioneve, në kuadër të standardizimit të njohurive sipas procedurave të NATO-s, duke bërë të mundur rritjen e bashkëpunimit ndërmjet FA-së dhe FSK-së si dhe standardizimin e stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta në terren.

Ky trajnim u drejtua nga instruktorë të FA-së dhe FSK-së dhe u monitorua nga instruktorët e palës amerikane, duke ndarë eksperiencën dhe profesionalizmin e tyre. Mbështetja nga USEUCOM nëpërmjet kompanisë “Golden West” tregon qartë rëndësinë e trajnimit të vazhdueshëm të personelit, të cilët përballen me sfida të ndryshme në menaxhimin e municioneve.



Kontingjenti EOD zhvilloi operacione në mbështetje të stërvitjes së përbashkët shumëkombëshe “Ares Strike” në kampin Adazi, Letoni

Trupat EOD me mision në Letoni kanë treguar përkushtim të lartë dhe profesionalizëm në stërvitjen e përbashkët shumëkombëshe “Ares Strike”, që u zhvillua në poligonin e stërvitjes në kamp Adazi, Letoni. Në këtë stërvitje kontingjenti EOD u angazhua me pesë detyra operacionale për vlerësimin, asgjësimin dhe largimin e pesë municioneve të ndryshme, duke bërë të mundur pastrimin nga municionet e rrezikshme të zonave të caktuara. Komandanti i grup - batalionit kanadez falënderoi dhe vlerësoi maksimalisht kontingjentin EOD për të gjitha operacionet dhe mbështetjen profesionale gjatë kësaj stërvitje.

Specialistët EOD zhvillojnë operacione për asgjësimin dhe largimin e municioneve të rrezikshme në zona të ndryshme të vendit

Specialistët EOD të batalionit të Xhenios realizuan me sukses detyrën për identifikimin, vlerësimin, asgjësimin dhe largimin e municioneve të paplasura të zbuluara në disa zona të vendit. Në fshatin Mirakë të bashkisë Librazhd, gjatë kryerjes së punimeve në kantierin e ndërtimit të Korridorit 8, nga firma “Alb-Building”, është zbuluar një sasi e konsiderueshme municioni të rrezikshëm, të cilat u larguan dhe u dërguan për magazinim në batalionin e Xhenios brenda rregullave të sigurisë. Po ashtu, në fshatin Mengel, bashkia Elbasan, municioni i gjetur u vlerësua i prekshëm dhe i lëvizshëm dhe u bë i mundur largimi dhe transportimi i tij. Një tjetër ekip xhener zhvilloi operacionin për asgjësimin e municioneve të rrezikshme në fshatin Xibër, Murriz, bashkia Klos. Pas identifikimit nga kryeoperatori EOD, municionet e gjetura u vlerësuan të paprekshme dhe të pa lëvizshme dhe u bë asgjësimi në vend i tyre brenda të gjitha rregullave të sigurisë teknike.



Përfundon ndërtimi i urës tip “Bailey” në bashkinë Berat

Banorët e fshatrave Moravë dhe Lapardha në njësinë administrative Otlak, bashkia Berat, tashmë do të kenë një urë të re.

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse, pas dhjetë ditësh punime, kanë përfunduar montimin e urës tip “Bailey”, 21 metra të gjatë, me seksion 2/1.

Ndërtimi i kësaj ure do t'i shërbejë rreth 1400 banorëve të kësaj zone, duke lehtësuar lëvizjen dhe duke bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet.



Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios kontribuojnë për eliminimin e rrezikut nga municionet e paplasura

Pas një njoftimi nga autoritetet vendore të fshatit Orizaj, bashkia Berat, për konstatimin e municioneve luftarake, një grup prej tre vetash, specialistë EOD të Batalionit të Xhenios në KM, në bashkëpunim me inspektorët e zonës, punonjës të Komisarariatit të Policisë Berat shkuan menjëherë në vendngjarje. Në masa të larta sigurie kryen kontrollin e vendit, ku u bë dhe identifikimi i municioneve të zbuluara, të cilat rezultuan të ishin katër predha artilerie ETH 70mm, prodhim italian i Luftës së Dytë Botërore.

Në zbatim të procedurave EOD, municionet u vlerësuan të prekshme dhe të lëvizshme, gjë që mundësoi lëvizjen dhe magazinimin në batalionin e xhenios. Operacioni përfundoi me sukses.



Ilir Lame: Respekti i njerëzve është çmimi dhe lumturia ime më e madhe

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Ilir Lame është ish-futbollisti i shquar i ekipit të Partizanit, gjatë viteve 1976-1989. Ai spikati me lojën e tij si një sulmues i talentuar i ekipit dhe ngriti peshë zemrat e tifozëve. Ai ka fituar disa tituj e trofe, 3 herë titullin “Kampion” me Partizanin në 1978-1979, 1980-1981, 1986-1987, si dhe Kupën e Shqipërisë me Partizanin 1979-1980.

Ai ka luajtur me Kombëtaren 13 ndeshje në vitet 1981-1986 dhe mban titullin sportiv “Mjeshtër Sporti”, medaljen “Naim Frashëri” të Klasit të Parë, 2020 Çmimi “Mjeshtër i Madh”, dhe Nderi i Qytetit të Përmetit në 2016. Po e sjellim në një intervistë për lexuesin e shtypit ushtarak.

Z. Ilir, ju keni qenë një nga figurat më të shquara të Partizanit të viteve '80, duam të zhvillojmë një intervistë të gjerë me ju rreth fëmijërisë tuaj, shkollimit dhe futbollit, ku ju shkëlqyët për brezin tuaj dhe jo vetëm. Si do ta niste tregimin për veten Ilir Lame?

Kam lindur në Tiranë, më 15 korrik 1956. Tirana është vendlindja ime, por të gjithë fëmijërinë dhe adoleshencën e kam kaluar në një qytet tjetër. Im atë ishte ushtarak dhe familjët e ushtarakëve transferoheshin shpesh në qytete të tjera, sipas detyrës që i ngarkohej ushtarakut për të shërbyer. Kështu dhe ne u transferuam në Përmet, pra fëmijërinë time, shkollimin bazë dhe gjimnazin e kam kaluar në Përmet. Ishte pikërisht ai qytet i bukur që do të bëhej për mua qyteti im shumë i dashur, pasi atje kam kujtimet e mia më të çmuara, të cilat shënjuan jetën dhe karrierën time.

Si ishte Ilir Lame si nxënës në mësim, po në sport kur keni spikatur?

Po sigurisht kam qenë një nxënës shumë i mirë në mësim, një nga nxënësit e dalluar të klasës, dhe këtë e them pa mburrje. Fotografinë time që në fillore e më tej do ta gjeje në këndin e nxënësve të dalluar që kishte shkolla atëherë. Madje, ende ruaj si kujtim në shtëpi një fotografi timen të hershme, të botuar në revistën “Fatosi” të asaj kohe, si një ‘nxënës i dalluar’ në klasën e dytë të ciklit të ulët.

E ndërkohë kam qenë edhe një fëmijë shumë i hedhur dhe i papërtuar dhe si fëmijët e asaj kohe luanim shumë, sidomos futboll, që ka qenë loja e parë për ne djemtë. Që në moshë të vogël, 6-7 vjeçare, në klasë të parë kam dëgjuar për herë të parë për futbollin, emrin Pano, “Panon e Partizanit”. Partizani doli kampion atë vit dhe kështu them se u dashurova me Partizanin. Unë isha i mirë në futboll përveç dëshirës për të luajtur, në fëmijëri dhe pikërisht në moshën 12-13 vjeçare, në një spartakiadë të 1969 që zhvillohej



tek ne, kjo gjë ra në sy të mësuesve të mi, të cilët më aktivizuan dhe më angazhuan më tej. Ata me sa duket panë tek unë aftësitë e veçanta që ka një futbollist dhe trajneri im i parë ka qenë mësuesi i gjuhës ruse, i cili vetë kishte qenë më parë pikërisht lojtar i “Skënderbeut”, nga Maliqi, Bujar Myrtezai, por që tashmë tek ne jepte rusisht. Ndërsa ndiqja pasionin tim të futbollit, njihja dhe doja të dija mbi ekipet e futbollit që ishin në Shqipëri në atë kohë dhe ekipi i cili më kishte rrëmbyer zemrën, siç e thashë më lart, ishte “Partizani”, që më vonë do të më përfshinte në gjirin e tij dhe do të bëhej pjesa ime më e rëndësishme dhe më e dashur.

Pra nuk ishte rastësi pjesëmarrja jote në këtë ekip?

Jo, nuk ishte rastësi. Partizani ishte një ëndërr për mua, që u bë ëndërra ime e realizuar. Ishte ëndërra dhe pikësynimi im, që kur u aktivizova me të rinjtë apo dhe më tej me të rriturit e qytetit.

Si ndodhi?

Ëndërra ime ishte jo vetëm futbollit por dhe të isha lojtar i Partizanit dhe nuk ka gjë më të bukur se kur ëndërra të realizohet. 12 -13 vjeçar aktivizohesha me të rinjtë dhe në moshën 15-vjeçare kalova tek ekipi i të rinjve. Kur u aktivizova me “24 Majin” e Përmetit fillorë të bija në sy gjë që bëri që më vonë të më merrnin në ekipin e shtetit, pra Partizanin.



Cili ishte pozicioni juaj në formacion, në fushën e lojës?

Në Përmet kam luajtur si sulmues i majtë, kur erdha tek Partizani u pozicionova si sulmues i djathtë, rol të cilin e mbajta deri në fund, dhe me ekipin e Partizanit edhe me ekipin e kombëtares. Në Përmet kam luajtur me "24 Majin" me ekipin e të rriturve deri sa mbarova maturën. Në atë kohë kur mbaroje maturën para fillimit të shkollës të lartë zhvillohej një vit stazh dhe ishte pikërisht ky vit kur unë erdha në Tiranë. Ishte xhaxhai im që jetonte këtu, dhe që njëkohësisht kishte ndjekur aktivitetin tim si futbollist, por edhe ndërkohë ishte njëri nga tifozët e flaktë të "Partizanit". Ai më çoi tek trajneri i Partizanit, Loro Boriçi. Trajnerët kishin informacion edhe për futbollistët që luanin me ekipet e rretheve dhe ndiqnin aktivitetin e tyre edhe nga shtypi i kohës. Më 14 gusht të vitit 1975, unë jam paraqitur në klubin "Partizani" para trajnerit Loro Boriçi, i cili sapo kishte mbaruar stërvitjen me ekipin e tij. "Ky është ai djali, profesor, shikoje", - i thanë. Pashë që Loros i ndrinë sytë, i shkëlqyen sytë sapo më pa. Direkt, tha: "Nesër në orën 10.00, do paraqitesh me ekipin në stërvitje". "Profesor po ju s'e patë", - i thanë, "E pashë, - tha ai, - e pashë". Unë që kisha pritur me emocion një testim të mundshëm, i madhi Loro Boriçi, i pagabueshmi në zgjedhjet që bënte për lojtarët e ekipit të vet, me sa duket, pa tek unë aftësitë e një futbollisti premtues, që jam përpjekur me punën dhe stërvitjen time të mos e zhgënjë në fushën e blertë. Ai ishte një seleksionues i madh. Parimi i tij, me sa duket ka qenë që t'i zgjidhte lojtarët e tij edhe me një fizik të fortë dhe shtatlartë dhe unë isha 1.83cm, 19-vjeçar, por dhe me një trup të formuar, pasi për tre vjet kam qenë gjimnast, përveç se futbollist, gjë që kishte dhënë rezultat në muskulaturën time. Ky ishte prezantimi im i parë dhe që atë ditë u aktivizova në stërvitje me ekipin e parë të "Partizanit". Pas dy javësh më rikthyen në Përmet, për shkak të burokracive të kohës dhe procedurave të transferimit nga njëri qytet në tjetrin edhe pse isha një futbollist i talentuar. Shkuarja në Përmet u organizua edhe me zhvillimin e një ndeshjeje, më 26 gusht, midis "Partizanit" dhe "24 Majit", që ishte në kategorinë e dytë. Ajo ishte një ndeshje historike, ku ekipi i "Partizanit" shkollon-

te në Përmet. Gjithçka u kthye në një festë, ku i gjithë Përmeti u mbush plot me të ardhur nga rrethinat e fshatrat përreth për të ndjekur ndeshjen, për të parë ekipin e "Partizanit". Kishin ëndërr të shikonin ekipin e "Partizanit", që në Përmet jo e jo, por ata nuk kishin pasur mundësi ta shihnin as në Tiranë. Stadiumi, fusha e sportit më tepër, të cilën ne e quanim stadium, u mbush plot me qytetarë të Përmetit dhe jo vetëm, sa nuk i nxinte, por që sigurisht drejtuesit e "Komitetit të Partisë" dhe të "Komitetit ekzekutiv", ata që do të jepnin vizën për pjesëmarrjen time në ekipin e "Partizanit" më vonë, ishin atje, prezent dhe ndoqën ndeshjen, ku unë debutova. E tillë ishte koha, që edhe pse mund të ishte talent nuk mund të lëvizje prej aftësive apo dëshirës tënde pa miratimin e autoriteteve të kohës. Kjo ishte shumë zhgënjyese dhe të demoralizonte si nga ana sportive dhe psikologjike aq më tepër për moshën e re, saqë herë-herë ndjehesh "i harruar", kur ti pret "atë shkresën nga lart". Pasi përfunduan procedurat lidhur me transferimin tim, më 19 shkurt të

vitit 1976, u paraqita zyrtarisht tek klubi "Partizani", ku u bëra dhe pjesë e ekipit përfundimisht.

Si ishte, të ishte pjesë e ekipit të ëndrrave?

Njëkohësisht është shumë bukur, aq sa është edhe sfiduese, duke pasur parasysh që unë vija nga një qytet i vogël nga një provincë, nga një ekip i vogël gjithashtu, nga një kategori më e ulët dhe bëhesh pjesë e një ekipi që ishte në krye të klasifikimeve, një ekip me një emër të madh, kampion i vendit disa herë, me ndeshje ndërkombëtare etj. Fillimi ishte shumë i vështirë, ishte sfida e përshtatjes



dhe integritit me ekipin, me një ekip që kishte njëkohësisht një emër tepër të madh, por ndërkohë ajo që më "jepte zemër", ishte se kisha mbështetjen e trajnerit. Ky është një avantazh i madh përveç parametrave që mund të kesh. Nga ana tjetër edhe stërvitja ishte tepër e madhe, me një ngarkesë tepër të lartë dhe ndryshe nga ajo që bënim në ekipin e Përmetit. Këtu tashmë kërkohej një nivel tjetër. Por që them se e përballova me sukses stërvitjen dhe përshtatjen.

Ju jeni një legjendë e ekipit "Partizani" si dhe e futbollit shqiptar, por gjithashtu jeni një emër që i ka bërë nder uniformës të ushtarakut, si ish-oficer. Si u gjendët në strukturat e FA-së. Kush ishte kontakti juaj i parë me to, si e kujtoni? Çfarë detyrash keni kryer gjatë karrierës ushtarake?

Kontakti im i parë me një strukturë ushtarake, ka qenë kur unë zhvilloja stazhin pas mbarimit të maturës, ku punova në një nga

repartet ushtarake, ndërkohë që zhvilloja dhe stërvitjen me “Partizanin”, pasi ekipi ishte pjesë e FA-së. Pas stazhit, mbarova studimet e larta në Institutin “Vojo Kushi”, 1976-1979, sot Universiteti i Sporteve të Tiranë, por ndërkohë vazhdova edhe stërvitjen me ekipin. Nga grupi im, unë së bashku me 10 shokë të tjerë u bëmë pjesë e Forcave të Armatosura. Pra veshja uniformën ushtarake dhe u titullova oficer, mora emërimin si pedagog i Edukimit Fizik në Katedrën e Edukimit Fizik në Shkollën e Bashkuar të oficerëve. Ndërkohë isha pjesë e sport-klubit të ekipit “Partizani”, ku zhvilloja gjithë aktivitetin tim sportiv, përveç detyrës ushtarake. Uniforma të jepte një emocion tjetër të veçantë. Dhe unë e kujtoj ditën time të parë të punës, tashmë si ushtarak me uniformë, teksa u futa në ambientet e Shkollës të Bashkuar, menjëherë sa u futa në oborr, ndjeva që dhjetëra sy u drejtuan nga unë, apo kthyen kokat për të më parë. Ishte një prej futbollistëve më të njohur të “Partizanit”, dikush më përshëndeti apo më buzëqeshi, apo ndaloi dhe më dha edhe dorën. Ishte një ndjenjë e veçantë në një ambient ushtarak. Dhe që nga ajo ditë e kam ndjerë respektin e tyre gjithmonë si nga kolegët ashtu dhe nga studentët.

Si e keni menaxhuar ju famën në atë kohë?

Fama është një fjalë që të vishet kur ti je dikush i njohur për një masë të madhe njerëzish, dhe ti e ndjen këtë kur ecën në rrugë, në këmbë apo dhe në autobus, siç shpesh ne lëvizim në kohën tonë dhe kur të tjerët të përmendin emrin, apo ndalojnë të të takojnë. Por sjellja dhe këndvështrimi mendoj se është shumë personal për secilin person, kur bëhet i njohur dhe të tjerët e përmendin. Jam përpjekur të jem i thjeshtë dhe modest gjatë karrierës time dhe shpresoj t’ia kem arritur. Jam përpjekur gjithashtu të manifestoj vlerat që kanë përçuar tek unë prindërit e mi, nëna ime dhe babai im ushtarak, prindërit që na ritën me sakrificë dhe na edukuan që të japim maksimumin kudo që të punojmë dhe shërbejmë.

Në radhë të parë duhet të jesh njeri pastaj sportist apo artist. Dhe të ishe në të njëjtën kohë edhe ushtarak dhe të kishe studentë njerëz që të adhuronin kur dilje në fushë si pjesë e ekipit, ishte një gjë e veçantë një përgjegjësi më e madhe gjithashtu. Por nuk e kam shfrytëzuar të qenit njeri “i famshëm”, për përfitim. Asnjëherë! Ndjehesha i respektuar dhe i vlerësuar. Nga ana tjetër të ardhurat e një sportisti shkonin sa ato të një ministri, në atë kohë por gjithashtu edhe trajtimi ushqimor ndryshonte nga ai i popullsisë së gjerë.

Po rivalitet a keni pasur?

Sigurisht që ka pasur rivalitet, ka pasur garë të pastër midis nesh.

Unë vija nga rrethet por ia dola, dhe u realizova. Por edhe midis skuadrave. Merrnin pjesë në kampionat dhe skuadrat më të forta ishin treshja: “Partizani”, “Dinamo”, “17 Nëntori”, pra tre skuadrat e kryeqytetit, si dhe “Vllaznia”, “Luftëtari”, “Flamurtari”, “Skënderbeu” etj.

Në sa ndeshje jeni aktivizuar? Po në ndeshje ndërkombëtare a keni marrë pjesë? Si ishin ato?

Jam aktivizuar në rreth 101 ndeshje dhe kam marrë pjesë në 14 kampionate. Me “24 Majin” kam luajtur në 1973-1976, kurse me “Partizanin” 1976-1989. “Partizani” është shpallur 16 herë kampion i Shqipërisë kurse unë si lojtar, kam marrë 3 tituj Kampion. Titullin Kampion me “Partizanin” 1978-1979, 1980-1981, 1986-1987. Kupën e Republikës të Shqipërisë me “Partizanin” e kam marrë në 1979-1980.

Me Kombëtaren kam luajtur 13 ndeshje, në vitet 1981-1986 dhe kam marrë 1 Kupë Republike. Edhe ndeshje ndërkombëtare sigurisht kemi zhvilluar. Unë kam qenë pjesë e kombëtares.

Kam marrë pjesë në 11 takime me ekipe ndërkombëtare, ku do të veçoja ndeshjen me Austrinë, me Maltën, me skocezët, si dhe me gjermanët.

Kush ka qenë ndeshja juaj e jetës, nëse do ta quanim kështu? Ndashja me Gjermaninë.

Cili është numri i golave që keni shënuar gjatë karrierës tuaj sportive?

Kam shënuar 40 gola gjatë karrierës time sportive.

A mban mend liri një moment të vështirë në karrierën e tij sportive, cili është ai?

Moment të vështirë jo, në lidhje me karrierën time sportive nuk them se kam pasur ndonjë moment të vështirë. Asnjë situatë, sportin e kisha me shumë pasion.

Si është të jesh në stolin rezervë, a keni mbetur ndonjëherë? Si jeni ndjerë?

Po, edhe unë kam mbetur në stolin e rezervave, por kur u bëra titullar jo më. Nuk besoj se ka futbollist që nuk e provon. Varet nga forma jote sportive, sa i aftë ndjelesh për ta përballuar ndeshjen dhe kjo të ndihmon pastaj që ti të riaktivizohesh dhe të futesh në formacion, me qëllim që ta meritosh vendin.

Kur krijuat familjen tuaj, sa mbështetëse ka qenë ajo?

Me shoqen time të jetës jam njohur që në bankat e shkollës, me të cilën krijuam më vonë familjen tonë të vogël. Të dy kemi ecur së bashku dhe bashkëshortja ime ka qenë mbështetja kryesore për



Ëndrra ime ishte jo vetëm futbolla por dhe të isha lojtar i Partizanit dhe nuk ka gjë më të bukur se kur ëndrra të realizohet. 12 -13 vjeçar aktivizohesha me të rinjtë dhe në moshën 15-vjeçare kalova tek ekipi i të rinjve. Kur u aktivizova me “24 Majin” e Përmetit fillova të bija në sy gjë që bëri që më vonë të më merrnin në ekipin e shtetit, pra Partizanin.

mua, për profesionin tim të cilin e vazhdova edhe pasi u bëmë prindër. Futboll luajta edhe 6 vjet më pas, teksa vajza dhe djali erdhën në jetë në familjen tonë. Tashmë vajza mjeke dhe djali profesor, janë bërë prindër dhe kanë krijuar familjet e tyre, duke na gëzuar dhe nderuar me titullin gjysh 3 herë. Jemi të plotësuar! **Cila ishte koha kur lliri nuk e veshi më bluzën e “Partizanit”. Çfarë ndjesie patët, kur u shkëputët nga futbolla?**

Shkëputja ime erdhi e natyrshme. Jam shkëputur nga futbolla në moshën 33 vjeç. Mendoj se ishte tamam koha për ta lënë fushën e blertë. Kjo jo për shkak të formës tim sportive, se sa për arsye se i duhet lënë terreni të rinjve. Pasi në kohën kur unë e lashë futbollin në ekip filluan të vijnë mosha më te reja. Çfarë ndjeva? Keqardhje! Ishte keqardhje pasi sikur të shkëputet diçka nga vetja, pjesa e rëndësishme e jetës tënde, ajo që të formësoi disiplinën, korrektësinë, karakterin, tërë vrullin e moshës të derdhur në atë fushë të blertë, ku ti vetëm për 90 minuta ke ngritur peshë me mijëra zemra. Dhe tani thirrjet e tyre, duartrokitjet, brohoritjet e tifozerisë, që të kanë shoqëruar për aq kohë, janë vetëm një kujtim që s’kanë çmim.

Sa i lidhur është ish-futbollisti i karrierës llir lame, sot me futbollin shqiptar?

U licencova për trajner, por vetëm një vit ndenja me ekipin si trajner i dytë dhe më 2001 u shkëputa. Më tej ndodhi që u riktheva sërisht në strukturat e FA-së, por tashmë si civil e jo si ushtarak. Mu propozua që të isha trajner i fëmijëve të ushtarakëve dhe të punonjësve civilë të MM dhe FA-së në QKMBMMFA, punë të cilën e bëra me përkushtim deri sa dola në pension. Rikthimi sërisht brenda garnizonit “Skënderbej”, për të punuar me këta fëmijë ishte kënaqësi, jo vetëm për t’iu dhënë atyre këshillat që zotëroja lidhur me pasionin e tyre për futbollin, por edhe se këta fëmijë shpesh ishin të simpatizantëve, apo studentëve të mi ushtarakë, gjë që më sillte shumë kënaqësi.

A është ende “Partizani” skuadra juaj e zemrës? Si ju duket “Partizani” sot?

Po sigurisht, “Partizani” është emri që më rriti dhe më dha suksesin, skuadra që më rriti që e ndjek dhe unë jam gjithmonë me “Partizanin”, sepse s’ka se si të jetë ndryshe. “Partizani” sot lufton për titull.

Djali im pati mundësi të luante dikur dhe ai luajti disa vite. Por jo në lartësinë që do ta kërkoja unë. Çuni im ishte talent dhe spikati. U aktivizua me moshat, ishte shënjues i mirë shënonte me të dyja këmbët dhe triblonte mirë dhe deri me moshat ishte përfaqësues shënjuesi i mirë, për mua ishte absolut, por them se

duhet të kishte më tepër vullnet, sepse sporti është i tillë sado i talentuar të jesh vullneti dhe puna është ajo që të bën të ecësh përpara. Mendoj se nëse kishte gjysmën e vullnetit tim, ai do të arrinte shumë lart me siguri.

Ndjen keqardhje lliri për këtë?

Po shumë! Shumë, pasi e pashë talentin e tij, madje tani mund të të përgjigjem kur më pyete pak më lart, nëse kam ndonjë peng. Pengu im është që djali im nuk u bë futbollist, por ama s’mund të them se ai e ndjen këtë keqardhje si unë. Unë pashë tek ai talentin e lindur. Ai ka marrë një drejtim tjetër në jetë, ka mbaruar tjetër fakultet dhe sot jep kontributin e tij për shtetin shqiptar si shumë të rinj të tjerë dhe natyrisht ka krijuar familjen e tij, ashtu si dhe vajza jonë. Jam shumë i lumtur si prind dhe shumë i plotësuar me nipër e mbesa që më rrethojnë.

Përveç që ju ishit njeri nga “tre mosketierët” e Partizanit, a kishit ndonjë epitet tjetër ju?

Po sigurisht, kjo gjë ishte e pashmangshme, sidomos në fushën e futbollit, kur ishe duke luajtur, tifozët sigurisht që ishin ata të parët që të ngjisnin epitetet. Por gjithashtu epitetet e tjera ishin edhe ato që të vendoste Ismet Bellova gjatë transmetimit të ndeshjes. Mua shpesh më quanin me të gjitha epitetet që tregojnë forcë, lokomotivë, diagaxh tank, traktor. Madje me epitetin ‘lokomotivë’ më ka pagëzuar Ismet Bellova, gjatë një transmetimi ndeshjeje, por që unë nuk e dija. Të nesërmen e ndeshjes, kur po shkoja në Shkollën e Bashkuar, e dëgjova që e pëshpëritën në autobus dy vajza të reja pas shpinës time, por dhe kur u futa në punë më ngacmuan shokët dhe kur panë që unë nuk dija gjë më folën dhe për në rubrikën sportive dhe epitetin tim të ri. Apo dhe kur shënova një gol nga 35-metërsi, Ismeti më kishte quajtur gjatë transmetimit, “tërmet, tërmet në Tiranë”.

Çfarë mendimi keni për sportin shqiptar të ditëve të sotme në përgjithësi? Cili është këndvështrimi juaj?

Sporti sot është kthyer në biznes, e sidomos futbolla, jo vetëm këtu por në të gjithë botën dhe më shpesh shihet si përfitim. Ka ikur ai pasioni i dikurshëm i yni që luanim një garë të pastër dhe të ndershme, që merrnim sadisfaksion moral, pse jo edhe material. Të ardhurat tona në atë kohë shkonin sa ato të një ministri, gjithashtu është trajtimi, ishte shumë i mirë përpara profesioneve të tjera.

llir, ju kemi parë që keni interpretuar edhe në një film të Kinostudios shqiptare “Kronikë e një nate”, të viteve 1990, në rolin e një oficeri nazist gjerman. Ishte një rastësi apo menduat të kaloni në këtë fushë?

Jo, nuk e pashë si një fushë ku të kontribuoja më tej pas sportit. Gjithçka ishte një rastësi, thjesht regjisori më ka zgjedhur mua dhe shokun tim për ngjashmërinë që patëm me personazhin të cilin luajtëm. Por vetëm kaq.

Ju jeni dekoruar me disa çmime si “Mjeshtër i Madh”, nga Presidenti i Republikës, me titullin “Nderi i qytetit të Përmetit”, titullin “Mjeshtër Sporti”, medaljen “Naim Frashëri” të Klasis të Parë, etj. Cilin çmim keni më për zemër?

Sigurisht që ç’do çmim ka rëndësinë dhe vlerën e tij, gjithsesi çmimi më i madh për mua është respekti i njerëzve, të cilët më kujtojnë ende dhe më mbajnë mend. Më përshëndesin për kënaqësinë që u kam dhënë me lojën time, pasi tashmë kanë kaluar shumë vite. Ky është çmimi dhe lumturia ime më e madhe.



Atdheu përjetë mirënjohës, veprës tuaj

Viti 1997 do të mbetet në memorien e shqiptarëve si një vit i tmerrshëm dhe i përgjakshëm.

Mijëra të rinj humbën jetën pasi popullsia ishte e armatosur për shkak të hapjes së depove të armatimit. Shkodra, mbetet një prej qyteteve me bilancet më të rënda nga kjo 'luftë civile', por falë sakrificave të disa oficerëve të policisë dhe ushtrisë, situata nuk u përkeqësua edhe më tej, pasi populli mund të pajisej me granata apo raketa.

Të gjithë shkodranët mbajnë mend mbrëmjen e 12 marsit të vitit 1997, ditën kur qindra qytetarë u nisën drejt repartit ushtarak dhe baterisë kundër-ajrore që ndodhej në Dobraq, për të marrë armë. Atë mbrëmje të hidhur ranë dëshmorë të atdheut edhe 2 oficerët e ushtrisë, Muhamet Hasmuja dhe Arben Hoxha.

Muhamet Hasmuja, asokohe ishte 38 vjeç kapiten i parë, ishte emëruar komandant i bazës, ndërsa Arben Hoxha nga Elbasani ishte toger, oficer i këtij reparti. Kolegë të tyre, kujtojnë ditën e 12 marsit, ku po shërbenin dy oficerët.

"Rreth orës 12:00, pasi u inspektua baza kundër-ajrore në Dobraq për t'u njohur me masat që oficerët kishin marrë për mbrojtje, pasi ishte situatë problematike, Muhameti si drejtues kishte marrë masa shumë të mira dhe gjithçka ishte e organizuar ashtu siç e kërkonte protokollin. Orët e mbrëmjes së 12 Marsit, u shoqëruan me sulmin e turmave ndaj reparteve ushtarake të Shkodrës. Rreth orës 19.30 minuta, ra Divizioni Ushtarak i Shkodrës, ku ishte e gjithë komanda e veriut. Urdhri ishte i qartë për drejtuesit e reparteve të tjera, që askush të mos përdorte armët, por të mbronin depot, zyrat dhe të gjitha godinat e ushtrisë. Pak orë më vonë, sulmi vazhdoi drejt Dobraqit, aty ku ishte bateria kundër-ajrore me drejtues. Kur turmat mbërritën tek reparti, ata tentuan të thyejnë barrierat dhe të futen. Ushtarët dhe oficerët ishin në njërin krah me armë në duar, por pa urdhër për të qëlluar dhe në tjetrin

krah turmat, ku mes tyre ishin edhe të armatosur. Në këtë situatë, Muhameti vendosi të futej në mes të turmës dhe oficerëve të tij për të shmangur përplasjet, pasi ushtarët ishin nën presion.

"Ai po u bënte thirrje qytetarëve që të largoheshin dhe situata të qetësohej. Në një moment, ai u rrëzua. Një dorë e zezë, nga turma qëlloi me armë drejt tij. Komandanti nuk u dëgjua më dhe u dha alarmi se Muhameti është qëlluar. Drejt tij u nisën oficerët Arben Hoxha dhe Agron Kodra për ta ndihmuar, por është dëgjuar një tjetër breshëri zjarri dhe të dy u rrëzuan", - tregon ish-shefi i Shtabit të Regjimentit kundër-ajror, Ndue Marku.

Arben Hoxha, oficeri nga Elbasani humbi jetën menjëherë, ndërsa oficeri tjetër Agron Kodra, u qëllua me 7 plumba, por për fatin e tij të mirë shpëtoi. Duke parë agravimin e situatës, ushtarët u detyruan që të qëllonin në ajër dhe të mbroheshin nga plumbat e turmave. Shkëmbimi i zjarrit ka vijuar deri rreth orës 3 të mëngjesit të 13 marsit, kur turmat janë tërhequr. Me një kamion, trupat e tyre janë transportuar për në spitalin e Shkodrës, ku janë njoftuar edhe familjarët e tij. Por çfarë pasojash do të kishte për Shkodrën dhe Shqipërinë nëse reparti kundër-ajror nuk do të mbrohej deri në fund dhe do të ishte në duart e turmave?

"Pasoja fatale! Fatkeqësi të jashtëzakonshme. Kemi të bëjmë me topa kundër-ajror, raketa në gatishmëri për zjarr dhe tritol. Një pakujdesi sado e vogël, madje edhe një cigare do të shkaktonte shpërthimin e tyre, pa llogaritur më pas nëse dikush do të aktivizonte topat apo raketat. Pasojat do të ishin fatale për mijëra njerëz", - shpjegojnë ekspertët.

Në vitin 1998, Muhamet Hasmujën dhe Arben Hoxhën, Këshilli i Qarkut të Shkodrës i shpalli "Dëshmorë të Atdheut". Në nderim të tyre u ngrit edhe një obelisk tek ish-regjimenti kundër-ajror në Tepe.

Nuredin Gorçe, heroi i pavdekësisë së “Komandove” shqiptare

27 vjetori i rënies në krye të detyrës së dëshmorit të atdheut kapiten i parë (I) Nuredin Gorçe.

“Çdo gjë për atdhe Komando jemi ne”, kjo është motoja që ka udhëhequr “Komandot” shqiptare në të gjitha misionet dhe detyrat që kanë kryer anembanë vendit.

Kapiten I Nuredin Gorçe, humbi jetën tragjikisht 27 vjet më parë, në vitin 1997, gjatë masave të marra në kuadër të mbrojtjes dhe sigurimit të Brigadës “Komando”, (njësi kjo në të cilën ai shërbente në pozicionin e Shefit të Xhenios), nga sulmet e grupeve të armatosura. Guximi dhe vendosmëria e Dëshmorit të Atdheut, kapiten I Nuredin Gorçe, për t’i qëndruar besnik betimit para flamurit, për të mbrojtur vendin nga çdo lloj kërcënimi dhe rreziku, qoftë edhe me jetën e tij, ngelet edhe sot burim frymëzimi, jo vetëm për efektivat e batalionit “Komando”, ku ai shërbeu me krenari dhe vetëmohim, por edhe për të gjithë efektivat e Forcës Tokësore, të cilët sot përulën me nderim para veprës së tij. “Komando” janë një emër i dashur nga i gjithë populli shqiptar, dhe kjo për misionin dhe peshën e madhe të detyrave që ata kanë kryer jo vetëm jashtë vendit, por edhe rolin e veçantë që ata kanë luajtur në ngjarjet mjaft të vështira në vitet e turbullta që ka kaluar Shqipëria.

Për çdo ushtarak, por edhe për çdo shqiptar ngjarjet e vështira të vitit 1997 kujtohen me mjaft dhimbje për faktin se destabiliteti politik i vendit dhe anarkia e krijuar kudo i vuri strukturat e FA-së në vështirësi të mëdha për të përmbushur detyrat e tyre. Kjo për faktin se vala e revoltës mbarë popullore, si rezultat i humbjes së të ardhurave në firmat piramidale, solli një tërmet dhe revoltë popullore, e cila e shoqëruar edhe me paaftësinë e strukturave politike, institucionale, por edhe ushtarake për të drejtuar dhe menaxhuar situatën e krijuar çoi në degradimin dhe përshkallëzimin e situatës deri hapjen e depove të armatimit, marrjen dhe shkatërrimin e arsenalit ushtarak të kohës. Pa dashur të bëj analogji dhe analizë së këtyre ngjarjeve, ajo që duhet të them si bashkëvuajtës i këtyre situatave është se zemërat e brendshme popullore ishte e aq e madhe dhe e drejtë, sa që asnjë ushtarak nuk mund të reagoonte ndaj turmës të dëshpëruar, të cilët kërkonin kursimet e tyre tashmë të humbura.

Brigada “Komando” e Zall-Herrit, e cila ishte krijuar në vitin 1995, si pasuese e strukturave të zbulimit tashmë me 6 batalionet e saj të dislokuara në qytete të ndryshme të vendit, si Shkodër, Përmet, Pogradec, Berat dhe 2 batalione në Zall-Herr Tiranë, ishin të angazhuara për të vendosur dhe ruajtur situatën e sigurisë tashmë të dalë jashtë kontrollit. Ishte një situatë e cila kishte precipituar në konfrontime fizike, armët kishin rënë në dorën e popullit, Reparti Zall-Herrit tashmë po haste vështirësi, sepse kishte dyndje të popullatës që kërkonin armë, por ata u përballën me vendosmërinë e oficerëve të patrembur, të cilët kishin vendosur të mbronin repartin, kështjellën e tyre të palëkundur të ruanin emrin e tyre të mirë, i cili ishte gdhendur në mendjen e çdo Shqiptari.

Mbrojtja e repartit është detyrë për çdo ushtarak, dhe do të ishte fatale të shkatërrohej kjo pasuri e ngritur me mund e djersë, rënia e kësaj strukture elitë do thoshte, se ushtria s’do kishte ringritje, emri “Komando” do të zbehej, vlerat që mbanin në këmbë këtë kolonë të fuqishme të FA-së do rrëzoheshin bashkë me atë fatalitet që sollën ngjarjet e zymta të 97-ës.

A e përmbysën “Komandot” misionin e tyre përballë këtyre ngjarjeve të vështira?

Brigada “Komando” është ndër njësitë e vetme të FA-së, e cila nuk u dëmtua gjatë trazirave të 97-ës, kjo falë vendosmërisë, përkushtimit



dhe profesionalizmit të oficerëve, n/oficerëve dhe ushtarëve të kësaj njësie elitë, të cilët jo vetëm e mbrojtën garnizonin e tyre, por u bënë burim frymëzimi edhe për repartet e tjera, ku mund të shikonin sinjalat e shpresës për t’u ringritur dhe kryer misionin e tyre. Duke kujtuar me dhimbje këto ngjarje, por edhe duke qenë krenar për atë çfarë ne bëmë, jo vetëm për ruajtjen e repartit, por edhe rolin që patën “Komandot” më vonë në ruajtjen dhe sigurinë e objekteve të rëndësishme të vendit. Është vështirë të sjellësh në vëmendje ngjarje të tilla, si ato të Marsit të vitit 97-të, ku ne qëndruam me ditë dhe net të tëra edhe pse reparti i rrethuar nga turma njerëzish nga katër anët, të cilët të irrituar kërkonin hapjen e repartit nga ku të merrnin armët, duke na njollësuar dhe vënë përpara historisë, e cila këtë gabim s’do na e falte kurrë. Të gjendur përballë vendosmërisë sonë, ligjit për ruajtjen e repartit, falë mbështetjes së gjithanshme të pjesës më të madhe të popullatës të fshatit Zall-Herr, turmat e irrituara u zbrapsën disa herë, duke bërë të pamundur rënien e këtij reparti elitë të quajtur “Komando”.

Mbrojtja e repartit na kushtoi shumë, ne humbëm heroin tonë të përkushtuar shefin e Xhenios, ushtarakun e nderuar Kapitenin I Nuredin Gorçe, Dëshmorin e Atdheut, i cili ra në krye të detyrës për të mbrojtur infrastrukturën ushtarake të repartit, duke e bërë këtë repart të pamposhtur, përballë çdo rreziku sado i vështirë që ishte. Ne krenohemi me këtë repart, jo vetëm se pikërisht në këto ngjarje djemtë e kësaj njësie e kanë treguar veten, por më pas ishte ky repart të cilit iu dha detyra të kryente sigurinë e objekteve të rëndësishme shtetërore, jo vetëm në Tiranë, por anembanë vendit. Emri “Komando” është lartësuar dhe vazhdon të lartësohet me misionet e tyre jashtë vendit, duke filluar nga Bosnje-Hercegovina, Afganistani, Iraku, Chad-i dhe së fundi në Kosovë, ku “Komandot” me disiplinën dhe profesionalizmin e tyre kanë shkëlqyer, duke mbajtur lart emrin e madh që kanë. Do doja të sillja në vëmendje të gjithë heronjtë e këtyre ngjarjeve, duke filluar nga Komandanti i Brigadës kolonel Arben Çuko, kolonel Fatmir Lokaj, n/kol. Rexhep Bleta, major Vladimir Vladi, major Shaqir Koliçaj, major Hajri Zhukri, major Përparim Tota, major Lulzim Sefa, major Asqeri Çeta, major Aleko Çuli, major Vangjel Ndini, kapiten Lirman Hoxha, kapiten Behar Mara, kapiten Fatmir Lleshi, kapiten Haki Dingu, kapiten Elidon Shehu, kapiten Altin Bundo, kapiten Ylli Prifti, kapiten Musa Hida, toger Julian Prena, kapiten Flamur Melani, kapiten Petrit Baçe, kapiten Besnik Saliasi, n/oficerët Arjan Rasa, Lutfi Hoxha, Ramazan Xhepa, Astrit Hoxha e të tjerë, të cilët kanë meritat e tyre të veçanta që historia në memorien e saj do t’i përmendë, si heronjtë e heshtur, të cilët i bënë një shërbim të madh vendit të tyre. Ata të gjithë së bashku mblihdhen çdo datë 20 mars për të kujtuar heroin e tyre të pavdekësisë kapitenin e parë Nuredin Gorçe.

N/kol. Behar Mara, ish-koleg protagonist i ngjarjeve të 97-ës



*Shqipet mbjellin paqe në çdo prag
Ata i kthejnë buzëqeshjen çdo fëmije
Feti Vogli mbjell lule Shqipërie
Skënderbegas të rriti ushtria
Ku rrojnë bashkë nderi dhe lavdia
O pishtar me drite lirie
Feti Vogli prej Shqipërie*

Ushtarakët shqiptarë kujtojnë ndarjen nga jeta në krye të detyrës të Kapiten Feti Voglit. Ai u nda nga jeta gjatë një misioni ushtarak, më 20 shkurt të vitit 2012, pas një misioni të marrë nga komanda amerikane për të shoqëruar një zyrtare të SHBA-së në një shkollë dhe në një spital të Afganistanit. Por u sulmuan nga një taleban, i cili hapi zjarr me mitraloz në drejtim të Feti Voglit që nuk i mbijetoi plagëve. Në këtë sulm, ku mbeti i vdekur Kapiten Feti Vogli, nga të shtënat u plagos rëndë dhe ushtari Aleksandër Peçi.

Kapiten Feti Vogli, lindi më 23.05.1981, në fshatin Baldushk të rrethit të Tiranës. Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore, u bë pjesë e Forcave të Armatosura, me detyrë komandant Toge në Brigadën e Stërvitjes të Bazës, Bunavi. Pas kryerjes me sukses të kursit Bazë të Forcave Speciale, më 16 korrik 2005, u bë pjesë e Batalionit të Forcave Speciale me detyrë Komandant Grupi. Nga data 1 qershor 2010 kryente detyrën e komandantit të Grupit të Parë Special në kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore. Kapiten Feti Vogli ishte një ushtarak karriere i shkëlqyer dhe si rezultat i arritjeve në detyrë është dekoruar disa herë me medalje të ndryshme si: Medalja

e Karrierës në vitin 2007, nga komandanti i Forcës së Bashkuar; Medalja për Shërbime Ndërkombëtare nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2007 dhe Medalje për shërbime të Shquara nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2010. Misioni “Eagle 4” i Forcave Speciale që la gjurmë të thella, kujtohet me krenari nga pjesëtarët e Forcave Speciale, por edhe nga përfaqësues të lartë të shtetit dhe ushtarakë të lartë Amerikanë.

Figura e kapiten Feti Voglit kujtohet dhe nderohet jo vetëm nga personeli i Forcave Speciale, por nga të gjithë strukturat e MM-së dhe SHP-së. Veprat sublime të njerëzve që bien për idealet e larta të lirisë nuk mund të harrohen, ato kujtohen me re-

spekt dhe përulje. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në ditën e rënies së dëshmorit Feti Vogli do të shprehte vlerësimin dhe respektin e pakufi për njerëz të cilët kanë ngritur lart emrin e Shqipërisë deri në dhënien e jetës, në emër të jetës: “Lavdi përjetë dëshmorit të atdheut kapiten Feti Vogli! I përjetshëm në memorien e Forcave të Armatosura”.

Ndërsa shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral-major Arben Kingji do shprehej “E paharruar do mbetet vepra e Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli, i rënë në krye të detyrës 12 vite më parë, në Afganistan. Lavdi dhe mirënjohje të përjetshme për sakrificën sublime për të gjithë Dëshmorët e Atdheut”.



NJË LETËR NGA SHBA



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Duke ju falënderuar ju personalisht dhe stafin e gazetës “Ushtria” dhe revistës “Mbrojtja” për pasqyrimin e veprimtarive të komunitetit të ushtarakëve shqiptarë me banim në SHBA, e veçanërisht të shoqatës “Skënderbej” në Nju Jork, do të dëshiroja t’u komunikoja lexuesve të shtypit ushtarak, se ne ushtarakët shqiptarë të liruar a në pension, që fati na hodhi përtej Oqeanit, vërtet jemi ME ZEMËR NË ATDHE. Dhe jo vetëm me fjalë. Lexuesit tuaj, por edhe miqtë tanë në rrjetet sociale, janë njohur me veprimtaritë e Shoqatës sonë, jo vetëm në festimin e ditëve të shënuara të Historisë së Shqipërisë, Kosovës dhe SHBA-së, por edhe për veprimtari kulturore e shkencore, si dhe për bashkëpunimin me shoqatat e ushtarakëve në Shqipëri dhe ato të Veteranëve të UÇK-së. P.sh., ne dhamë një ndihmë modeste për Dokumentarin kushtuar shoqeve e kolegeve tona oficere, në 55-vjetorin e brezit të parë të vajzave oficere. Etj. Por ajo çka bëjnë kolegët tanë këtu, disa herë është tej të zakonshmes, p.sh. tej pjesëmarrjes në paradat e shqiptarëve në Nju Jork apo Filadelfia, apo dhurimit të një shume për të ndihmuar familjen e një oficeri policie të rënë në krye të detyrës në Shqipëri, gjë që e kemi bërë me shumë dashuri. Ne kemi shembuj ku ata janë treguar misionarë të pajtimit kombëtar këtu në Diasporë, me qëllimin e bukur të bashkimit të tyre për të ruajtur identitetin dhe traditat tona, gjuhën dhe kulturën tonë. Një nga shoqatat më aktive, më të organizuara, mbase më e suksesshmja në gjithë SHBA-të, është shoqata “Bijtë e Shqipes”, në Filadelfia. Dhe një nga drejtuesit më aktivë të Shoqatës “Bijtë e Shqipes”, do të thosha një nga shtyllat e saj, është shoku e kolegu ynë, Petrit Zanaj. Skënderbegas, e më pas student i shkëlqyer, Petriti ka qenë oficer kundërajror, dhe para se të emigronte në SHBA ka qenë pedagog në Shkollën e Lartë e më pas në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”. Njeri me kulturë dhe me interesa të gjera, Petriti është kompozitori i Himnit të Artilerisë Kundërajrore, një këngë (me tekst nga autori i kësaj letre), që është kënduar deri vonë në repartet e Ushtrisë. Me shpresë që kur kjo armë të rikrijohet, edhe Himni do të dëgjohet përsëri. Por e kisha fjalën tek shoqata “Bijtë e Shqipes” dhe Petrit Zanaj. Për një periudhë Petriti ka qenë edhe kryetar i saj, e tani drejton me dorë të hekurt sektorin e financave, ku mbase fshihet sekreti i suksesit të Shoqatës. Dhe në përpjekjet për ta ngritur e

forcuar Shoqatën, së bashku me shokë e miq të mrekullueshëm, intelektualë e atdhetarë të vërtetë, si Llazar Vero e Vlash Fili, Sadik Elshani, Enver Parllaku e Bujar Gjoka, ushtarakë si Haki Çollaku, Ali Sopi, Lutfi Brami e Hys Hasa, sa për të përmendur disa, Petriti me shokë përjetuan një ngjarje të jashtëzakonshme. Një ndodhi ku u bashkuan jo vetëm brezi i emigrantëve të pasluftës Nacionalçlirimtare me brezin e emigrantëve të pas nëntëdhjetës, por dhe bij të etërve që kishin luftuar në llogore të kundërta në ato vite. Por ishte diçka e madhe që i bashkoi: dashuria për Shqipërinë.

Fatkeqësisht, njëri nga heronjtë e kësaj ngjarjeje, z. Benjamin Risilia është ndarë nga jeta vitin e kaluar, por kjo nuk e zbeh bukurinë, rëndësinë dhe domethënien e saj. Përkundrazi. Dhe më mirë se vetë Petriti, askush nuk mund ta tregojë këtë histori, e cila vjen për lexuesin tonë siç ai e ka treguar, në një ceremoni të datëlindjes së Beniaminit, katër vjet më parë.



VËLLEZËR!

Dy vlonjatë të butë e miqësorë dukemi në këtë foto. Njëri nga Risilia dhe tjetri nga Lapardhaja. Bërë para pak kohe në mjediset e Shoqatës “Bijtë e Shqipes” në Filadelfia. Një foto me Benin, Benjamin Risilinë, me bashkatdhetarin e një familjeje të nderuar shqiptare në Filadelfia, që na u gjend pranë në ato kohë të vështira të mbijetesës e formësimit të Shoqatës sonë. Beni, bir i një nacionalisti e unë, bir i një partizani. Rrota e historisë i përplasi baballarët tanë në kahe të kundërta në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Në një luftë për ta çliruar Shqipërinë nga fashizmi, por jo një luftë që duhej ta vazhdonim edhe ne, fëmijët e tyre në

kohë paqeje. Një luftë që për fat të keq ende vazhdon në kokat e disave në Shqipëri.

Të dy bashkë na ka sjellë një hall i madh këtu. Kurbetçinj në këtë tokë të largët. Beni u largua nga Shqipëria në moshën 12 vjeç, në vitin e largët 1944, me ankthin për jetën, me atë ikje nga sytë këmbët. Një fëmijë që i ndërpritet fëmijëria në mes, pa ditur fare se çfarë gabimi apo faji kish bërë që po largohej. Por që shqipen e flet dhe e shkruan sikur ka ikur dje nga Shqipëria. Unë ika 42 vjeç, në vitin e mbrapshtë 1997. Po ikja duke e ditur shumë mirë gabimin që po bëja, duke lënë mbrapa Shqipërinë, Vlorën time të fëmijërisë, Tiranën ku u shkollova the punova. Dhe jeta na bëri bashkë të dyve këtu larg, me atë ndjenjën e mallit dhe të fajit që kishim ndaj Shqipërisë, por edhe me forcën dhe besimin që mund ta ndërtonim këtu në Filadelfia një Shqipëri të vogël, për vete dhe për fëmijët tanë, nipërit dhe mbesat që do të vinin.

E krijuar që në vitin 2002, Shoqata "Bijtë e Shqipes" po përpëlitej të mbijetonte dhe e mbante frymën me ato pak dhurime që bënin bashkatdhetarët tanë akoma të pa stabilizuar dhe vetë drejtuesit e Shoqatës së asaj kohe. Ambiente pune e zyra nuk kishim, dhe edhe një shkollë shqipe që hapëm për fëmijët tanë në vitin 2004, mësimet i zhvillonte në një qendër sociale katolike, që na u ofrua falas. Shoqata po strukturohej shpejt dhe ishte gati që të bënte hapin e madh që të ngrihej në nivelin përfaqësues të të gjithë komunitetit shqiptar në Filadelfia, por mundësitë tona si emigrantë aq ishin.

Pikërisht në ato momente të vështira, në verën e vitit 2005, na u ofrua dora ndihmëse e familjes së nderuar Risilia. Duke ditur hallet dhe kërkesat e Shoqatës, vetë Beni na erdhi dhe na gjeti. Për të na ndihmuar ne, por edhe për të vënë në vend amanetin e vëllait të tij të ndjerë, Hasan Risilisë, këtij bashkatdhetari të nderuar në gjithë Filadelfian, i cili ishte një derë e hapur dhe një dorë e shtrirë për çdo shqiptar të ardhur rishtazi si emigrant në këtë qytet. Dhurimi i jo pak, por plot 64 mijë dollarëve për të blerë një godinë të vogël, por funksionale, na dha pikërisht oksigjenin që aq shumë na mungonte.

Na i dha ashtu, thjesht, pa shumë bujë, në kundërshtim edhe me ndonjë zë në familje që të mos ua jepte fondin "bijve të komunistëve". Me një kërkesë të vetme shumë miqësore: Ndërtesa e re që do të blihej, të shërbente jo vetëm për shkollën dhe zyrat e Shoqatës, por si qendër e gjithë komunitetit shqiptar në Filadelfia. Na besoi dhe na ndihmoi në ato ditë të vështira, dhe ne e kemi nderuar e respektuar në ato pak raste që na ka lejuar ky njeri i mirë. Shoqata "Bijtë e Shqipes", vërtet është bërë një zë i fuqishëm dhe gjithëpërfshirës i Komunitetit shqiptar në Filadelfia.

Beni po afron të 90-at. Ka mbetur ashtu, fisnik dhe fjalëpakë si 15 vjet më parë kur na u gjend pranë. Vjen shpesh te Shoqata, dhe ne i bëjmë ndonjë vizitë në shtëpi. Preket si fëmijë kur i themi fjalë të mira, që ai i meriton. Me fat ne që na u gjend për të na ndihmuar, por me fat edhe ai që na ka pranë, për të dëgjuar fjalë të mira nga vëllezërit e tij shqiptarë.

Si dy vëllezër vlonjatë u takuam kur bëheshim gati t'i festonim datëlindjen, e një grup shokësh i bëmë një vizitë në shtëpi. Dhe në veshët e mi akoma rreh ajo shprehja e tij e zakonshme, kur e ngacmoja me fjalë, e ai ma kthente; "ah ç' je një ti more vlonjat!", sikur do patjetër ta kujtojë Vlorën tonë, të bukurën e Perëndisë, që e lamë pas e shpirti s'na ndahet prej saj!

Petrit Zanaj,
Ish-Kryetar i Shoqatës "Bijtë e Shqipes", Filadelfia

ENDJE MBI NJË TREGIM



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Shkruar në 80-vjetorin e çlirimit të Ishullit të Sazanit nga forcat partizane, më 21 tetor 1944.

Ku ta dish?! Mbase edhe kjo "Endje..." mund të quhet tregim. Se rrëfimi mbi të cilin do të mundohem të end është i bukur, shumë i bukur! Shkruar nga dorë Mjeshtri,- ta dini, nuk e shkruaj kot me "M", - e mbi të bukurën o end bukur, o mos iu afro!

Dhimitër Shuteriqi është tregimtar i rrallë. Ndër më të mirët e Letërsisë Shqipe, bashkë me Naum Priftin, Kiço Blushin, Martin Camajn, Anton Pashkun, Faik Ballancën, Zija Çelën dhe disa si ata.

Por Shuteriqin do ta veçoja. Se si i thur ato fjali, se si i rrëfen ato ngjarje... Të mer për dore dhe të çon aty ku ecën, flet, mediton personazhi i tij, të bën një me të. Ti qesh, qan, vuan, gëzohesh si dhe ai. More vërtet bëhesh një me të! Ja, lexo "Zot dhe Rob" dhe jam i sigurtë që kur të lexosh fjalën e fundit, mbi pikën e fjalisë do të bjerë dhe pika e lotit tënd. Jo thjesht për fatin e Uanit, jo për shpirtin e tij të madh, por për zgjimin e atij shpirti, shpirtit të Robit. Lexojeni, lexojeni atë tregim.

Ose atë tjetrin, "Buka dhe Thika". E keni parë filmin "Udha e Shkronjave"? Pa dyshim filmi më i bukur shqiptar. E pra, gjithë atë kryevepër Vladimir Prifti dhe tre aktorët brilantë, Sandër Prosi, Ndreka Luca dhe Bujar Lako e ngritën mbi një tregim të Shuteriqit, "Buka dhe Thika". Lexojeni dhe më thoni, është filmi aq i bukur sa tregimi?!

Por mjaft, se tjetër gjë jam nisur t'u tregoj. E thashë në krye, 80 vjet më parë Sazani, ishulli ynë i vetëm, iu bashkua tokës mëmë. Shekuj e shekuj të tërë na e kishin zaptuar. Gjithë perandoritë e mbretëritë e botës, si për çudi ishin dashuruar me atë copë shkëmb në mes të detit, e nuk e lëshonin e nuk e lëshonin sikur ç'të bëhej! E ne e kishim plagë në zemër!

Ta kesh tokën tënde e të ta mbajë të rrëmbyer tjetri?! Dhe ku? Te dera e shtëpisë! E t'i rrinte Sazani Vlorës, po ç'thua?!, jo vetëm Vlorës, por gjithë Shqipërisë, si thika në fyt. Se gjithë perandoritë

e mbretëritë, nga romakët e venecianët që moti, e turqit e grekët e anglezët më vonë e fashistët e nazistët në Luftën e Dytë Botërore, e kishin mbushur me llagëme e topa, e kishin bërë Ishullin fortesë. Por Lufta e Dytë po mbaronte, Shqipëria ja, pothuaj ishte çliruar, partizanët kishin vënë në darë Tiranën dhe po bëheshin gati ta shtërngonin fytin e pushtuesit dhe atyre që u bënë një me të, po Sazanit, Sazanit si do t'i bëhej?!

Si do t'i bëhej? Do të çlirohej, ja, kjo do të bëhej! Po si? Do ta çlironte një skuadër partizanësh, ky ishte urdhri i Komandës së Brigadës XII. Dukej pak si aventurë ajo punë. Dhe ashtu ishte. Nuk ishte gjë e lehtë. Po prit, se lufta, çdo lloj lufte, është dhe aventurë, kjo s'do shumë mend. Se është aty guximi dhe zgjuarsia, rreziku dhe fati, forca dhe dhimbja, fantazia dhe realiteti, humbja dhe fitorja...

E ajo skuadër partizanësh, gjithë-gjithë nëntë djem të rinj, shumica nga Bregu, që ishin rritur me Sazanin në sy së largu që kur kishin lindur, shto dhe dy ushtarë italianë, nga ata që mbetën rrugëve të Shqipërisë pas dorëzimit të vendit të tyre, por që nuk dolën të hajrit, madje u bënë dëm, se u vodhën barkën me të mbërritur në Ishull dhe u zhdukën në det a në dreq, e pra ata nëntë partizanë do t'i hynin një aventure. E ç' morën me vete kur u nisën? Armët vetjake, një mitraloz, një dylbi, një hartë në cepin e së cilës lexohej "Carta Militare. Stato Maggiore. Secreto.", e ku ishte vizatuar shumë saktë Ishulli, nga një orë dhe elektrik dore, pinca dhe ushqime për tre ditë. Ishte e mërkurë. Kalendarit shënonte 20 tetor 1944. Nata ishte e ftohtë, ciknë. Qielli pa re, por dhe pa hënë. Mbushur me yje. Yje pa fund. Qiell më të yjësuar të mos kishe parë! Të kishe t'i numëroje! Po kush ia kishte ngenë?!

Zbritën në një cep të Ishullit përballë Vlorës, pak larg molit, që të mos shiheshin nëse aty kishte roje. Jo, roje s'kishte. Edhe fari ishte hedhur në erë. Ta kishin braktisur Ishullin gjermanët?! Dy zbuluesit që dërgoi komandanti i skuadrës raportuan se te moli rrëzë kodrave ishin vetëm disa ndërtesa të shkatëruara. Dhe rruga e makinave, që ishte dhe në hartë. Moli ishte rrethuar me disa bunkerë të vegjël si zgjoje bletësh, që më vonë do të mësonin që ishin çerdhe flakëhedhësish, e që gjermanët me ta kishin rrethuar krejt Ishullin. Por tashmë ishin shkatërruar, sikurse fortifikatat e tjera.

Puna nuk priste. Skuadra u nda në tre drejtime për të zbuluar ç' kish më tej në Ishull. Aty, mbi pyllin me pisha, në një çukë që dukej edhe natën, e lanë të takohen pas një ore. Parulla: "Çlirimi". Kundërparulla: "Atdheu".

Njëra nga patrullat zbuloi një tunel me një arsenal të tërë armësh e municionesh, e skuadra u armatos mirë me mitraloza të rinj "Fiat". Dy patrullat e tjera sollën lajmin se armiku ishte ende në Sazan. Të sigurt se nuk mund t'i sulmonte kush, ia kishin shtruar me të ngrëna e të pira, bërtisnin e këndonin nën tingujt e një fizarmonike e të një pianoje. Duhej të ishin shumë, se bëhej potere e madhe. Të hyje në ndërtesë edhe mund të bëhej, se roje nuk kishte, por ishte punë me rrezik, se partizanët aq ishin, më pak se gishtat e dy duarve. Vendosën të prisnin mëngjesin e të sulmonin. Zunë pozicione, duke e rrethuar mirë ndërtesën, mitralozat e automatikët gati, municion tashmë kishin me bollëk, dhe qëndruan në pritë. Një natë e ftohtë, e gjatë. Por ata djem kishin kaluar net e ditë ku e ku më të vështira. Pastaj në det agimi sikur vjen më shpejt. Dhe ja ku po zbardhte. Me daljen e diellit, një zë i çjerrë i zgjoi nazistët nga gjumi dhe ai që dukej të ishte komandanti i tyre, i cili i rreshtoi

në oborr. Si të mos i mjaftonte e pira e natës, edhe tani mbante një shishe në dorë dhe shante e ulërinte si i marrë, duke vështruar me dylbi horizontin në drejtim të Italisë. Si duket priste ndonjë anije për t'i marrë. Asgjë. Vetëm det, heshtje dhe ata ushtarët e tij, që mund të ishin më shumë se dyzet, e që partizanëve të maskuar mirë vetëm 40-50 metra larg, u dukeshin si një tufë bashibozukësh me ato uniformat e çrregullta, gjysmë a plotësisht të dehur e që pa zë, mbase të frikësuar, por sigurisht të demoralizuar, dëgjonin të sharat dhe nuk kundërshtonin grushtet apo shqelmat e komandantit të tyre pijanec. Në një moment ky urdhëroi të hapej një derë dhe pas pak, njëri pas tjetrit dolën përjashta me duart lart nga pesëdhjetë djem të tjerë, të lebetitur, të rreckosur e të verdhë në fytyrë, nga frika a nga uria a nga të dyja bashkë, se u mor vesh që ishin robër italianë, mbetur aty nga viti i shkuar pas kapitullimit të Duçes. Komandanti nazist urdhëroi të vareshin dy nga robërit dhe i caktoi me gisht. Trekëmbëshi me litarin ishin gati.

Atë çast krisën mitralozat partizanë. Nazistët e parë hëngrën dhe. I pari komandanti i tyre. Të tjerët nga sytë këmbët. Po ku do të vinin? Në grykat e armëve të rrethuesve. Ata që u shpëtuan plumbave tentuan të fshiheshin pas ndonjë muri ndërtese a shkurreje e transheje, por ishin gjithnjë nën zjarrin e partizanëve. Këta shtinin dhe bënin thirrje të dorëzohen. Dhe vërtet, duke parë se nuk kishin shpëtim, njëri pas tjetrit, kush me këmbëshën e bardhë si flamur e kush me të dy duart lart, u mblodhën në shesh.

Italianët gjithashtu nuk lëviznin. Duke parë se askush prej tyre nuk ra nga zjarri i rrethuesve, ata e kuptuan se kish ardhur shpëtimi i tyre e pas një çasti hutimi e ngrirjeje, shpërthyen në thirrje gëzimi e hareje: "Partigiani! Partigiani!" E filluan të kërcëjnë si të marrë.

Partizanët zunë tridhjetenjë robër, të gjithë esesë nazistë. Katërmbëdhjetë mbetën të vrarë. Robërit italianë u treguan çlirimtarëve të tyre se nazistët i trajtonin si skllëvër. I rrihnin, i burgosnin, i linin pa bukë, i vrisnin për mosgjë. Me muaj pritën nazistët anijet e tyre t'i merrnin, por më kot. Ndërlidhja me radio me komandën e tyre u prish javët e fundit, e, pasi kuptuan se dhe Vlora ra në duart e partizanëve, u bënë si të marrë. Disiplina, disiplina e famshme hitleriane, kish marrë fund. Morali përtokë. Frika në qiell. As roje nuk nxirrte dot ai komandanti i tyre, megjithëse kishte pushkatuar 2-3 nga të tjihtë, por ata ktheheshin nga vendrojat pa vajtur mirë atje.

Robërit nazistë i mbyllën në një tunel, ku nuk kishin nga të shkonin, dhe me ndihmën e italianëve, partizanët kërkuan ndonjë mjet lundruer, por nuk gjetën. Si ta lajmëronin komandën se misionin e kishin kryer? Lu kthyen traditës së hershme: ndezën zjarre dhe filluan të qëllonin në ajër. Tym e flakë e bënë Sazanin dy net rresht, por vetëm ditën e tretë, Komisari i Brigadës XII mbërriti me një benzinatë që dikush e kish fshehur në Pashaliman. "Po ju ndezët qiell e tokë a derëbardhë!", - iu drejtua i gëzuar partizanëve çlirimtarë, duke i përqaftuar e përgëzuar për aktin e madh të çlirimit dhe bashkimit pas shekujsh të Ishullit të Sazanit me tokën mëmë.

Unë këtu po e mbyll "Endjen..." time mbi rrëfimin e Dhimitër Shuteriqit. Ai rrëfim, i marrë nga goja e komandantit të skuadrës çlirimtare, me fjalët e Mjeshtrit është ku e ku më i bukur, më i gjallë e me më shumë detaje se në rrëfimin tim. Prandaj ju them ta lexoni në librat e tij. Në "Tregimet e Zgjedhura" a në "Vepra Letrare 6", e siç u thashë, jo vetëm atë, por edhe Tregimet e tjera, se nuk do të zhgënjeheni. Përkundrazi.

Drejt 80-vjetorit 'Skënderbegas'

VERI TALUSHLLARI
Ish-skënderbegas, 1971-1975

Marsi që vjen, më 2025, shënon 80-vjetorin e hapjes së Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej". Një Shkollë që tani i përket historisë, pasi funksionoi vetëm 47 vjet. Por mjaftueshëm për ta shkruar emrin me germa ari në dy nga shtyllat ku mbahet Kombi dhe Shteti: Në Historinë e Ushtrisë më moderne që shqiptarët kanë patur në shekuj dhe Historinë e Arsimit shqiptar, posaçërisht atij të Mesëm të Përgjithshëm e atij Profesional.

Të gatshëm për të sharë e mohuar gjithçka të ngritur e të ndërtuar në regjimin e kaluar, edhe ndaj asaj Shkolle nuk kanë munguar nëmat e gurët, madje as ironitë e sarkazmat. Por ne nuk do të merremi shumë me to, megjithëse është e pamundur të kalohen krejt në heshtje. Por do të themi diçka për vlerat dhe vendin që Shkolla jonë zë në Historinë e Ushtrisë dhe të Arsimit Shqiptar. Shkolla "Skënderbej", në kuptimin sa figurativ aq dhe real, i ka themelet të Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar dhe Ushtrisë NÇ kundër nazi-fashizmit dhe bashkëpunëtorëve të tyre, si pjesë e Frontit Antifashist Botëror dhe Aleancës Antifashiste Anglo-Sovjeto-Amerikane.

Ajo lindi pikërisht në atë kohë, mes krismave të armëve, kur flamujt e fitores nuk ishin ngritur ende mbi Rajshtag. Realisht sepse në bankat e asaj Shkolle, në ditën e parë, u ulën partizanë, djem dhe vajza luftëtarë të moshës 12-15 vjeç, për të cilët drejtuesit e Ushtrisë dhe të pushtetit që po lindte nga Lufta, menduan me të drejtë se lufta e tyre e ardhshme ishte dija. Ishte një shkollë në kushte lufte e paslufte, me kushtet më minimale për jetesë e mësimdhënie, por me shikim nga e ardhmja. Hapja e Shkollës së Pionierëve të Luftës, (Shkolla mori emrin "Skënderbej" në vitin 1947), më 28 mars 1945, është një akt shtet-formues dhe arsimdashës.

Në momentin që kjo Shkollë u mbyll, në gusht të vitit 1992, në bankat e saj kishin kaluar rreth 35 mijë nxënës. Shkolla "Skënderbej" ishte burimi kryesor për tre Shkollat e Larta Ushtarake, Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" në Tiranë, Shkollën e Aviacionit dhe atë të Marinës, këto të fundit në Vlorë, për të gjitha specialitetet, armët e shërbimet që kishte nevojë Ushtria. Por nga bankat e asaj Shkolle, veç oficerëve të Ushtrisë, kanë dalë figura të shquara në të gjitha fushat e jetës shoqërore, shkencore, kulturore e sportive të vendit tonë. Jo vetëm drejtuesit e lartë të njësive e reparteve ushtarake, por skënderbegas kanë qenë edhe politikanë, mjekë, shkrimtarë, sportistë, gazetarë, diplomatë, artistë, pedagogë, juristë.



Si çdo institucion shoqëror, shtetëror, arsimor etj., edhe Shkolla "Skënderbej" pati procesin e vet të rritjes e zhvillimit, pasurimit e përsosjes, pati probleme, vështirësi, suksese, dështime, arritje... E pra, edhe ajo nuk mund të mos ishte një pasqyrë e vetë shoqërisë shqiptare. Por duke parë bilancin e arritjeve të asaj Shkolle, e sidomos boshllëkun që ajo ka lënë në këto më se 30 vjet pas aktit banditesk, përbuzës, antiarsimor, antikulturor, antikombëtar të mbylljes së atij burimi kuadrosh që Shqipërisë do t'i duheshin në fushën e Sigurisë Kombëtare, pa folur për fusha të tjera, them me bindje se ajo Shkollë i tejkaloi objektivat dhe shpresat, shkoi tej detyrimeve e mundësive të një Shkolle të Mesme. Në çdo stad të ngritjes dhe modernizimit të Ushtrisë Popullore, Shkolla "Skënderbej" kishte në gatishmëri një kontingjent nxënësish për të marrë përsipër ngritjen dhe funksionimin e një arme a shërbimi që Komanda e Përgjithshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm planëzonin. Këmbësorët e parë, Aviatorët e parë, Detarët e parë, Artiljerët e parë, Kundërajorët dhe Radiolokatorët e parë, Ndërlidhësit apo Xhenjerët e parë, Prapavijasisit apo Tankistët e parë, Kimistët, Zbuluesit, Automobilistët... të gjithë kanë qenë skënderbegas. Dhe pas të parëve, brezat vazhduan

njëri pas tjetrit, edhe më të përgatitur, edhe më të ditur. Sepse programi mësimor erdhi duke u zhvilluar e përmirësuar, niveli i kërkesave ishte më i lartë, më i vështirë. Nuk mund të krahasohet p.sh., programi i vitit 1947 me atë të vitit 1974. Në vitin 1947 ishin kaluar programet e analfabetizimit dhe njohuritë ishin ato të nivelit nën të mesëm. Kurse në vitin 1974 ekipi përfaqësues i Shkollës “Skënderbej” në konkursin mes shkollave të mesme të Tiranës, padyshim ndër më të mirat në Shqipëri, i mundi të gjitha, doli në finale, dhe vetëm një vendim qesharak dhe absurd i ardhur “nga lart” ia hoqi fitoren, sepse binim në sy për keq po të fitonin ushtarakët. Konkursi përfshinte shkencat shoqërore dhe ato ekzakte, Letërsi, Histori, Gjeografi, Fizikë, Kimi dhe lëndë të tjera. Sepse Shkolla “Skënderbej” vepronte me programet mësimore të Ministrisë së Arsimit, plus përgatitja speciale ushtarake. Prandaj nuk është e rastit që skënderbegasit që shkonin për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes në Universitetin e Tiranës, në degë të tilla si Letërsi, Ekonomi, Inxhinieri, Mjekësi etj., dilnin me rezultate të larta.

Po përmend këtu pak emra për ilustrim, duke u kërkuar falje qindra kolegëve të tyre, po aq të suksesshëm. E dinë lexuesit se një nga ata që thirren si “bisturi e artë”, kirurgu Ismail Feta, ka qenë skënderbegas? Siç ka qenë skënderbegas Dr. Mantho Nakuçi, ikona e dermatologjisë shqiptare. Siç kanë qenë skënderbegas edhe Sabri Godo e Fatmir Haxhiu, Kujtim Çako dhe Anastas Angjeli, Ilir e Zenel Shalari, Pandi Zguro, Arben Duka, Lulëzim Bilbili, Xhafer Qamirani, Hasan Çipuri, Bashkim Myhedini, Thanas Tane, Hysni Milloshi, Roland Qafoku... dhe sa e sa të tjerë. Nuk po përmend kuadrot e lartë ushtarakë, komandues njësisish dhe drejtues të lartë ushtarakë, deri Shefa të Shtabit të Përgjithshëm, profesorë dhe pedagogë të Akademisë dhe Shkollave të Larta Ushtarake.

Çfarë duhet të bëjmë këtë 80-vjetor

Hapi i parë do të ishte një takim i Kryetarëve të Shoqatave të Ushtarakëve dhe krijimi i një komisioni, ku të angazhohen figura vërtet përbashkuese, si Presidenti Alfred Moisiu, Gjeneral Perlat Sula dhe emra të këtij kalibri. E kam shkruar edhe diku tjetër se



asgjë nuk na ndan, asgjë nuk do të marrim me vete, (jeta bën të vetën dhe radhët tona po rrallohen), gjithçka na bashkon e së pari fakti që jemi betuar mbi një Flamur për t'i shërbyer Atdheut. Na bashkon fakti që kemi sakrifikuar rininë, gjithë vitet tona më të bukura larg familjeve, larg prindërve, maleve e fushave të Shqipërisë. Na bashkon fakti që kemi qenë pjesë e Ushtrisë më moderne që shqiptarët kanë patur në gjithë historinë e tyre mijëra vjeçare. Dhe në përgjigje të atyre që hedhin gurë e baltë mbi ne dhe Ushtrinë ku ne shërbyem, na bashkon krenaria që për 50 vjet askush nuk guxoi të vinte në rrezik ekzistencën e shtetit shqiptar, të lirisë dhe rendit kushtetues. Përtej politizimeve, ne mbajtëm me nder fjalët që shqiptuam në Betimin Ushtarak.

**Autori është zëvendës president i Shoqatës së Ushtarakëve Shqiptarë “SKËNDERBEJ USA”, në Nju Jork.*





“Spiunazhi turistik”, instrumenti më i ri i luftës hibride ruse



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“ Pas përplasjeve diplomatike mes Moskës dhe Tiranës ndodhi edhe incidenti në uzinën ushtarake të Gramshit. Kjo uzinë është përmendur në mediat tona dhe të huaja se mund të rivihej në punë për interes të NATO-s, për prodhim të municionit me kalibër standard të aleancës. Ky fakt besohet se e ka kthyer ish-uzinën në shënjestër të GRU-së dhe njësisë së saj 29155 me “turistët” e saj.

Ë një studim nga Universiteti i Portsmouth në Angli, lidhur me tendencat e inteligjencës për vitet 2024–2030 dhe në vazhdim, është zbuluar se “spiunazhi turistik”, është një fenomen në përhapje si në terrenin real ashtu edhe atë online. Operacionet klandestine ruse në Europën Juglindore, pavarësisht luftës në Ukrainë, sipas Universitetit të Portsmouth, parashikohen të jenë më të shpeshta deri në 2030, por edhe pas. Shumë aktivitete të spiunazhit politik, ushtarak dhe industrial, janë zhvilluar dhe drejtuar si kundër Shteteve të Bashkuara por edhe jashtë saj, para dhe përgjatë vitit 2023, përmes shteteve autoritare të Ruisë, Iranit dhe Kinës. Studimi parashikon se viti 2024 do të jetë i ngjashëm me vitin e kaluar, ndërsa Kina e Rusia do të vazhdojnë të investojnë në operacionet e tyre të spiunazhit, që synojnë si Shtetet e Bashkuara ashtu edhe aleatët e saj në NATO. Për vitin akademik 2023-2024 “Universiteti Shtetëror i Moskës” njofton se ofron programe specializimi në luftën hibride, programe të pa para dhe dëgjua më parë në sistemin arsimor civil rus. Kjo risi në fushën akademike, ka si mision kryesor përgatitjen dhe rekrutimin e mundshëm të studentëve të degëve civile të ndryshme, me aftësi të spikatura sidomos në teknologjinë e informacionit, të dhënë pas udhëtimeve dhe mendje hapur për t’u përdorur si “spiunë turistikë”.

Instrumentet e luftës hibride që do përdoren, sipas universitetit të Portsmouth, do të vazhdojnë të kenë target aktorët qeveritarë, sektorin privat, por edhe pronësinë intelektuale. Lehtësia dhe liria e lëvizjes së përfituar nga shoqëritë demokratike, është në favor të “turistëve spiunë”, çka nuk është aspak e tillë në shtetet e tyre autoritare, ku çdo i huaj survejohet, ndiqet dhe kontrollohet rreptësisht. Edhe vendi ynë, duke pritur disa milionë turistë në sezon, kryesisht nga Europa lindore dhe ish-BS gjatë verës, është i ekspozuar nga një depërtim dhe përdorim keqdashës i mikpritjes dhe i hapjes. Misionet klandestine ruse në Europën juglindore, pavarësisht por edhe për shkak të luftës në Ukrainë, parashikohet të jenë më të shpeshta deri në 2030, madje edhe më vonë. Tanket dhe avionët nuk janë të përshtatshëm të përdoren në Ballkan, pas konsumit në frontin ukrainas, pasi Putin nuk e bazon luftën e tij kryesisht tek armët e zjarrit. Ai është një operativ i KGB-së, që njeh, beson dhe operon me mjete hibride 3S (spiunazh, subversion, sabotazh). Madje në 2022 “lufta hibride” është futur në programet mësimore të universiteteve shtetërore civile të Rusisë.

Kjo kategori e agentëve “turistikë” 3S (spiunazh, sabotazh, subversion), është e përbërë nga persona jo anëtarë aktiv të shërbimeve sekrete dhe inteligjente. Ato kontaktohen nga inteligjenca ushtarake, qysh në universitete për të kryer një “punë të caktuar”. Motivi i tyre për t’i shërbyer agjencisë është kryesisht ai klasik (MICE) që do të thotë paraja, ideologjia, shtrëngimi apo egoja. Nganjëherë “spiunëve turistë” u paguhen vetëm shpenzimet e pushimeve për punën e kryer, që në shumë raste janë 10 ditë pushime për vetëm 10 minuta video në interes të inteligjencës ruse. Çdo aftësi apo hobi i të rinjve përdoret nga shërbimet e inteligjencës kryesisht ushtarake ruse, që sot janë edhe profesorë të universitetit shtetëror të Moskës. Ata trajnohen për të marrë informacionin e synuar, në mënyrë thuajse të hapur, por me “histori mbulimi” ose “legjendim”, të mirë siç quhet në gjuhën e inteligjencës. Studentët e përzgjedhur trajnohen në drejtim të patriotizmit, luftës së “drejtë” të Rusisë, fajësimin e Perëndimit për gjithçka shkon keq në Rusi, etj. Më pas nga ekspertët e spiunazhit u mësohen, vetëmbrojtje fizike, sjellja ndaj kundërzbulimit vendas, teknikat e marrjes në pyetje nga prokuroria, përdorimi i pajisjeve, përsëritja e “vijës së sjelljes” në mënyrë të përkryer në çdo orë të ditës dhe natës; mënyrat e sjelljes dhe shkrirjes me publikun; afrimit drejt objektivit; marrjes së fotos, videos, dokumentit apo përgjimit të kërkuar etj. Rëndësi i kushtohet trajnimit për fshehjen e informacionit të vjedhur, duke e përzier atë me shumë informacion turistik, kulturor, muzikor nganjëherë edhe erotik. Çfarë është kryesorja, studentët trajnohen të justifikojnë, në çdo situatë rrjedhshëm dhe pa ngatërresa, pse ndodhen në atë vend, në atë kohë dhe çfarë po bëjnë. Ata shkrihen me masën e turistëve, janë si ata, sillen si ata frekuentojnë të njëjta vende si turistët e tjerë, fotoqojnë dhe filmojnë disa giga bite, ku midis tyre vetëm 10% mjaftojnë të jenë filmime, foto apo materiale të tjera me interes dhe të porositura nga agjencitë e inteligjencës ruse.

Historitë e tyre të “cover story” janë shumë afër të vërtetës, pasi realisht ata janë njerëz që nuk përdorin emra të rremë, zotërojnë hobi të veçantë, kanë profilet e tyre reale në mediat sociale facebook dhe X, kanë publikuar shumë nga “udhëtimet turistike” që po bëjnë, madje kanë edhe një rreth të gjerë miqsh që deklarojnë me “dorë në zjarr” që nuk i njohin si agjentë të

GRU-së, por blogerë pasionantë, për shembull. Në disa raste edhe brenda grupit të “turistëve spiunë” vetëm njëri e di vërtet çfarë bën, të tjerët përdoren nga ai si “mbulim” për të gjetur foto, video, objekte vendndodhje historike dhe interesante, në dukje të parë. Këto “cover story” i bëjnë “turistët spiunë” të mbrohen ndaj kundërzbulimit vendas dhe të aleancës, si dhe t’ia bëjnë të vështirë prokurorisë të ngrejë një akuzë. “Spiunët turistë” nuk figurojnë në asnjë regjistër të shërbimeve të inteligjencës, edhe nëse këto regjistra bien në dorë të kundërzbulimit, pasi ata janë nënkontaktorë.

Studentët snobë dhe pasionantë të përzgjedhur, rekrutohen vetëm në interes të një misioni, të një “pune” të vetme. Pas kësaj marrëdhënie me to ndërpritet duke i trajtuar ato si “agjentë një-përdorimësh”, kjo me qëllim shmangien e “rrjedhjeve”, rrezikut nga “agjentët e dyfishtë” apo dhe tradhtive të mundshme që ndodhin në botën e spiunazhit. Në disa raste për të rritur vështirësinë e zbulimit të tyre nga kundërshtari apo të dyshimit për to, “turistët spiunë” rekrutohen mes nacionaliteteve, moshave dhe sekseve të ndryshme me qëllim fshehjen e kombësisë ruse. Për të kryer “punën”, rekrutët përdorin periudhën e verës, ku justifikimi i udhëtimit turistik është i besueshëm, i përshtatshëm dhe i natyrshëm. Të rinjtë spiunë në shumicën e rasteve nuk e njohin dhe nuk dinë asgjë për organizatën në përgjithësi, strukturën e GRU-së, FSB-së, SVR-së, apo agjencive të tjera që i drejtojnë. Ata thjesht dinë punën dhe njohin vetëm “oficerin e çështjes”, me të cilin nuk kanë asnjë kontakt telefonik, fizik apo në rrjetet sociale. Në këtë mënyrë edhe nëse “spiunët turistë” rrëfehen apo bëhen “agjentë të dyfishtë”, ata nuk dinë asgjë me rëndësi që mund të dëmtojë organizatën porositëse të “punës”.

Sipas mediave ndërkombëtare, shumë aktivitete të dyshimta janë kryer nga njësi speciale 29155, e cila është e mbushur me “turistë” që qarkullojnë lirshëm në Perëndim. Kjo njësi vepron në të gjithë Evropën si grupi kryesor, i atentateve, sabotazhit dhe luftës psikologjike të GRU-së. Përveç, sabotimeve kundër Çekisë, Polonisë, Bullgarisë etj., veçojmë si shumë domethënëse, një shpërthim depoje municioni në qershor 2021, në Çaçak të Serbisë, në fabrikën e municioneve “Sloboda”. Për këtë akt, media e pavarur serbe e akuzoi drejtpërdrejt Moskën. Analistët gjykojnë se Moska me këto akte synon ta mbajë Beogradin, njëkohësisht të mbështetur, por edhe të kontrolluar e shantazhuar sipas parimit, beso por kontrollo. Në nëntor 2019, në një video të publikuar dhe që gjendet në youtube, provohet spiunazh i pastër nga Rusia kundër Serbisë. Nënkolonel Georgiy Kleban, zëvendës atashe ushtarak në ambasadën ruse në Beograd dhe një ushtarak i lartë serb, shihen qartë duke shkëmbyer çantën me dokumente, me një çantë me para. Vuçic, shumë i zhgënjyer, i bën ambasadorit rus në Beograd vetëm një pyetje për skandalin “pse?”. Rusët, ndoshta si shumë vende të tjera edhe në Perëndim, në fushën e spiunazhit nuk njohin miqësi të përjetshme, por vetëm interesa të përhershme. A mund të ketë ndodhur në vendin tonë një veprimtari e tillë “spiunazhi turistik”? Përgjigja është po, sepse ekzistojnë motivet, mjetet dhe mundësitë në duart e agjencive të shteteve armiqësore me vendin tonë dhe aleancën ku ne jemi pjesë. Përveç të qenit anëtar i NATO-s, edhe në marrëdhëniet mes dy vendeve tona ka patur përplasje, të cilat mund të përdoren si shenjë hakmarrjeje dhe ndëshkimi nga ana e Kremlinit. Shqipëria



vazhdon të mbështesë Ukrainën, duke organizuar një Konferencë për të, më 28 shkurt 2024. Një pretext mund të jetë fakti që qeveria jonë e shpalli Aleksei Krivosheev person “non grata” dhe i kërkoi atij të largohej nga vendi brenda 72-orësh, për shkak të shkeljeve “të përsëritura” të kufizimeve të pandemisë nga diplomati rus që nga prilli i vitit 2020. Më 7 mars 2022, Rusia shpall zyrtarisht Shqipërinë vend armik, për arsye të kundërshtimit zyrtar dhe sanksioneve si shkak i agresionit mbi Ukrainë.

Në rastin e vendit tonë, ka disa indikatorë të aktivitetit të dyshimtë të “turistëve rusë”, ku njëra është një ngjarje e 15 tetorit 2021, në zonën e Golemit në Kavajë, ku Sergey Burenkov 60 vjeç, gruaja e tij Natalia 58 vjeç, vajza e tyre Ekaterina 31 vjeç dhe bashkëjetuesi i saj Nikita Belousov, 37 vjeç, u helmuan nga monoksidi i karbonit. Shtetasi rus Sergey Vasiljeviç Burenkov, në vitin 2015 ka shërbyer si kolonel policie i OMON në zonën e Irkuyskut. Në maj 2023 pezullohen hetimet, pasi pala ruse nuk i përgjigjet, pa asnjë shpjegim letërporsisë së prokurorisë shqiptare.

Shqipëria është për rusët dhe europiano-lindorët, një destinacion i preferuar turistik, ku vetëm për vitin 2021 u regjistruan 110 205 turistë, që hynë në Shqipëri. Nga të dhënat zyrtare të policisë kufitare rezulton se në Shqipëri janë me leje qëndrimi 130 shtetas rusë, ku nuk llogariten turistët. Zyrtarisht për vitin 2015 hynë në Shqipëri 16.192 rusë; në 2016 - 15.367 shtetas rusë; në 2017 - 17.160 shtetas rusë; në 2018 - 24.915 shtetas rusë; 2019 - 34.146 shtetas rusë; 2020 - 4.590 shtetas rusë dhe 2021 – 36.475 shtetas rusë. Zak Topuzi, kryetar i shoqatës së turizmit, thotë që ka ulje për sezonin e verës 2022 të ndikuar nga lufta, por që në 2023-2024 dhe vazhdim, rusët do të jenë mbi 150 mijë turistë, ose rreth 2,5% të numrit të përgjithshëm të turistëve. Në këtë fluks

kaq të madh, aftësia dhe mundësia për të infiltruar agjentë sekretë të tipit turistik, është e madhe. Me një referim, policia kërkonte nga prokuroria hetimin e dy shtetasve rusë, Georgi Budanov dhe Vladislav Cherkasov, të cilët kanë vizituar Shqipërinë para dhe gjatë stërvitjes ushtarake “Defender 21” dhe të dyshuar për dhënie dhe sigurim informacioni. Prokuroria e Tiranës e ka regjistruar çështjen në bazë të neneve 213 dhe 214 të Kodit Penal; që kanë të bëjnë me dhënie dhe sigurim informacioni sekret shtetëror. Dyshimet për ta janë ngritur, sepse shtetasit e huaj, kanë qëndruar pranë bazës ushtarake në Urën Vajgurore. Burime mediatike bëjnë të ditur se në kuadër të masave të sigurisë së stërvitjes “Defender Europe 21” është mbledhur informacion për një qytetar nga Rusia, i cili ka hyrë më 12 maj në pikën e kalimit kufitar në Muriqan dhe pas kontrollit i është gjetur një dron. Vladislav Cherkasov ka deklaruar se do vizitonte qytetin e Durrësit, kohë kjo që përkonte me stërvitjen ushtarake të “Defender Europe 21”. Ai është një ndër dy qytetarët rusë që kanë hyrë në Shqipëri, ndërsa Prokuroria e Tiranës e ka vënë nën hetim si të dyshuar për spiunazh.

Pas përplasjeve diplomatike mes Moskës dhe Tiranës ndodhi edhe incidenti në uzinën ushtarake të Gramshit. Kjo uzinë është përmendur në mediat tona dhe të huaja se mund të rivihej në punë për interes të NATO-s, për prodhim të municionit me kalibër standard të aleancës. Ky fakt besohet se e ka kthyer ish-uzinën në shënjestër të GRU-së dhe njësisë së saj 29155 me “turistët” e saj. Ngjarja në ish-uzinën e armëve në Gramsh, më 20 gusht 2022, na tregon qartë se “turistët rusë” janë prezentë dhe madje duke operuar për një kohë të gjatë në rajon dhe Shqipëri, sidomos pas fillimit të luftës në Ukrainë. I riu rus Mikhail Zorin është arrestuar nga rojet tona, pasi ka përdorur spërkatës neuro-paralizues, duke

Shqipëria është për rusët dhe europiano-lindorët, një destinacion i preferuar turistik, ku vetëm për vitin 2021 u regjistruan 110 205 turistë, që hynë në Shqipëri. Nga të dhënat zyrtare të policisë kufitare rezulton se në Shqipëri janë me leje qëndrimi 130 shtetas rusë, ku nuk llogariten turistët. Zyrtarisht për vitin 2015 hynë në Shqipëri 16.192 rusë; në 2016 - 15.367 shtetas rusë; në 2017 - 17.160 shtetas rusë; në 2018 - 24.915 shtetas rusë; 2019 - 34.146 shtetas rusë; 2020 - 4.590 shtetas rusë dhe 2021 – 36.475 shtetas rusë.

ua hedhur në fytyrë ushtarëve roje. Ukrainasit Fedir Alpatov 25 vjeç me arsim të lartë, rusja Svetlana Timofeeva e 33 vjeç dhe rusit Mikhail Zorin 23 vjeç, u janë sekuestruar pas arrestimit: një automjet, dy dronë, sasi të konsiderueshme valute, një dylbi e shikimit natën, një laptop, disa karta sim, një hardisk i jashtëm, një fishek model 56 kalibër 7,62 mm, një predhe fisheku arme zjarri kalibër 12.7 mm, pajisje kampingu të ndryshme, një spërkatës neuro-paralizues dhe 6 telefona celulare. “Bloggerët” aktualisht janë liruar nga gjykata, por nga analiza e mjeteve speciale që përdorën, e rëndësishë së objektit që fotografuan dhe filmuan, e sulmit me spërkatës neuro-paralizues ndaj një ushtaraku me uniformë dhe emblema të dallueshme kombëtare, e bën këtë ngjarje “spionazh turistik” tipik rus.

“Vija e sjelljes” si bloggerë dhe kërkesa e Ruisë për ekstradim të Svetlana Timofeeva, se gjoja kërkohet për një vepër të ngjashme në Moskë; janë praktika profesionale të shkollës së spiunazhit, që duhet të bindë gjithëkënd në Shqipëri.

Incidenti që ndodhi në Uzinën e Përpunimit të Armëve në Gramsh ka marrë edhe vëmendjen e mediave ndërkombëtare. Kanali informativ britanik “Sky News”, i cili i ka kushtuar një rëndësi të madhe luftës në Ukrainë, e raportoi ngjarjen të shtunën, një ditë më vonë, më 21 gusht 2022. Por edhe tabloidi gjerman “Bild” ka komentuar ngjarjen e rëndë të ndodhur në ish-uzinën e armëve: “Situatë e ndjeshme në Shqipëri! Dyshimi i qartë: ata ishin agjentë rusë”. Në lidhje me pasaportat e zbuluara ukrainase, “Bild” thotë: “Nuk jemi të befashuar, pasi qindra mijëra pasaporta ukrainase përfunduan në duart e rusëve në territoret e pushtuara. Sigurisht agjencia ruse e GRU-së qëndron pas sulmit”. Edhe mediat greke kanë raportuar për ngjarjen e rëndë të ndodhur në Gramsh, ku dy rusë dhe një ukrainas sulmuan dy ushtarakë shqiptarë, pasi këta i ndaluan të futen brenda fabrikës së armëve. “Zougla.gr” ka bërë

edhe një historik të shkurtër për fabrikën, duke theksuar se në të kaluarën ajo ka prodhuar pushkë ruse AK-47 dhe tani përdoret për të çmontuar armët e vjetra. Gazetari i njohur bullgar, Christo Grozev, pjesë e ekipit që zbuluan agjentët rus që helmuan ish-spiunin rus Sergei Skripal, shkruan se një nga ruset e ndaluara në Gramsh, Svetlana Timofeeva, ka një histori interesante udhëtimi. Sipas tij ajo ka udhëtuar disa herë në shoqërinë e ‘fotografëve’ dhe se madje njëri prej tyre është arrestuar në Egjipt dhe Ministria e Jashtme ruse ka ndërhyrë për ta liruar. “Një nga ruset e ndaluara në Shqipëri është Svetlana Timofeeva. Ajo ka një histori interesante udhëtimi: kalimet kufitare tregojnë se ajo udhëtoi shumë herë në shoqërinë e ‘fotografëve’, të paktën një prej të cilëve u arrestua këtë janar në Egjipt dhe duhej të shpëtohej nga FSB-ja”, - shkruan Grozev.

Deklarata e përbashkët e Zelensky-it me kryeministrin Rama, në samitin e Tiranës për Ukrainën, më 28 shkurt 2024, për riaktivizim të prodhimit të armëve dhe municioneve në Shqipëri, është një tjetër provë që Gramshi ishte një operacion spiunazhi i ditur nga rusët dhe u përgatit që më parë. Në Kuçovë, inaugurimi i bazës ndihmëse ajrore të NATO-s, më 4 mars 2024, do të përbëjë një objekt më të “pëlqyeshëm” për “turistët rusë” të verës së vitit 2024 dhe në vazhdim.

Ndërsa mediat ndërkombëtare dhe NATO, i përgëzuan FARSH-të për këtë sukses, disa media dhe analistë “gjithologë” shqiptarë spiunazhin rus në Gramsh e “hëngrën” siç ishte gatuar në kuzhinat e GRU-së. Më 24 shkurt protagonistja ftohet në një emision televiziv dhe trajtohet si viktimë e mentalitetit komunist, të përbashkët të Shqipërisë dhe Ruisë?! Në rajonin tonë ka media dhe individë të sponsorizuar nga Rusia, që qëllimisht mund ta kenë bërë këtë, por ka gjithashtu edhe një grup analistësh dhe diplomatësh naivë, që nuk janë njohës të gjeopolitikës dhe instrumenteve hibride të Putinit. Spiunazhi në ish-uzinën e armëve në Gramsh dhe tentimi për t’u infiltruar me agjentë në stërviçet e rëndësishme të NATO-s (Georgi Budanov dhe Vladimir Cherkasov), në Shqipëri janë tregues dhe alarm për mbrojtjen dhe sigurinë tonë dhe aleancës. Spiunët rusë, sllavë apo serbë, ukrainas apo bjellorusë, të rekrutuar dhe maskuar, si diplomatë, analistë, gazetarë dhe turistë, mbeten sfida e re për organet e sigurisë të shteteve ballkanike. Rusia, e cila është dobësuar nga sanksionet ndërkombëtare dhe pushtimi i komplikuar dhe me kosto të lartë i Ukrainës, pritet t’i rrisë sulmet 3S kundër aleatëve strategjikë të SHBA-së, dhe NATO-s në Evropë dhe në Ballkan.

Analiza e ngjarjeve të ndodhura në vitet e fundit, janë indikatorë se si parashikohet të jetë periudha 2024 - 2030, në raport me Ruisë. Aktualisht po ndodh, nga janari deri më 31 maj 2024, nga rreth 90 000 trupa nga 31 vende anëtare të NATO-s dhe Suedia po zhvillohet stërviçja “Steadfast Defender 2024”. Kjo stërviçje do të zhvillohet në hapësirat e shteteve në kufi dhe pranë Ruisë si Finlanda, Estonia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Letonia, Lituania, Norvegjia, Polonia, Romania, Sllovakia, Suedia dhe MB. Përveç formave të tjera të luftës hibride, hapësira e stërviçjes sigurisht do të jetë e frekuentuar nga “turistët spiunë” rusë, që do të vizitojnë rajonet ku do të zhvillohet kjo stërviçje, që është target i inteligjencës armike të NATO-s, e cila këtë javë është me 32 anëtarë.

Stërvitjet NATO/SHBA, përtej kakofonisë bolshevike



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

Sigurisht e kam ndjekur me interes të shtuar, konfirmimin e nisjes së stërvitjes së NATO-s, “Steadfast Defender 2024”, e cila do të zgjasë deri në maj 2024. Në kapacitetin e ekspertit për Sigurinë Kombëtare, rajonin dhe NATO-n, në vijim po paraqes një përmbledhje me mesazhet gjeostrategjike si dhe kakofoninë politike rreth kësaj ngjarjeje madhore për historinë e Aleancës:

Së pari, qëllimi ose mesazhi gjeopolitik i stërvitjes “SD-2024” është: “të testojë, kompaktësojë dhe përmirësojë fuqinë ushtarake të NATO-s për të shkurajuar (deterrence), përballur si dhe mposhtur sulmet e armiqve potencial ndaj tërësisë territoriale të 31 vendeve anëtare dhe ndaj interesave të Aleancës Transatlantike”.

Ndërsa qëllimi dhe mesazhi strategjik i “Steadfast Defender 2024” është: “të demonstrojë fuqinë e pamposhtur ushtarake, përfshi aftësitë manovruese të NATO-s për të dislokuar me shpejtësi forcat nga Amerika e Veriut dhe 29 vendet europiane si dhe të përmirësojë ndërveprueshmërinë e trupave në fushëbetejë”, nën moton “Të bashkuar mbetemi të pathyeshëm”.

Po ashtu objektivi operacional i kësaj stërvitjeje mbetet: “të certifikojë ekzekutimin e planeve të mbrojtjes, që NATO ka përgatitur/planëzuar në tre dekadat e fundit”. Edhe pse në deklaratën e Komandantit Suprem të NATO-s, njëherësh edhe i Forcave Amerikane në Europë, gjeneral me 4 vje, Christopher Cavoli, ndoshta për “kujdes diplomatik” nuk përmendet Rusina – Putiniste, por nënvizoi se: “Kjo stërvitje do të zhvillohet mbi një skenar të simuluar të konfliktit në zhvillim me një kundërshtar të afërt, duke iu përgjigjur kështu një sulmi nga armiqtë potencial”. Ndërsa, duhet thënë se mbas sulmit neo-nazist ndaj sovranitetit të Ukrainës, nuk ka mbetur më asnjë sekret që në planet strategjike të NATO-s, Rusia - Putiniste është (vetë) identifikuar si: “kërcënimi serioz ndaj rendit global të sigurisë, ndaj integritetit territorial të 31 anëtarëve si dhe ndaj interesave gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike”.

Më konkretisht, në “Steadfast Defender 2024” do të angazhohen

qindra njësi luftimi dhe ato të mbështetjes nga 31 vendet anëtare të NATO-s, përfshi Suedinë (që pret vetëm nënshkrimin e Ankarasë). Qendra e gravitetit të kësaj stërvitjeje do të jenë vendet Baltike si dhe ato të vijës parë, të cilat shihen më të rrezikuara nga një sulm ushtarak i Rusisë, ndërsa peshën kyçe për mbështetjen do e mbajë Gjermania dhe vendet në skajet e aleancës si Norvegjia dhe Rumania.

Në këtë stërvitjeje do të angazhohen rreth 90,000 trupa; mbi 50 asete strategjike detare, përfshi aeroplanmbajtëse, fregata, destrorjerë, etj.; mbi 80 kapacitete ajrore si F-35, etj.; avionë luftarakë nga USA, UK, Norvegji, Finlanda, Spanja, Polonia, Hungaria; helikopterë luftimi dhe drone; të paktën 1,100 automjete luftarake, duke përfshirë 166 tanke, 417 transportues të blindur (APCs) si dhe 533 automjete luftimi të këmbësorisë (IFVs), etj.!

Në përmbledhje të sa më sipër, mund të themi se “Steadfast Defender 2024” është një mesazh i fortë jo vetëm i forcës së kohezionit të vendeve anëtare dhe i vendosmërisë së Aleancës, për të mbështetur pa asnjë kompromis Ukrainën martire deri në fitoren e saj ndaj Rusisë, por edhe një demonstrim i fuqisë së pamposhtur ushtarake në mbrojtje të tërësisë territoriale të 31 vendeve anëtare si dhe interesave gjeopolitike të Aleancës Transatlantike (SHBA/NATO/MB).

Së dyti, me gjithë sasinë e konsiderueshme të trupave dhe mjeteve, numrin e vendeve pjesëmarrëse dhe shtrirja gjeografike, stërvitja “Steadfast Defender 2024”, nuk është më e madhja e zhvilluar nga NATO pas viteve '90 (luftës së ftohtë). Për shkak edhe të vërtetës, na duhet të zgjojmë memorien strategjike që: “stërvitja më e madhe në historinë e Aleancës së pas viteve '90 mbetet “Reforger - 1988” me 125,000 trupa, e cila i parapriu (ndoshta për ko incidencë...), të parës luftë fitimtare të NATO-s, pra fushatës ajrore për çlirimin e Kosovës në gjashtëmuorin e parë të vitit 1999!

Kështu, si një ndër dëshmitarët modest të planifikimit strategjik në SHAPE/NATO” mund të konfirmoj se: stërvitjet e mëdha të NATO-s, planëzohen dhe zhvillohen vetëm mbi bazën e peshimit strategjik të rreziqeve potenciale si dhe të nevojës për zhvillimin e respektivisht aftësive operacionale për të përmbushur misionin e mbrojtjes kolektive (artikulli 5).

E thënë edhe më drejtpërdrejtë, Steadfast Defender 2024, nuk ka asnjë lidhje me ndonjë konspiracion global; as me fushatën e Presidentit Biden apo rivalit Trump në USA; as me zgjedhjet apo me ndonjë axhendë të protagonistëve politik në 31 vendet anëtare të NATO-s. Kjo pasi, kolegët e planifikimit në Komandën Supreme të NATO-s (SHAPE), i ndërtojnë skenarët e stërvitjes: vetëm për mbrojtjen kolektive nga kërcënimet ndaj tërësisë territoriale të NATO-s, dhe për asnjë arsye nuk mund të ndërhyjnë në problemet e



brendshme të vendeve anëtare!

Gjithsesi “Steadfast Defender 2024” është stërvitje ushtarake kryesisht e trupave Amerikane, Kanadeze si dhe 29 vendeve Europiane të NATO-s. Nga ana tjetër, është fakt i mirënjohur që të gjitha vendet NATO-s, përfshi RSH, e vetë-shpallin SHBA-në partner strategjik! Kjo pasi, kur vjen fjala për SHBA-të, të gjitha qeveritë Europiane e pranojnë që SHBA-të mbajnë peshë kritike për sigurinë, ndërsa forcimi i lidhjeve transatlantike mbetet me rëndësi jetike për NATO-n!”.

Së treti, sjellim në vëmendjen strategjike që me përjashtim të Serbisë, në këtë stërvitje, marrin pjesë, Sllovenia, Kroacia, Mal i Zi, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, etj. Prandaj duke e parë në planin rajonal, kjo stërvitje do të shërbejë, ndoshta “jo vetëm rastësisht” si demonstrim i fuqisë së pakonkurueshme të SHBA/NATO ndaj ambicieve dhe kërcënimeve gjeopolitike të Kremlinit edhe në rajonin e Ballkanit perëndimor si dhe vendet e Europës jug-lindore. Prandaj, kjo stërvitje do të shërbejë edhe si mesazh i fuqisë ushtarake të SHBA/NATO, drejtuar Beogradit: “Për të mos vijuar të (keq) përdorohet për interesat e Moskës në Rajon; të mos e armatosë deri në dhëmbë Serbinë (me “Mig29”, raketat dhe së fundmi me dronë Rus); të mos frymëzojë radikalet e tipit Dodik në Bosnje si dhe Grupet Kriminale në Veriun e Kosovës, etj.

E thënë edhe më shkurt: “Serbia të mos kërcënojë me agresion ushtarak ndaj tërësinë territoriale të Kosovës; status-kuonë gjeopolitike si dhe investimin e USA/NATO për paqen, stabilitetin dhe axhendën Euroatlantike të Rajonit të Ballkanit perëndimor!”. E thënë në dimensionin operacional, kjo stërvitje do të shërbejë edhe si konfirmim i mesazhit konstant që SHBA dhe NATO, i kanë përcjellë Serbisë prej qershorit 1999: “Një agresion ushtarak kundër sovranitetit të Kosovës, do të konsiderohet edhe si sulm ndaj trupave të KFOR-it/NATO-s!”. Prandaj, shpresoj që kjo stërvitje të shërbejë edhe si një mesazh për vendet e Ballkanit, në mënyrë që paqen

dhe stabilitetin afatgjatë të mos e bazojnë përjetësisht as si dhuratë me prezencën dhe aktivitetet madhore të NATO-s, por do u duhet ta para-kushtëzojnë me zhvillimin e Masave të Mirëbesimit Reciprok, nëpërmjet të cilave Beogradi Zyrtar “të imponohet” se: (1) do të ruajë balancat e fuqisë ushtarake sulmuese (si “Mig-29, raketa “Pantsir-S”, helikopterë, tanke dhe dronë rus) deri në nivelin që të mos kërcënojë integritetin territorial të asnjërit nga vendet (përfshi Republikën e Kosovës); (2); si dhe nuk do të vendosë instalime dhe aktivitete ushtarake (20 km distancë ajrore dhe 5 tokësorë), në kufijtë shtetërore mes vendeve ndërkufitare. Më tej këto kushte me peshë duhen të monitorohen nga NATO, që mbetet faktor kritik për paqen dhe integrimin e 6 vendeve të Ballkanit perëndimor.

Po ashtu, prezenca e KFOR-it, “Steadfast Defender 2024” si dhe dhjetëra aktivitete të NATO-s në Rajon, janë arsye më shumë për vendet e Ballkanit, në mënyrë që paqja të mos keqpërdoret as kërcënohet nga Moska apo axhendat elektorale të udhëheqësve lokalë. Gjithsesi shpresoj që edhe kjo stërvitje t’iu shërbejë elitave mendjehapura, jo vetëm në Beograd si “mesazh mirëbesimi reciprok” për të punuar kundër rikthimit të errësira e urrejtjes dhe gjakderdhjes shekullore mes popujve. Prandaj besoj fort, se jo LUFTA, por mirëbesimi, PAQJA dhe axhenda e integritetit në NATO/BE mbeten misioni i vetëm i ardhmërisë së Serbisë si dhe 5 vendeve të tjera të Ballkanit perëndimor.

Së katërti, në planin kombëtar, RSH në 15 vite si vend anëtar (2009 - 2024), ka konsoliduar ndjeshëm standardet e planifikimit, kapacitetet operacionale dhe kulturën e bashkëpunimit me NATO-n. Kjo për vetë faktin se me qindra ushtarakë/e, kanë shërbyer në Shtabet e NATO-s si dhe me mijëra (për të mos thënë 100 % e personelit aktiv) kanë kontribuar në operacionet e saj, në Afganistan, Bosnjë, Irak, Kosovë, Mali, etj. Prandaj, jam shumë i sigurt, që FARSH-të do të demonstrojnë profesionalizëm elitare në këtë stërvitje, duke përmirësuar edhe aftësitë e planifikimit, drejtimit si dhe ato luftarake (veçanërisht Tokësore & Detare pasi kapacitetet e luftimit ajror kanë kosto përtej mundësive reale të RSH-së).

Në shtesë, ndërsa 32 vjet pluralizëm politik dhe 15 vite anëtarësim në NATO, stërvitja “Steadfast Defender 2024”, etj. ngjarje madhore të NATO-s, janë eksperiencë me mesazhe të një gjeopolitike ndaj Tiranës: “për të forcuar qasjen gjithëpërfshirëse, kohezionin e kombit si dhe konsensusin e gjerë në adresimin e interesave kombëtare; forcuar partneritetin strategjik me SHBA/NATO-n.

Thënë këto, dëshiroj ta ritheksoj, se “Steadfast Defender 2024”, etj., janë ngjarje madhore të fuqisë së partneritetit strategjik me SHBA/NATO, të cilat mbartin mesazhe me peshë kombëtare. Me këtë rast, shpreh konsideratat ndaj Shtabit të SHAPE/NATO, Belgjikë si dhe Ambasadës së SHBA-së në Tiranë, për mesazhet e qarta gjeopolitike në mbrojtjen e tërësisë territoriale si dhe interesave të Aleancës Transatlantike (përfshi të RSH).

Së fundmi, duke shprehur nderimin për përkushtimin shembullor dhe sakrificat sublime për paqen, ju uroj përzemërsisht suksese ushtarakëve të RSH dhe të 31 vendeve të tjera pjesëmarrëse, jo vetëm në këtë stërvitje.

Me këtë rast, rikonfirmoj se, mbetem ushtar i Atdheut, për të kontribuar me përlulesi në mbrojtjen e interesave kombëtare si dhe forcimin e partneritetit strategjik me USA/NATO-n!

MARO KONDI, portreti i labes së rrallë

Me dështimin e Kryengritjes së Tanzimatit, në verën e vitit 1847, udhëheqësit e kryengritjes Zenel Gjoleka me luftëtarë të tjerë u strehuan në një shpellë në malin Çorraj. Maro Kondi, vajza, komandantja trime, u kap nga ushtarët osmanë, kur kishte zbritur për të marrë ujë. Pushtuesit i kërkuan t'u tregonte ku fshiheshin luftëtarët e lirisë, dhe me të mirë dhe me kërbaç i kërkuan t'i çonte atje ku strehoheshin prijësit e kryengritjes, te shkëmbi i Kadafiqit. Ajo i kaloi në një rrugë të vështirë. Kur iu afrua shpellës, u hodh në një humnerë prej 150 m, duke tërhequr edhe ushtarët turq që e ndiqnin të lidhur me litar. Thuhet se pashai turk kur mësoi për këto humbje, veç atyre që mundi të kapë e t'i pushkatonte, bëri dhe këtë mallkim: "U shfarostë ky millet qafir". Poshtë Kadafiqit, në këmbët e Malit të Harapës, te Guri i Gjatë, për nder të saj është ngritur lapidar.

Në radhët e trimëshave shqiptarë të shekullit të kaluar, vend nderi zë dhe bija guximtare e Labërisë, Maro (Mete) Kondi. Maroja, trime dhe komandante popullore, njihet me emrin Mete, e lindur në fshatin malor Çorraj të Kurveleshit, në vitin 1820, në familjen Kondi, në lagjen Gjilhilaj dhe u martua në fisin Kolekaj. Mjaft bashkëfshatarë dhe të afërt të saj ishin luftëtarë, si Duke Kondi, Malo Duka, Foto Kopali etj. Fillimisht bënë pjesë në ushtrinë e Ali pashë Tepelenës. Më pas, me rënien e pashallëkut të Janinës u bashkuan me krahë të Labërisë dhe të Bregdetit, u treguan vazhdimisht trimëri dhe zhvilluan luftime kundër ushtrisë osmane.

Maro Kondi u rrit dhe u edukua në këtë mjedis të flaktë patriotik. Në mjaft raste, Maro kishte parë shtëpi dhe të mbjella të fshatit të djegura nga pushtuesi. Të afërmit e saj ishin rrahur barbarisht nga kamxhiku i osmanlinjve, të lidhur me zinxhirë mbas kuajve të pushtuesit se nuk pranonin në vendin e tyre reformat skllavëruese, se nuk donin që vendi të qeverisej nga të huajt dhe as të paguanin taksa dhe të shkonin ushtarë për Turqinë.

Maro shumë herë ishte udhërrëfuese për luftëtarët e krahinës, organizatore e grupit të grave në prapavija.

Bazuar në përvojën dhe kryengritjet e mëparshme, të cilat për vite me radhë nuk kishin pushuar, edhe në kryengritjen fshatare të vitit 1847, luftëtarët e Çorrajit u ngritën më këmbë. Ata u betuan për të luftuar kundër pushtuesit osman, për jetë a vdekje. Edhe gratë e Çorrajve, e njihnin me pëllëmbë malin e Çorrajit, me gjithë qafat, shtigjet, shpellat e burimet zonës. Vendi ishte tepër i thepisur, por Maroja e kishte mësuar çdo skutë të tij që kur ishte e vogël, duke kullotur dhinë e duke prerë drutë për dimrin e ashpër të kësaj krahine. Shpella e Karanit gjendet pranë fshatit Çorraj. Aty gjendet dhe shkëmbi i Kadafiqit. Ajo kishte një lartësi prej 1-2 m

“ Maro Kondi u rrit dhe u edukua në këtë mjedis të flaktë patriotik. Në mjaft raste, Maro kishte parë shtëpi dhe të mbjella të fshatit të djegura nga pushtuesi. Të afërmit e saj ishin rrahur barbarisht nga kamxhiku i osmanlinjve, të lidhur me zinxhirë mbas kuajve të pushtuesit se nuk pranonin në vendin e tyre reformat skllavëruese, se nuk donin që vendi të qeverisej nga të huajt dhe as të paguanin taksa dhe të shkonin ushtarë për Turqinë.

dhe gjatësi rreth 50 m. Në hyrje të saj ka një shesh të vogël. Rruga për të shkuar në shpellë është shumë e vështirë. Gjatë luftës me pushtuesit osmanë këtu u strehua Zenel Gjoleka, kapedan Foto Kopali, si dhe vetë banorët e fshatit.

Ndërsa shkëmbi i Kadafiqit në fshatin Çorraj është shumë pranë shpellës së Karanit. Ky shkëmb u bë i njohur nga akti heroik i Maro Kondit në vitin 1847, e cila, për të shpëtuar Zenel Gjolekën me shokë që strehoheshin në shpellë, u hodh në humnerë nga lartësia 150 m, duke marrë me vete dhe ushtarët osmanë që e shoqëronin. Kënga thotë: "Kadafiqi shtigje-shtigje, ...Nxore nëntëdhjetë vige".

Maro ka qenë shumë aktive dhe në kryengritjen fshatare të vitit 1847. Me përfundimin e kryengritjes së vitit 1847, ekspedita ndëshkimore osmane i ndoqi kudo luftëtarët shqiptarë. Pjesa më e madhe e luftëtarëve u strehuan gjatë vitit 1847 në malet e larta dhe të thepisura të Labërisë. Trimëshen Maro Kondi, me mjaft bashkëfshatare të tjera, e gjejmë me luftëtarët e Çorrajit në malin e fshatit. Të gjitha kujdeseshin për strehimin e luftëtarëve kryengritës. Trimi dhe luftëtari i dëgjuar i Labërisë, Zenel Gjoleka, kishte gjetur strehim në këto male. Ai bashkë me luftëtarët kryengritës ishte strehuar në shpellën e Karanit, në Harapë. Kujdes i veçantë u tregua për të nga njerëzit e Maros, siç ishte trimi Malo Duka. Ky luftëtar dhe bujar, për mikpritjen e tij ishte i njohur në të gjithë krahinën dhe njihet me emrin "Malo Buka".

Komanda osmane e kishte pikasur këtë strehim. Ajo kishte marrë masa dhe ishte nisur me repartet ndëshkuese nga në dy drejtime. Njeri drejtim përshkonte rrugën nga Borshi i Vjetër, për në shpellë dhe tjetri nga Rrëza e Vake, përsëri për në shpellë. Luftëtarët e Çorrajit, duke studiuar situatën morën masa dhe shpërngulën gjithë fshatit me pleq e fëmijë, duke e siguruar në mal, në Harapë. Luftëtarët e çetës u vendosën në pozicione



luftimi. Ata zunë të gjitha shtigjet e vështira për kalim nga lumi deri në Katafigj. Lufta ishte e ashpër nga të dy palët. Luftëtarët e çetës së Çorrajt, nuk i pushuan luftimet, ata përbuzën propozimin e pashait turk, se luftëtarët shqiptarë do të ishin të lirë, vetëm t'i lihej e lirë rruga, kolonës ushtarake osmane për të shkuar në Harapë.

Pashai turk, në këto rrethana dhe në pamundësi për të kaluar në Harapë nga grykat ku ishin vendosur luftëtarët shqiptarë, sugjeroi që me dredhi të gjente tjetër rrugë-kalimi. Ai urdhëroi dhe zuri të gjitha rrugët dhe vendburimet nga furnizohej mali me ujë. Qëllimi për të shtrënguar trimat që të dorëzoheshin nga etja. Kjo pengesë u kalua nga kryengritësit. Gratë e fshatit gjetën rrugë të tjera dhe furnizuan me ujë luftëtarët, pa u diktuar nga ushtarët osmanë.

Akti heroik i luftëtares Maro

Ushtarët osmanë, pasdite vonë mundën të kapin në befasi, duke mbushur ujë, bijën luftëtare të fshatit Çorraj, trimëshën Maro Kondi. Ajo kishte zbritur fshehtas nga mali për të mbushur ujë për luftëtarët, por ishte ndjekur nga ushtarët osmanë.

Fillimisht luftëtaren e morën me të mirë, për t'u treguar shtigjet e kalimit për në mal. Më pas kur nuk tregoi, filluan ta torturonin gruan luftëtare. Ata e detyruan të ecte në gjurmët e saj, andej nga kishte ardhur. Shtegu për në vendstrehim, për në Katafigj, ishte thiktë dhe i rrezikshëm. Pakujdesia më e vogël të hidhte në humnerë pa asnjë shpresë shpëtimi.

Ushtarët turq ecnin këmba-doras të lidhur me litarë njëri mbas tjetrit. Ata shikonin të tmerruar humnerën, honin e pafund që shtrihej poshtë këmbëve të tyre, disa qindra metra thellë. Maro Kondi, megjithëse dhe e torturuar, me fëmijën në duar ecte e qetë në krye të ushtarëve armiq. Siç përshkruhet në librin "Trima të kryengritjeve popullore", luftëtarja Maro Kondi kur ariti në kthesën e fundit, në një vend shumë të rrezikshëm, ku ushtarët osmanlinj duhet të kalonin për një, mendoi

të hidhej nga shkëmbi si rruga e vetme për të mos dorëzuar kryengritësit te armiku. Aty duhej të ecje ngjitur dhe duke u mbajtur pas shkëmbinje të thepisur. Këtu u kthye mbrapsht me rrëmbim dhe hodhi në humnerë ushtarin e parë osman që vinte pas saj. Ai duke qenë i lidhur me të tjerët, i mori me vete në humnerë. Britmat e ushtarëve osmanlinj u dëgjuan në mbarë vendin.

Luftëtarët shqiptarë që vrojtonin lëvizjen e kolonës armike, i qenë afruar grykës, ndërsa ushtarët osmanë, që i shpëtuan grackës, u vërsulën mbi këtë bijë shqiptare. Ajo tërhoqi pas vetes dhe një nga ushtarët që e kishte mbërthyer, dhe u hodh në humnerë bashkë me fëmijën e saj. Luftëtarët çorrotë të zemëruar nga humbja e kësaj trimëreshë, vunë në përdorim shkëmbinjte e gurët. Kështu u mbyllën shtegun e kalimit osmanëve të mbetur në qafë të malit. Të gjithë ushtarët osmanë përfunduan në fund të humnerë.

Sakrificat e luftëtarëve dhe banorëve të fshatit Çorraj janë përjetësuar në vargjet popullore: "...Katafigji portë-portë,/ Shove gorogoriciotë...". Rreth nëntëdhjetë ushtarë e oficerë turq u gjendën të copëtuar nëpër shkëmbinjte e Katafigjit. Kënga popullore thotë: "...Katafigji shtigje-shtigje,/ Nxore nëntëdhjetë vigje...". Ushtarët osmanë u mbartën nga autoritetet osmane dhe u varrosën në Delvinë. Ndërsa Maro luftëtarja, e copëtuar, së bashku me fëmijën e saj u varros me nderime të mëdha nga luftëtarët shqiptarë, poshtë Katafigjit, në rrëzë të Harapës, te Guri i Gjatë.

Për figurën e Maro Kondit është shkruar gjerësisht në librin "Dëshmorët e Atdheut", të botuar në vitin 2012, nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Maro Kondi, me vendim nr. 116, datë 6 nëntor 1984, të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Sarandës, është shpallur dëshmore dhe ndodhet në varrezat e Dëshmorëve të Sarandës.

Kjo është dëshmorja e parë e Atdheut për nga largësia e viteve, e shpallur në bazë të ligjeve të shtetit shqiptar.

Lamtumira për pedagogun ushtarak Avni Hajro në tokën e bekuar



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Pedagogu me takt në auditor...

Miku im, dr. Albert Hitoaliaj më njofton se ditë më parë ishte ndarë nga jeta ushtaraku Avni Hajro në SHBA. “Mundesh të shkruash diçka për të, pasi na mungon informacioni dhe besoj se duhet të kesh informacion më të detajuar”. Në kujtesë nga studimet në Akademinë e Mbrojtjes, pedagog Avni Hajro na jepte disa leksione të Historisë të Artit Ushtarak, për veprimet luftarake të njësisë të UNÇSH-së në tokat e Jugosllavisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe leksionin për provokacionet e gushtit të vitit 1949. Në leksion, por dhe në seminare ishte tepër i kujdesshëm në analizën dhe nxjerrjen e përfundimeve ushtarake për çdo luftim apo betejë të zhvilluar. Ishte i ngadaltë në shpjegim, por argumentues dhe tepër i vëmendshëm në përgjigjet akademistëve. Ndërhynte me kujdes dhe shpesh theksonte se “sikur të trajtohet problemi në këtë kënd shikimi”. Pra nuk kërkonte një riprodhim të leksionit, por këndvështrimin e akademistit dhe logjikën në argumentimin e problemit... Kohë më vonë, nga fillimi i vitit 1994, kur kishte dalë në lirim, e kam takuar në një dyqan që shiste fruta-perime, pasi kishte dalë në reformë, një pedagog i përgatitur dhe me përvojë në fushën e historisë ushtarake, me gradë shkencore për këtë fushë...

Shkollimi dhe pasioni për profesionin

Avni Sulejman Hajro ka lindur më 19.12.1947, në fshatin Boshanj të Ersekës, në një familje me tradita të hershme atdhetare. Në fshatin e lindjes në vitet 1954-1961 ndoqi shkollën 7-vjeçare. Në çdo vit të shkollës kishte dalë me rezultate të larta, kështu që mundi të ndiqte arsimin e mesëm. Në atë kohë shumë të rinj pëlqenin uniformën e shkollës “Skënderbej”, një uniformë që e kishin ëndërr shumë djem të moshës 14-15 vjeçare. Ëndrra u realizua dhe Avni ndoqi në vitet 1961-1965 shkollën Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë. Aty mësoi shumë dhe u njoh me mjaft të rinj që studionin me këmbëngulje për të arritur diçka në jetë. U dha shumë pas sportit dhe studimit, u bë një skënderbegas i fuqishëm dhe i dalluar në mësim. Kjo për faktin se kur kaloi në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, nxënësit me

rezultate të larta regjistroheshin në Fakultetin e Artilerisë. Kështu në vitet 1965-1967 ndoqi studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Shkollën e përfundoi me rezultate të larta dhe i dalluar në të gjitha disiplinat ushtarake. Çdo oficer që përfundonte shkollën e lartë e niste karrierën komandant toge, pra nga elementi më fillestar i një kuadri ushtarak për të ecur më tej në karrierë. Në vitet 1967-1970, kreu detyrën e komandantit të togës në një repart ushtarak në grupin e Artilerisë Tokësore. Punoi me përkushtim dhe në çdo vit ishte në pararojë të realizimit të detyrave luftarake. Për punë të mirë në vitin 1970 emërohet shef zbulimi artilerie në një repart ushtarak të Artilerisë Tokësore, detyrë e kryer deri në vitin 1975. Përsëri ishte në ballë të detyrave luftarake dhe në vitet 1975-1980 kreu detyrën e komandantit të Grupit të Artilerisë Tokësore në Mëzez të Tiranës.

Komandant Avni u përkushtua përsëri studimit të artilerisë tokësore, si artileri e paracaktuar kryesisht për luftë kundër objektivave tokësore. Në ushtrinë popullore ajo përbëhej nga nënreparte, reparte dhe njësi të artilerisë së Forcave Tokësore. Kujdes të veçantë komandanti i kushtonte sistemeve të topave, obusëve, top-obusëve, mortajave, si dhe mjeteve të ndërlidhjes, por dhe instrumenteve dhe aparaturave të nevojshme për zbulim e qitje. Reparti ku drejtonte ishte model dhe shpesh në të organizoheshin mësimet treguese si dhe shkëmbim përvojë midis repartesh. Ky grup dallohej në zgjidhje të detyrave të zjarrit, të shumëllojshmërisë dhe të mbështetjes me zjarr të FT-së në të gjitha llojet e luftimeve dhe operacioneve. Komandant Avni Hajro i kushtonte vëmendje të madhe kësaj arme, pasi Artileria Tokësore përbënte dhe masën kryesore të artilerisë të FA-së. Nëpërmjet mësimet, seminarëve, stërvitjeve dhe fushimeve, grupi i artilerisë që drejtonte komandant Avni u përvetësoi mjaft mirë parimet kryesore të përdorimit luftarak, si përqendrimi i masës kryesore në drejtimet më të rëndësishme, bashkëveprim të ngushtë dhe të vijueshëm me këmbësorinë, tanket dhe llojet e tjera të armëve, realizimin e një drejtimi elastik, të pandërprerë dhe të qendrorizuar të artilerisë dhe të zjarrit të saj, si dhe befasia dhe saktësia e hapjes së zjarrit. Të gjitha këto parime u vunë në praktikë dhe komandantit Avni Hajro iu dha e drejta për studime të thelluara në fushën ushtarake.

Pedagogu që shkroi për luftën partizane

Pas studimeve dyvjeçare, në vitet 1980-1982, përfundoi me rezultate të larta Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm dhe mori emërimin pedagog në Katedrën e Historisë të Artit Ushtarak. Kështu nisi një detyrë e re, por bazë kishte përvojën e mëparshme dhe praktike të bazës së ushtrisë, repartin. Edhe në akademi iu përvesh punës për të realizuar studimet që kërkonin një vëmendje të madhe, studim të literaturës, “gërmime” në arkiva, takime me veteranë dhe luftëtarë, përgatitje për leksion, mbrojtje të leksionit në katedër, lektim para



akademistëve dhe zotërim të orës së seminarit etj.

Gjatë viteve të punës si pedagog i HAU kreu studimin “Provokacionet e Gushtit 1949”, si dhe “Veprimet e UNÇSH për çlirimin e tokave të Jugosllavisë”. Ndërsa në vitet 1980-1986 punoi si bashkautor për librin “Historia e Artit Ushtarak të LANÇ-it”, libër i vlerësuar në stafet akademike si dhe ushtarake, por dhe nga Akademia e Shkencave. Gjatë kësaj periudhe të qëndrimit pedagog për 11 vjet në akademi redaktoi nga ana ushtarake Historikët e BrIIS, BrVIIS, BrXXIIS dhe BrIXS. Në vijim botoi në revistat shkencore artikuj shkencorë, si dhe në shtypin ushtarak tematikë nga HAU shqiptar, botëror, përvojë nga Luftërat Lokale pas Luftës së Dytë Botërore etj. Njëkohësisht ka qenë autor i 7 zërave të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (FESH) të vitit 1985, por dhe 2008, si dhe autor i 10 zërave të Fjalorit Enciklopedik Ushtarak (FEU) të vitit 2022.

Për të gjithë këtë punë studimore dhe pedagogjike Avni Hajro mbrojti gradën shkencore “Doktor” me temën “Veprimet luftarake dhe tiparet e AU-së të njësive të UNÇSH-së, në ndjekje të armikut në Kosovë e në vise të tjera të Jugosllavisë, tetor 1944-shkurt 1945”. Udhëheqës Shkencor të doktoraturës ishte Katedra e HAU në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm. Mbrojtja u zhvillua më datë 28.05.1988, para jurisë së posaçme të kryesuar nga Prof. Kostaq Karoli.

Disa prurje të reja në studimin për LANÇ-in të pedagog Avniut

Në studimin “Tiparet e operacionit mësymës të njësive të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për çlirimin e Kosovës, gjatë viteve 1942-1945” ka vënë në dukje se këto formacione luftuan me ndjenjën e atdhetarizmit dhe internacionalizmit kundër ushtrive nazifashiste dhe tradhtarëve në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Bosnje-Hercegovinë. Që nga mesi i vitit 1942, së bashku me vëllezërit shqiptarë e partizanë të Kosovës i goditën armiqtë në Plavë e në Guci, në trevën e Kosovës e në Rrafshin e Dukagjinit.

Ka theksuar si tipar kryesor: Divizioni I Sulmues i UNÇSH-së, së

bashku me forcat partizane kosovare e maqedonase, me anë të sulmit çliruan qytetin e Dibrës, më 3 shtator 1944. Në vjeshtën e vitit 1944 treva e Kosovës merrte rëndësi ushtarake të veçantë për ushtrinë gjermane. Ka theksuar se Kosova, duke qenë në qendër të Ballkanit, kishte rrugët më të shkurtra që të çonin drejt Europës. Njëpërmyet Kosovës kalonin rrugë kryesore, që shërbenin për të tërhequr forcat gjermane nga Greqia, Maqedonia, për të dalë në Bosnje e në Kroaci. Afrimi i Ushtrisë së Kuqe në krahun jugor të Ballkanit, si dhe sulmet që i jepnin Vermahtit partizanët shqiptarë, jugosllavë e grekë, vunë në rrezik rrethimin dhe asgjësimin e rreth 300 mijë nazistëve.

Ka nxjerrë në dukje se njësitë e UNÇSH-së, kishin në vëmendje bashkëveprim me repartet e njësive partizane kosovare e të përkrahura nga populli, ndonëse mësynin në një front të gjerë dhe kundër një armiku që kishte epërsi në forca dhe sidomos në teknikë luftarake, duke kaluar nga sukseset e shkallës taktike në ato operative, me luftime të përgjakshme plotësuan detyrën për çlirimin e Kosovës. Populli i Kosovës i priti me përzemërsi dhe u dha çdo ndihmë luftëtarëve të brigadave partizane shqiptare. Brenda një muaji efektiv i brigadave të ushtrisë partizane shqiptare që vepronin në Kosovë, u dyfishua me vullnetarë kosovarë.

Një faktor vendimtar për arritjen e sukseseve në luftimet që zhvilluan forcat partizane në Kosovë ishte ndërgjegjja e lartë, besimi në fitore, fryma e atdhetarizmit dhe e internacionalizmit, rreptësia ndaj armikut dhe papajtueshmëria me çdo shfaqje nacionalizmi e shovinizmi. Këto virtyte të partizanëve shqiptarë ngjallën te populli kosovar dashurinë për UNÇSH-n. Në këtë kohë mijëra luftëtarë të kësaj krahine të moçme shqiptare, vërsuan për të formuar e forcuar Brigadat I, II, III, IV, V, VI, VII dhe VIII partizane kosovare. Numri i përgjithshëm i partizanëve kosovarë, në pranverën e vitit 1945, arriti në më shumë se 53.000 djem e vajza. Këto brigada, si dhe partizanët kosovarë, që bënë pjesë në brigadat shqiptare dhe jugosllave, luftuan me trimëri kundër pushtuesve dhe tradhtarëve vendas, duke dhënë një ndihmesë të çmueshme në luftën antifashiste për çlirimin e popujve të Jugosllavisë.

Faktor tjetër i rëndësishëm për arritjen e suksesit në operacionin mësymës të njësive shqiptare për çlirimin e Kosovës ishte dhe taktika e zhdërvjelltë në veprimet luftarake. Mbatja e nismës në veprimet luftarake, goditjet e shpejta, të befasishme e të njëpasnjëshme, bënë që forcat partizane të kryenin detyrat luftarake me sukses. Duke manovruar me zgjuarsi për të asgjësuar trupat gjermane dhe mercenare sa në një drejtim në një drejtim tjetër, armiku u godit në ato objekte, nga marrja e të cilave u shkatërrua gjithë sistemi i mbrojtjes së tij. Këto theksonte në përfundim të studimit pedagogu Avni Hajro, tregojnë se UNÇSH-ja kishte fituar një përvojë të madhe në fushën e artit ushtarak.

Lamtumira në tokën e bekuar...

I gjendur për disa vite pranë fëmijëve, pedagogu dhe doktori i shkencave ushtarake shqiptare, vitet e fundit i kaloi në SHBA. Pedagogu që zotëronte gjuhën gjermane si dhe angleze, nga Amerika ndiqte vazhdimisht problemet ushtarake. Sa ishte në Shqipëri shkroi mjaft artikuj në shtypin ushtarak për historinë ushtarake. Një pjesë e materialeve të Tij të botuara në libra studiohen në akademinë tonë ushtarake. Avni Hajro doli në rezervë me gradën ushtarake të “nënkolonelit”. Gjithashtu ai kishte dhe mjaft vlerësime pozitive për punën në vite, si dhe ishte dekoruar me Medaljet e “Shërbimit Ushtarak” dhe “Për shërbime të veçanta”. Me këtë përkushtim në jetë të pedagogut Avni Hajro, iu dha lamtumira e fundit në tokën e bekuar...

Gjergj Klimi, pedagogu skënderbegas i 'balistikës së predhave'

Gjergj Klimi studiuesi që identifikohet me "gjetjen mbi balistikën e predhave që përdoren në ushtri". Kështu e vlerësonte profesor Gjergj Klimin një studiues i Pentagonit, teksa shprehte konsideratat e tij për librin më të fundit "Elements of Exterior and terminal Ballistics". I gjashti në kolanën e botimeve të këtij lloji me autorësinë e tij, libri i profesorit shqiptar që ushtronte pedagogun në universitetet e Nju Jorkut, tërhiqte vëmendjen, ndër të tjera, për mënyrën interesante të shfrytëzimit të ligjit të Njutonit dhe atij të Snellit në çështjet e balistikës, por jo vetëm. Po kush është profesor Klimi që ka bërë emër në qarqet shkencore të Amerikës për botimet në këtë fushë pak të studiuar e hulumtuar dhe çfarë veprimtarie shkencore ka kryer në vite, si një kërkues e pedagog modest, i thjeshtë e i përkushtuar. Çfarë përfaqëson puna e tij shkencore dhe për se e vlerësojnë specialistët e fushës.

Ka qenë viti 1972, kur profesori i njohur Gjergj Klimi, i ri në moshë atëherë, kapërceu postbllokun e Akademisë Ushtarake, garnizonit më të madh në qytetin e Tiranës, për të ushtruar profesionin e pedagogut të matematikës e fizikës. Dashuria për profesionin dhe aftësia për të depërtuar në zemrat e kadetëve me uniformë me çiltërsi dhe kulturë, i dhanë dorë për ta kryer me sukses detyrën. Plot 20 vite shërbeu aty, me përkushtim e pasion.

Familja

Gjergj Klimi, biri i Vlashit dhe Violetës lindi në Tiranë në vitin 1947. Pas përfundimit të shkollës shtatë vjeçare "10 Korriku", kreu gjimnazin "Sami Frashëri" në Tiranë, për të vijuar studimet universitare në Fakultetin e Shkencave, në degën Matematikë-Fizikë. Familja e tij me origjinë nga Voskopoja, u vendos në Tiranë, falë këmbënguljes së gjyshit, që la vendlindjen dhe bleu një shtëpi prej qerpiçi, me disa toka përreth në qendër të qytetit



(aty ku ka qenë MAPO e madhe, më vonë disko "Albania"), në rrugën e Dibrës, të cilën e bëri dykatëshe me shumë dhoma e anekse. Nëna e tij, Violeta nga Pogradeci, vinte në Tiranë nga një familje e pasur dhe me tradita të hershme. Familja e saj kishte një shtëpi dykatëshe me bahçe me një vresht me rrush e pemishte frutash dhe kishin ndërtuar një hotel dykatësh me restorant në katin e parë e dhoma gjumi në katin e dytë, pranë tij kishte edhe një pajisje furnizimi me karburant. Gjendej në rrugën kryesore, përballë liqenit të Ohrit. Violeta kishte edhe dy vëllezër, Kristaqin e Mihallaqin dhe dy motra Gliqirien e Adelinën. Bashkëshortja e Klimi, Dorina Paço, me të cilën ka dy djem, Iveni dhe Hiperioni, është e bija e skulptorit të shquar Janaq Paço. Ajo ka përfunduar studimet për frëngjisht dhe ka punuar shumë vite në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", Tiranë.

Karriera

Profesor Gjergj Klimi e ka nisur profesionin si mësues matematike e fizike në vitin 1970 fillimisht në shkollën e Arbanës në Tiranë e pastaj në gjimnazin e Laçit. Nga viti 1972 dhe deri në vitin 1992 ka ushtruar profesionin e pedagogut në Akademinë ushtarake

nga pedagog i thjeshtë te përgjegjës i departamentit të Fizikës. Karrierën profesionale si mësimdhënës e ushtroi më vonë në Kolegjin e Teknologjisë NYC dhe në Universitetin Pace (Nju Jork). Në vitet '90, ka punuar në Komitetin e Shkencës dhe Teknologjisë dhe në Ministrinë e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit shkencor në Shqipëri si Drejtor i Zyrës "Tempus", përgjegjës për zbatimin e Programeve të Komunitetit Evropian për rishtrukturonimin e arsimit të lartë. Është vlerësuar me Medaljen e Artë të Shqiponjës, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, për kontributin e dhënë në lëvizjen demokratike kundër diktaturës dhe për rishtrukturonimin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Botimet

Gjergj Klimi, tashmë profesor në pension, për vite me radhë ka qenë pedagog i Matematikës në "NYC College of Technology" dhe në "Pace University" (New York). Është autor i pesë librave për balistikën e jashtme: "Balistika e Jashtme me Zbatime" (2008), "Balistika e Jashtme e Armëve të Vogla" (2009), "Balistika e Jashtme: Një Qasje e Re" (2010), "Balistika e Jashtme: Metodot e Shquara," (2014) "Elementet e Balistikës së Jashtme: Qitje me distancë të largët" (2016). "Balistika e Jashtme me Aplikime 2011".

Botimet e Klimi janë ndjekur me shumë interes nga autoritetet e fushës në SHBA.

Edukimi universitar: Ph.D 1999 Universiteti Tiranës, Fakulteti Shkencave të Natyrës, Tiranë, me tezën: "Studime mbi aplikimin e Dinamikës së Gazeve dhe Fizikës bërthamore për vlerësimin e efekteve imobilizuese të municioneve konvencionale dhe bërthamore". 1969 Universiteti Tiranës, Fakulteti Shkencave të Natyrës, Tiranë, Diplomë në Fizikë. Provime Pasuniversitare: Universiteti Tiranës: Gjuha Angleze (1978); Dinamika e Gazeve (1990); Mekanika (1996).

Trajnime afatshkurtër: Universiteti i Ferrarës, Itali 1994; Instituti për Studime të Kërkimit Shkencor dhe Dokumentimit, Romë, Itali 1994. Punësimet: Shtator 2005-2015, "NYC College of Technology" (CUNY), Departamenti i Matematikës, Mësimdhënie në Matematikën Bazë, Statistikën Elementare, Përlogaritje dhe nivele të ndryshme të llogaritjes, probabilitetit dhe statistikës.

Shtator 2009-2011, 2013-2015 zëvendësues dhe me kohë të plotë. Shtator 2000-2015, Pace University, Departamenti i Matematikës (Kampusi Manhattan), ndihmës ass/profesor në Matematikë. Mësimdhënie në Matematikën Bazë, Matematikë fundore Përlogaritje dhe nivele të ndryshme të llogaritjes, Probabilitetit dhe Statistikës. Shtator 2004 - gusht 2005 Mesivta Yesodey Yeshurun NY, Mësimdhënie Përlogaritje AP, Para-Llogaritje, Matematik Bazë, Matematikë AB, IT. Tetor 2001 - gusht 2004, Pace University, Center for Academic Excellence (Kampusi Manhattan) Specialist/Kordinator Laboratori Matematike (pozicion me kohë të plotë) Mësimdhënie & eksperiencia të tjera profesionale: 1995 – 1997 Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Tiranë, Shqipëri: Drejtor i Zyrës së Tempusit të Shqipërisë 1993 – 1995 Komiteti Shkencës dhe Teknologjisë, Tiranë. Zyrtar i Lartë në Drejtorinë e Politikave të Shkencës dhe Programeve Kombëtare. 1988 – 1993 Akademia Ushtarake "Skënderbej", Tirana. Përgjegjës i Departamentit të Fizikës. Mësimdhënie në Lëndën e Fizikës së Përgjithshme, Përlogaritje; Probabilitet. 1972 -1992 Akademia Ushtarake "Skënderbej", Tirana. Departamenti i Matematikës dhe Fizikës.. Mësimdhënie në Përlogaritje; Probabilitet. 1988 – 1992 Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm (Institut Post Graduate) Tirana. Mësimdhënie në "Aplikim i elementeve të fizikës së shpërthimeve". 1970 -1972 Shkolla e Gjymnazit – Laç. Mësues në lëndën e Fizikës 1972 Mësues në shkollën e Arbanës,

Matematikë e Fizikë.

Publikimet më të rëndësishme: Libra: Klimi G. "Elements of Exterior and Terminal Ballistics", Xlibris, shkurt 2021; "Elements of Exterior Ballistics: Long Range Shooting", Xlibris, mars 2016; "Exterior Ballistics: The Remarkable Methods", Xlibris, shkurt 2014; "Exterior Ballistics: A New Approach", Xlibris, prill 2010; "Exterior Ballistics of Small Arms: Companion to Exterior Ballistics with Applications", Xlibris, 2009; "Exterior Ballistics with Applications: Skydiving, Parachute Fall, Flying Fragments", Xlibris, 2008; Botim i tretë publikuar në 2011. Kërkime shkencore, leksione: "Studime mbi aplikimin e gazdinamikës dhe fizikës bërthamore për vlerësimin e efekteve imobilizuese të municioneve konvencionale dhe bërthamore", 1999. Disertacion i prezantuar për gradën Ph.D., Libraria Kombëtare; "Prezantim i studimit mbi bombën me neutron", Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm. 1989, Leksione të Fizikës – Akademia Ushtarake e Tiranës, 1991; "Elemente të Fizikës së aplikuar në ushtri", 1986, Akademia Ushtarake. "Leksione mbi fizikën e shpërthimit", 1988, Akademia Ushtarake; Shtabi i Përgjithshëm, Tiranë, 1983, "Elementet e probabilitetit të aplikuar", 1983, Libër, Botim i Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë; "Studime mbi aplikimin e gazdinamikës dhe fizikës bërthamore për vlerësimin e efekteve të paaftësisë së municioneve konvencionale dhe bërthamore", 1999 – Disertacion i prezantuar për gradën PhD (Biblioteka Kombëtare, Tiranë). Prezantime & Studime: Klimi, G. Boatwright, J. "Metodat e reja bashkëkohore në balistikën e jashtme". "City Tech Faculty Research Conference", mars 30, 2012 Klimi, G. Greenstein J. "Vlerësimi i fuqisë shkatërruese të meteorit Baringer Tungusta, "City Tech Faculty Research Conference", 1 prill 2012. "Trajektorja e predhës – Modeli i Drejtësisë dhe ligji Snell-it", "City Tech Faculty Research Conference", 12 mars 2010.

Prezantim mbi librat e Klimi, G: "Exterior Ballistics with Applications" dhe "Exterior Ballistics of Small Arms" në Akademinë Ushtarake Mbretërore, Departamenti i Sistemeve të Armëve dhe Balistikës (ABAL), Bruksel, Belgjikë, 10 prill 2009 Klimi, G., Lowenthal J. "Zgjidhja e ekuacioneve diferenciale të lëvizjes së predhës, duke përdorur metodën e Euler-it", prezantim me poster, Takimi Vjetor i Seksionit Metropolitan New York, 3 maj 2008, Mascuili A. "Zgjidhja analitike e ekuacioneve diferenciale të lëvizjes së predhës, duke përdorur metodën Siaçi", "City Tech" sesioni 5-të vjetor i posterave kërkimore shkencore të Fakultetit dhe Studentëve, 15 nëntor 2007, Prezantim Poster "Energjia e tërmeteve dhe testeve bërthamore nëntokësore", Universiteti William Paterson, "5th Garden State Undergraduate Mathematics Conference", 12 prill 2008; SENCER Project i Grantit: Problemet e botës reale. Implementimi në "City Tech", Viti Akademik 2010 – 2011.

Risia e aplikimit në ligjit e Njutonit "Formalisht ngjan me ligjin e Snellit i interpretuar sipas Njutonit. Përqasja te ky ligj që autori i ka vënë emrin "snel-low" në analogji është komplet origjinal si nga trajtimi dhe rezultati që merret në balistikën e jashtme. Autori e ka quajtur "snel low", por nuk janë e njëjta gjë. Janë të ngjashëm në formë por jo në trajtim. Autori shkon më tej duke na prezantuar "tangent low", i cili është interpretim i saktë i përdorimit të balistikës së jashtme me trajtim origjinal e pa përdorimin e sistemit të ekuacioneve diferenciale. Në literaturën botërore nuk përdoret ligji i "snel low", aq më pak në balistikën e jashtme. Lexuesi i vëmendshëm e vë re se trajtimi i bërë nga Gjergji në faqen 148 si edhe në dy librat e mëparshëm të tij nuk ka lidhje me "Njuton snel low", të cilin autori e ka përdorur me modesti vetëm për një farë ngjashmërie që formalisht ata kanë.

Flamuri suedez ngrihet në selinë e Aleancës: Askush nuk mund ta mbyllë derën e NATO-s

PËRSHTATI:
MIMOZA GOLIKJA

Flamuri suedez u ngrit në selinë e NATO-s për herë të parë, më 11 mars 2024 në një ceremoni për të shënuar anëtarësimin e vendit në Aleancë. Suedia u bë aleati i 32-të i NATO-s, më 7 mars, pasi depozitoi instrumentin e saj të pranimit në Traktatin e Atlantikut të Veriut me qeverinë e Shteteve të Bashkuara në Uashington D.C.

Sekretari i Përgjithshëm mirëpriti kryeministrin Ulf Kristersson në selinë e NATO-s, për ceremoninë e ngritjes së flamurit për të shënuar pranimin e Suedisë. Duke folur përpara të pranishmëve në ceremoni, Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Kryeministrin Kristersson për udhëheqjen e tij të fortë personale dhe angazhimin e Suedisë në NATO. Ai tha se: “Suedia ka zënë vendin e saj të merituar në tryezën e NATO-s nën mburojën e Nenit 5, garancia përfundimtare e lirisë dhe sigurisë sonë. Të gjithë për një dhe një për të gjithë.”

Flamuri i Suedisë u ngrit për t’u bashkuar me flamujt e 31 aleatëve të tjerë, ndërsa u luajt himni kombëtar suedez dhe himni i NATO-s. Ceremonitë e ngritjes së flamurit suedez u zhvilluan njëkohësisht në Operacionet e Komandës Aleate (SHAPE) në Mons (Belgjikë) dhe Komandën Aleate të Transformimit në Norfolk, Virxhinia (SHBA). Duke qëndruar përkrah kryeministrin Kristersson, Sekretari i Përgjithshëm tha se: “Aderimi i Suedisë tregon sërish se dera e NATO-s mbetet e hapur. Askush nuk mund ta mbyllë. Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë rrugën e tij dhe ne të gjithë zgjedhim rrugën e lirisë dhe demokracisë”.

Duke vënë në dukje se NATO do të shënojë 75-vjetorin e saj këtë vit, Stoltenberg nënvizoi se lidhja transatlantike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut ka siguruar lirinë dhe sigurinë tonë. Suedia do të ndihmojë në ndërtimin e një NATO edhe më të fortë në një kohë kritike për sigurinë euroatlantike, tha ai, duke shtuar se “bashkimi me NATO-n është i mirë për Suedinë, i mirë për stabilitetin në veri dhe i mirë për sigurinë e të gjithë Aleancës sonë”.

Pranimi i Suedisë tregon sërish se dera e NATO-s mbetet e hapur

“Kjo është një ditë historike”, përsëndeti të pranishmit me fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në krah të Kryeministrin të Suedisë, Ulf Kristersson, në ceremoninë e ngritjes së flamurit, që shënoi pranimin e Suedisë në NATO. “Ne e mirëpresim Suedinë në NATO, në një kohë kritike për sigurinë tonë të përbashkët. Në të njëjtin moment, ne do të ngremë flamurin suedez këtu në selinë e NATO-s dhe në të gjithë Aleancën për herë të parë, tridhjetë e dy flamuj që valëviten



së bashku. Ata përfaqësojnë tridhjetë e dy kombe që punojnë për një qëllim të përbashkët: Për të mbrojtur një miliard njerëz, parandaluar luftën dhe ruajtur paqen. Anëtarësimi i Suedisë e bën NATO-n më të fortë, Suedinë më të mbrojtur dhe ne të gjithë më të sigurt”, - tha Stoltenberg. “Suedia sjell aftësi të nivelit të lartë, Forcat ushtarake të klasit të parë dhe shpenzon më shumë se 2 për qind të PBB-së për mbrojtje. Pranimi i Suedisë tregon sërish se dera e NATO-s mbetet e hapur. Askush nuk mund ta mbyllë. Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë rrugën e tij. Dhe ne të gjithë zgjedhim rrugën e lirisë dhe demokracisë. Populli trim i Ukrainës po lufton për këto vlera ndërsa flasim”, - tha Shefi i NATO-s. “Për 75 vjet, lidhja transatlantike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut ka siguruar lirinë dhe sigurinë tonë. Si një mik dhe një fqinj nordik, më jep krenari të madhe që Suedia tani na bashkohet në këtë mision thelbësor. Sot, ndërsa ngremë flamurin suedez, qëndrojmë së bashku në unitet dhe solidaritet. Të përkushtuar për të siguruar dhe mbrojtur njëri-tjetrin. Të gjithë për një, dhe një për të gjithë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai falënderoi Kryeministrin Kristersson, për angazhimin e tij personal ndaj Aleancës Euroatlantike dhe vlerësoi rolin kritik të ish-kryeministren Magdalena Andersson në aplikimin për anëtarësim në NATO. “Më vjen mirë që të dy jeni këtu me ministra dhe liderë të tjerë politikë bashkë me të gjithë ne sot. Kjo pasqyron mbështetjen e gjerë politike për NATO-n në shoqërinë suedeze. Kështu që të gjithë suedezëve u them: “Velkommen til NATO! Mirë se vini në NATO!”.



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg publikoi raportin e tij vjetor për vitin 2023

Sekretari i Përgjithshëm shpalli rezultatet e sondazhit vjetor të NATO-s, i cili anketoj gjithashtu pjesëmarrës nga Finlanda dhe Suedia për herë të parë. Stoltenberg tha se: “të dhënat janë të qarta. Mbështetja publike për NATO-n është jashtëzakonisht e fortë në të dyja anët e Atlantikut. Nëse një votim do të bëhej sot, një shumicë dërrmuese e qytetarëve në të gjithë vendet aleate do të votonin në favor të NATO-s. Ai shtoi se në Shtetet e Bashkuara, vetëm 13 për qind do të votonin kundër, duke nënvizuar se “mbi 80% e qytetarëve tanë besojnë se Amerika e Veriut dhe Evropa duhet të vazhdojnë të punojnë së bashku për sigurinë tonë të përbashkët”. Ai nënvizoi se këto rezultate tregojnë se në të gjithë Aleancën, mbështetja për NATO-n mbetet e fortë.

Në vitin 2023, aleatët vazhduan të ofrojnë nivele të paprecedentë mbështetjeje për Ukrainën. Stoltenberg tha se: “Për herë të parë, një numër aleatësh dërguan gjithashtu sisteme me rreze të gjatë, raketa UK “Storm Shadow” dhe franceze SCALP dhe aleatët ranë dakord të dërgonin avionë F-16. Ai shtoi se disa aleatë tani kanë nënshkruar marrëveshje dypalëshe sigurie me Ukrainën. “Ukrainasve nuk po u mungon guximi. Atyre po u mbarojnë municionet... Ky është një moment kritik dhe do të ishte një gabim i rëndë, historik të lejonim që Putini të mbizotërojë. Ne nuk mund të lejojmë që liderët autoritarë të arrijnë rrugën e tyre duke përdorur forcën.”

Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti që viti 2023 ishte viti i nëntë radhazi i rritjes së investimeve në të gjithë Evropën dhe Kanadanë, duke arritur në “rritje të shpenzimeve të mbrojtjes me 11% të paprecedentë”. Në vitin 2024, Stoltenberg theksoi se Aleatët e NATO-s në Evropë do të investojnë një total prej 470 miliardë dollarësh në mbrojtje, duke arritur në 2% të PBB-

së së tyre të kombinuar për herë të parë. “Këtë vit, dy të tretat e aleatëve do të përmbushin objektivin prej 2%, nga vetëm tre aleatë në 2014”, - tha ai. Stoltenberg tha se ai pret që aleatët të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për të mbështetur Ukrainën, për të përforcuar mbrojtjen e NATO-s dhe për të thelluar partneritetet në mbarë botën në Samitin e 75-vjetorit të NATO-s në Uashington.

Në Samitin e Vilniusit 2023, aleatët ranë dakord për një plan të ri veprimi për prodhimin e mbrojtjes për të rritur prodhimin, për të forcuar angazhimin me industrinë dhe për të rritur ndërveprimin. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se “që atëherë, NATO ka rënë dakord për kontrata me vlerë dhjetëra miliarda dollarë për municione dhe aftësi kyçe”. NATO gjithashtu ka thelluar më tej marrëdhëniet e saj me partnerët në Indo-Paqësorin dhe Bashkimin Evropian.

Në një kohë kritike për sigurinë euroatlantike, Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi gjithashtu se Finlanda iu bashkua familjes së NATO-s vitin e kaluar dhe vetëm javën e kaluar, Suedia u bë Aleati i 32-të... “NATO tani është më e madhe dhe më e fortë”.

Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje gjithashtu se Përshpejtuesi i Inovacionit të Mbrojtjes së NATO-s për Atlantikun e Veriut - DIANA - po dyfishon rrjetin e tij të përshpejtuesve dhe qendrave të testimit. Këto vende të klasit botëror në të dy anët e Atlantikut do të fokusohen në zgjidhjen e sfidave të mbrojtjes dhe sigurisë dhe mprehjen e avantazhit teknologjik të NATO-s në fusha që variojnë nga inteligjenca artificiale dhe kibernetike, te 5G, hipersonikët dhe sistemet autonome.

Raporti Vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm për vitin 2023 detajon punën dhe arritjet e NATO-s gjatë gjithë vitit.



Zoti nuk i rreh gratë



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Zoti nuk i rreh gratë.

- Çfarë ke grua?
- Dua të vdes.
- Pse do të vdesësh?!
- Se të vdekurit nuk i rrahin. Nuk do të më rrahin më. Nuk do të më dhembë trupi nga druri dhe nuk do të më nxihet lëkura nga shenjat e drurit. E kupton?! Nëse një grua ëndërron të bukurën, unë kam ëndërruar gjithmonë veç të mos më rrahin. Ëndrra ime ka qenë gjithmonë një ditë pa dru. Një ditë ku dikush mos të ngrinte dorën dhe të më godiste. Kurrë nuk e jetova një ditë të tillë. Druri ishte vakt për mua. Kur të tjerët hanin mëngjes, unë haja dru. Kur të tjerët hanin drekë, unë haja dru. Kur të tjerët hanin darkë, unë haja dru.
- Kush të rrihte grua?
- Burri.

- Pse nuk e denoncon grua?

- E denoncova. Policia lëshoi një urdhër mbrojtjeje për mua dhe dje shkova të flija te motra ime. Erdhi burri dhe më mori me forcë nga atje dhe më çoi në shtëpi. Më rrahu prapë.

Ka mijëra gra, historia e të cilave është brenda dosjeve të komisarateve. "Do ta shohim rastin tuaj", - thotë polici, dhe historia mbyllet këtu.

- Ku po shkon grua?!

- Do të ngjitem në katin e tretë dhe do të hidhem. Do të shkoj pranë Zotit. Zoti nuk i rreh gratë dhe e di që Zoti do të më qortojë për këtë që po bëj, por do t'i them veç një gjë: "Zot, unë doja veç një ditë pa dru".

Shënim: Gruaja e radhës i dha fund jetës pasi kish denoncuar dhunën nga i shoqi. Policia kishte qenë 24 orë më parë në banesën e saj.

Historia vazhdon Tashmë në Perëndim

Unë quhem Alice, jam 27 vjeçe dhe nesër martohem. Zemra po më dridhet nga lumturia. Ndjeh flutura në stomak, në të gjithë botën e brendshme, në të gjithë brendësinë time. Bashkëshorti im quhet Luigi. Ai është dashuria e jetës sime. Dashuria që ndiej për të, është e pa kufij.

Quhem Alice, jam 30 vjeçe dhe jam shtatzënë. Ndjeh të përziera në mëngjes, sapo ngrihem nga shtrat dhe pasi hap sytë. Dhe në mbrëmje kam uri, uri për gjëra që nuk gjenden në frigorifer, ndaj Luigi duhet të dalë të blejë gjëra të ndryshme gjatë ditës, përpara se të kënaqë të voglin që jeton në barkun tim dhe që kërkon ushqim të veçantë. Luigi thotë se jam e bukur, nuk e besoj, kam shtuar dhjetë kilogramë, por gjithsesi e lejoj të më përkëdhelë me fjalët dhe duart e tij.

Quhem Alice, jam 31 vjeç, dhe prej disa muajsh mbaj në krahë Franceskon. Francesco është i mirë. Dëshiron të pijë shpesh qumësht, më sheh i habitur. Po aq e habitur jam edhe unë me veten time. Pyes veten: “A doli vërtet ky fëmijë nga unë?”. Jam e prekur nga gjithçka, kurse Luigi nuk duket dhe aq i emocionuar. Ai shpesh më ngre zërin: “Bëje atë të ndalojë së qari”. Dje më qëlloi me pëllëmbë në fytyrë. E fala menjëherë. Është i lodhur. Kjo atësi e gjeti të papërgatitur.

Quhem Alice, jam 32 vjeçe dhe sot, duke e parë veten në pasqyrë, vura re një mavijosje në krahun tim të djathtë, një në mollëza dhe një afër buzës. Vendosa menjëherë grimin dhe gjithçka u zhduk si me magji.

Emri im është Alice, jam 33 vjeç dhe sonte përfundova në urgjencë me tri brinjë të thyera. Luigi më goditi fort me bërryl. Por vazhdoj të mendoj që nuk është faji i tij. Nuk është faji i tij. Ai është aq i lodhur dhe unë jam aq e hutuar sa rashë në kuzhinë, duke i çuar pjatën me ushqim në tryezë.

“Burri im u përpoq të më ndihmonte të ngrihesha, por ai ra



mbi mua”. Kështu thashë në spital. “E sigurt?”, - më pyetën. “Sigurisht”, - u përgjigja me zë të ulët, me një dëshirë për t’ia plasur të qarit që u mundova ta fshihja me mjeshtëri.

Quhem Alice, jam 35 vjeçe dhe këtë mëngjes Luigi më futi një thikë në fyt. E ndjeva dhimbjen sapo tehu i thikës më hyri në mish. Për disa sekonda mbaja frymën dhe mendova: “A po më ndodh vërtet kjo gjë?”. Kam vdekur pas disa orësh. Nga ai moment nuk rrodhi më gjak.

Emri im është Alice, dhe tani jam re, shi, dhe tokë dhe det. Jam edhe fryma e nënës për të gjithë jetimet e kësaj bote”.

Nuk është një përrallë, as dhe një trill krijues, por një realitet trishtues i shoqërive në mbarë botën e “qytetëruar”.

Dhe ne që risjellim jetën, ne që sakrifikojmë gjithçka nga vetja për të gjithë, por kurrë për veten, presim 8 marsin të kujtojmë që dhe ne kemi vendin e padiskutueshëm mbi këtë galaktikë. Presim 8 marsin të përkëdhelim sedrën femërore dhe fill pas kësaj në datën 9, rikthehemi ku ishim, tek sublimja tek gjithçkaja e të gjithëve dhe asgjëja e vetvetes.

Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën, kurse të gjitha ne, po!

Nëse do të zhvillohej midis shtetesh, do ta quanim luftë. Nëse do të ishte një sëmundje, do ta quanim epidemi. Nëse do të ishte një derdhje e naftës diku në det, do ta quanim një katastrofë. Por, është diçka që po u ndodh grave dhe konsiderohet si një

çështje e jetës së përditshme. Është dhuna ndaj grave. Është ngacmimi seksual në punë dhe abuzimi seksual i vajzave të reja. Është rrahja ose dhuna fizike që secila prej miliona grave vuan çdo ditë. Është përdhunimi brenda shtëpisë ose në një takim. Është vrasje. Nuk është se ka ndonjë armik sekret që tërheq këmbëzën e armës. Nuk ka ndonjë virus të padukshëm që çon në vdekje. Janë vetëm meshkujt. Jo të gjithë, por shumë prej tyre. Në disa vende shumica e meshkujve kurrë nuk do të jenë të dhunshëm ndaj një gruaje. Ndërsa në vende të tjera, pjesa më e madhe e meshkujve do ta konsiderojnë si një të drejtë që e fitojnë që në lindje: të bëjnë çfarë të duan dhe kur të duan ndaj grave.

Por cilët janë këta meshkuj?

Thjesht meshkuj normalë, që vijnë nga të gjitha shtresat sociale të të gjitha ngjyrave dhe moshave. Të pasur, të varfër që punojnë tokën, apo meshkuj që qëndrojnë në zyrë pas një tavoline. Të gjithë këta janë meshkuj normalë, megjithatë, kanë ndihmuar në krijimin e një klime frike dhe mosbesimi tek gratë. Shumë nga gratë, nënat dhe motrat, të dashurat dhe bashkëshortet, nuk ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre. Natën ato nuk mund të shkojnë të blejnë diçka për të ngrënë, pa parë se kush po ecën pas tyre. Është e vështirë që ato të ndezin televizorin dhe të mos shohin meshkuj që shfaqin brutalitetin e tyre ndaj femrave dhe meshkujve të tjerë.

Të gjitha femrat ndihen “të burgosura”

brenda një kulture të dhunës

Unë kam parë dhe takuar shumë gra viktime të dhunës në familje gjatë përvojës sime të punës, kam dëgjuar shumë histori, përpjekje pa fund për hir të dashurisë, familjes, fëmijëve, respektit dhe vlerave. Kam takuar shumë gra, të cilat dhuna i kishte zhveshur nga vlerësimi për veten, nga shpresa për të ardhmen, dëshira për t’u ndjerë të realizuara në familje dhe në punë. Kam dëgjuar gjithashtu nga shumë njerëz të tjerë, të cilët mendojnë se kjo është një çështje që nuk i prek, që nuk ia vlen të flasësh dhe të përgjithësosh histori të veçanta dhe të trishtueshme të zënkave familjare, sepse në fund të fundit këto janë çështje private dhe nuk mund të gjykohen

A ndryshon kjo, nëse mund t’i ndodhë një personi

të rëndësishëm për ju, nënës, motrës, shoqes, koleges?

A ndryshon ndopak, nëse dhunuesi është babai, vëllai, miku apo kolegu juaj? Në fakt, të gjithë këta njerëz jetojnë jo vetëm në të njëjtin planet, por në të njëjtin qytet, lagje, banesë apo shtëpi, duke konsumuar në heshtje frytet e hidhura të dhunës. Dhuna në familje mund të prekë këdo, edhe ty nëse nuk mendon për të. Dhuna në familje prek çdo ditë mijëra gra dhe fëmijë. Pasojat e saj mund të jenë të dukshme dhe të padukshme dhe mund të zgjasin me vite. Dhuna shkatërron atë çfarë mund të jetë më e rëndësishme tek njeriu, marrëdhënien me veten, botën dhe gjithçka të shtrenjtë, e deri jetën.

Ne shpesh mendojmë se gjërat do të zgjidhen në heshtje, dikur apo dikush mund t’i ndryshojë gjërat, por jo ne. Kjo nuk është e vërtetë! Këto gra kanë nevojë për një fjalë, për një sinjal mirëkuptimi, për një mesazh të qartë se kjo që po u ndodh nuk është e drejtë, që ato dhe fëmijët e tyre meritojnë një jetë më të mirë dhe mbi të gjitha ato kanë nevojë të dinë se ka një rrugëdalje, dikush mund t’i ndihmojë në këtë situatë të vështirë.

Le të përpiqemi së bashku që çdo ditë të vitit ta kthejmë në një fillim pranvere.

Nënat që lindën diktatorë

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Lindin apo bëhen diktatorë?!

Nënat janë qenia që sjell jetën mbi tokë, por cili është ndikimi në rritjen e krijesës së saj? Në kohëra të ndryshme kemi parë që qeniet humane të ndikuar nga jeta në familjet e tyre të sjellin pikërisht kaosin dhe dhunën që kanë përjetuar.

Të tillë kanë qenë dhe liderët që kanë drejtuar popujt e tyre drejt shfarosjes. Teksa njih fëmijërinë e tyre kupton derivatin e jetës pa ndjenja, gati shtazore dhe pse jo jetës amorfe të tyre.

Diktatorët nuk vijnë në botë me mustaqe dhe një pushkë në dorë.

Klara Hitler

Po të marrim një nga figurat e rëndësishme të historisë të njerëzimit, Hitlerin.

Klara rridhte nga një familje e thjeshtë, nga një qytet i vogël pranë Austrisë. E përshkruanin si një nënë shumë punëtore e përkushtuar për familjen, energjike, e dashur, shumë e urtë, e qetë dhe shumë e devotshme.

E përshkruar si një grua punëtore, e përlur dhe thellësisht fetare. Kur ishte vetëm 16 vjeç u martua me kushërinin e saj Alois Hitler. Familja pati tre fëmijë që vdiqën nga difterija para moshës dy vjeçare. Fëmija



i katërt, Adolfi, lindi në pranverën e vitit 1889. Klara iu përkushtua familjes së saj dhe e kaloi jetën duke u kujdesur për fëmijët: Adolfin dhe Paulën. Në vitin 1907, katër vjet pas vdekjes së burrit të saj, Klara u diagnostikua me kancer në gji. Pas trajtimeve të gjata dhe të dhimbshme, eksperimenteve me shumë ilaçe dhe kura, ajo vdiq në fund të vitit. Vdekja e saj e shkatërroi krejtësisht Adolfin, me të cilën kishte lidhje shumë të fortë. Ai nuk arriti ta kapërcejë vdekjen e saj deri në fund të jetës. Lidhjet në familjen Hitler konsiderohen si një nga arsyet kryesore për atë që u bë dhe që u shndërrua Adolfi. Nga njëra anë babai i tij i pashpirt, barbar, i cili abuzonte me të dhe nënën e tij, nga ana tjetër ishte vetë Klara, e cila, përballë frikës duronte burrin e saj. I mbante fëmijët dhe i trajtonte me respekt dhe dashuri. Zbutja e

vazhdueshme e ndjenjave të dikujt dhe ndërtimi i një imazhi imagjinar i vetvetes, sipas historianëve dhe psikologëve, lëshuan mizori mbi Adolfin, duke e kthyer atë në Fyrherin, tmerrin e botës.

Nëna e Hitlerit e shtypte të birin me kujdesin e tepruar dhe me idetë e saj të fiksuara. Mendohet se ai ka qenë “djali i llastuar i mamasë”. Në këtë rast, tiparet femërore mbizotëruan në tiparet mashkullore. Pra e kam fjalën, prania e mamave, dashuria e tyre dhe jo prania e baballarëve.

Në fëmijëri i ati e torturoi për vdekje në prani të Adolfit qenin e tij të preferuar. Kjo ishte një nga rastet që u bë shkak dhe një nga arsyet që Adolfi më vonë u diagnostikua me çrregullime obsesivo-kompulsive. E gjithë bota përreth tij i dukej armiqësore. Ai nuk ndihej i sigurt askund dhe kishte probleme me veten. Hitleri preferonte të luante me vajza dhe i pëlqente të ishte në shërbimin e tyre. Ai vuante nga orientimi i tij i pakuptueshëm seksual, kishte frikë të ekspozohej dhe kishte kompleks vetmie dhe tjetërsimi.

Akumulime të tilla shkaktojnë pa dyshim mizori. Vdekja e mamasë ishte një ngjarje thelbësore në biografinë shpirtërore të tij. Për Hitlerin kjo u bë një katastrofë për universin e tij personal. Hitleri e rrethoi nënën e tij, që po vdiste nga kanceri, me një kujdes të tillë që, ishte jashtë aftësive të tij. Diktatori gjithnjë mbante në dhomën e tij një fotografi të vjetër të nënës. Ndjenja e vetmisë dhe mendimi se mbi të rëndonte padrejtësia që i bëhej, nuk e la kurrë.


Hitleri nuk u pajis me arsimin e duhur. Disa historianë pohojnë se kjo ishte për shkak të zymtësisë, ashpërsisë dhe urrejtjes që kishte ndaj shkollës. Hitleri, ndryshoi shkollat njëra pas tjetrës pa mundur të përfundojë asnjërën prej tyre. Në librin e tij të famshëm, ai pohoi se kishte përvetësuar jo më shumë se 10% të atyre që kanë mësuar të tjerët. Dhe e justifikonte veten se nuk donte të studionte se nuk kishte para dhe se duhej të punonte. (gjë që nuk ishte e vërtetë, në të dy rastet gënjeshtrore ishte një tipar patologjik.) Hitleri duket se prej asaj kohe po grumbullonte urrejtje për njerëzit e shkolluar dhe inteligjencës. Në shënimet e tij, diktatori i quajti mësuesit “majmunë dhe hajvanë”. Një tipar tjetër i zakonshëm i Hitlerit ishte arroganca e tij shumë e dhimbshme. Si fëmijë, u torturoi nga fobi të shumta. Të gjithë studiuesit janë të mendimi që kur arriti moshën madhore, në karakterin e tij u formuan elemente të tipit psikologjik të diktatorit.

Ekaterina Gelazde Zhugazhvili

Ekaterina lindi në familjen e një kopshtari fortesash në Gjeorgji. Babai i saj vdiq shumë i ri dhe megjithëse familja nuk kishte shumë para, nëna e birësuar e Ekaterinës arriti t'i jepte një edukim. Ekaterina u martua



me Vasarion Dzhugashvili në moshën 17 vjeç. Fëmija i parë dhe dy të tjerët vdiqën shumë shpejt, dhe i treti ishte Jozefi. Vasarioni e braktisi familjen në 1890, pasi u bë i varur nga alkooli dhe rrihte gruan dhe të birin. Një grua e fortë dhe e rreptë si Ekaterina donte të siguronte të ardhmen e të birit, të cilin e donte pafund. Ajo ëndërroi që Jozefi të studionte dhe të bëhej prift, pavarësisht kundërshtimit të burrit të saj, i cili donte që i biri të trashëgonte zanatin e tij, këpucarinë dhe shpesh nuk e linte të shkonte në shkollë. Për të siguruar arsimimin e djalit, Ekaterina mësoi të qepte dhe filloi të punojë. Lidhja midis Stalinit dhe nënës ishte shumë e fortë, por ambiciet që drejtonin të gjitha veprimet e saj pasi ai u rrit, lanë gjurmë në mendjen e djalit. Terrorizmi është kthyer në njëllë të zezë e mijëvjeçarit të ri. Kjo njëllë e përgjakshme po sjell shkatërrim në shoqërinë njerëzore. Për ta luftuar terrorizmin dhe për t'iu kundërvënë, duhet të njihen rrënjët e tij, jo vetëm në politikë dhe ekonomi, por edhe në shpirtin njerëzor.



Maria Alexandrovna Ulyanova

Një nga shkatërrimtarët ishte edhe diktatori Lenin. Ai vinte nga një familje normale, në të cilën babai ishte figura kryesore dhe kishte qëllime të larta në jetë. Nëse trau i shtëpisë i traditës familjare të Uljanovëve ishte shumë i lartë dhe i vështirë për t'u arritur nga fëmija, që në përgjithësi i dukej i pa arritshëm. Ky ishte saktësisht problemi i Vladimir Ulianov. I ati që qëndronte përballë tij ishte i paarritshëm fatkeqësisht.

Ishte më e lehtë të bëhej revolucionar dhe të shkatërronte gjithë botën se të përpiquej të arrinte babanë e tij. Në shtëpinë e Uljanovëve sundonte një atmosferë rivaliteti, përpjekja për arritje të mëdha në jetë, sikur ishin në gara me njëri-tjetrin. Babai, Ilija Nikolajevič bëri një karrierë të dukshme, u bë fisnik, këshilltar dhe mori Urdhrin e Shën Stanislaus nga Perandori Aleksandri III. Babai Uljanov mungonte në shtëpi për muaj të tërë, nuk ishte prezent e nuk merrte pjesë në edukimin e djemve dhe fëmijëve në përgjithësi. Ai vizitonte provincën e Simbirskut dhe kontrollonte nivelin e arsimit publik.

Nëna Maria Alexandrovna ishte një nënë-mësuese-edukatore “me orar të plotë” në kushtet e shtëpisë. Ajo ishte tërësisht e angazhuar në edukimin e fëmijëve. Ishte zonjë me vullnet të fortë, krenare dhe e mbyllur. Kështu e rriti i ati, që ishte një burrë i fuqishëm dhe madje despot. Maria ishte e ftohtë si akulli, e egër, e cila pa asnjë dyshim nuk u martua me dashuri. U transmetoi fëmijëve metodat e edukimit të babait të saj, kultivoi tek ata vullnet dhe ndjenjën e epërsisë ndaj të tjerëve. Vladimiri i ngjante më shumë nënës se babait.

Edhe pse përfundoi shkollën me medalje ari, ai ishte një njeri i kufizuar dhe i mbyllur brenda kornizave. Edukimi i tij provincial, veçanërisht në sfondin e detyrave që iu caktuan. Kultura për të cilën Vladimir Uljanov kishte cilësi, u zëvendësua nga ideja e tij fantastike për “riorganizimin e botës”. Kjo ishte një tragjedi e zakonshme për të gjithë diktatorët dhe terroristët.

Historia vazhdon ... Sadam Husein

Sadam ishte fëmijë i padëshiruar. Fëmijëria e dhimbshme e Sadam Huseinit dhe diagnostikimi i rastit të presidentit irakian Sadam Husein ishte një narcizëm i dhimbshëm. Lindja e diktatorit u shënuar nga dy vdekje. Babai i tij, i cili ishte një fshatar i varfër, vdiq, ndërsa gruaja e tij ishte ende shtatëzënë. Babai i Sadamit vdiq nga kanceri menjëherë pasi vdiq vëllai i tij i madh. Prandaj, është e kuptueshme që nëna e tij Subha ra në depresion të thellë nervor. Ajo madje dëshironte ta abortonte fëmijën. Pasi nuk arriti, Subha bëri disa përpjekje për vetëvrasje pa sukses. Ishte e vështirë për të, të kujdesej dhe ta ushqente me gji të porsalindurin, i kujtonte dy të vdekurit, burrin dhe djalin. Pra tre vitet e para të jetës së Sadamit kaluan në kujdesin e dajës së nënës.

Më pas, Subha u martua. Dukej se ishte fillimi i një fati më të mirë dhe për djalin. Mjerisht, njerku i tij, Ibrahim al-Hassan, doli se ishte një tiran kokëfortë, i egër, i pamëshirshëm, njerku e rrihte dhe tallej rëndë me të. Këto veprime krijuan tek Sadami një reagim tejet të dhimbshëm ndaj realitetit përreth tij. Që atëherë, ai nuk i bëri kurrë autokritikë vetes dhe ishte shumë mizor. Tabloja plotësohej nga uria e vazhdueshme e nënës së tij, dhe qëndrimi i neveritshëm i njerkut të poshtër. Uria ishte një fenomen i përditshëm për mamanë dhe për Sadamin. Sadami i urrente delet që duhej t'i kulloste çdo ditë. Kishte vetëm dy rrugë për të dalë nga ky ferr, dëshpërimi dhe shpresa, apo ëndrrat për lavdinë e ardhshme. Ai zgjodhi ëndrrat. Thuhet se njëherë të afërmit erdhën për të vizituar shtëpinë e tyre. Me ta ishte një djalë moshatar me Sadamin. Vizitori menjëherë filloi të mburrej se ishte në klasën e dytë dhe se mund të lexonte dhe të numëronte, madje shkroi emrin në rërë. Sadami i prekur thellë shkoi te Al Hassan me një kërkesë për ta dërguar në shkollë. Puna mbaroi me rrahje të rëndë nga njerku, ky veprim e bëri djalin që më pas të ikte nga shtëpia. I arratisuri u strehua përsëri tek xhaxhai i tij Heyrallah. Ai ishte personi i tretë në fëmijërinë e tij që krijoi dhe formatoi karakterin e tij. Ëndrra e Sadamit për të mësuar të shkruante u shndërrua në një dëshirë të papërmbajtshme, por i shërbeu edhe për të sunduar mbi njerëzit. Xhaxhai u përpoq që të brumoste në kokën e nipit se ai ishte i destinuar për vepra të jashtëzakonshme. Trashëgimia nga fëmijëria dhe mënyra e rritjes së njerkut kishin reflektuar dukshëm në sjelljen e tij në shkollë. Në shkollë u konsiderua nxënësi më i dobët, por askush nuk guxoi ta tallte, djali shpesh kishte sjellje brutale. Gjatë kohës së shkollës, Sadami vodhi kapelën e një mësuesi dhe e grisi copa copa. Një herë tjetër ai u zu keq me një shok të klasës, nxori një thikë dhe gati sa e vrau.

Në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, Sadami ishte tronditur thellë nga vdekja e kalit të tij të dashur. Aq shumë sa krahu iu paralizua për disa muaj. Narcizmi i sëmurë i Sadam Huseinit u manifestua në disa aspekte, ai mbyllej në vetvete, kishte shumë probleme me veten, dhe nuk ndjente dhembshuri për të tjerët. U përpoq të arrinte qëllimet e tij me çdo kusht dhe ishte një sociopat i plotë. Sadami ishte paranojak, i bindur se rrethohej vetëm nga armiq. Ai i donte lojërat e mëdha, armët, pa të cilat nuk ndjehej i qetë. Presidenti irakian kishte shumë ngjashmëri me Osama bin Ladenin.

Diktatorët

Pavarësisht nëse ne ende i konsiderojmë ata njerëz të mëdhenj apo psikopatë të zakonshëm që dinin të përfitonin dhe e përdorën si “shans” historik për të nxirë fatin e kombeve të tëra, përfshirë edhe kombin e tyre, këta ishin diktatorët e mëdhenj të shekullit XX.

Mbeten një enigmë e madhe e pazgjidhur që ngjall kureshtjen e miliona njerëzve në të gjithë botën. Nëse i besojmë teorisë tashmë “të vjetruar” të Sigmund Freud, fëmijëria dhe makthi janë faktor i rëndësishëm në formimin e personalitetit.

Gjykoni vetë si ishte fëmijëria e tyre, vitet e para të jetës dhe sa shumë ndikoi në fatin e tyre dhe në fatin e botës... Historia vazhdon...

Brezat e pakohë të shekullit XXI

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Të rinjtë sot?

Të riut i ndizet mendja me ëndrra fisnike; i riu është gati të vazhdojë mendime të bukura pa interes vetjak, është i zoti të vuajë për ideale, dridhet nga padrejtësia dhe mbrapset nga dinakëritë si nga murtaja, i riu di edhe gëzimin e zemrave të pastra, të riut i qesh shpirti dhe buza.

“Në Shqipëri shohim djem të ngrysur me sy të turbulluar nga djallëzitë, të kërrusur nga barra e mendimeve hesapesh dhe ngatërresash. Edhe çiliminjtë në djep, duken të mrvrojtur dhe të thartë. Nuk ka shqipëtarë të rinj, po vetëm ca shqipëtarë të lindur më parë, ca të lindur më pas, të thatë nga zemra e tyre, e cila s’ka njohur kurrë entuziasmë për gjësendi”, këto rreshta i ka shkruar Konica në 1937-n, por duket se, sikur të mos ishte gjuha dhe stili i tij i njohur, shumëkush prej nesh, duke i lexuar, do të pandehte se i përkasin rinisë shqiptare të viteve 90. E themi këtë, pasi përshtypja që kemi krijuar nga kontakti me masën e të rinjve, madje me pjesën më të kultivuar të saj, është se preokupimi i tyre kryesor sot sillet rreth argëtimit, parasë, sigurimit të ndonjë udhëtimi jashtë shtetit dhe se jo rrallë janë gati të bëjnë çdo djallëzi për t’i arritur këto pikësynime. Pak, shumë pak ëndrra fisnike dhe vuajtje për ideal kemi gjetur në mendjet dhe në zemrat e tyre, pak, shumë pak luftë për drejtësi, pak, shumë pak kërkesa për të afirmuar origjinalitetin dhe personalitetin... Por, mbi të gjitha, ajo që na duket karakteristike e përbashkët e rinisë shqiptare është se pak, shumë pak ndjehet tek ajo ndjenja e rebelimit ndaj autoriteteve. Kur themi autoritete nuk e kemi fjalën vetëm për autoritetet politike, por për autoritetet në të gjitha ato fusha të veprimtarisë artistike dhe shkencore, ku rinia, së bashku me energjinë dhe rebelimin, sjell me vete edhe idetë e reja. Dhe jo për autoritetet si persona fizikë, por kryesisht për traditën që ata mishërojnë apo kanë krijuar.

Ç’do të thotë të jesh i ri?

Të jesh i ri do të thotë të përpiqesh për origjinalitet, për aktivitet të lirë, të kesh shpirt pavarësie, të jesh zot i fatit tënd, ndryshe nga plaku, i cili, përkundrazi, është më pasiv dhe dominohet kryesisht nga një shpirt përshtatjeje ndaj gjërave e rrethanave. Por ajo që vihet re tek rinia shqiptare është pikërisht ky shpirt përshtatjeje ndaj një tradite dhe zakonesh nga më konservatorët. I riu shqiptar fatin e tij e ka lënë në dorë të të moshuarve, të cilët e kanë udhëzuar si të futet në shina të sigurta e si të mos ia hedhë të tjerëve i pari. Prandaj dhe na duken shumë të vërteta fjalët e Konicës se, rrallë gjen të rinj shqiptarë që të vuajnë për ideale. Të kesh një ideal dhe të luftosh për të do të thotë, në njëfarë kuptimi, të mos kesh atë eksperiencën e hidhur që ka plaku, i cili tashmë e di se ideali është një pikë që nuk arrihet

kurrë. I riu, përkundrazi, beson tek ai, lufton për të pamundurën, hedh mbi supe më shumë sesa ç’ mund të mbajë, fluturon drejt synimit, pa marrë parasysh mjetet dhe etapat, e pikërisht këto karakteristika sjellin në më të shpeshtën e herëve ndryshimet dhe zhvillimet në një shoqëri, e cila përndryshe do të mbetej në vend.

Pleqëria, koha e pa kohë?

Nëse shumica e të rinjve shqiptarë arrijnë moshën e pjekurisë pa kaluar ethen e rinisë, pra, pa qenë asnjëherë të rinj ashtu siç e shoh rininë sot, atëherë afërmendsh atyre do t’u mungojë një tharm shumë i rëndësishëm për krijimin e personalitetit. Prandaj duket se është me vend të shtrohet edhe pyetja “A ka pleq Shqipëria?”, e cila ndryshe mund të shtrohej në trajtën, “A ka personalitete Shqipëria?”, në kuptimin e personalitetit si mishërim i një individualiteti të lirë dhe të ndërgjegjshëm për lirinë dhe individualitetin e tij. Përgjigja do të ishte se Shqipëria nuk është e varfër vetëm në të rinj, ashtu siç i përshkruam karakteristikat e të riut, por edhe në pleq të urtë. Pjesa dërrmuese e pleqve shqiptarë pikërisht se u ka munguar origjinaliteti dhe liria në rininë e tyre, pra se nuk kanë qenë kurrë të rinj, kur plaken bëhen pleq të dështuar, me fjalë të tjera pa ndonjë personalitet të spikatur.

Për të kompensuar këtë mungesë ata zhvillojnë anën tjetër të mekanizmit mazokist, fillojnë t’i shtypin të rinjtë, duke kërkuar me insistim që këta t’u nënshtrohen dhe jo rrallë të kujtojnë ‘Erazmin’ kur thotë se “rinia engjëllorë pjell pleq satanikë”. Ky rreth vicioz shtypje-nënshttrim është mekanizmi kryesor që dominon marrëdhëniet tona shoqërore. Ai është aq organik saqë nuk mund të kuptohet se kush është primar, pasiviteti dhe nënshttrimi i të rinjve apo sundimi i pleqve, madje mund të thuash se diferenca e vetme midis tyre qëndron vetëm në atë që thotë Konica se, disa kanë lindur më parë e disa më pas, pra, se janë e njëjta gjë.

Na duket se shkaqet e mungesës së të rinjve në shoqërinë tonë duhet t’i kërkojmë, mbi të gjitha, në traditën e saj, ku i pari i fisit, i klanit mbetej autoriteti vendosës deri në fund të jetës dhe, për ta mbajtur fort pushtetin e tij, kujdesej gjithnjë të ishte mishëruesi dhe mbrojtësi i traditës. Ndërkaq, i biri e fitonte parësinë vetëm pas vdekjes së tij, duke i ardhur kështu radha të bëhej mbrojtës i traditave dhe i zakoneve të të parëve.

Dhe historia vazhdon...

Sundimi është elementi komplementar i nënshttrimit, ai që, sipas mendimit tim shpjegon faktin që gjatë këtij shekulli, atëherë kur i është dhënë mundësia për t’u çliruar nga autoriteti i etërve, rinia shqiptare në thelb s’ka bërë tjetër veçse ka imituar autoritetin shtypës të tyre, duke i shërbyer të njëjtës traditë. Kjo shpjegon pse aspiratat për modernizimin e Shqipërisë, politikani i ri Ahmet Zogu ia nënshtroi, në thelb, nevojës për të përjetësuar pushtetin me çdo mjet, sipas mendësisë së zotit absolut të Malësisë së Matit, që e kalonte pushtetin nga i ati tek i biri... Kjo shpjegon çudinë e atyre që panë të shndërrohej



në një diktator aq të tmerrshëm një njeri si Enver Hoxha, të cilin në rini e kishin njohur si një djalë gazmor... dhe në një nivel më të gjerë, se si, me gjithë mohimin e madh që pretenduan se i bënë komunistët zakoneve të vjetra, në fund të fundit ia përshtatën ideologjinë e tyre revolucionare këtyre zakoneve dhe modeleve konservatore të të jetuarit. (Le të sjellim ndërmend se si lufta e klasave, që në teorinë marksiste konceptohej si një mekanizëm kontradikte midis një klase të re që lindte dhe një klase të vjetër, u aplikua tek ne në trajtën e një mekanizmi me tipare të theksuara hakmarrjeje klanore, për asgjësimin e të gjithë atyre që ishin kundër klanit komunist apo që dilnin prej tij.) ... Në mënyrën e vet më të rëndë, gjatë këtij shekulli, mekanizmi nënshtrim – sundim u shfaq në periudhën midis luftës nacionalçlirimtare dhe viteve '90. Në fillim të viteve '70, kur u godit liberalizmi, një nga akuzat që u bë ishte edhe ajo ndaj idesë-fantazmë se elementët liberalë kishin nxitur konfliktin e brezave. Në propagandën e asaj kohe së bashku me kërkesën për kultivimin e traditave e folklorit, trajtohej edhe kjo herezi e madhe, të cilën nuk mund ta pranonte askush, e dënueshme njëlloj si anti-atdhetarizmi. Si përfundim, fjala konflikt brezash u varros, humbi nga fjalori dhe të gjithë sikur u ndjenë të kënaqur që baballarët mbetën atje ku ishin, të pacenuar në madhështinë e tyre ...

Nëse sot në Shqipëri gjen shumë nxënës, adhures, vazhdues, dishepuj, ithtarë, pas të cilëve rreshtohet një masë amorfe të rinjsh pa asnjë individualitet dhe fare pak rebelë e të revoltuar me ide të reja, kjo tregon se, në thelb, kemi mbetur në të njëjtën gjendje. Në qoftë se deri dje ishte frika ajo që dominonte në marrëdhëniet tona, e cila jo rrallë e bllokonte krejt komunikimin e natyrshëm midis individëve, sot, ndonëse komunikimi është më i lirë, karakteristikë e tij mbetet mosbesimi, dyfytësia, të cilat, në thelb, nuk janë tjetër veçse refleksi i një shoqërie, ku vazhdojnë të mbizotërojnë marrëdhëniet sundim-nënshtrim, ku në vend të energjive që çliron dialogu i hapur ne përjetojmë tensionin që krijojnë këto marrëdhënie dy nivelesh që kërkojnë energji të dyfishta për t'u mbajtur.

Pikërisht sepse individi shqiptar, duke qenë nën diktatin e patriarkut, klanit, ka pasur hapësirë më të pakët për t'u shprehur, shpesh ai ka shfaqur në jetë ose nënshtrimin, çka ka krijuar shoqërinë e mbyllur dhe të dhunshme, 'at-vrasjet' apo 'bir-vrasjet', të cilat kanë qenë thellësisht shkatërruese. Në hullinë e kësaj tradite duket se u tjetërsuan edhe energjitë që çliruan idealet e studentëve të kryevitit '90.

Shembja e një sistemi thellësisht autoritar, siç ishte ai komunist, ka sjellë çlirim pozitiv të energjive të rinisë shqiptare. Mjafton të përmendim faktin se një grusht gazetarësh, me kurajën e tyre qytetare, jo vetëm hodhën bazat e një gazetarie të re shqiptare të çliruar nga urrejtjet ideologjike, por kanë dhënë një kontribut të veçantë për ruajtjen e mendimit të lirë në Shqipëri.

Megjithatë ngulmojmë se ky soj të rinjsh përbën një pakicë të pamjaftueshme për emancipimin e jetën kulturore, politike e shoqërore të Shqipërisë, madje se ekziston rreziku që ata t'i asimilojë tradita e vjetër autoritariste. Nuk duket se ka një rrugë të shpejtë për ta shndërruar energjinë e moshës rinore të Shqipërisë nga një energji që derdhet dhe ngrin në shtretërit e vjetër tradicionalë, në një të tillë që ngrihet drejt sintezave të reja pas dialogut me traditën.

Sot flitet shumë për mungesën e një ideali përbashkues tek rinia. Por, nëse duam të ndërtojmë një shoqëri të hapur s'ka si të synojmë bashkimin e energjive të rinisë rreth një ideali të vetëm. Madje një synim i tillë do të ishte i rrezikshëm. Në një shoqëri të hapur idealet janë të shumta, shpesh herë edhe individuale, prandaj dhe ndërtimi i tyre është shumë më i vështirë dhe kërkon shumë më tepër kohë. Duket se do të kalojnë disa breza përpara se të ndërtojmë një shoqëri të tillë, por guximi i një brezi, guximi i një grupi, krijon tharmin për emancipimin e një shoqërie të tërë. Prandaj, pa mohuar personalitetet e afirmuar, në gazetën tonë do të përpiqemi, të inkurajojmë dhe botojmë sa më shumë protagonistë të rinj të kulturës, artist ushtarak, hulumtues të historisë shqiptare, të cilët i duhen kombit si asete të tij.

'Kush bie për atdhe, nuk vdes por ka le'

Mihal Duri lindi në fshatin Erind të Lunxhërisë, Gjirokastrë, në vitin 1916. Pas vdekjes së të atit, ai bashkë me nënën dhe motrën më të vogël erdhi në Tiranë. Me të mbaruar shkollën fillore, hyri si punëtor në shtypshkronjën "Dielli", ku punonte 10-12 orë në ditë, por paguhej shumë pak. Ai ishte i pajisur me veti të rralla të punëtorit revolucionar. Që në moshë të re hyri në lëvizjen punëtore dhe shumë shpejt u bë aktivist i dalluar. U lidh me Qemal Stafën, Vasil Shanton, Enver Hoxhën, Vojo Kushin etj. Mihal u bë anëtar i Grupit Komunist të Korçës, në degën e Tiranës. Këtu ai futi mjaft intelektualë revolucionarë, siç ishte bashkëfshatari i tij Misto Mame, i cili erdhi në Tiranë. Mihal dhe Misto ishin ata që krijuan shtypin ilegal që para themelimit të PKSH-së, duke shtypur trakte, parulla e artikuj për demaskimin e propagandës fashiste. Ata, përgatitën edhe shtypjen e gazetës "Zëri i popullit" dhe revistës "Kushtrimi i Lirisë". Për të realizuar këto, bënë një sërë aksionesh për sigurimin e shaptilografëve, makinave të shkrimit, letrës, shkronjave dhe mjeteve të tjera të nevojshme. Kryerjen e këtyre aksioneve ia ngarkuan Mihal Duri dhe njërit nga njësitet guerile të komanduar prej tij. Një nga këto aksione ishte ai që u bë në ish-Ministrinë Botore, ku u mor një sasi e madhe letre. Pas këtyre njësitit gueril me komandant Mihal Durin kreu shumë aksione të vështira, çka i alarmoi së tepërmi fashistët dhe vunë në lëvizje spiunët për survejimin e atentatorëve.

Mihal u pranua në radhët e PKSH-së që në themelimin e saj. Së bashku me Vasil Shanton, Qemal Stafën e luftëtarë të tjerë, ai ishte një nga partizanët e parë të vitit 1941, që u hodh në radhët e çetës së Pezës e komanduar nga patrioti Babë Myslimi, e cila u bë shumë shpejt e njohur në të gjithë vendin për aksionet dhe luftën e saj. Më 25 nëntor 1941, komunistët Vasil Shanto, Mihal Duri, Ferid Xhajko, Stavri Themelko, Pandi Nasho, Baki Starja, Loni Grazhdani etj., u mbledhën në Maknor dhe formuan celulën e parë të PK-së në çetën e Pezës, ku sekretar u zgjodh Mihal Duri. Nën udhëheqjen e Partisë, Peza u bë shkollë për përgatitjen e kuadrove të rinj e të nevojshëm për të udhëhequr nga ana ushtarake dhe politike çetat partizane që u formuan më vonë në shumë krahina të vendit tonë.

Mihal Duri, si sekretar i celulës së PKSH-së në çetën e Pezës, dallohej për vendosmërinë dhe shpirtin e tij luftarak.

Në janar 1942, u mbledh në Tiranë aktivi i Partisë, ku u punua rezolucioni i formimit të PKSH-së. Ishin mbledhur 15-20 shokë në një shtëpi përdhese të një familjeje tiranase. Bënte shumë ftohtë. Ora po afronte 24.00 e natës. Mbledhja nuk po fillonte. Të gjithë ishin mbledhur pranë një mangalli me pak zjarr. Dukej se dikë pritnin. Dhe ja, u duk Enver Hoxha, bashkë me Vasil Shanton e Mihal Durin.

Mihal disa ditë para se të vritej erdhi në Tiranë dhe u takua me shokët e Komitetit Qarkor të PKSH-së të Tiranës për punët e luftës kundër fashistëve e spiunëve. Mbase mbaroi punë, me dy shokë të qytetit shkoi në Pezë të Vogël ku ishte çeta e saj. Me të arritur atje, Mihal organizoi dhe përgatiti njerëz për të studiuar zbulimin e kazermeve të Sharrës, që ishin të mbushura plot me municione e që duheshin djegur. Për t'ia arritur qëllimit, aty për aty, në Kodrën e Çorrit mbi Pezën e Vogël, ku qëndronte çeta, Mihal bashkë me komunistin Xhevdet Petrela përgatiti njësitin që do të bënte zbulimin dhe studimin e vendit, pastaj do të merrte masa për të kryer aksionin. Në zbulim u përgatitën të shkonin 6 vetë, Mihal me dy shokët e tij që e shoqëronin nga qyteti dhe Xhevdeti vetë i tretë. Ata u maskuan me rroba katundarësh dhe kaluan nëpër katunde si të panjohur. Rreth orën 5.00 të pasdites, njësit u afrua në fshatin Damjan, ku gjendeshin shumë milicë dhe karabinierë të ardhur nga Tirana.

Tek po futeshin në shtëpitë e para, ata ranë në pritën e armiqve dhe lufta filloi. Pushka u ndez në gjithë fshatin. Partizanët u tërhoqën në rregull, duke luftuar në distancë të largët rreth 500 m. Milicët e dendësuan shumë zjarrin e luftës kundër partizanëve që luftonin pa ndërprerje. Në këtë përpjekje plumbi armik e shkëputi Mihalin nga shokët dhe më 20 gusht 1942 ai ra dëshmor. Vrasja e tij që



një humbje e madhe për celulën e Partisë së çetës së Pezës dhe përgjithësisht të PKSH-së së Tiranës.

Myslim Peza në kujtimet e tij kujton: "Në çetën tonë erdhi Mihal Duri, një djalë i pashëm, me trup të fortë. Ishte azgan djalë, trim që s'mbahej, njeri i aksionit. Si sekretar i celulës së Partisë, Mihal u dallua edhe për gojëtarinë e tij të zjarrtë, për ta bërë sa më të kuptueshme për të gjithë njerëzit vijën e Partisë. Ai u dallua si një nga shokët tanë të çetës, nga më trimat, derisa u vra si Hero në fushën e luftës". Nënë Sillua e donte shumë Mihalin. Në kujtimet e saj të shtrenjtat për të birin, momenti i vrasjes së tij është shumë i rëndë, gati i papërbalueshëm: "Ishte errësirë dhe thash të flija. Hoqa njërën çorape, po dëgjova të vinin disa makina përpara derës së shtëpisë dhe menjëherë filluan të trokiturat e forta: "Hape derën, hape derën sa do ta thyejmë!". "Kush ini ju, - i pyeta e shqetësuar. - Jam plakë dhe mezi eci!". "Hap derën", - bërtisnin bishat, por nuk i numërova dot sa policë e milicë kishin ardhur. "Hajde, - më thanë, - se do të vish me neve në kuesturë". Më morën dhe hipën në makinë. Rrugës mendoja mos e kishin kapur dhe vrarë Mihalin. Unë një natë më parë e përçolla dhe ai më tha: "Mos i beso askujt, edhe në qoftë se të thonë se unë jam vrarë, pa më parë me sytë e tu dhe mos trego asnjë nga shokët!". Më zbritën nga makina, më vunë dritat ë sy, pastaj dritat i vunë tek një trup i hedhur përdhe dhe i tërhequr zvarrë. "Djali yt është ky?", - më pyeti duke mu afruar kuestori i poshtëri i quajtur Papalilo. U afrova dhe vura re se ishte Mihal, djali im i shtrenjtë. Iu afrova kuestorit dhe i thashë: "Po ky është djali im Ç' m'i kini bërë kështu more të poshtër?!". U afrova tek Mihal, i ngrita kokën dhe me gjakun e tij leva gjoksin tim...Vajta në shtëpi dhe qava shumë gjithë natën.

Presidiumi i Kuvendit Popullor i dha Mihal Duri dekoratën më të lartë "Hero i Popullit". Ndërmarrjes ku shtypeshin librat dhe gazetat iu vu emri "Mihal Duri". Edhe një shkollë 9-vjeçare mban emrin e këtij heroi të lavdishëm.

SAMI GOLEMI I FUSHËBARDHËS: "BESËN PËR LIRINË, GJAKUN PËR ATDHEUN"



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

(Në nderim të 80-vjetorit të rënies së dëshmorit të Fushëbardhës, Sami Sejdi Golemi si dhe shokëve të tij të Labërisë të rënë pranë Senicës së Delvinës. Mirënjohje Këshillit Bashkiak të Delvinës që miratuan njëzëri dhe firmosën ligjërisht Vendimin e Këshillit Bashkiak të Delvinës që mban nr.14 datë 30.3.2021, "Për miratimin e ngritjes së memorialit për 5 dëshmorë të LANÇ-it: Hasan Salih Çerepi 17 vjeç, Karafil Vehip Bello 42 vjeç, Sami Sejdi Golemi 37 vjeç, Sefer Ramo Meta 28 vjeç, Skënder Mato Pepiaj 19 vjeç, pranë fshatit Senicë të Delvinës).

Vitet kalojnë dhe u bënë dekada, nga rënia për atdhe e dëshmorëve të lirisë. Edhe pse kaluan tetë dekada, më i lartë është nderimi, mirënjohja dhe respekti për bartësit e idealeve të lirisë, për bijtë e bijat e Labërisë dhe mbarë kombit shqiptar, që gjakun e çimentuan me lirinë. Epitetet për lartësinë e piedestaleve e memorialëve kanë bazë të fuqishme kur kujtohen e respektohen me dinjitet e krenari. Nderimi dhe mirënjohja për dëshmorët është nderim e respektim i idealeve të kombit e flamurit. Një ndër luftëtarët e lirisë gjatë LANÇ-it ishte partizani i orëve të para Sami Sejdi Golemi, që jetën ia fali atdheut me përkushtim të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare të lirisë. Ai ra trimërisht në Senicë përtej Skërficës, Luvadhut e Zagonikut. Atje ku kishte rënë edhe trimi Karafil Bello, ranë në betejë më 14 mars 1944 edhe Sami Golemi, Hasan Çerepi, Sefer Meta, Skënder Pepiaj, pranë fshatit Senicë të Delvinës. Brezat e burrëruar në kohë baruti, pas luftës mbajnë në kujtesë një lapidar në formë koni si kujtesë lufte, në vendin e quajtur Qafa e Hanit, që fliste shumë për burrat që ranë për Atdheun, që gjakun e çimentuan me lirinë dhe merituan titullin e lartësuar "Dëshmor i Atdheut". Historia labe dhe jo vetëm flet qartë për trimërinë dhe lavdinë e burrërisë shqiptare, për heronjtë e dëshmorët që gjakun e dhanë me vullnet të lirë për shenjtërinë e Atdheut dhe kombit. Refreni i këngës tingëllon fuqishëm edhe aktualisht: "Nëna ju kish rritur, për një botë të re, / lule more trima, / që ratë për atdhe". Rrëzoma dhe Krahina e Kardhiqit shekujve kanë qenë si një shtëpi me dy porta që për kulm kishin qafën e Skërficës, një qafë që shekujve përbashkonte zemrat ashtu sikurse sot rruget dhe tuneli i ka bërë njësh sup-bashkuar në luftëra dhe në halle, të bashkuar në zemra e në lidhje të shumta shpirtërore. Këtu në Senicë përbri rrugës së re pritët që të marrë jetë një projekt i dy dekadave më parë, më 4 prill 2004, kur një grup intelektualësh krijuan Shoqatën "Fushëbardha", por që e firmosur ligjërisht në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Delvinës që mban nr.14



datë 30.3.2021, "Për miratimin e Propozimit për ngritjen e memorialit për 5 dëshmorë të LANÇ-it, pasi gjaku nuk bëhet ujë. Që prej 80 viteve flakadani i atdhetarisë në truallin e Fushëbardhës, krahinave Kardhiq e Rrëzomë, Delvinës, Labërisë, gjithë Shqipërisë ka qenë i ndezur dhe prushi i patriotizmit gjithmonë i nxehtë. Nuk ka dëshmi më të madhe e më solide se gjaku për atdhe, për kombin, për lirinë. Ishin pesë dëshmorë që ranë në një copëz toke Arbënore në shkurt-marsin e vitit 1944, atje pranë Senicës historike të kuvendeve, nderit dhe lavdisë, të mençurisë dhe punës, të pushkës dhe të diturisë, të punës dhe ardhmërisë. Pluhuri i harresës nuk mund të mbulojë dhe as të fshihet nga kujtesa e kombit shqiptar, ajo lavdi që u shkrua me gjakun e dëshmorëve. Prandaj liria i ka rrënjët thellë në gjakun e të rënëve. Për këtë arsye poeti qartëson: "...duhet të ngrënë nga balta e të rivrasin të rënët". Memoria e kombit shqiptar për të rënë është çimentuar me gjakun e të rënëve nuk matet as me numra e as me kile, "as me okë e as me kokë". Gjaku është shpagimtar më solemn i lirisë, themeli i së vërtetës, ideali i trupëzuar në panteonin e jetës prandaj burrat që i dolën zot vatanit meritojnë vetëm nderim. Pesë dëshmorët do jenë roje të lirisë së tokës arbërore, buzë rrugës së re Kardhiq - Delvinë. Ata do të trupëzohen njësh me tokën e gurtë, por dhe të sertë, shpirtërisht të lidhur besa-besë si një gjerdan në kalanë natyrore, por edhe përjetësisht në memorien e brezave. Aktet e mëdha njerëzore i japin kuptim historisë së mbijetesës, për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin kombëtar, për të përjetësuar sakrificat e mëdha për liri dhe mëvetësi, që është historia e vërtetë e këtij kombi, është historia e dëshmorëve. Fakt është se më mirë, më drejtë, më bindshëm flet gjaku i dëshmorëve të Labërisë, flet historia për trimat Sami Golemi

e Karafil Bello nga Fushëbardha, Hasan Çerepi nga Zhulati, Sefer Meta nga Golemi, Skënder Pepiaj nga Progonati, që ranë pranë Senicës së Delvinës, do të vijojë të flasë.

Sami Sejdi Golemi, me pushkë në dorë për lirinë e Atdheut

Sami Sejdi Golemi, ishte lindur më 15.7.1907 në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Ai rridhte nga një familje me ndjenja e kontribute patriotike e atdhetare me emër të nderuar në Fushëbardhë dhe në krahinën e Kardhiqit. Fshati i tij i lindjes Fushëbardha është kodrinor e malor, mes malesh, në lagjen e Goleme, ku dimri vjen shpejt dhe ikën vonë, ku pranvera dhe vera ia lënë vendin njëra-tjetrës pa shumë ndryshime, veç plot lule e freski në behar dhe shumë dëborë e acar në dimrin e gjatë. Jeta e detyroi që të përballej herët me vështirësitë në fushë e në mal, duke e kapërcyer Qafën e Skërficës ditën e natën në borë e suferinë. Përfundoi shkollën fillore, por vuajtjet dhe hallet e kohës e mësuan të dalonte të mirën nga e keqja, padrejtësinë nga e drejta dhe kjo shpesh e revoltonte djalin e ri fushëbardhiot. Familja e tij ishte një familje e madhe. Babai i tij Sejdiu dhe nëna Nefize kishin tetë djem dhe dy vajza. Fisi i tij, Golemi ishin njerëz punëtorë, të thjeshtë, të dashur e të respektueshëm në fshat e krahinë, kishin shumë miq në krahinat e Kardhiqit dhe Rrëzomës por edhe deri në Përmët, Korçë, Ersekë, Himarë, Delvinë, Zonën e Konispolit e Çamërisë, në Vlorë e Mallakastër. Ishin njerëz zemërbardhë e mikpritës siç i thonë në Labëri, janë familje bukëdhënë, që rrezatonin mirësi. Familja përjetoi siç thotë populli “të zezat e ullirit” veçanërisht në përballjen me andartët grekë më 1913-1914. Viti 1914 shënon edhe dramën e ndarjes forcërisht nga gjiri i familjes së trungut të shtëpisë, babait të tij Sejdiut, i cili u rrëmbye dhe u dërgua në ishullin e Korfuzit me anijen dragaminë me gjithë gjënë e gjallë. E megjithatë familja e tij mbijetoi. Vëllai i madh i Samiut, Kasëm Golemi mbajti vëllazërinë të përbashkuar si dhe në Luftën e Vlorës në 1920 ishte luftëtar me çetën e Fushëbardhës e Zhulati dhe që kishte luftuar bashkë me Selam Musa Salarinë. Ai ka qenë anëtar i Këshillit Krahinor të krahinës së Kardhiqit deri në çlirimin e vendit. Samiu i doli zot vetes në Fushëbardhë, u burrërua para kohe dhe pas shkollës punuar në bujqësi, por të shquar në blegtori, në traditën e Sinanialjve/ Goleme. Në periudhën 15.7.1927 deri 15.7.1929, kreu shërbimin ushtarak në Ushtrinë Kombëtare, në regjimentin e Gjirokastrës, me disa bashkëmoshatarë të tij. Kjo ishte periudha e “pjekjes së djelmohave” dhe që ishte detyrë ndaj shtetit bazuar në Ligjin ushtarak “Mbi Rregullimin e Ushtrisë Kombëtare”, një ushtri me 700 oficerë, 800 nënoficerë, 7800 ushtarë, që harxhonte deri në gjysmën e buxhetit të shtetit, por që nuk ishte e gatshme ta mbronte realisht vendin. Pas ushtrie Samiu më i rritur dhe i pjekur gjykonte thellë problemet e kohës, mbante pranë vetes dhe i mësonte nipçet e tij si Feron, Fejzoni etj., me ta kalonte në fushat e në malet e Fushëbardhës, të Çajupit, të Malit të Gjerë, të Delvinës e deri në Bureto. Duke parë shtypjen dhe shfrytëzimin, e urreu regjimin shtypës dhe barbar të Italisë fashiste që erdhi më 7 prill 1939. Më 12 dhjetor 1942 formohet çeta “Çerçiz Topulli” në Fushëbardhë ku, që me themelimin e saj ishte dhe Sami Golemi me bashkëmoshatarë të tij të tjerë. Ai përjetonte një rrizgjim të ri të burrërisë shqiptare, kur komandant ishte Dilaver Poçi, komisar Siri Çarçani, zv/komisar Gani Haloçi dhe intendent Mitat Kondi. Çeta “Çerçiz Topulli” e formuar në Fushëbardhë ishte një ndër 288 çeta, që u krijuan gjatë LANÇ-it në të gjithë vendin. Çeta kishte në ditën e parë 27 partizanë që më vonë shkoi 40 partizanë, numër që erdhi gjithmonë në rritje. Sipas planit, çeta kaloi fillimisht në Vurg të Delvinës, ku u prit me dashuri nga populli. Më pas çeta kaloi në Dermish, ku shkatërroi Urën e Çakallos e më pas në Theollogo për asgjësimin e postave kufitare të armikut në Zminec, në Vërvë e Leshnicë. Materialet e postave kufitare të armikut u morën nga çeta partizane. Çeta kaloi gjithashtu edhe në fshatin Kulluricë, ku hapi depot e drithit dhe ua shpërndau fshatarëve të varfër, që bëri bujë të madhe për kohën. Në vitin 1943 çeta luftoi me italianët dhe bashkëpunëtorët e tyre në Vasjar të

Tepelenës, më 11 dhe 12 qershor 1943, luftoi në Urën e Kardhiqit, në Humelicë dhe Cepo. Më 10 deri më 12 gusht 1943 çeta ku bënte pjesë Sami Golemi luftoi me milicët italianë. Në 30 dhe 31 gusht 1943 luftoi me garnizonin italian në Libohovë. Në shtator të vitit 1943 batalioni tek ura e Kardhiqit hyn në Gërhot pas kapitullimit të Italisë fashiste. Sami Golemi mori pjesë aktive në të gjitha veprimet luftarake në përbërje të formacioneve të çetave dhe batalioneve territoriale dhe të rinisë. Ai u bë luftëtar shumë aktiv, duke u gjendur në ballë në shumë aksione luftarake. Shokët e tij partizanë e njihnin Samiun me cilësitë më të mira, si trimërinë, zgjuarsinë, shkathtësinë dhe, për këto, ai gëzonte dashurinë dhe respektin e tyre. Një pjesë nga katër çetat e batalionit kaloi në batalionin territorial me komandant batalioni trimin Karafil Bello. Sami Golemi në batalionin territorial ishte skuadër komandant dhe me të njëjtën detyrë edhe në batalionin e rinisë. Në luftimet e Senicës së Rrëzomës tek bokërrima e kuqe, pranë qafës së Ujkut, bie heroikisht komandanti i batalionit territorial Karafil Bello në fillim të shkurtit 1944. Batalioni u riorganizua përsëri dhe në mes të marsit 1944 kalon në luftime në Senicë, Vergo, Kalasë me gjermanët si dhe bashkëpunëtorët e tyre. Pararoja bie në përpjekje dhe në këtë luftë vritet Sami Golemi, Sefer Meta, Skënder Pepiaj dhe Hasan Çerepi. Në të gjitha betejat tregoi guxim dhe trimëri të rrallë, gjaku i tij skuqti rrugët e gurta aq të njohura të Senicës, në përleshje fyt për fyt me fashistët gjermanë dhe tradhtarët. Ishte agjitor i LANÇ-it, duke shprehur urrejtjen ndaj okupatorit fashist italian dhe nazist gjerman, ku dhe ra, për të mos vdekur kurrë në luftën për çlirimin e Senicës, një fshat ngjitur me fshatin e tij të lindjes. Samiu ra në fushën e betejës duke lënë jetime vajzën njëvjeçare Gurien, pa e njohur vajzën e tij dhe ngeli dëshmor në përjetësinë e nderit të kombit. As vajza nuk e njohu dot babanë e saj, por njohu bashkëluftëtarët shokët e tij të armëve, njohu kujtimin dhe nderimin për përkushtimin heroik të babait dëshmor ndaj lirisë së Atdheut, respektin e brezave për këtë luftëtar të lirisë e kanë shoqëruar bijën e tij gjatë jetës. Ata i dolën zot Atdheut në kohë të vështira e rreziku, për lirinë dhe për të pasur shtet, prandaj nderohet e respektohet lufta e tyre, lufta e kombit shqiptar kundër nazizmit, fashizmit e bashkëpunëtorëve të tyre. Sami Golemi është shpallur “dëshmor i Atdheut” 27 vjet pas rënies me vendim nr. 65, datë 2 tetor 1971, të Komitetit Ekzekutiv të KP të Gjirokastrës. Kujtimi i Sami Golemi dhe dëshmorëve të tjerë, që dhanë jetën do jetë i përjetshëm. Treva labe dhe jo vetëm i ka nderuar dhe nderon në vijimësi brez pas brezi trimat, bijtë që kanë rënë në betejat e historisë për mbrojtjen e truallit arbëror. Ata ranë me armë në dorë për lirinë e Shqipërisë, prandaj dhe meritojnë nderimin në përjetësi. Memorial i munguar në dekada për djemtë dëshmorë, do shndërrohet në frymëzim brezash. Memoriali “Armëbashkuar për flamur” që do ngrihet në përkujtim të 80-vjetorit të rënies të pesë bijve të Labërisë nga Fushëbardha, Zhulati, Golemi, Progonati do të jetë vlera e çmuar e vend nderimit të shenjtëruar të lavdisë dhe krenarisë sikurse çdo komb i qytetëruar. Në bibliotekat tona nuk kanë munguar librat, enciklopeditë, monografitë, shkrime të shumta për historitë, artikuj të pafund, në Evropë e më gjerë që përkujtojnë të rënë për Atdhe. Europa është e mbushur me buste, lapidarë e memorialë, pllaka, rrugë, sheshe, shkolla, që mbajnë emrin e tyre. Nderimi dhe respekti për të rënë në trevën labe me memorialë në kuadrin e tetëdhjetë vjetorit të çlirimit të Atdheut, shpreh vlerësimin e idealeve të çlirimit, madhëstsinë e fitores dhe lirisë së Atdheut, si dhe devizën e përhershme kombëtare se, “kur bie për atdhe mbetet në pavdekësi”. Prandaj në pavdekësi do të mbeten dëshmorët e LANÇ-it: Hasan Salih Çerepi (1927-1944) 17 vjeç, Karafil Vehip Bello (1902-1944) 42 vjeç, Sami Sejdi Golemi (1907-1944) 37 vjeç, Sefer Ramo Meta (1916-1944) 28 vjeç, Skënder Mato Pepiaj (1925-1944) 19 vjeç, ku moshë mesatare ishte 28.6 vjeç. Memoriali i pritshëm për t'u ngritur do të mbushë një boshllëk për nderimin dhe mirënjohjen e munguar në tetë dekada për djemtë dëshmorë të cilët ranë me devizën: “Besën për lirinë, gjakun për Atdheun”.

Ata ishin katër...

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Katër djem në Tiranë masakrohen...

(Në kuadrin e 80 vjetorit të rënies)

U njohën ata në vitet e zjarra

Në një rrugë të Tiranës, që mban emrin "4 Dëshmorët" ngrihet një lapidar. Është një ndër simbolet që përjetësojnë kujtimin e të rënëve, kujtimin e dëshmorëve të Atdheut. Ata ishin katër, Gjergj Frashëri, Skënder Kosturi, Trajan Pekmezi e Viktor Gjokoreci. Katër nga të armatës së madhe të luftës, katër nga tërë ajo rini antifashiste që ngritën grushtin lart e morën armët për të sjellë lirinë, qëllimi më i lartë i të cilëve ishte lufta për çlirim e vendit. Dhe ky ishte një ideal që ushqej nga dashuria për Atdheun. Të katër u njohën në vitet e zjarra, ku shkelën dhe vrapuan në të njëjtën rrugë herë në rolin e atentatorit, herë në rolin e shpërndarësit të traktateve, herë të kthyer nga malet me partizanët. Edhe në ditët më të vështira, në ditët e punës ilegale në kryeqytet punuan krahu njeri-tjetrit.

Gjergj Frashëri u lind në vitin 1924 dhe ishte bir i një familjeje me tradita patriotike. Më 1936 u regjistrua në klasën e parë të gjimnazit të shtetit në Tiranë. Në qershor të vitit 1942, mbasi morën fund mësimet shkollorë, hyri si ndihmës-mekanik në një garazh të Tiranës. Më 1943 Gjergji u bë anëtar i njësitit gueril të Tiranës. Si pjesëtar i njësitit mori pjesë në disa aksione të armatosura që u kryen në kryeqytet. Në këto aksione ai u tregua si përherë i shkathët dhe trim. Më 30 tetor 1943, ai kaloi në rreshtat partizane, në fillim në batalionin "Dajti", që vepronte në afërsitë e Tiranës, dhe më vonë në Brlls. Si partizan, Gjergji mori pjesë në luftimet që u zhvilluan në Qafën e Kërrabës, të Çermenikës, të Labinotit, të Martaneshit, të Polisit dhe të Kostenjës. Në fillim të janarit 1944, u sëmur, u kthye me lejen e shtabit të brigadës në Tiranë, ku qëndroi ilegal. Përsëri u aktivizua me njësitin gueril dhe vazhdoi veprimtarinë...

Skënder Kosturi lindi në vitin 1922 në një shtëpi të Tiranës, pranë ish-stacionit të trenit. Në Gjimnazin e Tiranës, Skënderi u dallua për ndjenja të thella patriotike. Vërejtjet që kishte marrë nga drejtorja e shkollës dëshmojnë për aktivitetin e tij revolucionar. Njohja me Qemal Stafën ndikoi shumë në formimin dhe në aktivitetin e tij të mëvonshëm antifashist. Ai u aktivizua me Grupin Komunist të Shkodrës. Disa muaj pas krijimit të PKSH-së, në mars të vitit 1942, pranohet anëtar i PKSH-së. Qarkori i Partisë për Tiranën e caktoi me detyra partie në Prizren, në Shkodër dhe në Vlorë, ku u plagos, arrestohet, por mundi të arratisë dhe të kthehej në Tiranë.

Viktor Sterjo Gjokoreci lindi në Korçë, më 4 dhjetor 1928. Babai që ishte komunist e brumosi me ide revolucionare, me guxim për pjesëmarrje në demonstrata e aktivitete të tjera revolucionare. Në vitin 1942 u bë anëtar i grupeve ilegale të Rinisë Komuniste. Në vitin 1943 ai u bë anëtar i njësiteve guerile të Tiranës, të cilat në atë kohë kryenin shumë aksione. Nga fundi i vitit 1943, ai doli partizan në njësitet që vepronin në rrethet e Tiranës, por papritur e zuri bronshiti dhe e detyroi të kthehej në qytet. Njësitit gueril u ngarkon një detyrë e rëndësishme, për të vrarë një agjent të Gestapos gjermane. Plumbat e armëve të Viktorit dhe të Gjergj Frashërit e rrëzuan për tokë spiunin e urryer nga të gjithë. Atentati u krye me sukses, por të dy shokët u ndeshën me një grup xhandarësh, në përleshje me ta Gjergji u plagos. Viktori, ndihmoi shokun e plagosur dhe kështu ata mundën të iknin dhe të strehoheshin në një shtëpi që ishte bazë e Lëvizjes. Pas shumë kërkimesh, natën vonë spiunët ranë në gjurmë dhe i arrestuan, i torturuan dhe i pushkatuan.

Trajan Stavri Pekmezi lindi në Ohër në vitin 1911. U brumos në një familje atdhetare. Ndoqi shkollat e kohës dhe u formua si një antifashist, duke marrë pjesë në mjaft veprimtari në interes të lëvizjes. Pas mbarimit të shkollës së mesme, Trajani ushtroi zanatin e



mekanik-hidraulikut, ku dyqanin e tij e ktheu një çerdhe të mbledhjeve e konferencave ilegale. Ishte një ideal që ushqej nga dashuria për Atdheun. Për këtë ideal, i sëmur nga tuberkulozi, Trajan Pekmezi u ngrit nga shtrati për të dhënë kontributin e tij në fitore.

Ata ishin katër të rinj antifashistë

Forcat e okupacionit dhe tradhtarët e vendit menduan se i kishin larë hesapet me popullin që kishte ngritur krye. Mendonin se e kishin frenuar lëvizjen antifashiste, e cila po shtoej nga dita në ditë. Forcat naziste dhe tradhtarët nuk menduan se ky popull kishte një parti komuniste që e udhëhiqte, kishte lëvizjeje të fuqishme që godiste armiqtë dhe tradhtarët e popullit, duke u dhënë dënimin që meritonin. I riu Gjergj Frashëri anëtar i njësitit gueril kishte marrë urdhër të kryente një atentat kundër një agjentit nazist. Për ditë me radhë Gjergji studioi lëvizjet dhe takimet e spiunit dhe, më 27 shkurt 1944, nga mesdita në kafenenë e rrugës së Kusit kreu atentatin kundër tradhtarit. Shoqëruesit e tij dhe ballistët nisën të shtinin dhe një plumb e zë Gjergjin në anën e majtë, kurse një tjetër në krahu, por përsëri vrapoi drejt shtëpisë së Trajanit, e cila ishte dhe bazë ilegale për mjekime. Forcat balliste bashkë me forcat gjermane e ndoqën antifashistin e plagosur pas pikave të kuqe të gjakut dhe rrethuan shtëpinë bazë. Ballistë e gjermanë hynë brenda dhe arrestuan gjithë sa ndodheshin aty: Gjergjin, Viktorin, Trajanin e sëmurë dhe prindërit e Gjergjit që kishin ardhur të takonin të birin. Gjatë bastisjeve përreth shtëpisë tradhtarët arrestuan dhe Skënderin. Në bodrumet e zyrave të policisë u torturuan katër shokët. Nënë Dhoksisë i dukej sikur i buçisnin në vesh fjalët e Gjergjit të saj: "Mbaju e fortë nënë, ne do të jemi me shokët!". Ata ishin së bashku dhe ashtu të katër u vranë. Gijyqi i burgut nga kryetar Xhelal Staravecka dhe mercenarë të tjerë natën vonë pasi i masakruan, i çuan në rrugën e Kusit, katër të rinjtë antifashistë. Në mëngjes ushtarë nazistë e ballistë qëndronin për të ruajtur trupat e katër të vrarëve që i kishin lënë në rrugë për të mbjellë panik në popull dhe për ta gjunjëzuar që të hiqte dorë nga lufta për liri. Por populli shqiptar i kishte matur mirë forcat dhe ëndrrat e tij se kishte partizanët që luftonin për liri. 28 shkurti i vitit 1944 u shënua në kronikat e epopesë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me emrin: "Dita e rënies së 4 dëshmorëve".

Të katër të rinjtë janë shpallur dëshmorë: Gjergj Frashëri me vendim nr. 104, datë 20.06.1977 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Tiranës; Skënder Kosturi me vendim nr. 104, datë 20.06.1977 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Tiranës; Trajan Pekmezi me vendim nr. 102, datë 28.05.1978 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Pogradecit dhe Viktor Gjokoreci me vendim nr. 102, datë 14.11.1969 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Korçës.

Ata bashkë janë përjetësuar në emrin e një rruge, të shkollës 9-vjeçare "4 Dëshmorët", të një lapidari të ngritur në vendin ku ranë në Tiranë.

Arsimtarët, martirë që gjakun ia falën lirisë së gjuhës shqipe

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Persekutime dhe masakrime që në gerrat e para të abc-së...

Historiografia e shkollës shqiptare na tregon se para dhe gjatë Rilindjes, përhapja e arsimit dhe e kulturës kombëtare ishte një nevojë, që ushtroi zhvillimi ekonomik e shoqëror, një kusht i domosdoshëm i përparimit material e shpirtëror i kombit shqiptar. Në këtë proces të zhvillimit, të shumtë kanë qenë arsimtarët dhe arsimtarët, të cilët janë ndjekur, persekutuar, martirizuar e vrarë për idetë dhe veprimtarinë patriotike të tyre. Nisur nga mësimi i gjuhës amtare shqipe, të vijuar me përpjekje për të edukuar me frymë patriotike e çlirimtare brendinë e përmbajtjeve të mësimëve, vendosmëria për të mënjanuar çdo ndikim të huaj dhe që binte ndesh me traditën shqiptare të edukimit patriotik, në luftë me pushtuesit, shkolla shqipe dha dhe dëshmorët e saj në çdo hap të saj. Në këtë luftë dhanë jetën për gerrat shqipe dhe mësimin e saj me dhjetëra dëshmorë, duke filluar që nga Pjetër Budi (1566-1622), Dhaskal Todhri (1730-1805), Ndrec Ndue Gjoka (1919-1946) etj.

E masakruan Gjok Shqiptarin, sepse shpërndante libra shqip, që të vegjlit shqiptarë të mësonin gjuhën amtare, që të miturit të hapnin sytë, që jeta të zhvillohej në çdo qytet e fshat. Me urdhër të patriarkut Igumenik të Fanarit e helmuan Naum Veqilharxhin (1797-1846), autorin e "Evëtarit" dhe të parës abetare të Shqipërisë. Ndërsa Anastas Kulluriotin (1822-1887), pjesëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e persekutuan dhe e burgosën. Kështu vijuan armiqtë me Balil Tahirin, "mësuesin shëtitës", që e vranë me pabesi rreth vitit 1893, për të vijuar me mënyra të ndryshme dhe të sofistikuara për kohën me atdhetarin e flaktë Koto Hoxhin (1824-1895). Agjentët e dhespotit të Kosturit, më 12.11.1905, therën mësuesin e shqipes Kristo Harallambin (Papa Kristo Negovanin 1875-1905), Pandeli Sotirin (1843-1891), Petro Nini Luarasin (1865-1911) dhe Nuçi Naçin (1871-1927) i ndoqën, i persekutuan dhe i martirizuan Fanari dhe Porta e Lartë, në kohën kur po hidhte arsimit kombëtar shqiptar, sepse ishin drejtorët dhe edukatorët e Mësonjëtores së Parë Shqipe të Korçës.

Dhe pse u shpall Pavarësia e Shqipërisë, përsëri shkollës shqipe i dolën pengesa të reja. Këto ishin kërkesa të reja dhe të kohës që kërkonin pavarësinë e shkollës, mënjanimin e klerikëve mbi arsimin, lufta për shkollën shqipe dhe mbylljen e shkollave të huaja, zhvillimin e arsimit femëror, për masivizim të arsimit, etj. Të gjitha këto dhe të tjera kërkesa u ndeshën në reaksionin antikombëtar dhe të elementëve reaksionarë, u ndeshën në pikëpamje fetare, etj., gjë që kërkoi përsëri sakrifica, gjakderdhje, luftë të pashembullt për arsimimin dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Më 1917, forcat e pushtimit francez ekzekutuan Themistokli Gërmenjin (1871-1917), kryetarin e Këshillit Administrativ të Republikës Autonome të Korçës, që mbylli shkollat e huaja dhe hapi shkolla në gjuhën shqipe. Forcat e pushtimit italian vranë tradhtisht, më 1920, inspektorin e arsimit Sali Nivicën (1890-1920), arrestuan Jani Mingën, Avni Rustemin (1893-1924), "udhëheqësin e djalërisë", Mësuesin e Popullit e vranë forcat reaksionare më 1924. Një vit

më vonë, reaksioni vrau tradhtisht mësuesin antiklerikalist Salih Çekën (1892-1925) dhe Luigj Gurakuqin (1879-1925). Më 1929, shovinistët serbë masakruan Shtjefën Gjeçovin (1874-1929), vetëm se punonte për shkollën shqipe. Gjatë gjithë periudhës së Pavarësisë lufta e elementit përparimtar me reaksionin ishte e ndezur dhe u shkrua me gjak.

Mësuesit dëshmorë në luftë...

Një kapitull të ri dhe të lavdishëm në historinë e arsimit tonë hapi Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare. Që më 1941, ra heroikisht në ballin e luftës mësuesi Faslli Cami (1912-1941), i pari dëshmor i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nga radhët e arsimtarëve. Më 1942, në përleshje për të çarë rrethimin e armikut, u vra në Dardhë mësuesi i shkollës qytetëse të Beratit, agronomi Kristo Isak (1913-1942). Po në këtë vit u var Jordan Misja (1911-1942), që kishte punuar si mësues në Veri dhe në Jug të Shqipërisë, në Vrakë të Shkodrës, në Pukë dhe në Lupçkë e Lugar të Përmetit dhe se shkroi në qershor të 1942, së bashku me Perlat Rexhepin e Branko Kadinë epopenë legjendare, që hyri në historinë tonë si epopeja e tre heronjve.

Lufta ishte ndezur kudo në Shqipëri dhe kur në hartën tonë shënoheshin zonat e çliuara, lufta rrëmbëu të tjerë mësues, mësuesin e shkollës së Vishocicës, Raqi Grabockën (1920-1943), mësuesin e ri, normalistin elbasanas, Abdyl Myzyrin (1921-1943), mësuesin e fshatrave të Korçës, Përmetit, Tepelenës e Beratit, Kristaq Capon (1914-1943), mësuesin e Kërriajës së Tropojës dhe Vrellës së Pejës, gjakovarin Hysni Zajmi (1916-1943), mësuesin e re, Heroinën e Popullit, Shejnaze Jukën (1924-1943), mësuesin e shkollës normale, Hiqmet Dusha (1915-1943), normalistët Tomor Sinani (1921-1943), Thanas Bozo, Muharrem Dollaku etj. Ata ishin mësues, edukatorë, partizanë dhe komisarë, organizatorë grevash, demonstratash, betejash.

Shumë mësues u ndeshën me reaksionin, me bajraktarët dhe iu ekspozuan rrezikut kundër atyre që nuk donin dritë. Kështu, vargut të dëshmorëve i shtohet Spiro Postol Velko (1921-1944), Isuf Gjata (1891-1944), mësuesi dhe poeti i ri Jani Dodi (1919-1944). Në ballin e luftës për çlirimin e plotë të atdheut nga fashizmi dhe shtypja e shfrytëzimi shekullor, vazhduan të bien dëshmorë të tjerë nga radhët e mësuesve Bido Sejko (1900-1944), Mehmet Pepi (1915-1944) etj. Ata vazhduan të shkruajnë faqe lavdie me gjakun e tyre.

Në betejën për çlirimin e Patosit ra mësuesi Lefter Talo (1912-1944), Hero i Popullit; në betejën e Qafë-Kërrabës, ra heroikisht për çlirimin e Tiranës Kadri Abdihoxa (1920-1944), mësuesi i Qafë-Murrës së Dibrës; për çlirimin e Fierit, në shtatorin e 44-ës ra Mustafa Jashari, mësuesi i Çërravës së Pogradecit; Feridun Xhindolli (1920-1944), mësuesi i Malindit të Skraparit dhe i Frakullës, ra në Mollas të Suloves; Raqi Oirinxhi (1913-1944), mësuesi i Liceut të Korçës, ra heroikisht, duke dhënë shembullin para nxënësve të tij dhe mbeti përgjithnjë Mësuesi i Popullit. Në kampin famëkeq të Prishtinës vdiq burrërisht mësuesi Shyqyri Haxhia (1917-1944). Më 1944 ranë gjithashtu në betejat me



“Skënderbegas, tokë, qiell, det, syri i shqipës që vigjilon”

Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” e nisi jetën e saj më 28 mars të vitit 1945, me pionierët partizanë. Fillimisht u emërtua “Shkolla e pionierëve të luftës”, pastaj “Shkolla e kadetëve” dhe më vonë Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”.

Historia e saj është një fill i pashkëputur mësimi, edukimi e formimi kulturor, atdhetar dhe ushtarak, është vepra më e arrirë e atij sistemi që lamë pas. Kjo shkollë do të mbetet gur themeli në historinë e Shqipërisë.

Më 28 mars 1945, në Tiranë u hap “Shkolla e Pionierëve të Luftës”, ku nxënësit e parë ishin 200 partizanë të vegjël midis tyre edhe 6 vajza. Në vitet që pasuan numri i nxënësve do të rritej ndjeshëm.

Në shkurt 1947, me urdhër të Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura, Nr. A 1-85, datë 11 shkurt 1947, “Shkolla e Pionierëve të Luftës” mori emrin Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Shkolla e nisi veprimtarinë në garnizonin ushtarak të Laprakës, më pas u vendos tek Regjimenti i Ndërlidhjes e së fundmi u vendos tek kompleksi i shkollave ushtarake. Deri në vitin 1953 skënderbegasit morën arsim 7-vjeçar, disa klasë të mesme dhe njohuri ushtarake. Në vitin 1953 u vendos që shkolla “Skënderbej” të bëhej shkollë plotësisht e mesme e arsimit të përgjithshëm, duke përfshirë në të edhe lëndë të karakterit ushtarak. Shkolla kishte program 4-vjeçar të gërshetuar me fushime dimërore e verore 15-30 ditë për çdo vit. Misioni i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” ishte të përgatiste nxënës me arsim të mesëm ushtarak të përgjithshëm dhe me formim të nevojshëm për ndjekjen e shkollave të larta civile dhe ushtarake, për t’u përgatitur si oficerë të aftë të Forcave të Armatosura. Nga viti 1960 gati 60% e studentëve të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve vinin nga Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”.

Akademia Ushtarake “Skënderbej”

Shkolla “Skënderbej”, që nga viti i parë i krijimit të saj e deri në mbyllje me Vendimin e Këshillit të Mbrojtjes Nr. 3, datë 17.8.1992, ishte furnizuesja kryesore e Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve në **Tiranë, Akademisë Ajrore dhe asaj të detarisë...**

Akademia Ushtarake “Skënderbej” u krijua, më 8 nëntor 1944, si një kurs i ulët për përgatitjen e kuadrove e oficerëve. Në janar të vitit 1945, u vendos në Tiranë. Më 8 janar të vitit 1949, ajo mori emrin: Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve “Enver Hoxha”. Për herë të parë në këtë shkollë, në vitin mësimor 1967-1968, u pranuan femrat, qindra prej të cilave e kanë mbaruar me sukses atë.

Shkollën e Bashkuar e kanë drejtuar gjeneralë e komandantë të shquar si Vaskë Gjino, Gjin Marku, Thoma Xhixho, Qazim Kapisyzi, Enver Begeja, Halil Xhuka, Spiro Adhami, Rustem Peci, Aleks Andoni, Perlat Sula, Armand Vinçani, Luan Hoxha etj. Mijëra ushtarakë kanë studiuar në këtë shkollë, ndërkohë që dhjetëra prej tyre kanë arritur të drejtojnë strukturat më të larta ushtarake dhe të marrin gradën “gjeneral”. Në vitin 1993, kjo shkollë mori emrin Akademia Ushtarake “Skënderbej”, kjo ka qenë vatra kryesore e përgatitjes së oficerëve për ushtrinë shqiptare.

Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”.

Në fillim të vitit 1948, komisar i shkollës u emërua Koço Lako, ndërsa drejtor i saj Stavri Angjeli. Në fund të vitit 1948, komandant i shkollës emërohet Ferit Radovicka, ndërsa komisar emërohet Bedri Gjergji. Në vitin shkollor 1949-1950, rritet numri i skënderbegasve, dhe shkolla transferohet në Laprakë. Fillimi i vitit mësimor 1951-1952 u bë në Vlorë. Në Olimpiadën Teatrale të zhvilluar në vitin 1954, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, mori Fletë Lavdërimi nga Ministria e Arsimit dhe

Kulturës. Në verën e vitit 1956, shkolla mori pjesë në aksionin për shpyllëzimin e kodrave të Zall Herrit. Në shtator të vitit 1959, Shkollës e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, zhvendoset në kazematat e Regjimentit të Ndërlidhjes. Në gusht të vitit 1966, për një muaj rresht, nxënësit e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, bënë aksion në Bizë për të mbledhur humus për tokat e reja dhe në Tapizë të Tiranës për shpyllëzim e hapjen e tokave të reja. Në shtator të vitit 1966, drejtor i shkollës emërohet Fiqri Shtëpani. Në nëntor të vitit 1966, në festimet për nder të 28-29 nëntorit, ditës së pavarësisë dhe çlirimit, efektiv i shkollës “Skënderbej” manifestoi kalimin me not dhe pajime të liqenit artificial, në prani të Enver Hoxhës e udhëheqësve të tjerë të vendit. Në qershor të vitit 1967, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, kreu aksionin e njohur në ndihmë të bujqësisë (prashitje misri e korrije gruri) në Zall Herr. Në maj të vitit 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPSH-së, i dha shkollës Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit III për rezultate të larta të qëndrueshme sportive. Në qershor të vitit 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, dekoron organizatën e rinisë së shkollës me Urdhrin “Për shërbime të shquara ushtarake dhe shoqërore të Klasit III” me motivacionin: “Është dalluar për rezultate të larta në përgatitjen politike-ushtarake, në forcimin e vigjilencës e të disiplinës dhe të rregullit ushtarak, për punë edukative me rininë në marrjen e iniciativave të reja për revolucionarizimin e stërvitjes dhe për ta bërë ushtrinë sa më pak të kushtueshme”.

Mbresa Skënderbegasish

Është shkruar shpesh për mësuesit dhe për komandantët, që kishim në Shkollën “Skënderbej”. Sidomos për komandantët! Për karakterin e veçantë të asaj shkolle, oficerët dhe nënoficerët komandues dhe organizatorë, luanin rolin e një anëtarit të rëndësishëm të “familjes” ushtarake. Ata përkujdeseshin për ne, djemtë e rinj 14-15-vjeçarë, si për vëllezërit, apo bijtë e tyre, sipas moshës, që kishin vetë ata. Pikërisht kjo i jepte atë ngrohtësi të veçantë Shkollës “Skënderbej”, ngrohtësi që nuk e gjeje në asnjë shkollë tjetër... Mendoj se kjo rriti në zemrat tona dashurinë për detyrën ushtarake që frymëzoi edhe shkëndijat e para të frymëzimeve poetike... Sipas organizimit ushtarak të shkollës me një komandë, kishte edhe një organizim të plotë arsimor. Drejtorja e shkollës administronte jo vetëm klasat, por edhe shumë laboratorë, nga më modernët e asaj kohe... Ne të togës së pestë po na tërhiqte më shumë laboratorit fizikës, ku kalonim disa orë në pasdite e lira, krahas sporteve dhe lojërave me top... Ishte shumë befasuese, kur në një mësim tregues para gjithë shkollës, krijuam “vullkanet” me krateret dhe lavën e zjarrtë... Po kështu edhe eksperimentet në laboratorin e kimisë, ku pedagogu Papakristo dhe nëndrejtoresha Agime na përgëzonin për eksperimentet, duke na nxitur për dije sa më të gjera shkencore... Por, megjithatë, tërheqja më e madhe ishte letërsia me rrethin e saj letrar! Ne shkonim atje një herë në dy javë si të hipnotizuar... Nuk ishin vetëm frymëzimet poetike të moshës, por edhe e veçanta e pedagogëve të spikatur Flutura Xoxa, Perikli Jorgoni, Adritaik Kallulli. Dijet e tyre të plota letrare, përkthimet dhe disa studime kritike, nxitën prirjet letrare tek ne... Nuk e harroj poetin e mirënjohur Hysni Milloshi se si recitonte me një pasion krejt të veçantë para pedagoges flokëverdhe të letërsisë F. Xoxa. Poeti drithërohej dhe bëhej rrëzëllitës, duke cituar vargjet e krijuara në mbrëmjet skënderbegase... Në kinemanë e ndërtuar në vitin 1962, recitimet e ndryshme në Konkursin e Fjalës Artistike u pritën me tifozllëk të madh. Shumë

skënderbegas deklamuan me nivel të lartë, jo vetëm poezitë më të mira të letërsisë shqipe, por dhe vargjet poetike të letrarëve të rinj... Unë u nderova me çmim për recitimin e poemës “Vrasja e Ofelisë”... Vite më vonë disa nga ato vargje do të më shërbenin për të krijuar tekstin për një këngë të veçantë me kompozitorin e shquar Kastriot Gjini... Përvoja e re e arsimit shqiptar kërkonte edhe shtigje të reja. Në vitin 1963, nga shkolla “Skënderbej” disa efektiva kaluan në Politeknikum dhe në Shkollën e Kulturës dhe atë Mjekësore. Kjo u bë për të pasur specialistë ushtarakë me arsimin përkatës në çdo fushë... Kjo ishte shenja që tregonte se në të ardhmen, pas shkollës së mesme ushtarake, skënderbegasit mund të dërgoheshin edhe në Universitetin e Tiranës, apo dhe në shkollat e tjera të larta... Ky ishte dhe programi i arsimimit të plotë e të gjithanshëm i skënderbegasve, që patën fatin ta zbatonim të parët, brezi i viteve 1962-1966. Ne ishim të parët që shkua nga Shkolla “Skënderbej” në Universitet. Por më përpara kaluam një vit stazh ushtarak në repartet e ndryshme ushtarake, pas heqjes së gradave në muajin maj 1966. Grupi ynë ushtarak në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në Degën e Gjuhës e Letërsisë, ishte i përbërë nga pesë vetë. Studimet e larta universitare të skënderbegasve përfshinë të gjitha degët e Universitetit të Tiranës, si dhe të shkollave të tjera të larta, të artit, kulturës dhe sporteve... Por kudo dhe kurdoherë ne mbetëm skënderbegas, duke ruajtur emrin e asaj shkolle, që na edukoi e na përgatiti në mënyrë të gjithanshme dhe me dashurinë e madhe për Kombin dhe detyrën ushtarake për Mbrojtjen e Atdheut. Jo pak vargje janë shkruar për djemtë dhe vajzat skënderbegas:

Skënderbegasit

Hysni Milloshi

E si shkuan katër vite, si shkuan,
Vite skënderbegase më nuk vinë,
Kur ne qeshëm, lozëm e kënduam,
Kur zuri bisqe botëkuptimi ynë.

I sjell ndërmend shpesh trotuaret,
Ku hapi ynë gjithmonë me ritmin djaloshtar,
Vegime më mbulojnë si fishekzjarre,
Ulem si dikur atje, në bankë të parë.

Vetë ulem, në bankë, vetë ulem,
Po mallin e gjelbër dot se shkund,
Në të poezisë kopësht’ vi e ulem,
Të mbjellë vjersha si grurin në katund.

Në këto vjersha, të thjeshta, blerimi,
Jeni ju skënderbegas, jeni ju,
Kur mendoj si shkoni e si vini,
Me këngë e pushkë nën qiellin blu.

Dhe ju bashkënxënës, në këto çaste,
Ndoshta përmbi hartë hidhni situata,
Kur borë e bardhë zbardh mbi çadër,
Kur si pendë korbi bie nata.

Dikush nga ju spirancën hedh në det,
Dikush nga ju, qiellit fluturon,
Skënderbegas, tokë e qiell, e det,
Si në sy të shqipes i fikson.

Sistemi gjeodezik i standardeve të NATO-s, realitet krenarie



“Mjeshtër Kërkimesh”, kolonel Myslim Pasha, ish-drejtori i Institutit të Topografisë Ushtarake

49 vite histori sukcesi

Shqipëria ka një datë me shumë domethënie në historinë e saj, ndoshta që prej Pavarësisë. Dhe kjo ka të bëjë me gjeodezinë, krijimin e këtij institucioni kaq të rëndësishëm.

Instituti do të hartonte politika të grumbullimit, përpunimit, mirë administrimit të informacioneve gjeografike dhe të gjeosistemeve në shkallë vendi. Ai organizonte përgatitjen topo-gjeodezike të terrenit shqiptar, përgatitjen e literaturës topografike e gjeografike ushtarake për armët dhe shërbimet e ushtrisë, planifikonte të gjithë punën për përgatitjen topografike të kuadrove dhe efektivave të

strukturave të forcave të armatosura, për planëzimin dhe krijimin e rezervave të nevojshme me harta topografike dhe tematike apo speciale, si dhe do të ideonte dhe organizonte punën studimore, shkencore në fushat përkatëse.

8 mars 1975, është festa e hartës, e pikturës së portretit hartografik të Shqipërisë, festa e koordinatave, lartësive dhe thellësive të trajtave të këtij vendi, e modelit të ndryshimeve në kujtesën dhe gjeo-historinë e kombit tonë, festa e Projeksionit të mbijetesës dhe zhvillimeve të së ardhmes.

Mbetet një ngjarje që nuk sjell thjesht një datë të zakonshme. Të zgjohet kujtesa me një hartë Shqipërie në dorë, krahë çeljes së luleve, me një hartë të përtërirë, të ardhur prej mbijetesës kombëtare, gjer në ditë të sotme.

Me këtë hartë shohim portretin e mbijetesës, ndihmesat e brezave, për të vizatuar e pikturuar tiparet e këtij Dheu dhe Deti, shtrirjen historike, në projeksionet e padrejtësive, kufijtë e prerë prej tragjedisë dhe me ndryshimet që u bënë përmbi këtë portret. Është djepi hartografik që na përkund.

Shërbimi Hartografik dhe Gjeodezik në FA ka një zanafillë që vjen që nga lashtësia

Hartat e botës që nga shekulli IV p.e.s. ato të Herodotit, Hekatu-t



Eratostenit, Strabonit dhe Ptolemeut, bartin në vete dhe trajtat e Ilirisë së hershme dhe vend-pozicionimin e Ilirëve. Historia që vjen e bart këtë portret me qëndresën aq të njohur të Ilirëve në hartat Romake, Arabe, Portulane, ndër hartat e Periudhës së Re, kur kontributet hartografike dhe gjeodezike erdhën nga pushtuesit, ndaj kemi gjurmët e Institutit Gjeografik të Vjenës, Institutit Gjeografik Ushtarak të Firences, që realizuan studimet dhe hartat e para topografike.

Në Periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, sërish në fatin e ndikimeve të sistemit komunist që u vendos, kur Bashkimi Sovjetik u shtri si një Perandori Komuniste. Hartat gjatë kësaj periudhe sollën standarde të reja, ku për herë të parë morën pjesë edhe hartografët dhe gjeodetët e parë të Shqipërisë. Më 2 prill 1946, fillon organizimi i Shërbimit Gjeodezik të Ushtrisë Popullore. Ndërkaq në vitin 1953 filloi veprimtarinë edhe Dega e Topografisë në Shtabin e Përgjithshëm. Më vonë krijohet dhe vepron Detashmenti Autonom Topografik i Shtabit të Përgjithshëm, që kreu disa detyra të rëndësishme gjeo-topografike.

Me vendim të Këshillit të Ministrave në datën 8.05.1975 krijohet Instituti Topografik i Ushtrisë (ITU). Ai kishte detyrë dhe mision kombëtar që të hartografonte Republikën e Shqipërisë në shkallë të mesme dhe të vogël, me vlera në fushën e Mbrojtjes së vendit dhe të zhvillimit ekonomik-shoqëror e kulturor të Shqipërisë. Ai do të kishte si detyrë bazë nga ana studimore të ndërtonte Rrjetin Gjeodezik Shtetëror, si dhe do të kishte edhe monopolin e Fotografimit Ajror. Kjo nuk është thjesht një histori. Është një ngjarje që nuk sjell vetëm një datë të thjeshtë të një Instituti të zakonshëm. Kjo ngjarje sjell një histori për një nga Institutet më në zë të fushës studimore dhe krijuese në Shqipëri, sepse ky Institut është marrë dhe merret me Hartën e Shqipërisë, me portretin e saj në kohë dhe hapësirë, me gjeo-historinë e këtij vendi që nuk i shërben vetëm ushtrisë por gjithë spektrit zhvillimor shqiptar.

Ideatorët kryesorë që duhet t'i përmendë historia janë: Dhimo Dhaskali, Limos Alimuçi, Vait Tartari, Çesk Begu, Thimi Jorgaxhi, Myslim Haxhiu, Filip Marga, Mulla Mullaj, të cilët ishin ndër kryesorët që punuan në këtë projekt të ri që do t'i vlente ardhmërisë së këtij shërbimi. Po nuk mund të harrohen edhe shumë të tjerë që punonin në sektorët e krijuar dhe dhanë mendime të çmuara. Ky Institut do të ishte institucion ushtarak kërkimor dhe prodhues, në fushën e përgatitjes topografike të ushtrisë shqiptare dhe më gjerë.

Më 15 mars 1975, u caktuan drejtori dhe zëvendësdrejtori: Limos Alimuçi dhe Vait Tartari. Pas tyre vinte një bashkësi kuadrosh oficerë të shkallëve dhe të breznive të ndryshme, të cilët kanë lënë jetën e tyre në vlera të mëdha hartografike dhe vepra që s'harrohen si: Perlat Gjoliku, Robert Hajro, Kleanthi Dhimitri, Çarçan Danaj, Novrus Xhaferi, Xhavit Xhani, Gani Mustafa, Vangjel Gaçe, Niko Zheku, Beniamin Lohja, Agim Mezini, Seit Shaplo, Hasan Dylë, Zeqo Zano, Bilbil Mehmeti, Hysen Dervishi, Liliana Duri, Marjeta Pasko e të tjerë. Më pas

vjen një brezni tjetër kuadrosh që mbaruan shkollat ushtarake brenda vendit dhe u arsimuan edhe në Universitetin e Tiranës: Përparim Likaj, Maksimilian Gjika, Eduart Isufi, Stafan Shahini, Asllan Muka, Piro Dado, Bajram Muja, Ptoleme Biku, Asllan Bebeçi, Kostandin Premti e shumë të tjerë, që mbushën kontributet teknike e kërkimore në fushat inxhinierike. Po kështu një bashkësi e tërë kuadrosh topografë nga shkollat ushtarake zunë pozicione të rëndësishme në Institut si në Astronomi, Gjeodezi, Hartografi si Asllan Gorezi, Llukan Mici, Vladimir Koruni, Asim Beja, Josif Kollçi, Mustaf Koçerri, Kujtim Ago. Një brezni e më këndejme do të vinte me Çelik Muratin, Behar Malajn, Bashkim Çapunin, Faik Teki Meta, Osman Tome etj.

Misioni që ka Instituti lidhet me Informacionet hapësinore e këtu buron ai kujdes inteligjent që duhet qysh në krye të veprave dhe projekteve. Mbase është dhimbje, por edhe ajo duhet cekur, gjithsesi. Nuk mund të harrohet asnjëherë Marrëveshja e Delimitimit të Detit midis Greqisë dhe Shqipërisë në vitin 2009! Ajo që ndodhi është dramatike. Kjo ka lidhje me atë se: a është në gjendje IGJI-ja të menaxhimit hapësinor hartografik të kufijve shtetërorë të Republikës?

Tani Instituti quhet: "Instituti Gjeografik dhe Infrastrukturës". Kërkohet një realitet dhe angazhim tërësor në zhvillime të sotme në rajon dhe më gjerë, në situatat gjeopolitike që mund të vijnë, ku gjeografia luan rolin e saj të madh vetëm atëherë kur rojat hartografike kombëtare janë në krye të orientimeve zhvillimore të reformave të sotme, jo vetëm në FA por edhe për gjithë vendin. Udhë e mirë e përtëritjes së hartave 1: 25 000 sipas standardeve të NATO-s dhe një projekt Detar me Norvegjinë, rrëfen se këto koordinata orientuese janë inspiruese. Në histori dhe në përvojë, Lufta e Kosovës ishte në kreun e ndihmesës së madhe hartografike dhe gjeodezike në studimin e hapësirës së Republikës së Kosovës. Projekti i parë që u krye me NIMA (National Imagery and Mapping Agency) e SHBA-së, përtëritja e hartave topografike të shkallës 1:50 000 sipas standardeve të NATO-s. Pikërisht nga ky Projekt filluan edhe ndryshimet e mëdha në Institut.

Me një vendim të posaçëm të KM-së dhe ligji për Institutin prej Parlamentit të Shqipërisë, u bënë ndryshime me rëndësi në Misionin. Instituti u quajt Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë.

Jo vetëm unë, por të gjithë kolegët kuadro ushtarakë të IGJI-së, punonjësit civilë, gjithashtu, kanë se çfarë të kujtojnë edhe në situatën ndërkombëtare. Një pushtim tragjik kryhet këto ditë nga Federata e Rusisë ndaj Ukrainës. Janë hapësira, vepra urbane qytete që pushtohen. Përpara se të kryhej ky akt është përtërirë harta topografike, është studiuar hapësira tokësore detare dhe ajrore, me sisteme koordinatash që përdoren nga të dy palët. Kjo na sjell në mendim, se sa vlerë kanë studimet e IGJI-së për ta ushqyer Shtabin e Përgjithshëm me harta dhe koordinata, dhe informacione të tjera që i duhen veprimeve luftarake.

EOD, 25 vite histori krenarie, guximi, trimërie

Në 19 mars 1999, në Forcat e Armatosura mori jetë një grup i ri ekspertësh dhe profesionistësh xhenerë, i kompletuar me ekspertizën e duhur në lëmin e asgjësimit të municioneve të paplasura. Në këtë nënrepart u thirrën më të mirët e të mirëve, pasi ky profesion kërkon guxim, dhe qartësi, për të marrë vendimin e duhur, ku jetën nga vdekja e ndan vetëm një vijë e hollë e padukshme. Për 25 vjet kjo strukturë na ka bërë krenarë si brenda dhe jashtë vendit, duke ngritur për herë të parë flamurin tonë në Bosnjë, në Mali, Letoni etj.

Prej ditës së parë të krijimi të grupit të asgjësimit të municioneve të tepërta e të rrezikshme, kompania EOD (Explosive Ordnance Disposal) vjen me një bilanc pune të jashtëzakonshëm.

Mbi 1 mijë hektarë sipërfaqe të pastruara nga municionet e paplasura, mbi dhe nëntokësore. Mbi 55 mijë tonë municione të asgjësuar, të llojeve të ndryshme dhe kalibrave të ndryshëm. 15 grup-depo të certifikuar dhe pjesëmarrje në misionet ndërkombëtare, si "Althea" në Bosnje dhe Hercegovinë, EUTM Mali, dhe grup – batalioni i NATO-s në Letoni.

Falë punës së specialistëve EOD, vendi ynë tani është më i pastër nga minat dhe eksplozivët e paplasur.

Por për të arritur deri këtu u desh dhe gjaku i 5 martirëve që dhanë jetën në krye të detyrës, e sot emri i tyre është gdhendur në historinë e ndritur të këtij reparti për t'u kujtuar përjetë.

Kjo komandë është e jashtëzakonshme nga rëndësia që ka në mbështetjen e operacioneve dhe jashtë vendit, tashmë ka fituar edhe një emër në hapësirën e NATO-s. Njësia EOD, e cila shërben në Letoni prej vitesh me rrotacion çdo 6 muaj është një kapacitet i madh tashmë i njohur edhe nga shtetet e tjera dhe që me të vërtetë, ndonëse jemi një vend i ri dhe i vogël në këtë aleancë, në këtë kapacitet specifik kemi bërë emër shumë të mirë dhe kemi marrë falënderime.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, me rastin e 25-vjetorit të krijimit të kësaj komande, do të shprehej se: "Kjo është rruga, përmes së cilës duhet të ecim, nga njëra anë duhet të forcojmë kapacitetet e brendshme dhe të jemi më të shkathët, më prezentë pranë qytetarëve sa herë që të jetë e nevojshme, duke mbështetur operacione humanitare dhe civile, por edhe t'i zbardhim faqen Shqipërisë dhe FA-së me kapacitetet tona të veçanta si ai EOD ne Letoni, por dhe kudo tjetër. Situata që po kalojmë është një situatë me dinamika, e turbullt herë pas here, me sfida, ndaj ne duhet të jemi të përgatitur për më të keqen, për të mbështetur frontin e parë, siç është dhe misioni i kësaj komande".



Heraldika

Heraldika si disiplinë e ka fillimin e praktikimit në Europë në shekullin XI, kohë kur filluan të kristalizohen rregulla në paraqitjen e simboleve në armët ushtarake, vulat dhe flamujt e feudalëve, shteteve e koalicioneve ushtarake. Këto rregulla fillësën e kanë në karakterin praktik, që të lehtësonin identifikimin e forcave ushtarake në fushat e betejës, ku simbolet që mbanin në mburoja dhe në flamujt e tyre e bënte të lehtë njohjen e reparteve ndërmjet tyre dhe kundërshtarit dhe lidhjet me komandantët e tyre. Këto simbole, që në fillim u praktikuan për qëllime identifikimi, më vonë u zhvilluan edhe në drejtimin artistik të tyre dhe në momentin që ata filluan të krijonin rregullsi njohje e individualiteti të feudalëve, shteteve etj., kjo tërësi rregullash u kristalizua në disiplinë, e cila duhej njohur nga bashkëkohësit për nevojat e organizimit politik, ushtarak e shoqëror.

Kjo disiplinë u emërua "heraldikë" nga emri i atij personi që kishte detyrë të njëjti këtë rregullsi tek fqinjët, eprorët e feudalit që i shërbente, të vasalëve të tij dhe të mbretit nga i cili varej. Heraldika kishte detyrë të drejtonte ceremonitë e oborreve, të mbante të vizatuara emblemat, vulat dhe flamujt e të gjithë atyre që kishin të bënin me zotin e tij. Emblemat heraldike ishin tashmë të përcaktuara qartë në ndryshim nga periudha paraardhëse, ku kushdo pa një rregullsi mbante simbole të ndryshme si në kohë dhe territor, por edhe brenda të njëjtit formacion politik e shoqëror. Emblemat ndryshonin, por tashmë me rregullsi dhe të shpallura publikisht. Ndryshimet bëheshin për arsye të zgjerimit ose zvogëlimit të territorit, të vasalitëtit në të cilin i përplaste jeta, nga lidhjet me krushqi, nga aleancat dhe nga ndarja e një dere në dy apo më shumë degë. Në Shqipërinë mesjetare kemi raste nga të gjitha këto raste të ndryshimit në vazhdimësi të emblemave. Nga martesja e Andrea Topisë ndryshoi stema e tij, duke përqafuar edhe simbolet e mbretërisë së Francës, dhëndër i të cilit u bë, me njohjen e derës së Muzakajve, titulli despot ku futi në përdorim elemente të simbolit perandorak, shqiponjën dykrenore, të cilës i shtoi yllin gjashtë cepash të Balshajve nga kishte varësi. Në këtë vazhdë nipi i Skënderbeut, i cili u hyri në hierarkinë kishtarë u detyrua që simboleve të emblemës trashëguese t'i shtojë dhe trekëndëshin, simbol i trinisë së shenjtë dhe ndryshime në ngjyra etj.

Në trojet shqiptare heraldika u zhvillua dhe praktikua që në fillimet e saj në Europë si rezultat i kontakteve me ushtritë europiane të kryqëzatave që zbritën në bregdetin Adriatik. Këtë fakt e kanë pranuar studiuesit e heraldikës, por e kemi të mbështetur dhe me dëshmi monumentale heraldike të shekullit XII është emblema heraldike e shtetit të Arbrit e zbuluar në Gëziq (Mirditë), po ashtu



e kësaj periudhe është emblema e vjetër e Muzakajve që mban një burim uji dhe dy pishtarë. Për përqafimin e disiplinës heraldike tek arbrit ndikuan shumë faktorë ekonomikë e kulturorë, por po veçojmë vetëm dy nga këto.

Në këtë periudhë për vetë pozicionin në të cilin ndodhet vendi ynë njohu një zhvillim ekonomik e shoqëror. Në një udhë përshkrim



të fillim shekullit XIV shkruhet: “Vendi (Arbëria) është i ndarë midis princave të vendit, të cilët e sundojnë vetë pa iu nënshtruar kërkuj...”.

Në drejtim të zhvillimit të artit në truallin tonë në fillimin e mijëvjeçarit të dytë kemi monumente kulturi me vepra arti e mbishkrime të gjuhëve greke e latine, që pa u zgjatur tregonin se vendi ishte në një lulëzim të artit e kulturës, ku gjallëronin si ndikimet kulturore të Perëndimit dhe të Lindjes që njiheshin.

Për zhvillimin e heraldikës ndikoi edhe ndërgjegjja e arbërve si vazhduese e lashtë në trojet e veta, ku ishin ruajtur në mitologji, tregime e gojëdhëna, ornamente veshjesh etj., simbole të paraardhësve që nga lashtësia, të cilat të konkretizuara ishin dhe në monumentet që ruheshin në çdo cep të truallit tonë. Pra, si popull kishim një trashëgimi simbolesh shumë të pasur, e cila gjallonte në objekte të kulturës materiale bashkë me shpjegimin mitik, ritual etj.

Nga ato të pakta monumente të fillimeve të heraldikës shqiptare që ruhen, shpaloset hapur se, kjo disiplinë njihet mirë me të gjitha rregullat e saj që në shekullin XII dhe ishte fryt i një shoqërie që kishte oborre feudale me njerëz me kulturë e artistë të nivelit të lartë artistik. Emblema e Shtetit të Arbrit e shek. XII ishte e vendosur në një ansambël arkitektonik me vlera artistike dhe mbishkrimi që e shoqëron është latinisht e sferave të larta kulturore të kohës, dhe emblema është e një cilësie që tregon dorën e një artisti të vërtetë.

Stema heraldike e Topiajve e shek. XIV që ruhet në manastirin e Shën Gjon Vladimirit, Elbasan (sot në Muzeun Kombëtar Tiranë), është sipas të gjitha rregullsive

heraldike që kishte kjo disiplinë në atë periudhë. Ajo është gdhendur nga mjeshtri vendas Dhimitër Spada, shoqërohet me mbishkrimin në tre gjuhë: latinisht, greqisht e sllavisht që tregon se edhe kasneci (heraldi) i kësaj dere fisnike shqiptare ishte me një kulturë të lartë dhe artist i vërtetë.

Meqë përmendëm fjalën stemë, duhet të dimë që kjo kupton fazën më të lartë të zhvillimit artistik e disiplinor të heraldikës, Në fillim ishin përbërëse të heraldikës vetëm forma e shqytit dhe simboli (një ose disa) të paraqitura në ngjyra dhe më vonë kësaj baze iu shtuan edhe elementë të tjerë, po sipas një rregullsie të përcaktuar. Tërësia e këtyre elementëve dekorativ-artistik u quajtën stemë. Por nuk ka heraldikë pa bazën e saj që është emblema (simboli), e cila i plotëson kriteret disiplinore edhe kur është e vetme pa shtesat e mëvonshme. P.sh. i plotëson kërkesat e heraldikës edhe emblema e Arbrit që ka vetëm simbolin shqiptonjë, po ashtu si dhe

emblema e Topiajve që ka simbolin në shqyt, helmetën, kreshtën, kurorën, pëlhurën dhe pendët.

Në po këto shekuj heraldika u përqaftua krahas klasës së bujarëve, edhe nga shtetet, qytetet, bashkësitë shoqërore e fetare dhe artizanati. Vendi ynë njohu zhvillim të heraldikës në të gjitha këto drejtime.

Monumentet heraldike që ruhen në truallin autokton shqiptar janë të pakta për arsye që dihen p.sh. pushtimi pesë shekullor osman zhduku qytete e dogji krahina, por pushtuesit e armiqtë tanë kanë punuar sistematikisht për zhdukjen e këtyre monumenteve që dëshmonin fazën e lartë të qytetërimit të kombit tonë në mesjetën e vonë. Nga pushtimi i serbëve në vitin 1912 u zhdukën tre emblema në kalanë e qytetit të Lezhës, po nga trazirat e këtij fillim shekulli u zhdukën disa emblema nga muret e kështjellës së Durrësit, gjatë gjysmës së parë të shek. XX u zhduk emblema me shqiptonjën dykrenare në Jabllanicë (Kosovë), në vitin 1912, u grabitën gurët e disa varreve monumentale nga serbët në periferi



të Tetovës, gjatë trazirave të vitit 1997 u zhduk emblema e Shtetit Shqiptar të Skënderbeut në portën e kështjellës së Himarës e mundet të rendisim dhe fakte të tjera të njohura. Për fat na janë ruajtur në truallin tonë emblema e Skurajve, Engjëllorve, Topiajve, e Kastriotëve, Gropajve, Shtetit të Arbrit e disa emblema të tjera të gdhendura në gur ose të pikturuara, e disa të tjera të pa identifikuar nga studiuesit.

Nga faza e parë e zhvillimit të kësaj discipline nga heraldika shqiptare sot njihen emblemat e fisnikëve Balsha, Muzaka, Topia, Skuraj, Bue Shpata, Engjëllorët, Bukja, Araniti, Buzezi, Dukagjini, Dushmani, Gropa, Himara, Kopili, Matranga, Tribaldi, Zakarija, Spani etj. Nga dinastitë arbërore kemi emblemat e Kastriotëve, të Shtetit të Arbrit të shekullit XII dhe emblema e “Mbretërisë Shqiptare” nën sovranitetin Anzhuinëve e fundit të shek. XIV

etj. Zhvillimi i shoqërisë shqiptare pësoi një frenim si rezultat i pushtimit otoman që fisnikërinë shqiptare ose e përndoqi nga atdheu, ose i detyroi të bëheshin vasalë të Portës së Lartë, e cila nuk njihje as nuk lejonte heraldikën. Në këto shekuj robërie si e gjithë kultura kombëtare pësoi goditje edhe heraldika, e cila ishte faktor dhe tregues i zhvillimit kulturor e shoqëror i kombit tonë përkrah vendeve europiane.

Faza e dytë e heraldikës shqiptare është e shekujve XVI-XVI kur afirmohen në ngjarjet historike pinjoj të dyerve arbërore në shërbim të shteteve perëndimore e në fusha të ndryshme kulturore, shkencore e fetare të rilindjes europiane, të cilat arritën t'i ruajnë e të fitojnë tituj të fisnikërisë. Disa nga këto dyer të para shqiptare mbajnë tituj fisnikërie të trashëguara nga atdheu si dera fisnike De Rada, Kladha, Maruli, Ralli, Vlorë, por nuk dimë për shekujt e mëparshëm si ishin emblemat e tyre. Na shfaqen në këto shekuj fisnikëria shqiptare e afirmuar e njohur nga oborret e Perëndimit: Peta, Marmora, Makri, pasardhës të Aranitëve e Muzakajve, Bokali, Basta etj., të cilat u shquan në fushën ushtarake e administrative. Nga dyert fisnike shqiptare u shquan në hierarkinë kishtarë shumë pinjoj që ua njohim emblemat, të cilat shumë elementë të simboleve i trashëguan nga emblemat e paraardhësve të shekujve XIII-XV si Konstandin Kastrioti, Bogdani, Mekajshi, e disa të tjerë që i fituan titujt më vonë si Vulgari, Lapacaja, Parrino etj.

Në fushën e kulturës, shkencës e artit u dalluan pinjoj të dyerve të vjetra shqiptare jashtë trojeve të tyre dhe që trashëguan ose fituan tituj fisnikërie dhe ua njohim emblemat Gjon Gazullit, derës Karajani, Maruli etj.

Zhvillimi ekonomik, kulturor e legjislativ i Arbërisë në shekujt e para pushtimit otoman kristalizoi forcimin e zhvillimin e shumë qyteteve shqiptare, të cilat disa kishin vazhdimësi që nga kohët e lashta si Shkodra, Lezha, Durrësi, Prizreni, Janina, Ulqini, Berati, Janjeva, Vlorë, por krahas tyre lindën e u zhvilluan në një hap me qytetet e vendeve europiane edhe Danja, Zvaqi, Drishti, Shurrdhahu. Me këtë zhvillim që patën këto qytete arritën të kenë statutet e emblemat e tyre. Nga këto ne sot njohim emblemat e qyteteve, Shkodër, Ulqin, Lezhë, Artë, Zvaq (Shasi i sotëm), Drisht etj.

Objekt studimi të heraldikës janë edhe vultat që ishin të domosdoshme për aktivitetin e kancelarive të oborreve e të shtetit mesjetar shqiptar. Nga ato të dhëna të pakta, kjo edhe për mungesë studimesh e gjurmimesh na janë ruajtur dhe kemi dëshmi për këtë fushë që në literaturën shkencore quhet sfragjistikë. Kemi dëshmi grafike për vulën e Gjon Kastriotit, vulën e Gjergj Strazimir Balshës dhe kemi dëshmi, por nuk e njohim paraqitjen grafike të tyre për vulën e qytetit të Durrësit, të qytetit të Himarës, të Ulqinit, Tivarit, Lezhës. Edhe gjatë pushtimit turk vazhduan të ruajnë për korrespondencën e tyre vultat peshkopët si Bardhi, Mekajshi, që në emblemat e tyre kishin simbolin e derës fisnike që i përkisnin etj. Por shumë e rëndësishme në këtë drejtim është se njohim vulën e Kryezotit të Shtetit Shqiptar të shekullit XV, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e cila ruan edhe simbolin e flamurit tonë kombëtar. Nga Kuvendi i Dukagjinit i viteve 1601-1602, ku morën pjesë përfaqësues nga 13 krahina, që nga Kosova, Dukagjini, Shpati e Myzeqeja, në përpjekje për çlirim nga pushtuesi, aktet i vulosën

me vulën, e cila na është ruajtur forma grafike e saj. Ajo ka mbishkrimin: “Sigillum Regni Macedoniae et Albaniae”, Vula e Mbretërisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë, e cila ka edhe ajo në mes shqiponjën dykrenare të trashëguar dhe bashkudhëtarë e shqiponjës së flamurit të kombit tonë.

Në mesjetë dyert fisnike kishin dhe flamurët e tyre që kryesisht kishin të njëjtin simbol si emblemat heraldike. Me krijimin e Shtetit Shqiptar

nga Kuvendi shqiptar i Lezhës, më 2 mars 1444, edhe kombi ynë unifikoi e njohu si flamur të tij flamurin që deri ahëre ishte i dinastisë Kastrioti. Në luftë të gjithë repartet e fisnikëve shqiptarë mbanin flamujt e tyre por në ballë të luftës e të ceremonive të tjera ishte flamuri i mbarë kombit. Sipas hulumtimeve dhe dëshmimeve arkivore shqiptare dhe të huaja, flamuri kombëtar shqiptar megjithëse i ndaluar nga pushtuesit, u ruajt e praktikua në ngjarje historike të krahinave të atdheut tonë pa ndërprerje deri më 28 nëntorin e 1912.

Në drejtim të heraldikës së bashkësive artizanale shqiptare mesjetare shpesh përmenden në dokumente e udhë përshkrime se bashkësitë e ndryshme të qyteteve kishin flamuj të veçantë, Njohim konkretisht emblemat e hekurpunuesve të Pejës, të tabakëve (lëkurëpunuesve) të Elbasanit dhe emblemën e mjeshtërve të punimit të armëve në Hajmel (Shkodër).

Nga shoqatat e klubet kulturore, atdhetare e botuese të periudhës së rilindjes njohim shumë emblema si nga ato brenda dhe jashtë atdheut nga fotot e botimet. Për fat na ruhet e qëndisur e krijuar nga Marubi emblema e Klubit “Gjuha Shqipe” e vitit 1908.

Sot nuk kemi tekste të shkruara në gjuhën shqipe për shekujt XII-XV që të njohim terminologjinë e kësaj disipline të popullit tonë. Por nga gjuha e folur dhe të periudhës kur shqipen e kemi të dokumentuar kemi pasuri dhe terminologji të pasur shqipe. Në zonat e thella ku pushtuesit kishin pushtet të kufizuar kemi në përdorim për disa pinjoj të dyerve fisnike kemi fjalën Zoti, zotërinjtë (p.sh. Zotnit e lballes), që gjuha jonë i përdor për të cilësuar dyert e para. Tek xhubleta e veshjes popullore të Mirditës dhe Matit është e ruajtur e qëndisur emblema e Kastriotëve dhe quhet “maroja”, që ruhet bashkë me emrin e mburojës ku vendosej. Pjesëtarët e dyerve të mëdha si na e dokumenton edhe F. Bardhi por edhe goja e popullit quhen “fisnik” e “bujar”. Termi bujar është ruajtur deri sot tek arbëreshët e Italisë në formën “buljar”. Termi “kasnec” është i gjuhës shqipe dhe i përgjigjet termit të përdorur në Europë “herald”. Ky term është me shumë rëndësi e tregues se qysh në fillimin e praktikimit të heraldikës në Arbëri ekzistonte terminologjia në gjuhën tonë për këtë disiplinë. Nga Bogdani kemi termin “shqyt” për mburojën, dëshmi që vërteton që edhe fjalët e huazuara shqipja ia kishte përshtatur strukturave morfologjike të saj.

Emblema shqiptare të shekujve XII-XV ruhen në katalogë të ndryshëm të arkivave private e shtetërore të Europës, të cilat shumë pak janë të njohura.

Gratë shqiptare që i dhanë emër historisë

Në ditën ndërkombëtare të gruas, 8 Mars, vendosëm të krijojmë diçka origjinale që rrjedh nga historia jonë kombëtare dhe pozita e gruas përgjatë kësaj historie. Ideja ishte të shkrijmë dy koncepte të ndryshme në një të vetëm: shënimi i ditës ndërkombëtare të gruas dhe arritjet e grave shqiptare përgjatë historisë.

Qëllimi ishte të përzgjedhim disa figura nga fusha të ndryshme të shoqërisë, për të cilat pak dihet për jetën dhe veprimtarinë e tyre. Përzgjedhja e emrave u realizua me qëllimin e përfshirjes të sa më shumë fushave të ndryshme dhe nga rajone të ndryshme ku jetojnë shqiptarët. Gratë e përzgjedhura për këtë koncept paraqesin veprimtari të fushave të ndryshme dhe të rëndësishme të shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Fushat në të cilat këto gra kanë vepruar, fillojnë që nga arti, shkenca, politika e shoqëria.



Musine Kokalari, 1917-1983, ishte shkrimtarja e parë shqiptare. Përmes shkrimeve të saj, ajo shprehu shpirtin e saj revolucionar dhe ngriti vetëdijen ndaj pushtetit komunist.



Valentina Pistoli, 1928, është arkitektja e parë shqiptare. Studioi në Universitetin e Sofjes, në Bullgari dhe ishte udhëheqëse e grupit të arkitektëve që e dizajnuan planin e Hotel "Tirana".



Qemoran Toptani, 1912-1981, ishte kirurgja e parë shqiptare. Pasi kreu shkollimin në Vjenë dhe Romë, u kthye në Tiranë, ku u shqua si një ndër kirurget më të mira që shëruan të plagosurit e Luftës së Dytë Botërore.



Tringë Ismajli, 1880-1917, ishte luftëtare guerile, e cila ishte pjesë e klanit Gruda të Malësisë, të cilët luftuan kundër Perandorisë Osmane.



Motrat Qiriazhi, Sevasti 1871-1949 dhe Parashqevi 1880-1970, me prejardhje nga Manastiri, ishin ndër gratë e para që u shkolluan në kolegjin amerikan në Kostandinopojë. Motrat Qiriazhi shquhen për kontributin e madh që e dhanë për arsimin dhe edukimin kombëtar.



Motrat Zengo, Sofia 1915-1976 dhe Androniqi 1913-2000, janë piktores e para shqiptare që njihen për pikturat e para profesioniste në historinë e artit pamor shqiptar.



Shote Galica, 1895-1927, ishte Heroinë e Popullit dhe luftëtare e kryengritjeve kosovare për çlirimin dhe bashkimin kombëtar.



Xhanfise Keko, 1928-2007, ishte regjisorja e parë shqiptare dhe një ndër themelueset e studios së filmit 'Shqipëria e Re'.



Eleni Qirici, 1928, ishte aktorja e parë shqiptare që depërtoi në skenat e filmit në Hollywood, ku u angazhua në shoqërinë e filmit "Goldwyn Mayer".



Dora D'Istria apo Elena Gjika, 1828-1888 ishte intelektuale dhe revolucionare shqiptare. Përpos spektrit intelektual ajo ndihmoi edhe në afirmimin e çështjes kombëtare sidomos në kontributin e madh që dha në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.



Nexhmie Zaimi, 1914-2003, ishte gazetarja e parë shqiptare që punoi për CNN dhe Zëri i Amerikës. Zaimi ishte gjithashtu një ndër gratë e para që raportoi nga Lindja e Mesme gjatë viteve '50.



Marte Tunaj, 1948-2016, është gruaja e parë që mori guximin të flasë në emër të gjithë grave të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë.



Xhevë Lladrovci, 1955-1998, ishte luftëtare e UÇK-së, gjatë luftës së fundit në Kosovë. Është luftëtarja e vetme grua që mori gradën më të lartë, Gjeneralmajor.



Erifili Bezhani, 1917-1959, ishte avokatja e parë shqiptare, e cila u diplomua për Drejtësi në Francë, ushtroi detyrën në Francë, mirëpo u dënua tragjikisht nga regjimi komunist në Shqipëri.



Shaqe Çoba, 1875-1954, ishte një ndër gratë e para intelektuale që kontriboi në ngritjen e figurës së gruas në shoqëri, duke themeluar kështu edhe organizatën "Gruaja Shqiptare", më 1920. Gra të tjera shqiptare që shënuan historinë janë të shumta, mirëpo këto që i kemi përzgjedhur janë disa prej tyre për të cilat pak dihet.

Simbolet e LANÇ-it, evidentim i vlerave historike të popullit shqiptar

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Ministria e Mbrojtjes, bashkitë dhe njësitë administrative, si dhe Organizata e Dëshmorëve, në këto vite të demokracisë kanë bërë kujdes për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të traditave patriotike të popullit tonë, për përjetësimin e ngjarjeve, si dhe të figurave më të rëndësishme, ku gjithnjë e më shumë, është rritur vëmendja ndaj simboleve monumentale në pasqyrimin e historisë së lavdishme të LANÇ-it.

Në vitet e socializmit, krahas vendosjes së pllakave përkujtimore, u ngritën lapidarë, buste, statuja e monumente që i kujtonin udhëtarit apo vizitorit, se shqiptari në jetën e tij ka qenë në luftëra të vazhdueshme për mbrojtjen e dinjitetit, të shtëpisë dhe të territorit të tij. Simbolet monumentale u vendosën me qëllim për të nderuar veprën e ndritur të dëshmorëve që dhanë gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre për Atdhe. Kështu u bënë emërtime në 2 900 institucione, qytete, kooperativa, reparte ushtarake, rrugë e sheshe me emra dëshmorësh, patriotësh, luftëtarësh e të ngjarjeve historike. Pas çlirimit të vendit u ngritën mbi 12 monumente, 145 buste, 590 lapidarë, si dhe janë vendosur mbi 530 pllaka përkujtimore në të gjithë vendin. Këto simbole monumentale ishin qendra të edukimit patriotik dhe u përdorën në mënyrë të veçantë në festa e ditë jubilarë, ku organizoheshin vizita, biseda, ekskursione, koncerte, etj.

Organizimi i aktiviteteve të shumëllojshme pranë objekteve të simboleve monumentale ngjall emocione të thella në ndërgjegjen e pjesëmarrësve, fakt ky që ka ndikuar pozitivisht, në rolin e madh militues që luajnë bustet, monumentet, lapidarët dhe objektet e tjera të simboleve monumentale në njohjen e traditave luftarake të popullit tonë.

Duke u nisur nga këto faktorë dhe me qëllim që të forcojmë e të ngremë më tej rolin dhe nivelin e punës së organeve kompetente që i njej ligji, si dhe Organizata e Dëshmorëve, në vlerësimin e simboleve monumentale, si një mjet që është në kontakt të vazhdueshëm me ne dhe të përjetësimin, del detyra madhore që të kuptojnë mirë e të trajtojnë drejt rëndësinë dhe efektin e organeve ligjzbatuese ndaj këtyre simboleve. Në këtë drejtim mbetet shumë për të bërë. Aktualisht probleme kryesore që tërheqin vëmendje dhe duhet përqendruar puna në këtë vit të 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut, duhet punuar me projekte konkrete me qëllim riaftësimin e tyre dhe përjetimin e ngjarjeve kulmore të kësaj lufte.

Ngritja dhe e vendosja e simboleve si monumente, statuja, buste dhe emërtime të ndryshme bëhet mbi bazën e disa kriterëve dhe të miratuara me ligj. Mirëpo këto kriterë nuk mbahen parasysh nga organet përkatëse. Janë vërejtur raste që duke mos njohur kriteret, me iniciativa private e lokale, që nuk janë në kompetenca të tyre, janë prishur apo dhe devijuar e premtuar për të ngritur më të kohës, por çdo gjë ka ngelur në premtime. Për disa figura të shquara të rëndësishëm të lëvizjeve patriotike, të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ose të periudhës së pas çlirimit nuk ka buste dhe simbole. Kështu në Tiranë sot nuk kemi asnjë bust të ndonjë Heroine të Popullit, apo të ndonjë dëshmoreje.

Çështja është për të qenë më parimorë dhe të kujdesshëm në zbatimin e përpiktë të kriterëve, për të vlerësuar drejt kontributin e çdo personi të rëndësishëm në shërbim të popullit.

Problemi nga organet zbatuese, por dhe nga Organizata e Dëshmorëve do parë dhe trajtuar, të mos gabojmë në vlerësimin e drejtë

të fenomeneve, që të nxisim ndjenja jo të mira. Prandaj për këtë problem të rëndësishëm do menduar e vepruar në mënyrë të planifikuar e në bazë të studimeve serioze e me perspektivë.

Është pozitiv fakti që janë përcaktuar dhe piketuar vende që paraqesin interes për historinë dhe traditat e popullit tonë, megjithëse në këtë fushë ka shumë pika të panjohura, që duhet, pa humbur kohë të zbulohen, të njihen dhe tani për tani të piketohen, por të orientuara nga organet kompetente dhe të përcaktuara me ligj.

Kjo do parë edhe për sa i takon çështjes së ndarjes të objekteve të propagandës monumentale, mbasi shpërndarja dhe vendosja e tyre, që nga objektet më të thjeshta e deri tek ato më të komplikuarat, nuk është bërë gjithmonë me studim dhe me kriterë të drejta. Natyrisht ngritja e lapidarëve, ashtu si edhe vendosja e objekteve të tjera përcaktohet nga ngjarjet që janë zhvilluar.

Kështu, në Tiranë, gjatë këtyre viteve janë prishur memoriali i Misto Mames, i Qemal Stafës, i heronjve Shyqyri Ishmi dhe Muhamet Gjollështa të varur në litar tek Pazarri i Ri, hequr pllakatet përkujtimore tek mjaft shtëpi, si dhe janë prishur qendra muzeale si shtëpitë e Partisë, të Rinisë, të bazave kryesore të shtypit dhe të ilegalëve të epopesë së madhe të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në Tiranë gjenden vetëm lapidari i Debatikut në kodrat e liqenit për veprimtarinë revolucionare të fëmijëve e pionierëve, lapidari i Mine Pezës, lapidari i Qemal Stafës që është në degradim, lapidari i "4 dëshmorëve", lapidari i Vojo Kushit me shokë, përsëri në gjendje të mjerueshme, si dhe lapidari ku u varën Shyqyri Ishmi dhe Muhamet Gjollështa në Pazarin e Ri, si gurë kilometrik të kohëve të shkuara dhe nuk ka më simbole. Gjithash-

tu ka boshllëqe dhe kufizime në tematikën e përkujtimeve që i kushtohen ngjarjeve para vitit 1939.

Në Tiranë mungojnë objekte që t'i kushtohen heroizmit dhe kujtimit të grave në luftë. Prandaj mbetet që në të ardhmen të pasqyrohet tematika e trajtimit të veprës dhe figurës së gruas shqiptare në të gjitha llojet e objekteve të simboleve monumentale. Tani për tani kërkohet të mendojmë si organizatë për të vënë në lëvizje sipas ligjeve të miratuara nga parlamenti shqiptar, bashkinë dhe institucione shtetërore dhe private për të ngritur bustet e grave dhe vajzave që janë shpallur heroina dhe gradualisht ndër parqe, lulishte e pika të tjera të vendosen përkujtime, dhe ku është e mundur, statuja në allçi e çimento, që të simbolizojnë figurën e femrës shqiptare si luftëtare që ka luajtur rol të rëndësishëm në të gjitha periudhat e historisë së popullit tonë.

Problem i rëndësishëm është dhe çështja e paraqitjes së tyre të gjithanshme, Duke i parë me këtë sy këto objekte rezultojnë se në disa prej tyre mungon përpjekja për origjinalitet kombëtar, dhe disa të tjera nuk janë të tilla që ta tërheqin dhe t'i ngjallin respekt vizitorit, siç po ndodh me lapidarin tek Pazari i Ri, apo dhe të memorialit të tre heronjve të Kodrës së Kuqe, etj. Kemi dhe objekte, sidomos lapidarë, pllakate përkujtime e ndonjë bust të projektuar e vendosur keq. Shumica e lapidarëve janë të ndërtuar një lloj, me tulla e suvatim, të veshur me mermer, apo të lyer me gëlqere, pa asnjë motiv dekorativ apo basoreliev të goditur dhe që të gjitha, thuajse vuajnë nga uniformiteti.

Me ndonjë përjashtim, nuk dallohen lapidarët që përkujtojnë të kaluarën nga ato të Luftës Nacionalçlirimtare apo të ndërtimit socialist. Fjala është që çdo epokë të ketë motivet e saj karakteristike. Nga ana tjetër ka lapidarë që nuk i përgjigjen qëllimit për të cilin janë ngritur, sepse nuk simbolizojnë ngjarje apo aksione konkrete. Ka edhe lapidarë që në fakt i kushtohen kujtimit të dëshmorëve të caktuar, por që në të vërtetë nuk njihen nga vizitori, sepse në to nuk ka asnjë mbishkrim sot.

Për sa i përket mbishkrimeve në një pjesë të mirë të objekteve të propagandës monumentale ato nuk janë të goditura. Mbishkrimet vuajnë për mungesën e përmbajtjes emocionale dhe si të tilla nuk lënë asnjë mbresë në kujtesën e vizitorit. Shpesh mbishkrimet janë të gjata, të shkruara keq e me gabime. Në shumë objekte ato janë bërë të pa lexueshme dhe në disa të tjera janë prishur. Gjendja flet për kujdesin e pakët që



tregohet ende për mirëmbajtjen e objekteve të simboleve monumentale sa që në ndonjë rast, disa prej tyre janë prishur krejtësisht. Kjo pakujdesi vërehet edhe në mirëmbajtjen e objekteve siç janë bustet me rëndësi, lyerja e të cilëve bëhet nga punonjës jo kompetentë të organeve të bashkisë. Për pasojë disa nga bustet për figurat e shquara po dëmtohen dhe po humbasin tiparet e tyre karakteristike. Prandaj, Organizata e Dëshmorëve duhet të ngrejë probleme në bazë të ligjit që organet përkatëse, duke filluar nga paraqitja e përgjithshme e objekteve, sistemimi, zburkimi i ambientit përreth, ndriçimi dhe vendosja e shtyllës së flamurit kombëtar, është e nevojshme. Çështja e mirëmbajtjes të simboleve ta bëjë me opinion dhe edukatën tek të gjithë anëtarët e organizatës dhe veçanërisht të brezit të ri.

Ka vend të ndërmerren aksione konkrete, duke i konsideruar këto faktorë në edukim. Aksionet të merren për të parë gjendjen e tyre, për të paraqitur kërkesën për rregullim

dhe mirëmbajtje, por edhe për ngritjen e objekteve të reja, që lidhen me ngjarje të shën-uara.

Për të përmirësuar gjendjen mendojmë të propozojmë dhe të merren masa që me rastin e festimit të jubileut të madh të 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut të shpallet një aksion i madh nacional për lapidarët dhe simbolet monumentale, për të rregulluar e përmirësuar objektet ekzistuese dhe të vendosen edhe objekte të reja.

Për këtë qëllim të kërkojmë nga Ministria e Mbrojtjes, nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me drejtoritë e bashkisë, të marrim masa që brenda një afati të mundshëm, të vishen me mermer të gjithë lapidarët që janë vendosur brenda në qytet dhe në të njëjtën kohë të zëvendësohen lapidarët e pa përshatshëm. Nga Ministria e Kulturës të bëhen projekte tip (disa lloje) për lapidarët që do të ngrihen, duke patur parasysh faktin që çdo model tip të përmbajë motivet karakteristike të epokave të caktuara nga historia e popullit tonë. Në kuadrin e aksionit për përmirësimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të simboleve monumentale, të mos mbetet asnjë ngjarje pa u përkujtuar dhe fiksuar në ndonjë objekt sado të thjeshtë. Me këtë rast të vendosen pllaka përkujtime në çdo objekt ku janë zhvilluar ngjarje, emërtime të shkollave, por dhe emërtime të rrugëve me dëshmorë apo dhe ngjarje.

Organizata e Dëshmorëve të kërkojë një bashkëpunim të ngushtë me ministrinë që lidhen me ecurinë e këtij problemi dhe me bashkinë e Tiranës, për të pasur përfaqësuesit e saj për t'u konsultuar në vijimësi. Nga Organizata kërkohet që këtë vit dhe në vazhdim të kemi të regjistruar dhe të pasaportizuar të gjitha objektet e simbolet monumentale dhe të jenë nën kujdesin e plotë të bashkisë, të muzeve, por dhe të Organizatës së dëshmorëve.

Për këtë aksion kombëtar për rregullimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të simboleve monumentale të shkruhet herë mbas here në shtyp dhe në TV, duke organizuar tryeza bashkëbisedimi dhe debati të zhvillimit të simboleve monumentale.

Organizata e Dëshmorëve në bashkëpunim me Bashkinë në 80-vjetorin e çlirimit të Atdheut të nxjerrë një album me veprat artistike më të arrira të simboleve monumentale, fletë palosje të objekteve, broshura për Heronj të Popullit që kanë 80-vjetorin e rënies. Ne mendojmë se përcaktimi konkret i masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të simboleve monumentale është i domosdoshëm.



Nga Shkodra në Çamëri

Mbretëria e Epirit nën udhëheqjen e Pirros nga vitet 307-277 p.e.s. dhe në Mesjetë në shekujt 14-15 me Despotatin e Epirit nën Gjin Bue Stpatën e pasardhësit e tij, kurse në Mesjetën e vonë nën Ali Pashë Tepelenën.

Për shtrirjen e saj në dialektin e tyre ata të thonë: “Çamëria zihet (quhet) nga lumi i Shalësit (Pavlo) në veri jaram (deri) tek Gurët e Zezë nën Prevezë (në jug)”. Këtë e pohojnë të gjithë autorët grekë të lashtësisë e Mesjetës: Straboni – Ptolemeu – Herodoti – Tuqiditi – Plini e Stefan Bizantini e deri tek studiuesit më afër kohës sonë si Pukëvili – Liku – Brukon – Boe – Lir – Han – Dozon si dhe akademiku ynë Eqerem Çabej etj.

Grekët e quajtën vendin Epir që do të thotë tokë – sterc – kontinent sepse vetë ata jetonin në ishujt e shumtë të Egjeut dhe popullsinë e Epirit. Varvaris ose Barbarë që do të thotë se nuk flasin gjuhën e tyre greke, por një gjuhë të ndryshme.

Në këtë shtrirje gjeografike janë 9.203 km² bashkë me ujërat e brendshëm, por bërthama tërësisht shqiptare jeton në 2.550 km². Në vitin kur filluan problemet në këtë krahinë, 1913, jetonin 50.000 myslimanë dhe 40.000 ortodoksë nga të cilët vetëm 18.000 flisnin gjuhën greke.

Sot, kuptohet me rritjen e popullsisë 165.000, shqiptarë në Çamëri, 300.000 në Turqi si dhe ata që jetojnë në Shqipëri dhe diasporë (SHBA) bëhen gjithsej, 700.000 çamë.

Ka një reliev të larmishëm me bregdet (me skela, limane stacione balneare e kripore) me fusha dhe kodra të shfrytëzueshme, male që e mbrojnë nga erërat e lindjes e me një klimë mesdhetare që lejon kultivimin e ullinjve, agrumeve, pemëve frutore, vreshtave, drithërave dhe bimëve industriale. Ka 343 ditë me diell ose mbi

2.700 orë me diell në vit, me temperaturë mesatare vjetore 13 – 15°C dhe në bregdet 17 – 18°C, që janë më të larta se në të gjitha trevat shqiptare.

Rrjeti hidrografik është mjaft i dendur me lumenjtë, Kalama ose Thiami, 115 km, që i ka dhanë edhe emrin krahinës, lumi i Artës 110 km në kufirin më jugor, lumi i Llurit 80 km, Lumi i Zi ose Akeroni 53 km, Llakat e Sulit dhe Lumi Pavell ose i Shalësit në veri me 50 km gjatësi.

PIKËTAKIMET E QYTETIT TË SHKODRËS ME ÇAMËRINË

Këto dy ekstremite të Shqipërisë kanë qenë gjithmonë prë e lakmive të fqinjëve tanë veriorë e jugorë, Shkodrën për famën e



kulturën e saj dhe që e donin për kryeqytet dhe Çamërinë për pasuritë, begatinë, klimën e bregdetin e saj.

Çamëria është temë e përhershme dhe shqetësim i madh i të gjithë rilindasve tanë, ku ndër ta shquhen Pashko Vasa, At Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Dom Ndre Mjeda etj.

Nga lashtësia na vijnë të dokumentuara lidhjet e Pirros së Epirit në jug me Mbretërinë e Ardianëve në veri.

Pashko Vasa më 1879 shkruan për gjithë ata burra që e bënë çështje të vetën lirinë dhe pavarësinë e Greqisë si, Marko Boçari dhe Foto Xhavela me familjarët e bashkëfshatarët e tyre.

Mjeda që në moshën 18-vjeçare në poezinë “Vllavrasësi” ngjarjet i vendos jo pa qëllim në Çamëri.

Në këtë kohë bandat greke të Delijanaqit masakronin popullsinë çame. Edhe tek poezia “Meyerling” ai heq një paralele në mes të dhimbjes së Elizabetës për të birin e vrarë me dhimbjen e nënave çame për bijtë e tyre të masakruar nga greku.

Në ciklin e gjatë me poezi “Iliria e Epirit” tek poemat “Lissus” dhe “Scodra” thotë për Teutën që rrjedh nga perënditë e Dodonës dhe për tempullin pagan të tij.

Edhe në abetaret apo librat e shkruara nga ai apo edhe në bashkëpunim me Xanonin, para dhe pas Konferencës së Ambasadorëve jep malet, lumenjtë, liqenet dhe qytetet e Çamërisë si pjesë integrale të Shqipërisë.

Por njëkohësisht duhet thënë se edhe burrat e Çamërisë ia kanë kthyer Shkodrës miqësinë me të njëjtën zemërgjerësi.

DISA FAKTE QË FLASIN SHUMË PËR ÇDO PERIUdhË QË KALOI POPULLI YNË

Më 1870, gjejmë në Shkodër si përgjegjës të bibliotekës së vezirëve dhe si mësues të fëmijëve të tyre, të atin e Hoxhë Tahsinin, Osman Efendi Rushitin.

Edhe vetë Hasan Tahsini dokumentohet të ketë ardhur dy herë si mik në familjen e vjetër dhe me tradita të Tabakëve.



1. Në vargjet e një kënge popullore Marko Boçari e këshilloi Ali Pashë Tepelenën për t'u bashkuar me Bushatllinjtë, për të dërmuar Turqinë e për ta bërë Shqipërinë.

Ja vargjet:

“Medet për vezir Alinë

Që nuk e dëgjoji Boçarinë

Të mblidhej me Bushatllinë

Për ta bërë Shqipërinë”

Në disa vargje të këngëtarit popullor çam (anonim) jepet vizioni sa real aq dhe fisnik e dashamirës në lidhje me fqinjët:

“Për të gjithë Shqipërinë

Gegërinë e Toskërinë

Nga Tivari në Janinë

Prevezë, Shkup e Prishtinë

Me gjtonët (fqinjët) miqësinë

Bashkë të shporrim Turqinë”

Një figurë shumë interesante është ajo e çamit me origjinë nga Parga, Kolë Arsen Idromenos, (i lindur në Shkodër me nënë nga familja e dëgjuar e Saraçëve të këtij qyteti). Kjo figurë poliedrike i dha shumë qytetit të Shkodrës, si patriot, piktor i talentuar, skulptor i gurit, mermerit e drurit, fotograf, muzikant, skenograf e butaforist, arkitekt dhe urbanist si dhe xhenier i shquar. Ai ishte edhe realizuesi i shfaqjes së parë filmike në Shqipëri në një distancë të shkurtër kohore nga shfaqja e parë e filmit në Evropë. Këtë figurë, që me plot gojë do ta quanim një “Da Vinçi” shqiptar.

Edhe Arshi Pipa, një personalitet i shquar i kulturës dhe letrave shqipe, si dhe një vatrën e kryetar i saj për një periudhë kohore, në një takim me intelektualët e qytetit të Shkodrës ka thënë: “Jam me origjinë nga Çamëria, prindërit e mi janë vendosur në Libohovë e më vonë në Shkodër”.

Gjithashtu Shkodra nuk harron veprimtarinë e gjeneralit Hilmi Seiti, një figurë karizmatike, siç na e përshkruan në kujtimet dhe intervistat e lëna nga At Zef Pllumbi, i cili dëshmon edhe për helmatisjen e tij nga regjimi i kaluar që e provon me rrëfimet e të penduarve në burg. Po kështu Shkodra ka vlerësuar edhe kontributet e familjeve çame.

Me shumë rëndësi ka qenë edhe fjala e Kryetarit të “Vatrës” Gjon Buçaj në manifestimin popullor të Qafë Botës, më 25 qershor 2011, ku thotë: “Krimi i grekëve ndaj shqiptarëve, sidomos pjesës myslimane të saj. Greqia mban peng në ndërgjegjen e saj fajin e krimit antinjerëzor, duke dhunuar e vrarë shqiptarët, përlyen kështu emrin e saj si “djep i demokracisë”. Gjaku nuk harrohet, por kur gjakësi kërkon falje, ajo edhe pranohet. “Burrë është ai që fal dhe jo ai që vret”. Ajo duhet t'u japë çamëve pasaportat dhe t'u kthejë pronat. Ne u lejojmë grekëve ngritjen e varrezave të tyre në tokën tonë dhe ajo nuk lejon që çamët të vizitojnë varret e të parëve të tyre”.

Tragjedia e Fekenit, Dëshmi e sakrificës sublime

Tragjedia e stërvitjes dimërore të 6 shkurt 1981, ishte një ngjarje e shkruar në memorien e gjithë ushtarakëve shqiptarë, por edhe më gjerë. Ishin tre oficerë dhe tetë studentë të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, që në kujtesën shqiptare quhen “11 dëshmorët e Meçekut”. Stërvitja dimërore masive e trupës studentore dhe pedagogjike në një ditë tepër të vështirë u kthye në një ditë që në memorien ushtarake shqiptare dhe më gjerë është quajtur “Tragjedia e Fekenit”, rrëzë malit të Meçekut. Tashmë janë të rrallë ushtarakët që e kanë jetuar ditën e tragjedisë së ushtarakëve të ish-SHLBO-së dhe që militojnë në FASH. Megjithatë kujtesa e shqiptarëve nuk mund të harrojë ushtarakët, studentët e pedagogë me në krye komandantin e shkollës Rustem Peçin, shefin e degës mësimore Hysen Shehun e shumë të tjerë, personalitete të shquar ushtarakë, një simbolikë solidariteti ushtarak e njerëzor. Katër dekada e gjysmë kanë shkuar dhe Lapidarët e Fekenit si maja malesh lartësohen në të katër anët e Shqipërisë. Që të gjithë ranë në emër të një kauze të madhe në zemër të malit të Meçekut mbrapa malit të Dajtit në Tiranë. Kjo është dokumentuar në kujtesën e mijëra pjesëmarrësve në stërvitje dimërore, studentë e oficerë, por edhe atyre që me zemër e shpirt ishin në stërvitjen dimërore të studentëve ushtarakë. Një korpus ushtarakësh në unitet vlerash njerëzore. Kështu është regjistruar tashmë jo vetëm në kujtesën e ushtarakëve ngjarja e rëndë tragjike, ku humbën jetën 11 pedagogë e studentë ushtarakë, gjatë një stërvitjeje dimërore në malin me borë përtej Dajtit. Kështu do t'i sjellin ata me kujtimet e tyre për të mos u harruar kurrë, kolegët shokët dhe miqtë e tyre, të cilët mbeten përjetësisht yje të pashuar.

Orteku u mori shokët por jo kujtimin për Ta

Shpend Topallaj kujton: “...Aty nga fundi i Gushtit 1960, kisha ardhur nga Tirana, këtu në Durrës, për të takuar prindërit që ishin me pushime dhe të shfaqja edhe njëherë pakënaqësinë time, ngaqë të nesërmen duhej të filloja mësimet në shkollën e mesme ushtarake ‘Skënderbej’, ndërkohë që më qe mbushur mendja për të vazhduar liceun për pikturë, për të cilin kisha prirje. Për një fëmijë trembëdhjetë vjeçar kjo qe më se normale, por prindërit, dëshira ime i kish vënë në siklet. Kur dolën të më përcillnin tek stacioni i Plepave, kur asokohe ndalonte treni, mes turmës që priste, na zuri syri tre skënderbegas të vegjël. Iu afruam dhe pasi babai u tha se ishte oficer, i pyeti për emrat dhe nga ishin. Ai më i shkurtri tha se e quanin Çilirim dhe qe i biri i oficerit Halil Pulaj. Babai i gëzuar, ngaqë kolonel Halilin e kish shok e koleg pune, u tregoi rastin tim që e kisha me pishmanllëk shkollën e tyre. Përsëri



u hodh Çlirimi, i cili serioz si një i madh, tha se kjo shkollë është më e mira në Shqipëri, se ajo vërtetë përgatit kuadrot e ardhshme për ushtrinë, por aty përkrahen e inkurajohen të gjithë ata që duan artin e letërsisë. Në vazhdim ai numëroi disa poetë, shkrimtarë e artistë që kishin dalë nga bankat e shkollës ‘Skënderbej’. Për të gjitha këto përfundoi Çlirimi, ti do të bindesh vetë, ashtu siç do të bindesh se më i bukuri nga të gjithë artet, është ai i mbrojtjes së Atdheut. Premtoi se do të më priste të nesërmen në postbllok dhe u ndamë. Çlirimi ish nga ata që e mbante fjalën: qe i pari njeri që më priti e më përqafoi tek dera e shkollës, pra tek gjersa e ushtrisë ku do të kaloja vitet më të mrekullueshme të jetës sime. Limua ishte një vit para meje, për mua më çudiste autoriteti e respekti që ai gëzonte tek shokët e eprorët. Duke parë pavendosmërinë time, ai jo vetëm që më mbante përherë pranë, por dhe u lutej oficerëve, të cilët përherë e dëgjonin, që të më lejonin të shkoja në shtëpi që të mos mërzitesha.

Dhe meqenëse kishin të njëjtin trup, gjersa na qepën tonat, më jepte për të veshur uniformën e tij të liridaljes. Në njëfarë kuptimi, ai qysh atëherë, u bë me këshillat e tij, jo vetëm shok, por dhe edukatori im. Ashtu si Çlirimi unë njoha shumë shokë të mirë: midis tyre dhe shokun e klasës Nikollaq Beron. Ky djalë i thjeshtë Berati, gjithmonë i qeshur e i përzemërt, me urtësinë, thjeshtësinë e sinqeritetin e tij, që nxehej veç kur ish fjala për të mbrojtur të vërtetën, kish fituar dashurinë e tërë shokëve. Nikollaqi ish i gatshëm të ndihmonte këdo, pa u mburrur kurrë për këtë, ndaj dhe kudo ku ka shërbyer, nuk e heqin nga goja, se kudo që shkeli këmba e njeriut të mirë edhe gjurma e tillë mbetet. Me zemër të

madhe qe edhe komandanti i batalionit, Dushan Shameti, oficeri qe kish zgjedhur për lajtmotiv, vargjet e heroit të popullit Ali Demi: 'Më jep fuqi që të qëndroj/Më jep guxim që të luftoj/ Më ço në sulm me vrap të shkoj/ Me nder të vdes me nder të rroj' dhe që i zbatoi ato pa hezitim gjersa dha frymën e fundit".

Po çfarë ndodhi atë 6 shkurt të vitit 1981!

Kronologjia e kësaj ngjarje tani thuhet njihet nga të gjithë. Shkolla e oficerëve kish dalë në fushimin dimëror. Ai që nuk ka qenë ndonjëherë në ato vende, pra ai që malin impozant të Dajtit, e sheh si një dekor piktoresk e tërheqës në sfondin e kryeqytetit, as që mund ta përfytyrojë se ç' aspërsi, ç'i ftohtë e ç' thyerje e konfiguracionit të terrenit të pret atje. Pas butësisë së Dajtit, fshihet një botë tjetër; aty nis shtrirja e pafund e kodrave e maleve që palë-palë shkojnë drejt veriut. Po të mendosh se vetëm mali i Meçekut arrin kuotën mbi 1827m, e kupton se s'ka asnjë ndryshim nga Korabi e Jezerca. E ja këtë mal me pjerrësi herë-herë 75°, ndërsa frynte një erë e marrë me shpejtësi 40m në sekondë, kish zgjedhur për të ngjitur nënreparti që udhëhiqej nga pedagogu Mark Mici.

Në pamje të parë sikur nuk ta mbushte syrin ky burrë i hequr, biond, me sy bojëqielli, me mjekrën pak të dalë që gjithmonë bënte shaka, nga të cilat qeshte edhe vetë me gjithë shpirt. Por po ta njihje nga afër do të mahniste me forcën, vullnetin, rezistencën, shkathtësinë e optimizmin e tij. Ai pa u lodhur i printe kolonës gjersa mbërritën në lartësinë 1400m. Papritur një heshtje kërcënuese, e cila sikur paralajmëronte diçka të keqe pllakosi anë e mbanë. Nuk vonoi shumë dhe një masiv i madh dëbore me zhurmë filloi të rrëshqasë poshtë. Marku e dinte, se pamje të tilla ishin interesante po t'i shikoje në televizor, se në të vërtetë ajo paraqiste një rrezik të madh për jetën e atyre që s'kishin ku të futeshin. Pa humbur kohë ai thirri: "Orteku-mbrohuni"! Po ku të mbroheshin. Sa hap e mbyll sytë, llava i përfshiu të gjithë. Vetëtimthi pyetën veten: Ç'po ngjiste kështu me ta? Një natë më parë qeshën e kënduan gjer në mes të natës. Sot që bora kishte mbërritur gjer në brez, ngjiteshin përpjetë me shkathtësinë e ketrit. Kishin shpirt poeti, ndaj i gëzoheshin bardhësisë verbuese të dëborës.

Dikush nën zë edhe recitonte: "Dëborë bie në pyllin plak", apo: "Ç'u zunë rrugët me dëborë/ Pranë teje s'mund të vij/ Rri dritareve me orë/Në mendime future rri".

...Qenë të rinj dhe dikush mendonte për të dashurën, e dikush kish të drejtë të ëndërronte. Por s'qe e thënë: bora paska si çdo gjë dhe anën tjetër të saj, atë të tmerrshme, atë të papërbalueshme, atë vrastaren që mbuloi gjithçka.... Kur çdo gjë kaloi i pari që u çua qe pedagogu. "Ku jeni vëllezër?" Dhe me vull nisi të kërkojë. Pa pushim. Me ngulç. Me dhembje. Dhe sapo i zbulonte, i udhëzonte të kërkonin të tjerët. Pastaj gjeti automatikun dhe zbrazti një krehër të tërë. Kudo u dha alarmi: "Shokët janë në rrezik". U dëgjuan urdhra e komanda të prera. Por dhe pa ato, ata do të ngjiteshin përpjetë malit, pa ndalur asnjë çast, mjaft të fitonin edhe një sekondë të vetme. Dashuria për shokët u jepte forcë. Në krye udhëhiqin oficerët, Çlirimi, Dushani, Nikollaqi, Petrit Murzaku, Abaz Çipini, Sali Zhakupi, Muzafer Kambo. U ngrit nga shtrati ku



dergjej i sëmurë edhe studenti Nexhip Çopa nga fshati Seferaj. Filloi lufta për jetën. Luftonte vëllai për të shpëtuar vëllain, thuhet qenë ngjallur vëllezërit Dioskurë, Poluksi dhe Kastori, të njohur për trimërinë që treguan në fushatën e argonautëve, kur anijen e tyre e zuri stuhia.

Dëshmitarët tregojnë:

Kur zbuluan studentin Besnik Shehu, Çlirimi ia mori kokën dhe ia mbështeti me dashuri në gjoks. Kujtonte se ishte gjallë dhe donte ta ngrohte me zjarrin e zemrës së tij. Ai as që mund ta merrte me mend se ç'do të ndodhte pas pak me vetë atë. Aty ku mbi kanosjen e pengesat e dëborës, triumfonte dëshira për të shpëtuar shokun e cila ndërthurej si rrallë herë më trimërinë e mospasjes frikë nga vdekja, shquhej si një luan i vërtetë, sportisti universal, rezultativi i papërsëritshëm, legjendari dhe i urti Petrit Murzaku, i cili u jepte frymë nga fryma e tij, studentëve, tamam si të qenë bijtë e tij. Një varg me studentë e kuadro ngjitej e vargu tjetër zbriste me shokët e plagosur në krah derisa panë se mungonte vetëm njëri Aleko Gjoni. O burra, përsëri, të gjejmë e shpëtojmë shokun. Por ...paskej qenë ditë e mallkuar: një ortek i dytë, një masiv i tmerrshëm dëbore, prej mijëra metra kub, filloi të lëvizte me furi drejt studentëve dhe oficerëve si për t'u hakmarrë për mposhtjen e ortekut të parë. Dhe ashtu me ulërimë dhe zhurmë që vinte

nga thyerja e pemëve, dëborë mbuloi gjithçka, siç mori me vete rrëshqanthi këdo që gjeti aty, pa pyetur as për herkuljanin Petja, të cilin pasi e zhvendosi nëpër shkrepë rreth 350m, i mbetën jashtë vetëm gishtat. Po të tjerët ku ishin? Nisi puna nga e para me vrull të paepur. Me shumë mund shokët gjendeshin, por tani të gjakosur, me plagë, pa ndenja dhe o zot! Sa shumë të vdekur. Vladimir Duro tregon: Komandant Dushanin e gjetëm rrëzë një pemë. Nga e çara e thellë e ballit i rridhte gjaku që i kish mbuluar fytyrën. Mendohej të ngrihej në këmbë. I vura kokën në gjoks dhe i thirra i mallëngjyer: “Komandant Dushani! Komandant Dushani!” Më rrodhën lot për komandantin tonë aq të dashur, me të cilin një natë më parë, gati gjithë reparti ynë kishim qeshur aq shumë deri natën vonë, si nuk shkriu në atë çast dëborë që kisha nën këmbë”. Në krah të tij Nikollaqi, pranë e pranë, thujse i kish zënë gjumi, pas një lodhje të gjatë. S’të besohej se s’do të ngriheshin kurrë më. Pak më tej të mbajtur për dorë qenë shtrirë djali nga Seferaj, trimi Nexhip Çopa dhe shoku i tij Pëllumb Rrapo që i plagosur nga orteku i parë, po transportohej drejt qytezës ushtarake. Mes atyre që e mbanin në sup, mes atyre që shpejtonin të shpëtonin shokun që dhe Nexhipi. Por orteku që pasoi nuk i kurseu të dy. Siç nuk kish kursyer dhe të mrekullueshmin Çlirim Pulaj, zëri i të cilit ende dukej se jehonte nga njëri shpat në tjetrin: “Forca shokë, kërkon me guxim”. Kish mbyllur sytë përgjithmonë skënderbegasi simpatik, që pata takuar dikur në stacionin e trenit, i cili edhe pse i vogël në moshë, arriti të më bindë me pjekurinë e durimin e një të rrituri që t’i hyja karrierës ushtarake, pasi ajo, kur punoje me nder, të bënte të respektuar sikur të ishe gjallë, ashtu edhe pas vdekjes. Xha Halil, si nuk t’u çua zemra, ty që t’u vranë shokët ndër duar gjatë luftës, kur dëgjove mandatën. Sa duron njeriu i shkretë, sa e fortë qenka zemra e prindërit. Ç’bëre moj dëborë e mallkuar kështu! Si nuk t’u dhimbs shoku besnik Bujar Ago, si nuk të erdhi keq për Ilirin e sinqertë, për Qemal Likën e urtë, që pak para se të vdiste u ndau shokëve karamelet që kishte në xhep, sikur po martohej dhe jo po shkonte për të mos u kthyer kurrë më, për Pëllumbin që shkruante vjersha plot ndjenjë e që ndofta atë ditë do të shkruante edhe për dëborën që i doli tradhtare dhe e pabesë, si e preve moj dëborë në mes këngën e Besnik Shehut, jetën e Bilbil Pashait që e donte aq shumë dhe të Alekos që e donin aq shumë... Në këtë përleshje të pabarabartë, më çmenduritë e natyrës, ku morën pjesë 203 vetë, shumica e të cilëve që farkëtuat në shkollën “Skënderbej”, bilanci përfundimtar që tepër tragjik. E parë me syrin e një ushtaraku me përvojë, është e kuptueshme se po të mungonte shpirti i pamposhtur luftarak dëmi do të që i pallogaritshëm. ..Këtu ngjet si në luftë, ku gjen zbatim sentenca e famshme se “Në tërheqje me panik, vdesin më tepër ushtarë se në betejë”. Nga ana tjetër, ndofta pikërisht për shkak të kësaj beteje, ne jemi mbledhur për t’i kujtuar me veneracion vëllezërit tanë dëshmorë, duke evokuar me këtë rast maksimën e Ovidit se “Kush do ta njihje Hektorin po të mos ndodhte fatkeqësia e Trojës?”

Viktimat e tragjedisë së Fekenit:

-Komandant Dushan Shametaj
-Shef i Planëzimit, Çlirim Pulaj
-Pedagog Nikollaq Bero
-Student Bilbil Pashaj
-Student Aleko Gjoni
-Student Qemal Lika
-Student Besnik Shehu
-Student Pellumb Rrapo
-Student Ilir Gramatiko
-Student Nexhip Copa
-Student Bujar Ago

BALLADA E TË NJËMBËDHJETËVE

(Kujtimet të dëshmorëve skënderbegas që u vranë nga orteku)

Agim Bajrami

*Klith` një er` e ftohtë
 Në rrëz` të Meçekut
 Sikur do t'i zgjojë
 Shokët posht` ortekut.*

*Netëve të gjata
 Nën një hën` që qan
 Njëmbëdhjet` balada
 Shtrirë pran` e pran`.*

*Njëmbëdhjet` ballada
 Gatuar me djej
 Me zjarre nga vatra
 Shkolla “Skënderbej”.*

*Ku u nisët bij
 Atë dit` mortore
 Qiellit ngjyrë gri
 Me sy prej dëbore.*

*Flokshprishur nga era
 Pabesi e shtegut
 Me këmb` mbi humnera
 Dhe grack` e ortekut.*

*Nën vështrim të malit
 Mbështjellë prej murlanit
 Se nuk din` të ndalen
 Bijt` e partizanit.*

*Ballet mbushur yje
 Poezi rinie
 Dimri nëpër pyje
 Shfryn mllef xhelozie.*

Shfryn mllef xhelozie
Ndaj dhe ngrihka leqe
Ah ju bij lirie
Ç'ju zu or` e keqe.

Në mal të Meçekut
Ç`tmerr ju panë sytë
Nën klithm` të ortekut
Sulmuan stuhitë.

Sulmuan stuhitë
Me kthetra mizore
Feken si s`t`u dhimbis
Nikua që na more.

Kur rrëmbeve Limon
Si se pyete zemrën
Mbi gjoks bashk` me yllin
Kish një vjersh` për nënën.

Po Qemalin bir
Me vështrim si dele
Sa kish ndar` për shokët
Një grusht kamele.

Kamele morti
Të verdha si ftua
Në mosh` të mëngjesit
I dhe vdekjen grua.

Krisma ngre kushtrimin
Gjaku skuq mbi tokë
Dyqind kryetrima
Për njëmbëdhjetë shokë.

Jeta s'fidon vdekjen
Me sy dashurie
Sa zbulojn` Alekon
Një shok` tjetër bie.

Na iku Bujari
Me shpirt prej poeti
Në sup të Bilbilit
Çast` i mbram` e gjeti.

Komandant Dushani
Lis me tre kurora
Nuk i dilka xhani
Pa zënë bijt` nga dora.

Si t`i mbroj nga vdekja
Nga bora me gurë
E çfarë bën` më tepër
Vëllezërit Dioskurë?

Nën këng` elegjie
Prehet monopati
Trimi Nexhip Çopa
Që u ngrit prej shtratit.

S`mund të rrinte brënda
E si mund të rrinte?
Kur vdekja tinzare
Shokët radhë i shrinte.

Ilir Gramatiko
Pëllumbi, Besniku
Vdekjen vun` përpara
Pa dridhje qerpiku.

Mben` të gjith` atje
Me vështrim nga prita
T`i tregojn` mëngjesit
Shtigjet nga vjen drita.

Në mal të Meçekut
Në buz` të humnerës
Njëmbëdhjetë ballada
Frymojn` prej pranverës.

Për martirët e Fekenit...

Myslim Pashaj

Ne ishim dje atje tek rrënjët e Shkollës Skënderbej. Përvjetori i shtatëdhjetë. Hodha sytë rrotull. Thirra. Vrojtova. Nuk po i dalloja sytë e tyre, sytë e Bilbilit dhe Çlirim. Njëri: vëlla dhe tjetri shok i bankës, i hartës e i koordinatës. Kisha atë çrregullimin tronditës që ta jep koha dhe hapësira, në bashkësinë rrotull, në raste të tilla. Pastaj ata u dukën dikund, mbi perden e rëndë të harresës, në të njëjtën kinema, ku dikur shfaqeshin filma të revolucionit, me të cilët ishin rritur të dy. Ngjanin të mërzitur dhe gati të mos më flisnin. I ranë tërthor sallës, dhe nuk po njihnin moshën, që ishte thinjur, ndërkaq ata vinin nga një kohë tjetër, e ata nuk kishin dashur kurrë të thinjeshin e të plakeshin, ata donin të mbeteshin të rinj, ashtu duke u ngjitur. Pastaj erdhën dhe u mbështeten në murin anësor, sepse nuk kish vende se ku të uleshin, Çlirimi në krahë të Kiço Mustaqit dhe Bilbili në krahun tim. Ne filluam të flisnim fjalë të thyera, se befasia na kapi në çast. Mirëpo të dy, si në të njëjtën gojë bënë shenjë të mos ndiheshim, sepse ata e kishin ndjekur jo vetëm Ortekun që i mori por edhe ortekun që përfshiu një shoqëri të tërë që vijon ende të jetë e çoroditur. Po dëgjonin edhe ca fjalime nga këta të mbeturit e sotëm. Askush rrotull nuk po i njihje. Shpirti është gjithnjë i ri, edhe pse i vjen edhe atij fundi. Po ama është i ri. Skënderbegasit e kishin lënë shpirtin e tyre diku në përfytyrime ëndrrash. “Më mirë që ikëm të rinj”, thanë. Pastaj u përthithën nga fryma dhe ne e kuptuam se ata kishin një pjesë nga fryma që bartim ne skënderbegasit, e gjallë. Dikush ma solli lajmin se në çdo përvjetor Vladimir Pulaj, i vëllai i Çlirim në krahë të një saksie me lule del për të pirë një kafe me Çlirim. “Po ti, ku po shkon?”, - më tha Kiço Mustaqi, komandanti ynë i togës. “Po shkoj në vendlindjen e Bilbilit, atje ku është një gur të cilin ia thonë emrin “Guri i Ullirit të Burimit”

POEZI PËR ÇLIRIM PULAJN

Ja, nga dritarja që u hap, Del Skënderbegasi përbri. Çlirimi iku, erdhi prapë, Po aq i bukur dhe i ri.	Çlirim i Pulajve, kujtesa, E ka një strehë që rri mbështjellë. Ajo që ne s'e themi dot, Më mirë në ortek të ishim matur,
Në këtë fragment` që sjell orteku Apo dëbora dhe acari, Çlirim i Pulajve, tek shtegu, Prapë skënderbegas, si i pari.	Se sa të grindet, jetë e mot, Nga ankthi që godet i çartur. Po gjersa diellin ti e deshe, Bashkë me Bilbilin, tim vëlla,
Në sup, i rëndë, një mal i ngritur, Çlirim, sa gjëra që kanë rrjedhur! Më mirë që ike pa e ditur, Se do të rrudheshe patjetër.	S`menduat kurrë se iku shpresa, Se ikin ëndrrat e mëdha. Ne bashkë e bëmë dikur një hartë, Diku mbi malin e Ivanit,
Tani ti vjen, në festa, mbresa, Se vet je mbresa më e thellë.	Aty ti rron si koordinatë, Që nuk ndryshon përmes tufanit.



‘Bac u kry’, Kosova e lirë nën hisen e diellit të vet

Masakra e Prekazit ishte një sulm i kryer nga Policia e Serbisë dhe nga Njësia Speciale Serbe, më 5–7 mars 1998, për të kapur luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët janë konsideruar si “terroristë” nga Serbia.

Gjatë sulmit, komandanti i UÇK-së, Adem Jashari dhe vëllai i tij Hamëz Jashari u vranë së bashku me afro 58 anëtarë të tjerë të familjes. Sulmi u kritikua nga Amnesty International, e cila shkruante në raportin e saj se: “të gjitha provat sugjerojnë se sulmi nuk kishte për qëllim kapjen e shqiptarëve të armatosur, por eliminimin e të dyshuarve dhe familjeve të tyre”. Serbia, nga ana tjetër, pretendoi se bastisja ishte për shkak të sulmeve të UÇK-së në postet e policisë. Adem dhe Hamëz Jashari ishin anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), organizatë guerile e shqiptarëve etnikë që kërkonin pavarësinë e Kosovës nga Jugosllavia.

Adem Jashari ishte përgjegjës për organizimin e formacionit

të parë të armatosur politik në Skënderaj, në vitin 1991. Duke ndjekur Adem Jasharin për vrasjen e një polici serb, forcat serbe u përpoqën përsëri të sulmonin kompleksin e Jasharëve në Prekaz, më 22 janar 1998.

Më 28 shkurt 1998, shpërtheu një përleshje zjarri midis luftëtarëve shqiptarë dhe një patrulle të policisë serbe në fshatin e vogël Likoshan. Katër policë serbë u vranë dhe disa u plagosën. Luftëtarët e UÇK-së, njëri prej të cilëve edhe Adem Jashari, kanë shpëtuar. Më pas, policia serbe vrau 13 civilë shqiptarë në një shtëpi aty pranë. Më vonë, po atë ditë, policët serbë sulmuan fshatin fqinj Qirezin dhe më pas vranë 26 shqiptarë. Mirëpo, luftëtarët shqiptarë arritën të arratiseshin dhe policia vendosi ta sulmonte Adem Jasharin dhe familjen e tij. Në luginën e Drenicës, Adem Jashari vendosi të qëndrojë në shtëpinë e tij dhe i porosit luftëtarët e tij që të qëndrojnë atje dhe të rezistonin deri në frymën e fundit.



ishite kontaktuar nga policia që t'i mblidhnin trupat, por kur këshilli kërkoi dokumentacion për të ndjerin asnjë nuk u bë publik. Sipas këshillit, policia i kishte zhvendosur kufomat në një morg të Prishtinës, para se t'i kthente në zonën e Drenicës.

Më 9 mars, policia paralajmëroi se nëse trupat nuk janë varrosur nga familja do të varrosen nga autoritetet, përdërisa familjet kanë kërkuar që të bëheshin autopsitë.

Më 10 mars, policia mori një buldozer dhe hapi një varr masiv afër Prekazit dhe varrosi trupat, 10 prej të cilëve ishin ende të paidentifikuar në atë kohë. Familjet kishin shpresuar se mund të kryheshin autopsitë, por një grupi mjekësh nga Prishtina, familjeve të të vdekurve, përfaqësuesve të Kishës Katolike, komunitetit mysliman dhe organizatave ndërkombëtare për

Më 5 mars 1998, UÇK-ja ka nisur një sulm në petrolin e policisë në Prekazin e Ulët, pas sulmit të dytë, policia u përgatit për përgjigjen brutale ndaj familjes Jashari. Ata filluan të gjuanin ushtarët lokalë të UÇK-së, të cilët u detyruan të tërhiqen në kompleksin e Jasharit në të njëjtin fshat.

Policët jugosllavë rrethuan grupin dhe i ftuan ata që të dorëzoheshin, duke u bërë thirrje të gjithë personave të tjerë për të pastruar lokalet. Policia më tej pohoi se ata u dhanë dy orë për t'u pajtuar. Sipas policisë, pas skadimit të afatit prej dy orësh, Adem Jashari, vëllai i tij dhe pjesa më e madhe e anëtarëve të familjes së tij, refuzoi të pajtohet dhe të mbetet brenda kompleksit. Pas një qëndrimi verbal të tensionuar, sipas deklaratave zyrtare serbe, grupi i Jasharit u përgjigj duke gjuajtur policinë me armë automatike, mortaja, granata dore dhe snajper, duke vrarë 2 dhe plagosur 3 policë.

Në dhunën pasuese, policia jugosllave vrau më shumë se 60 vetë, duke përfshirë edhe vëllezërit Jashari. E vetmja që mbijetoi ishte Besarta Jashari, vajza e Hamëz Jasharit.

Ajo pretendonte se policët e kishin kërcënuar me thikë dhe e urdhëruan të thoshte se xhaxhai i saj (Adem Jashari) kishte vrarë të gjithë ata që donin të dorëzoheshin. Goran Radosavljeviç, një nga drejtuesit e Ministrisë së Brendshme të Serbisë, deklaroi se: "Adem Jashari i kishte përdorur gratë, fëmijët dhe të moshuarit si pengje...".

Dëshmitë e mblidhura më vonë treguan se sulmi nuk kishte për qëllim të kapte ushtarët e armatosur shqiptarë; përkundrazi, sulmi ishte për t'i eliminuar ata dhe familjet e tyre. Shtëpitë e tjera të anëtarëve të familjes Jashari u sulmuan gjithashtu nga policia si dhe kompleksi rezidencial i familjes Lushtaku. Si përgjigje, këshilli i sigurimit i OKB-së u kthye në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara pa autorizuar masën përfundimtare të kapitullit që ishte ndërhyrja ushtarake.

Këshilli lokal për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut,

të drejtat e njeriut iu mohua qasja në zonë. Krerët e policisë serbe akuzuan organizatat se në të kaluarën kishin kontrabanduar armë në rajon. Më 11 mars, trupat u rivarrosën sipas traditës islame. Thuhet se 42 individë, shqiptarë, u identifikuan të kenë vdekur në Prekazin e Ulët gjatë operacionit, 6 shqiptarë vdiqën në fshatin aty pranë, Llaushë, në rrethana të paqarta. Të shtënat në kompleksin e familjes Jashari, ku përfshihej Adem Jashari, komandant i UÇK-së dhe përreth trupat jugosllave në vitin 1998 rezultoi në masakrën e shumicës së anëtarëve të familjes Jashari. Vdekja e Jasharit dhe familjes së tij shkaktoi një reagim ndërkombëtar kundër Republikës Federale të Jugosllavisë. Sulmi i Prekazit çoi në një rritje të shpejtë të popullaritetit të UÇK-së në mesin e shqiptarëve etnikë dhe milicët e fshatrave u formuan në shumë pjesë të Kosovës. Ndërsa lajmet për vrasjet u përhapën, milicët e armatosura shqiptare të Kosovës u shfaqën në mbarë Kosovën, duke kërkuar të hakmerreshin për vdekjen e Jasharit, ndërsa shqiptarët dyndeshin për t'iu bashkuar UÇK-së. Ngjarja u bë një thirrje tubuese për rekrutimin e UÇK-së në lidhje me rezistencën e armatosur ndaj forcave jugosllave.

Pas ngjarjes, vetë Adem Jashari u portretizua si "terrorist" në mediat jugosllave, ndërsa mediat shqiptare e përshkruanin si "luftëtar lirë". Viktimat e sulmit do të cilësoheshin si rënia e "dëshmorëve" në mediat shqiptare, ndërsa në mediat serbe raportoheshin si "efekte kolaterale të luftës kundër terrorizmit".

Më 13 mars, rreth 50 000 njerëz bënë demonstrata kundër sulmeve, ndërsa më 15 mars, Kisha Katolike bëri thirrje që të mbahen mesha në të gjithë rajonin, pas së cilës rreth 15 000 njerëz demonstruan në Prishtinë.

Në fund të marsit 1998, më shumë se 100 000 njerëz marshuan në 8 qytete amerikane dhe kryeqytetet evropiane për të protestuar kundër sulmit. ngjarjet dolën jashtë kontrollit dhe kjo solli Luftën për liri në Kosovën martire.



25 vjet nga 24 marsi 1999

Pasditen e 24 marsit 1999, presidenti i 42-të i SHBA-ve, Bill Clinton, në momentin e fillimit të fushatës së sulmeve ajrore iu drejtua nga Shtëpia e Bardhë, kombit amerikan lidhur me këtë ngjarje.

Në fjalën e tij, atëkohë, Bill Clinton tha:

“Bashkëkombas të mi! Në këtë moment trupat serbe po lëvizin nga një fshat tek tjetri, po bombardojnë vendbanimet civile dhe po djegin shtëpitë. Ne po shohim njerëz të pafajshëm, të përzënë me forcë nga shtëpitë e tyre, njerëz që me forcë janë vendosur para togave të pushkatimit dhe gjuajtur me plumba. Burrat janë ndarë nga familjet e tyre, prindërit dhe fëmijët bashkë, të vënë në rresht, janë gjuajtur me një herë me armë zjarri.

Kjo që po ndodh në Kosovë, nuk ka asgjë të ngjashme me luftën dhe me ligjet tradicionale të luftës; kjo është një luftë e padrejtë e kryer me të gjitha arsenalet ushtarake ndaj njerëzve të pafajshëm që nuk mund të mbrohen dhe kur ata dhe udhëheqësit duan vetëm paqe. Pra, bashkëkombas, të luftojmë që ta mbyllim këtë tragjedi, e cila për kombin tonë është një kërkesë morale. Misioni ynë është më se i qartë: të tregojmë se ne dhe NATO e kemi seriozisht, që t'u lëmë të kuptojnë atyre që kontrollojnë në Serbi sot (24 mars 1999) se është e domosdoshme të ndërrojnë rrugën, të ndalojnë këtë lloj ofensive të ndërmarrë, duke derdhur gjak kundër qytetarëve të Kosovës, ta ndalojmë atë me të gjitha format që duhet ndaluar, duke e dëmtuar seriozisht ushtrinë serbe që është

kundër njerëzve të pafajshëm në Kosovë. Dhe nëse presidenti Milosheviç nuk i bindet paqes atëherë na takon ne, që duke përdorur forcën ushtarake, ta ndalim atë dhe atij t'i shpallim luftën. Në anën tjetër, Serbia dhe personalisht Milosheviçi nuk i kanë pranuar bisedimet për zgjidhjen paqësore e politike të çështjes së Kosovës. Milosheviçi, përveç sundimit ndaj shqiptarëve me një sistem të paparë, filloi edhe ofensivat dhe krimet e veta masive kundër popullit shqiptar: me vrasje dhe masakra masive, djegie, dëbim masiv të shqiptarëve nga Kosova dhe me spastrimin etnik të Kosovës...

Bashkëkombas! Unë jam i bindur se rreziku për të hapur luftë dhe bërë diçka nga SHBA-të, nuk është aq i madh sa ç' është rreziku të rrimë duarkryq dhe të mos bëjmë asgjë, që të nxjerrim nga ky rrezik njerëzit që nuk mund të mbrohen. Sikur, ne sot, së bashku me aleatët tanë, ta lëmë që kjo luftë e padrejtë të vazhdojë, atëherë, presidenti Milosheviç, do të inkurajohet nga hezitimi ynë duke e quajtur luftën e tij, si një drejtësi duke vrarë njerëzit në Kosovë.

Kështu që atij ne i lëmë dorë të lirë për të bërë më shumë masakra, dhe më shumë shpërngulje me forcë të qindra mijëra refugjatëve, të cilët presin vetëm mbrojtjen tonë. Tani, bindja jonë e fortë për gjithçka që po ndodh në Kosovë, është e vetmja shpresë e popullit të Kosovës. Populli i saj, megjithëse në Kosovë kanë vendin e tyre, nuk mund të jetojnë atje, prandaj na duhet ne të sigurojmë jetën e

tyre dhe ata të mos kenë më frikë për jetën.

Në anën tjetër, Serbia dhe personalisht Milosheviçi nuk i kanë pranuar bisedimet për zgjidhjen paqësore e politike të çështjes së Kosovës. Milosheviçi, përveç sundimit ndaj shqiptarëve me një sistem të paparë, filloi edhe ofensivat dhe krimet e veta masive kundër popullit shqiptar, me vrasje dhe masakra masive, djegie, dëbim masiv të shqiptarëve nga Kosova dhe me spastrimin etnik të Kosovës...

23 mars, 1999

Një ditë para bombardimeve mbi Serbi, dhe caqet ushtarake në Kosovë, liderët shqiptarët nga Kosova, përfshi këtu edhe Thaçin, e pranuan marrëveshjen në parim, u kthyen në shtëpi për t'ua treguar atë njerëzve të tyre dhe në mes të marsit udhëtuan për në Paris për të firmosur dokumentin e përfunduar. Serbët e bojkotuan ceremoninë, ndërkohë që 40 mijë trupa serbe ishin grumbulluar përreth Kosovës, dhe Millosheviçi përsëriti se ai nuk do të lejonte kurrë vendosjen e trupave të huaja në tokën jugosllave.

Unë e dërgova Dik Hollbruk-un (Richard - "Dick" Holbrooke) për ta takuar atë për herë të fundit, por edhe Dik-u nuk mundi ta lëvizte nga vendi. Më 23 mars, pasi Hollbruk-u largohet nga Beogradi, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, me mbështetjen time të plotë, i kërkoi Gjeneralit Uesli Klark të fillonte sulmet ajrore. Në të njëjtën ditë, me shumicë votash 58- 41 Senati votoi për të mbështetur këtë veprim. Në fillim të muajit Dhoma e Përfaqësuesve kishte votuar 219 me 191 për të mbështetur dërgimin e trupave amerikane në Kosovë në rast se nënshkruhej marrëveshja e paqes. Mes Republikanëve të njohur që votuan në favor të këtij propozimi ishin edhe Dennis Hastert dhe Henri Hajd (shënim i im Henry Hyde, një mik i madh lobit shqiptarë, pikërisht ish-kongresist republikan të New Yorkut, Xhozef DioGuardit).

Ndërsa shumica e Kongresit dhe të gjithë aleatët tanë në NATO mbështesnin sulmet ajrore, Rusia nuk ishte në të njëjtën linjë. Kryeministri Yevgeni Primakov ishte duke udhëtuar drejt Shteteve të Bashkuara për t'u takuar me Al Gore. Kur Al e njoftoi se një sulm mbi Jugosllavinë ishte i mundshëm, Primakov urdhëroi që aeroplani i tij të kthehej mbrapsht drejt Moskës.

Më datën 24 (mars 1999) unë iu drejtova popullit amerikan për t'i treguar se çfarë isha duke bërë dhe arsytet pse po ndërmerrija një akt të tillë.

U shpjegova atyre se Millosheviçi u kishte zhvatur shqiptarëve nga Kosova autonominë, duke u mohuar të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë për të folur gjuhën e tyre, për të pasur shkollat e tyre dhe për t'u vetëqeverisur. Unë iu përshkrova atyre masakrat serbe: vrasjen e civilëve, djegien e fshatrave, dëbimin e njerëzve nga shtëpitë e tyre, 60 mijë vetëm në pesë javët e fundit dhe gjithsej një çerek milioni.

Më në fund unë kisha mundësi t'i vendosja ngjarjet aktuale në kontekstin e luftërave që Millosheviçi kishte shpallur kundër Bosnjës dhe Kroacisë dhe në ndikimin shkatërrues të vrasjeve të tij mbi të ardhmen e Europës.

Fushata e bombardimeve kishte tre qëllime: t'i tregonte Millosheviçit se ne e kishim seriozisht se do të ndalonim një radhë

tjetër të spastrimit etnik, se do të shmangnim një sulm akoma më të përgjakshëm kundër civilëve të pafajshëm në Kosovë dhe se nëse Millosheviçi nuk do të dorëzohej së shpejti ne do të dëmtonim seriozisht kapacitetin ushtarak të Serbisë.

24 mars 1999, filluan sulmet ajrore

Ato do të zgjasnin për 11 javë, ndërkohë që Millosheviçi vazhdonte të vriste shqiptarët e Kosovës dhe të dëbonte rreth një milion shqiptarë prej shtëpive të tyre. Bombat do të shkaktonin dëme të



mëdha mbi infrastrukturën ushtarake dhe ekonomike të Serbisë. Fatkeqësisht në disa raste ato do t'u shmangeshin koordinatave të përcaktuara dhe do të merrnin jetën e njerëzve që ne po përpiqeshim të mbronim.

Disa njerëz arsyetonin se qëndrimi ynë do të kishte qenë më i justifikuar nëse do të kishim dërguar edhe trupa ushtarake nga toka. Por me këtë argument kishte dy probleme. Së pari, derisa ushtarët të arrinin në pozicionet e tyre, të mjaftueshëm në numër dhe me mbështetjen e duhur, serbët do të shkaktonin një dëm shumë të madh. Së dyti, viktimat civile të një fushate ushtarake në tokë do të kishin qenë shumë herë më të mëdha sesa numri i viktimave si rezultat i bombave të pasakta.

Unë nuk u bashkova dot me argumentin se duhej të ndiqja një kurs, i cili do të merrte më shumë jetë amerikanësh, pa siguruar shumë bindshëm mundësinë e një fitoreje. Strategjia jonë shpesh do të dyshohej, por ajo kurrë nuk u braktis.

Më 24 mars 1999, NATO filloi bombardimin e trupave ushtarake dhe paramilitare të Serbisë. Bombardimet përfunduan, më 6 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës, që parashihte tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova dhe vendosjen e trupave paqësore ndërkombëtare.

Më pas, Këshilli i Sigurimit i OKB-ës miratoi rezolutën 1244 me të cilën u vendos protektorati, prania ndërkombëtare në Kosovë, UNMIK-ut si mision civil dhe KFOR-it, mision ushtarak.

Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë, e cila është e njohur deri tani nga 120 shtete përfshirë SHBA-të, Anglinë, Gjermaninë, Francën, Italinë, Holandën, Suedinë, Japoninë, etj.

INTERNATIONAL MOTHER LANGUAGE DAY



Gjuha Amtare, identifikim, vlerë, histori kombëtare

Një element bazë për shmangien e gabimeve drejtshkrimore është ngritja e ndërgjegjes dhe kulturës gjuhësore të secilit prej nesh, duhet të gjithë të mundohemi të shkruajmë pa gabime dhe shtrembërime, të cilat po e tjetërsojnë gjuhën gati të pakuptueshme ose me disa kuptime, pse jo dhe gjuhë konvencionale.

Çdo individ e ka për detyrë të bëjë çmos për mbrojtjen dhe zbatimin e drejtë të normave dhe rregullave gjuhësore.

Një kulturë paqeje mund të ndërtohet vetëm në një hapësirë, ku secili ka të drejtë të përdorë plotësisht dhe lirisht gjuhën e tij amtare në të gjitha rrethanat e ndryshme të jetës. Kjo ditë është një mundësi për të promovuar diversitetin gjuhësor dhe kulturor dhe për të punuar për të ruajtur këto dallime në kultura dhe gjuhë që promovojnë tolerancën dhe respektin për të tjerët.

Më 21 shkurt 2022, UNESCO shënon Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare të 23-të për të promovuar diversitetin gjuhësor global dhe edukimin shumëgjuhësh.

Diversiteti gjuhësor është çelës për ndërtimin dhe ruajtjen e

shoqërive integruese, të hapura, të larmishme dhe pjesëmarrëse. Gjuhët përcjellin informacion dhe njohuri, duke promovuar në këtë mënyrë prosperitetin, ndryshimin shoqëror dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Shoqëritë shumëgjuhëshe dhe multikulturore ekzistojnë nëpërmjet gjuhëve të tyre, të cilat transmetojnë dhe ruajnë njohuritë dhe kulturat tradicionale në mënyrë të qëndrueshme.

Njohja dhe respektimi i diversitetit gjuhësor dhe kulturor janë thelbësore për bashkëjetesën paqësore.

Termi gjuhë amtare zakonisht i referohet gjuhës së parë të mësuar, atë që flasim që në vegjëli. “Gjuha amtare është një gjuhë e mësuar nga folësi në fëmijërinë e hershme pa udhëzim zyrtar. Sipas Kluge-së, fjala ndoshta është krijuar sipas modelit të latinishtes *lingua materna* (fjalë për fjalë: “gjuha nga ana e nënës”). Gabime drejtshkrimore gjenden edhe në tekstet shkollore, si dhe në shumë dokumente të tjera, të cilat bëhen publike nga organizatat dhe mekanizmat tjerë në vendin tonë.



Gjuha shqipe ka përparuar shumë këta njëqind vjet edhe për sa i përket shkallës së përpunimit të saj. Nga gjuhë me disa variante letrare e dy gjuhë zyrtare (toskërishtja në Shqipëri, gegërishtja në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), prej vitit 1972 ajo është ngritur në shkallën e gjuhës letrare kombëtare, të pranuar nga të gjitha pjesët e kombit. Ishte Konsulta e Prishtinës e prillit 1968 ajo që hodhi hapin e madh të bashkimit gjuhësor, kur intelektualët shqiptarë të atjeshëm, të udhëhequr nga motoja “një komb – një gjuhë letrare”, shpallën se shqiptarët në Jugosllavi pranonin “si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit ëmë”.

Kongresi i Drejtshkrimit e sanksionoi këtë vendim, duke shënuar në këtë mënyrë fundin e periudhës kur shqipja shkruhej në disa variante dhe fillimin e jetës kombëtare të shqipes letrare. Periudha nga Kongresi i Drejtshkrimit e deri më 1990 vlerësohet nga të gjithë si periudha e përpjekjeve për zotërimin dhe përdorimin e normave të gjuhës letrare në të gjithë veprimtarinë ligjëruese të shkruar e të folur. Në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë Konsullata u vuri detyrë shkollës enteve botuese, redaksive e gazetave dhe administratës zbatimin e normën letrare, kurse në Shqipëri, zbatimi i normave të gjuhës letrare nga shkolla, entet botuese dhe administrata shtetërore u bë i detyrueshëm me një vendim të vitit 1978 të Këshillit të Ministrave.

Pas viteve '90, me përmbysjen e sistemit politik dhe kalimin në pluralizëm, u vu re një rënie e theksuar e kujdesit për gjuhën nga të gjithë, nga shteti e shoqëria, që u pasua edhe me kontestime të gjuhës letrare e me përpjekje për krijimin e gjuhëve të reja letrare. Si pasojë e mungesës së kujdesit shtetëror për gjuhën, në botimet, në gazetatat e revistat, në televizionet dhe në dokumentacionin zyrtar vërehen shkelje të pafalshme të normave të gjuhës letrare. Më e dukshme kjo dukuri e shëmtuar është në fushën e fjalorit, ku vërehet një vërshim i fjalëve të huaja të panevojshme, të cilat po e drunjëzojnë dhe po e venitin gjuhën, duke u zënë vendin dhjetëra

fjalëve të bukura shqipe që përdoren në kontekste të ndryshme sintaksore, edhe në fushën e drejtshkrimit mospërdorimi i shkronjave ë dhe ç është tregues i injorancës kompjuterike, po edhe mungesë e respektit për alfabetin tonë, për shkronjat e të cilit është derdhur gjak. Në televizione po sundojnë modele aksentologjike të huaja. Ky model i huaj theksimi ka prishur edhe melodinë dhe metrikën e frazës.

Mjaft lëshime hasim në përdorimin e gjuhës shqipe që s'janë vetëm mungesë dijesh gramatikore, por mospërfillje dhe pavetëdije për krimin që i bëhet gjuhës. Jemi dëshmitarë të shkëlqes së rregullave gjuhësore pothuajse në të gjitha llojet e komunikimit, përfshirë edhe librat që i botojmë, dhe më skandalozja e më e dhimbshmjja, tekstet shkollore që i hartojmë. Gabimet e shumta gjuhësore, janë të pranishme thuajse në të gjitha lëndët, në të gjitha tekstet shkollore, duke filluar nga librat e gjuhës shqipe edhe tek të gjithë librat tjerë.

Shërbimi, gjuhës amtare duhet t'i bëhet nga secili prej nesh dhe deri te institucionet shtetërore dhe tek ato private, të cilat e kanë edhe obligim kushtetues. Në shumë vende të botës gjuha amtare mbrohet me ligj.

Një element bazë për shmangien e gabimeve drejtshkrimore është ngritja e ndërgjegjes dhe kulturës gjuhësore të secilit prej nesh, duhet të gjithë të mundohemi të shkruajmë pa gabime. Çdo individ e ka për detyrë të bëjë çmos për mbrojtjen dhe zbatimin e drejtë të normave dhe rregullave gjuhësore.

Nga ana tjetër kur gjuhët shuhen, diversiteti kulturor, i cili përbën pasurinë e njerëzimit, gjithashtu zbehet.

Më shumë se 43% e rreth 6700 gjuhëve të folura në botë kërcënohen me zhdukje. Kjo do të thotë se çdo dy javë, një gjuhë zhduket përgjithmonë, duke marrë me vete një trashëgimi të tërë kulturore dhe intelektuale. Çdo gjuhë dhe dialekt që ekziston në botë u lejon atyre që i flasin të përcaktojnë veten si një komunitet, me një sërë referencash kulturore, një histori dhe shpesh vlera të përbashkëta.

WINSTON CHURCHILL: Unë nuk kam asgjë tjetër për të ofruar, veç mund, djersë, gjak e lot

Fjalime të mbajtura gjatë Luftës së Dytë Botërore e pas saj, 1940-1946

Nga të gjitha figurat politike britanike të shekullit të XX, Winston Churchill spikati si oratori më i shquar. Në njëfarë mase, jehona e fjalimeve të tij të Luftës së Dytë Botërore është një pasqyrim i kohëve të turbullta në të cilën ato u mbajtën. Por përveç kësaj, historia u ka dhënë atyre fjalimeve një rol qendror në qëndresën e përpjekjeve të luftës së Britanisë, në mënyrë të veçantë gjatë viteve 1940-1941, kur një vend relativisht i cenueshëm i bëri ballë i vetëm makinës së fuqishme ushtarake gjermane.

Churchill merre shkas nga ngjarjet e luftës, shpesh dëshpëruese në vetvete, dhe i interpretonte ato në mënyrë të atillë, që fatkeqësinë dhe dëshpërimin ta kthente në vetëbesim, në shpërfillje të rrezikut e në vendosmëri të patundur. Duke theksuar, nganjëherë dhe me të tepërt, atë që në lojë, ai e paraqiste luftën e Perandorisë së tij Britanike, si një pjesë të dramës së përbotshme për shpëtimin e qytetërimit. Në gjithë këtë kishte diçka mesianike, tek i ledhatonte dhe i fuqizonte dëgjuesit e tij, duke i bërë të besonin se lufta kundër Gjermanisë naziste ishte një betejë që ia vlente të luftohej dhe një betejë që ata mund ta fitonin.

Në ditët e hershme të karrierës së tij, Churchill ndihej inferior ndaj shumë prej shokëve të vet, ngaqë nuk kishte ndjekur arsimimin universitar. Atij i vinte keq për mungesën e praktikës në të folurit publik, gjë që do ta kishte fituar në debatet universitare.

Ai gjithashtu vuante nga një 'thuthuqje' e lehtë e nga njëfarë belbëzimi. Kjo ishte arsyeja përse atij iu bë zakon t'i përgatiste me shkrim fjalimet, në mënyrë që të shmangte modelet e fjalimeve të përditshme pa letër.

WINSTON CHURCHILL

Lindi më 30 nëntor 1874, në Blenheim Palace, Oxfordshire, Angli. Djali më i madh i lord Randolph Churchill dhe Jennie Jerome (vajza e një manjati amerikan). I arsimuar në Harrow School / Royal, Military Academy, Sandhurst.

Shërbeu në kabinetin e luftës të Camberlenit, në shtator të vitit 1939, si Lord i Parë i Admirialiatit, përpara se ta zëvendësonte atë si kryeministër, dhe korrespondent lufte, duke qenë se me fjalimet e tij, ai krijoi një frymë sfiduese.

I pranishëm në Betejën e Omdurman-it (1897) ndaj rrezikut, ai punoi shumë dhe në luftën kundër Boerëve në një aleancë transatlantike. U zgjodh në Parlament si deputet dhe në maj të vitit 1940, krijoi një qeveri të re koalicioni, si një udhëheqës i shquar i dorës së fortë dhe tepër energjik i kohës së luftës.

Konservator më 1900, kurse më 1904 kaloi me Partinë Liberale

qeverisëse, ku u ngrit në detyrën e Sekretarit të Brendshëm më 1910, dhe më pas u bë Lord i Parë i Admirialiatit, më 1911. Në vitin 1915 ai mori përgjegjësinë për dështimin e fushatës ushtarake kundër turqve në Galipoli (Dardanele) dhe e la politikën për Frontin e Perëndimit, përpara se të kthehej prapë si ministër i rezervave ushtarake (1917). Shërbeu si Sekretar për Luftën dhe Aviacionin (1919-21) e pastaj, duke mbështetur Konservatorët, si ministër i thesarit (1924-29), pa ndonjë sukses.

Pas pothuajse një dekade largimi nga udhëheqja në vitin 1941, kur u rikthye paqja, pasi Partia Laburiste fitoi zgjedhjet më 1945, ai u bë udhëheqës i opozitës. Mbajti shumë fjalime në mbështetje të Kombeve të Bashkuara dhe paralajmëroi Luftën e Ftohtë dhe kërcënimin bërthamor.

Në vitin 1953, u rikthye në krye të qeverisë, mori titullin e kalorësit në vitin 1953, dhe u tërhoq nga jeta politike më 1955. "Anglezi më i madh i gjallë", siç u bë i njohur, u argëtua më pas me punën e muratorit, me pikturimin e peizazheve, me shkrime historike dhe duke pirë sa munda shampanjë.

Ai u vizitua tek terapistët e të folurit, duke i praktikuar gjetet përpara pasqyrës. Nganjëherë atij iu deshën javë të tëra për të realizuar fjalimet me stil të rrallë. Fjalori i tij ishte tepër i gjerë, i mbushur me lojëra fjalësh me aliteracione, plot me figura e metafora të gjalla.

Stili i tij nuk përputhej gjithmonë me gjendjen shpirtërore të kohës. Fjalimet e tij u panë me skepticizëm në Dhomën e Komunave, ku ai u zgjodh për herë të parë më 1900.

Gjatë viteve 1930, apo "viteve të shkreta" të tij, ai s'që veç një deputet i thjeshtë, ai dha mjaft shpesh mesazhe apokaliptike, as politikanët e as vetë publiku s'ua vunë veshin shumë. Por bindja e tij tek Gjermania Naziste - që ajo ishte një ekspansioniste e pangopur, doli se ishte krejtësisht e bazuar. Kur Britania i shpalli luftë Gjermanisë, në shtator të 1939, Çurçilli u thirr të bënte pjesë në qeveri. Më 10 maj 1940, në kohën që forcat gjermane po pushtonin Vendet e Ulëta, besimi te kryeministri Çamberlen kishte marrë fund dhe kishte ardhur koha e Çurçillit. Qe pikërisht Çamberleni ai që ia rekomandoi Çurçillin, mbretit Xhorxh VI, që e ndjeu sikur "e tërë jeta e tij kishte kaluar veç një përgatitje për këtë orë". Më 13 maj, ai i shpjegoi Dhomës së Komunave se çfarë kishte për t'i ofruar vendit të tij.

Atij iu dha misioni për të formuar një qeveri të re. Do të ishte vullneti i qartë i Parlamentit dhe i mbarë kombit që kjo duhet të krijohet me bazën më të gjerë të mundshme dhe të përfshijë të gjitha partitë. Ai tashmë e ka përfunduar pjesën më të rëndësishme të kësaj detyre.



Ftoi 'Dhomën' të vendosë për miratimin e këtyre hapave të ndërmarrë dhe t'i deklarojë besimin e saj qeverisë së re. Dhe ky vendim është që: "Kjo Dhomë e mirëpret formimin e një qeverie përfaqësuese të Vendosmërisë së përbashkët e të patundur të mbarë kombit për të vijuar luftën me Gjermaninë deri në fitoren përfundimtare. "Unë nuk kam asgjë tjetër për të ofruar, veç mund e djersë, gjak e lot", - u shpreh Çurçilli.

Më tej në retorikën e tij ai theksoi se: "Të formosh një administratë me këto përmasa e kaq të ndërlikur, është në vetvete një sipërmarrje serioze. Por ne jemi në fazën paraprake të njëjës prej betejave më të mëdha të historisë. Ne jemi në veprim edhe në shumë vende të tjera, në Norvegji e në Holandë, dhe na duhet të jemi të përgatitur në Mesdhe. Beteja ajrore është duke vijuar dhe na duhet të bëjmë shumë përgatitje këtu në Atdhe.

Në këtë krizë, unë mendoj se mund të më falet nëse sot nuk zgjatëm dhe aq përpara Dhomës dhe shpresoj që secili nga miqtë dhe kolegët, apo kolegët e mi të mëparshëm që janë prekur nga ky rindërtim politik, do të ma lejojnë çdo mungesë ceremonie me të cilën ka qenë e nevojshme të veprohet.

Unë po i them Dhomës, sikurse u kam thënë dhe ministrave që u

bënë pjesë e kësaj qeverie, se nuk kam asgjë tjetër për të ofruar 'veç mund e djersë, gjak e lot'. Ne kemi përpara nesh një provë nga më të rëndat. Ne kemi përpara nesh shumë e shumë muaj lufte dhe vuajtjeje.

Ju do pyesni, po cila është politika jonë? Dhe unë them se ajo është të luftojmë në tokë, në det e në ajër. Luftë me të gjithë fuqinë e me të gjithë forcën që na ka dhënë Zoti dhe të luftojmë kundër një tiranie të përbindshme, që nuk është parë kurrë në katalogun e errët e të dhimbshëm të krimit njerëzor.

Kjo është politika jonë!

Ju do pyesni: Cili është qëllimi ynë? Dhe unë mund t'ju përgjigjem me një fjalë të vetme: është fitorja! Fitore me çdo çmim! Fitore pavarësisht të gjitha tmerreve! Fitore, sado e gjatë dhe e vështirë të jetë ruga, sepse pa fitore nuk ka mbijetesë!

Dhe kjo duhet kuptuar mirë nga të gjithë. Nuk ka mbijetesë të Perandorisë Britanike, nuk ka mbijetesë për gjithçka që Perandoria Britanike ka përfaqësuar, nuk ka mbijetesë as për nxitjen e për shtysën e epokave që e bëjnë njerëzimin të shkojë përpara drejt qëllimit të vet!

Unë e marr përsipër detyrën time me optimizëm dhe shpresë.



Importet e armëve të Evropës pothuajse dyfishohen, Franca kalon Rusinë si eksportuesi i dytë më i madh në botë

Vendet evropiane pothuajse kanë dyfishuar importet e tyre të armëve midis viteve 2014-2018 dhe 2019-2023, duke rritur blerjet e tyre me 94% në periudhën e vëzhguar, sipas një studimi të ri nga Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve të Paqes në Stokholm (SIPRI).

Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje ishte për shkak të transfertave të armëve në Ukrainë, e cila ende po lufton kundër pushtimit rus dhe e cila, midis 2022 dhe 2023, mori 23% të importit të armëve të rajonit në 2019-2023.

Dy vende evropiane - Franca dhe Italia - gjithashtu kanë rritur ndjeshëm eksportet e tyre në të njëjtën periudhë, duke gjetur blerës të gatshëm në Evropë, Azi dhe Lindjen e Mesme.

Ndoshta çuditërisht duke parë situatën aktuale në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës, me konfliktet në Ukrainë dhe Gaza, vëllimi global i transfertave ndërkombëtare të armëve ra paksa me 3.3% midis 2014-2018 dhe 2019-2023.

Nga kush po blen armë Evropa?

Importuesi më i madh në Evropë ishte deri tani Ukraina, e cila përbënte 23% të të gjitha importeve të Evropës midis 2019 dhe

2023. Importuesit e radhës më të mëdhenj ishin Mbretëria e Bashkuar (11% e të gjitha importeve evropiane) dhe Holanda (9.0%).

Një shumicë prej 55% e importeve të armëve nga vendet evropiane midis 2019-2023 erdhi nga SHBA-ja, eksportet e të cilave në Evropë u rritën me 35% krahasuar me periudhën e mëparshme të analizuar, 2014-2018. Armët e tjera kryesore të importuara në Evropë midis 2019 dhe 2023 erdhën nga Azia, Oqeania dhe Lindja e Mesme.

“Shumë faktorë formësojnë vendimet e shteteve evropiane të NATO-s për të importuar nga SHBA-të, duke përfshirë qëllimin e ruajtjes së marrëdhënieve transatlantike së bashku me çështjet më teknike, ushtarake dhe të lidhura me koston”, - shpjegoi në një deklaratë për shtyp drejtori i SIPRI, Dan Smith. “Nëse marrëdhëniet transatlantike ndryshojnë në vitet e ardhshme, politikat e prokurimit të armëve të shteteve evropiane mund të modifikohen gjithashtu”.

Mbështetësit e radhës më të mëdhenj pas SHBA-së ishin Gjermania (6.4%) dhe Franca (4.6%).

Rritja e eksporteve të armëve të Francës

SHBA-ja dhe Franca aktualisht dominojnë eksportet globale të armëve, me Uashingtonin që ka rritur eksportet e tij me 17% midis 2014-2018 dhe 2019-2023 dhe Parisi me 47% në të njëjtën periudhë.

Vetëm SHBA-ja ishte përgjegjëse për 42% të totalit të eksporteve globale të armëve, duke shpërndarë armë në 107 shtete midis 2019 dhe 2023, më shumë se çdo eksportues tjetër i madh. Rritja e eksporteve franceze të armëve, nga ana tjetër, ishte kryesisht për shkak të dërgimit të avionëve luftarakë në Indi, Katar dhe Egjipt.

Për herë të parë, Franca ishte përpara Ruisë në listën e eksportuesve më të mëdhenj të armëve në botë, duke u renditur e dyta ku Rusia renditej e treta. Kjo për shkak se ndërsa eksportet e Francës u rritën, eksportet e Ruisë u përgjysmuan (-53%) në të njëjtën periudhë. Ndërsa Rusia eksportoiti në 31

eksporteve të tyre të armëve në tre vitet e fundit. Në Itali, eksportet e armëve u rritën me 86%, ndërsa në Korenë e Jugut u rritën me 12%.

Kina pati rënie të eksporteve të armëve me 5.3%, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe me 14%, Spanjës me 2.2% dhe Izraelit me 25%.

Kujt po i shet armë Evropa?

Së bashku me SHBA-në, Evropa Perëndimore përbënte 72% të të gjitha eksporteve të armëve në 2019-2023, ndërsa vetëm Evropa ishte përgjegjëse për rreth një të tretën e eksporteve globale të armëve, duke përfshirë vëllime të mëdha që dilnin jashtë rajonit.

Gjithsej pesë vende evropiane, me përjashtim të Ruisë, ishin në mesin e 10 eksportuesve më të mëdhenj në botë, duke përfshirë Francën (vendi 2), Gjermaninë (vendi 5), Italinë (vendi 6), Britaninë e Madhe (vendi 7) dhe Spanjën (vendi 8). Holanda ishte në vendin e 12-të, e ndjekur nga Suedia (13), Polonia (14), Zvicra (17), Ukraina



shtete në vitin 2019, numri ra në vetëm 12 në 2023.

Pjesa më e madhe e eksporteve të armëve të Francës (42%) shkoi në vendet e Azisë dhe Oqeanisë, ndërsa 34% e tjera shkuan në shtetet e Lindjes së Mesme.

Përfituesi më i madh i eksporteve franceze të armëve ishte India, me gati 30% të të gjitha eksporteve. Vendi ishte importuesi kryesor i armëve në botë midis 2019-2023, megjithëse furnizuesi kryesor i tij mbetet Rusia, e cila përbënte 36% të të gjitha importeve të saj.

“Franca po përdor mundësinë e kërkesës së fortë globale për të nxitur industrinë e saj të armëve përmes eksporteve”, - tha Katarina Djokic, një studiuese në SIPRI. “Franca ka qenë veçanërisht e suksesshme në shitjen e avionëve të saj luftarak jashtë Evropës”.

Vende të tjera, duke përfshirë një tjetër evropian, panë rritje të

(18), Norvegjia (19), Belgjika (22) dhe Bjellorusia (23).

Rreth 30% e transfertave ndërkombëtare të armëve shkuan në Lindjen e Mesme në 2019-2023, me tre blerësit kryesorë në rajon që ishin Arabia Saudite, Katar dhe Egjipti. Pjesa më e madhe e importeve të armëve nga shtetet e Lindjes së Mesme u furnizua nga SHBA (52%), e ndjekur nga Franca (12%), Italia (10%) dhe Gjermania (7.1%).

Importuesit më të mëdhenj në 2019-2023 ishin India, Arabia Saudite dhe Katar, e ndjekur nga Ukraina, e cila ka marrë transferime të mëdha armësh nga mbi 30 vende midis 2022 dhe 2023. SHBA-ja dhe Gjermania përbënin përkatësisht 69% dhe 30% të importeve të armëve nga Izraeli, i cili aktualisht po lufton një luftë vdekjeprurëse kundër Hamasit në Gaza, e cila vrau mbi 30 000 njerëz, shumica e të cilëve ishin civilë.

Shkrim nga “Euronews”

Evolucioni i komunikimeve ushtarake

Ndërsa fusha e betejës bëhet më e avancuar teknologjikisht, rritet nevoja për sisteme komunikimi të sigurta, të besueshme dhe të shpejta. Ne eksplorojmë përparimet më të fundit në teknologjitë e komunikimit ushtarak dhe se si ato po transformojnë operacionet e mbrojtjes.

Me përparimet e shpejta teknologjike dhe dixhitalizimin që krijon kërcënime të reja ushtarake, sistemet e komunikimit luajnë një rol thelbësor në luftimin e tyre dhe mbrojtjen e trupave gjatë operacioneve.

Operacionet moderne luftarake kërkojnë sisteme të integruara të komunikimit taktik për të siguruar komunikime të menjëhershme nëpër platforma dhe sisteme të ndryshme për të marrë vendime strategjike në kohë reale në fushën e betejës.

Sistemet e komunikimit ushtarak kanë bërë një rrugë të gjatë që nga ditët e kodit "Morse" dhe flamujve sinjalizues. Zgjidhjet e zgjuara të komunikimit tani u ofrojnë trupave avantazhe të shumta taktike që nuk do të ishin të mundshme me sistemet analoge.

Përpjekja për të zhvilluar zgjidhje të reja të komunikimit ushtarak është e dukshme në rritjen e parashikuar. Sipas një raporti të GlobalData, tregu global i komunikimit taktik vlerësohet të rritet me një CAGR prej 3,68% në 18,8 miliardë dollarë deri në vitin 2031. Në të njëjtin vit, tregu global i luftës elektronike do të jetë me vlerë 11,8 miliardë dollarë.

Komunikime inovative për fushën e betejës së ardhshme

Teknologjitë e provuara si LiDAR për gjurmimin, zbulimin dhe hartimin taktik të objektivave me teknologji të tjera komunikimi si radiot, sistemet satelitore dhe rrjetet e të dhënave po i mundësojnë personelit ushtarak të komunikojë në mënyrë efektive dhe të koordinojë operacionet.

Sistemet e komunikimit dixhital ofrojnë kanale më të qarta dhe më të besueshme. Lidhja me dronë zgjeron më tej fushën e komunikimit dhe informacionin e disponueshëm gjatë operacioneve. Sistemet dixhitale gjithashtu mund të transmetojnë dhe analizojnë vëllime më të larta të të dhënave sesa sistemet analoge – por gjithashtu mund të jenë më të prekshëm ndaj një sulmi kibernetik, kështu që kërkojnë nivele të larta të kriptimit. Për më tepër, sistemet e përdorura në fushën e betejës duhet të jenë mjaftueshëm të fuqishme për t'i bërë ballë mjediseve ekstreme.

Ndërsa luftimet moderne bëhen më të bazuara në teknologji, forca të ndryshme të mbrojtjes kombëtare po investojnë në komandë, kontroll, komunikim, kompjuterë, sisteme të inteligjencës, mbikqyrjes dhe zbulimit (C4ISR) dhe sistemeve të komandës dhe kontrollit (C2).

Në vitin 2022, Ushtria Britanike porositi "L3Harris" të ndërtojë dhe furnizojë 1,300 Radio Multi-Mode (MMR) për 109 milion dollarë për të përmirësuar ndërveprueshmërinë midis ushtrisë dhe aleatëve të saj. Ministria Britanike e Mbrojtjes (MoD) thotë se MMR-të do të rrisin ndjeshëm komunikimet në fushën e betejës. Përveç kësaj, transportueshmëria e lartë e njësive dhe jetëgjatësia e gjatë e baterisë do të ndihmojnë në mbrojtjen e kanaleve të komunikimit gjatë operimeve në vende të largëta.

Në mënyrë thelbësore, përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) dhe mësimi i makinerive parashikohen gjerësisht për të transformuar të ardhmen e komunikimeve ushtarake. Në fillim të këtij viti, Ushtria Amerikane njoftoi planet për të investuar më shumë se 200 milionë dollarë në AI dhe mësimin e makinerive, dhe mbi 9.8 miliardë dollarë



në modernizimin e rrjetit. Inteligjenca artificiale mund të përdoret gjithashtu nga forcat armiqësore dhe kërcënime të tilla, dhe zhvillimi i saj po monitorohet dhe menaxhohet me kujdes. Megjithatë, aftësia e teknologjisë për të analizuar vëllime të gjera të dhënash me shpejtësi të lartë dhe për të parashikuar skenarë të shumtë brenda sekondave do të thotë se përdorimi i saj mund të jetë i paçmuar për komunikimet nga forcat e armatosura.

Ndërtimi i komunikimeve elastike për operacionet ushtarake

Sistemet e komunikimit ushtarak do të vazhdojnë të operojnë shpesh në mjedise armiqësore që mund të shkaktojnë ndërhyrje në sinjal, duke çuar në zvogëlimin e rrezes dhe reduktimin e kapacitetit për të komunikuar. Operacione të tilla kërkojnë sisteme komunikimi të ndërveprueshme që ofrojnë vendosje të shpejtë dhe rikonfigurim të lehtë për t'iu përshtatur kërkesave operacionale në ndryshim. Aftësia për të krijuar dhe mbajtur lidhje komunikimi ndërsa jeni në lëvizje është thelbësore për ruajtjen e ndërgjegjësimit dhe koordinimit të situatës.

Në një skenar të tillë, kabllo dhe lidhësit janë kritikë në komunikimet ushtarake, sepse ato ofrojnë infrastrukturën fizike për dërgimin e sinjaleve dhe të dhënave ndërmjet pajisjeve dhe sistemeve të komunikimit.

Kabllo dhe fuqishme dhe të besueshme mund të sigurojnë transferim efikas të sinjaleve të zërit, të dhënave dhe video. Kjo lejon integrimin e komponentëve të ndryshëm si radiot, antenat dhe терминаlet e të dhënave, duke ndërtuar një rrjet të unifikuar komunikimi.

Komunikimi i sigurt i të dhënave me valë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ushtrinë. Komunikimi i detyrës kritike është kyç.

Brenda aplikacioneve operative, komunikimi i misionit kritik – duke përfshirë komunikimin kritik të tipit të makinës (cMTC) – është thelbësor. Kjo përfshin sigurimin e funksionalitetit të nevojshëm, një shkallë të lartë qëndrueshmërie, sigurie, mbrojtjeje të të dhënave dhe sigurimin e kohëzgjatjes së lartë në operatorët ekzistues me valë si LTE dhe 4G me bazë IP. Megjithatë, në përputhje me rritjen e dixhitalizimit, automatizimit dhe autonomimit, është thelbësore

që ushtria të mund të shfrytëzojë gjithashtu teknologji të reja si komunikimi celular i gjeneratës së pestë. Kjo do të thotë, se 5G nuk është një teknologji në vetvete, por është një grup kërkesash.

Shpejtësi të larta dhe vonesë të ulët në rrjetin 5G

Shpejtësia 5G prej 10 gigabit për sekondë, vlerësohet të jetë 100 herë më e shpejtë se 4G. Dhe vonesa teorike e teknologjisë prej vetëm disa të mijta të sekondës (1 ms) është 400 herë më e shpejtë se sa hap e mbyll sytë...

Terminologjia 5G pëlqen të flasë për URLLC (ose komunikime ultra të besueshme me vonesë të ulët). Vonesa e ulët arrihet ndër të tjera me ndihmën e të ashtuquajturit "Edge computing", ku përpunimi i të dhënave dhe gjenerimi i të dhënave (treguesit sistematikë, tendencat dhe të dhënat e performancës) ekzekutohet sa më afër që të jetë e mundur me pikat përfundimtare, duke përfshirë sensorët dhe efektorët, ku këto mund të shkëmbejnë të dhëna me njëri-tjetrin në nivel lokal me kohë pritje praktikisht zero.

IoT në fushën ushtarake; IoMT

Tashmë jemi shumë të njohur me shprehjen Internet of Things", i ashtuquajturit IoT ose IIoT (Internet Industrial of Things), ndërsa zhargoni ushtarake ndërkombëtar flet për Internet of Military Things (IoMT) ose Internet of Battlefield Things (IoBT).).

Cilido qoftë termi që përdoret, thelbi është i njëjtë: pajisje inteligjente që flasin me njëra-tjetrën dhe rrethinat e tyre në domenet e tyre kibernetike nëpërmjet internetit. Në këtë mënyrë, ju mund të mblidhni, përpunoni dhe interpretoni të dhëna, si dhe të kontrolloni pajisjet dhe sensorët nga distanca. Për ushtrinë, bëhet fjalë për shkrirjen e sensorëve; bashkimi dhe analizimi i të dhënave nga pajisjet dhe sensorët si kamerat e vëzhgimit, sensorët e zbulimit, stacionet bazë dhe portat, telefonat inteligjentë, radiot dhe nyjet e komunikimit, dhe jo më pak nga të gjitha automjetet dhe dronët me njerëz dhe autonome.

Bazuar në këtë informacion, gjenerohen modele dhe të dhëna të përdorshme në kohë reale për logjistikën dhe kontrollin e zonës, inteligjencën dhe ndërgjegjësimin e situatës, komandimin dhe kontrollin dhe në fund mbrojtjen aktive të njësisë dhe bazave luftarake. Me veçoritë dhe kapacitetet e ofruara nga teknologjia 5G, ne mund të bëjmë një hap gjigant përpara dhe (siç u përmend më parë) ushtria mund të mblodhë IoMT-në e tyre së bashku në një pjesë të dedikuar, me algoritme dhe procedura të fuqishme sigurie, dhe ku veçoritë dhe shpejtësia në kohë reale e teknologjisë 5G (me performancë në përputhje me fibrat optike) nënkuptojnë cilësinë e garantuar të shërbimit (QoS).

E gjithë kjo do të thotë se ushtria mund të përfitojë sa më shumë nga inteligjenca artificiale (AI), realiteti virtual (VR) dhe realiteti i avancuar (AR). Ata gjithashtu mund të reagojnë ndaj situatave emergjente dhe të kontrollojnë dronët dhe anijet - individualisht ose në grupe - në kohë reale përmes rrjetit celular.

Infrastruktura, cënueshmëria dhe diapazoni i frekuencës

Ka pasur gjithashtu një debat të madh rreth 5G dhe cënueshmërisë së tij, jo më pak në lidhje me pajisjet radio dhe komponentët kryesorë për rrjetin bazë 5G nga kompania kineze "Huawei". Disa vende kanë zgjedhur të ndalojnë teknologjinë kineze nga infrastruktura e tyre kritike, themelet dixhitale të kombit. Kompanitë më të mëdha të telekomunikacionit në Norvegji kanë vendosur gjithashtu kundër "Huawei-it" që nga hyrja në fuqi e Aktit të ri Norvegjez të Sigurisë në 2019. Bëhet fjalë gjithashtu për atë se çfarë diapazoni të frekuencës do të përdoret ushtria. Në Evropë, ekzistojnë tre të ashtuquajtura banda pioniere 5G, dy prej të cilave bien nën Gamën e Frekuencës 1 (<6 GHz), veçanërisht brezi i ulët (700 MHz-2.3 GHz) dhe brezi i mesëm (3.5 GHz). E treta bie nën Gamën e Frekuencave 2 dhe

shpesh quhet valë milimetrike ose brezi i frekuencës së lartë (26 GHz+).

Ka mundësi dhe kufizime, avantazhe dhe disavantazhe për brezat e ndryshëm të frekuencave, duke përfshirë edhe përdorimin e ardhshëm të ushtrisë. Brezi i ulët, i njohur në Norvegji si rrjeti kombëtar, karakterizohet nga një shkallë e lartë qëndrueshmërie dhe rritje e mbulimit të zonës. Megjithatë, nuk është veçanërisht i shpejtë në krahasim me dy grupet e tjera. Brezi i mesëm trajton vëllime më të mëdha të dhënash dhe zakonisht ndërtohet në zonat periferike. Brezi i frekuencës së lartë karakterizohet si super i shpejtë, por vetëm në distanca të shkurtra, që do të thotë se kërkon një densitet të lartë qelizash dhe përdorim të gjerë të përsëritësve (valët milimetrash pësojnë dobësim të konsiderueshëm ose bllokohen plotësisht nga muret e ndërimit dhe pengesat fizike dhe absorbohen në atmosferë).

Ushtria ka aplikime në të gjitha brezat e frekuencave

Asnjë ushtri nuk mund të mbështetet vetëm në frekuencat e huazimit nga operatorët komercialë, dhe në vend të kësaj duhet të jetë në gjendje të krijojë dhe menaxhojë mbulimin e vet aty ku është e nevojshme. Organizatat ushtarake gjithashtu kuptojnë se frekuencat brenda të tre gamave janë të dobishme, por për aplikime të ndryshme. Frekuencat në brezin e ulët janë të dobishme për zgjidhjet me brez të gjerë dhe linjat taktike të radios (jashtë zonave të ndërtuara ku rreziku i ndërprerjeve të WiFi është më i ulët).

Në brezin e mesëm, ushtria tashmë ka licenca ekzistuese për instalimet e radarëve dhe varet nga marrja në konsideratë e këtyre frekuencave në vijimësi. Ekzistojnë gjithashtu pjesë të kësaj game që janë me interes për ushtrinë në lidhje me teknologjinë e antenave të përcaktuara nga grupi dhe drejtimi (MIMO/formimi i rrezeve) dhe zbulimi i dronëve 5G (radari shumë statik). Brezi i mesëm përdoret gjithashtu gjerësisht në SHBA për radarët, mbrojtjen raketore, luftën elektronike dhe monitorimin e hapësirës ajrore.

Megjithatë, Departamenti Amerikan i Mbrojtjes (DoD) miratoi kohët e fundit frekuencat 3.4 dhe 3.5 GHz për të ndihmuar kompanitë kombëtare të teknologjisë të konkurrojnë me Kinën. Së fundi, brezi i frekuencës së lartë është interesant për Forcat e Armatosura për sa i përket komunikimit me karta ultra-broadband në baza dhe seli, për sensorë të shpërndarë që kërkojnë shumë komunikim të të dhënave dhe për teknologjinë satelitore 5G.

Pavarësisht nga diapazoni, pasja e frekuencave të veta të dedikuara dhe të harmonizuara do t'i lejojë ushtrisë të zhvillojë zgjidhje teknologjike të reja, të fuqishme dhe të sigurta për aplikime administrative dhe operacionale.

Pa 5G, ne nuk mund të shfrytëzojmë plotësisht potencialin e teknologjive të reja

Ekziston gjithashtu një debat i ndezur brenda NATO-s në lidhje me cënueshmërinë, infrastrukturën dhe gamën, por ajo që është e sigurt është se pa komunikimin 5G do të ishte pothuajse e pamundur të shfrytëzohen plotësisht mundësitë e ofruara nga të dhënat e mëdha, inteligjenca artificiale dhe përpunimi i cloud në fushën ushtarake dhe sektorë të tjerë. E njëjta gjë vlen edhe për marrjen e efektit të kapacitetit të plotë nga platformat e teknologjisë së lartë siç është avioni me shumë role F35 në të ashtuquajturat operacione me shumë domene ku informacioni i situatës nga Toka, Deti, Ajri dhe Hapësira përpunohet në një domen të pestë - domeni kibernetik - duke na lejuar të reagojmë duke kombinuar efektorët nga këto fusha. Ushtria duhet të jetë më e mira në përdorimin e teknologjisë dhe kjo duhet të arrihet përmes një shkalle të lartë të kompetencës së pavarur teknologjike dhe bashkëpunimit midis ushtrisë dhe agjencive qeveritare.

Për ju që jeni si unë, Grua...

Gratë më të famshme të botës, si këngëtare, aktore, fituese të çmimit “Nobel” kanë për të thënë diçka për mua, ty, ne. Fjalët janë një forcë e fuqishme. Ato mund të ndryshojnë historinë, të mobilizojnë ushtritë dhe të fillojnë revolucionet.

Gra që në rrugëtimin e tyre janë përplasur fort pas toke, por ia kanë dale të ngrihen dhe me kokën lart janë përballur me erëra të forta, duke i bërë sfidë gjithçkaje dhe gjithkujt që përpiqet të ndalojë misionin e saj për jetën, që jeta të jetojë”.

Disa prej mesazheve të grave që jeta i sfidoi në dimensione të ndryshme.



Malala Yousafzai, aktiviste dhe fituese e çmimit “Nobel”, 2014:

“Ne nuk mund të kemi sukses, kur gjysma prej nesh pengohen të ecin përpara.”



Gillian Anderson, aktore dhe aktiviste

“Feminizmi nuk ka të bëjë me rritjen profesionale të grave, ato (gratë) janë tashmë të forta, por është ndryshimi i mënyrës se si bota e percepton këtë forcë.”



Annie Lennox, këngëtare dhe aktiviste politike

“Ne të gjithë luftojmë mbi atë që ka etiketën 'feminizëm', por për mua ka të bëjë me fuqizimin. Nuk ka të bëjë me të qenit më të fuqishëm se burrat, ka të bëjë me të drejtat e barabarta në mbrojtjen, mbështetjen, drejtësinë. Bëhet fjalë për gjëra shumë themelore. Nuk është një simbol sikundër një artikull i modës”.



Bette Davis, aktore

“Kur një burrë jep mendimin e tij ai është një zotëri. Kur një grua jep mendimin e saj, për fat të keq shpesh quhet e përdalë.”



Madeleine Albright, politikane

“Ka një vend të veçantë në ferr për gratë që nuk ndihmojnë gratë e tjera.”



Rebecca West, shkrimtare

“Unë vetë nuk kam qenë në gjendje të zbuloj saktësisht se çfarë është feminizmi. Unë vetëm e di se njerëzit më quajnë feministe sa herë që unë shpreh ndjenja që më dallojnë nga një çerdhe.”



Kate Nash, këngëtare

“Feminizmi nuk është fjalë e ndyrë, por mbi të gjitha barazi.”



Hillary Clinton, politikane

“Unë besoj se të drejtat e grave dhe vajzave janë biznesi i papërfunduar i shekullit të 21-të.”



Michelle Obama, ish-zonja e parë e Amerikës

“Asnjë vend, kurrë nuk mund të lulëzojë me të vërtetë, nëse e mbyty potencialin e grave të tij dhe i privon vetes kontributet e gjysmës së qytetarëve të tij.”



Beyoncé, këngëtare

“Kush e drejton botën? Vajzat!”



Angelina Jolie, aktore dhe aktiviste

“Gratë ende trajtohen si çështje dytësore. Është akoma shumë e pranuar që udhëheqësit injorojnë të vërtetat e pakëndshme... Gratë, ne e dimë, janë të parat që preken nga lufta dhe të fundit që duhet marrë parasysh kur mbaron.”

Maya Angelou, shkrimtare

“Unë jam feministe. Unë jam një femër dhe do të ishte budallallëk po të mos isha në anën time.”



Antonella Gambotto-Burke, gazetare

“Vetëm nëpërmjet vajzës sime kam arritur të kuptoj se një jetë pa feminitet - pa mister, emocion, butësi dhe forcën e brendshme e dashurinë e gruas, nuk është aspak jetë.”



MBROJTJA

REVISTA

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikimet/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja)



LAVDI
Ë HERMËTSHMË
DËSHKONËVE